


HYRJE NË ISLAM

Muhamed Hamidullah



© LOGOS·A
SHKUP
PRISHTINË
TIRANË
2011

Muhamed Hamidullah

HYRJE NË ISLAM

Boton: Logos-A

Biblioteka: Botime të veçanta

Për botuesin: Adnan Ismaili

Kryeredaktor: Husamedin Abazi

Redaktor biblioteka: Afrim Gashi

Redaktor gjuhësor: Nazif Zejnullahu

Redaktor artistik & disenji: Edi Agagjyshi

Redaktor teknik: Halil Berisha

Përgatitja kompjuterike: Focus Pro - Shkup

Shtypi: Focus - Shkup

Copyright©Logos-A, 2011

ISBN 978-9989-58-385-8

www.logos-a.com.mk

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jofitimprurës.

Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit

apo edhe për afirmim të kulturës së leximit në përgjithësi.

*Por, nuk lejohet riprodhimi, transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi
pa lejen paraprake të Logos-A.*


HYRJE NË ISLAM

Muhamed Hamidullah

*Titulli në boshnjakishte:
Muhamed Hamidullah, "Uvod u islam", Sarajevo, 1989*

*Përkthyen:
Bahri Aliu & Neshat Xheladini*

Botimi i dytë



© LOGOS A
S H K U P
PRISHTINË
T I R A N Ë
2 0 1 1

Përmbajtja:

<i>Disa fjalë lexuesit</i>	11
<i>Shënime mbi autorin</i>	13
<i>Hyrje</i>	17
<i>Arabia</i>	19
<i>Religjioni</i>	20
<i>Shoqëria</i>	21
<i>Lindja</i>	22
<i>Rendi trimërues</i>	23
<i>Paraqitja e ndërgjegjes religjioze</i>	24
<i>Shpallja</i>	25
<i>Misioni</i>	27
<i>Bojkot shoqëror</i>	28
<i>Miraxhi</i>	29
<i>Shpërngulja në Medinë</i>	30
<i>Riorganizimi i shoqërisë</i>	32
<i>Lufta kundër padurueshmërisë dhe mosbesimit</i>	33
<i>Pajtimi</i>	35
<i>Ruajtja e besimeve burimore</i>	41
<i>Mënyra e ruajtjes</i>	42
<i>Burimet e Islamit</i>	43
<i>Historia e Kur'anit</i>	44
<i>Përmbajtja e Kur'anit</i>	52
<i>Hadithi</i>	55
<i>Dokumente zyrtare</i>	57
<i>Kompilimi në kohën e Pejgamberit</i>	61
<i>Redaktimet nga koha e shokëve të Pejgamberit (a.s.)</i>	63
<i>Ndalimi i shkrimit të hadithit</i>	66

- Në shekujt e mëvonshëm* 68
- Koncepti i jetës* 73
- Ideologjia islame* 76
- Besimi tek Allahu (xh. sh.)* 81
- Shoqëria* 83
- Kombësia* 84
- Jeta ekonomike* 85
- Liria e vullnetit dhe fati* 87
- Njeriu dhe besimet e tij* 93
- Allahu (xh. sh.)* 95
- Engjëjt (melaqet)* 98
- Librat e shpallur* 104
- Pejgamberët e Zotit* 106
- Eskatologjia (ringjallja)* 107
- Përcaktimi dhe dëshira e lirë* 111
- Përfundim* 113
- Kryerja e detyrave fetare* 117
- Namazi* 118
- Agjërimi* 126
- Haxhi* 130
- Zeqati* 134
- Përfundim* 141
- Kujdesi për jetën shpirtërore* 145
- Sofa* 148
- Thelbi i misticizmit* 149
- Simpatia e Zotit* 152
- Aktet e veçanta* 157
- Përfundim* 161
- Etika islame* 165
- Pikat karakteristike të Islamit* 167
- Themelet e moralit* 168

- Mëkati dhe falja e tij* 173
Ndalimet 176
- Sistemi politik në Islam* 185
- Nacionalizmi* 185
Mjetet për realizimin e universalitetit 188
Historia e halifatit 191
Funksionimi i shtetit islam 195
Forma e sundimit 196
Këshillimi dhe kontakti me popullin 197
Politika e jashtme 199
- Sistemi juridik islam* 209
- Kontributi i veçantë i muslimanëve* 209
Shkenca juridike 209
Motivi (qëllimi) dhe vepra 210
Kushtetuta e shkruar 210
E drejta e përgjithshme ndërkombëtare 211
Karakteristikat kryesore të drejtësisë islame 212
Filozofia e së drejtës 214
Sanksionet 215
Legjislatura 217
Gjykatat 222
Burimi dhe zhvillimi i së drejtës 223
Përfundim 231
- Sistemi ekonomik në Islam* 235
- Të trashëguarit* 239
Testamenti 241
Pasuria publike 242
Shpenzimet shtetërore 243
Tatimet e jashtëzakonshme 248
Sigurimet shoqërore 248
Lojrat e fatit 252

- Huaja me interes* 253
Statistika 255
Jeta e përditshme 255
Gruaja muslimane 259
 Vërejtje të përgjithshme 259
 Detyrat e gruas 261
 Të drejtat e gruas 267
Pozita e jomuslimanëve në shtetin islam 277
 Burimi hyjnor i detyrave 278
 Parimet themelore 279
 Praktika e Pejgamberit (a.s.) 280
 Praktika e mëvonshme 284
 Autonomia shoqërore 286
 Kthimi 292
 Lufta e shenjtë 293
Kontributi i muslimanëve në shkencë e në art 297
 Qëndrimi i përgjithshëm 297
 Shkencat fetare dhe filozofike 300
 Shkencat shoqërore 302
 Drejtësia 303
 Fikhu 304
 Historia dhe sociologjia 306
 Gjeografia dhe topografia 308
 Astronomia 310
 Shkencat natyrore 311
 Shkenca e medicinës 312
 Optika 313
 Mineralogjia, mekanika e të ngjashmet 313
 Zoologjia 314
 Kimia dhe fizika 314
 Matematika 315

- Arti 316
 Historia e përgjithshme islame 325
 Halifët ortodoksë 325
 Emevijët 330
 Abasijët 332
 India 335
 Halifati andaluzian 338
 Lindja dhe juglindja e Azisë 339
 Afrika 340
 Bota e sotme 341
 Jeta e përditshme e muslimanit 345
 Lindja 345
 Fillimi i jetës 347
 Zeqati 350
 Martesa 352
 Vdekja 352
 Zakonet e përgjithshme 353
 Ngrënia dhe pija 355
 Teshat dhe frizura 357
 Falja e namazit 357
 Disa veçori 362
 Ndryshimet në mes ca shkollave 363
 Namazi i istihares (lutja për udhëzim) 365
 Pengesat në namaz 365
 Vërejtje e përgjithshme 366
 Namazi i xhenazes 367
 Sëmundja dhe udhëtimi 367
 Koha e namazit 368
 Pse namazi kryhet vetëm në gjuhën arabe 372
 Pse një kalendar i pastër lunar 379
 Përfundim 381

Disa fjalë lexuesit

Me rastin e përkthimit të kësaj vepre në gjuhën shqipe, e pamë të arsyeshme që t'i themi disa fjalë lexuesit si për veprën që me të drejtë zë vend nderi në historiografinë arabe e më gjerë, po ashtu edhe për autorin e saj, që konsiderohet si njëri ndër njohësit më të spikatur të Historisë islame, të cilën gjë e dëshmojnë dhjetëra vepra kapitale, si dhe një varg trajtesash, esesh, studimesh nga baza e besimit islam.

Edhe përkthimi i kësaj vepre të dr. Muhamed Hamidullahut në gjuhën shqipe është një sihariq i madh, kur dihet se veprat e tij janë përkthyer në gjuhë të ndryshme të botës dhe kanë pasur jehonë të madhe.

Jo vetëm tema e qëlluar, por edhe mënyra e mbarështrimit, plot koncizitet, në të cilën janë ngjizur aftësi kreative dhe invenca krijuese mahnitëse e këtij dijetari që opinionit lexues t'i ofrojë një vepër si kjo, e cila përmban të dhëna të bollshme mbi bazat e fesë islame, madje edhe për kulturën dhe historinë islame nëpër etapa të ndryshme historike.

Me rastin e përkthimit shqip, jo vetëm që i bëjmë një nder autorit të kësaj vepre, por edhe ne, si lexues, jemi të nderuar prej tij, duke i begatuar njohuritë tona me brumin e ideologjisë islame.

“Hyrje në Islam” me plot të drejtë mund të konsiderohet një enciklopedi e vogël mbi Islamin dhe ja-

shtë – zakonisht e përshtatshme për çdo lexues që dëshiron të njihet me aspektet e mendimit islam.

Duke marrë parasysh se lexuesve tanë u ka munguar një literaturë e këtillë, me gjithë vështirësitë e shumta, kur dihet se pas botimit të Kur'anit (a. sh.) në gjuhën shqipe përkthimi i kësaj vepre shënon hapat e parë në këtë drejtim. Është e natyrshme se kanë mundur të na përvidhen gabime dhe lëshime natyrash të ndryshme, por duhet të theksojmë se gjatë përkthimit në përpikëri i jemi përmbajtur përkthimit në gjuhën serbokroate, e në këtë gjuhë nga anglishtja. Duhet pasur parasysh se një përkthim si ky, kur origjinali as që është përfillur, edhe neve na ka penguar shumë në punën tonë pasi shumë konstrukte fjalish as për së afërmi nuk i përshtaten natyrës së gjuhës shqipe. Në këtë mënyrë është lënduar edhe stili i rrjedhshëm i dr.M.Hamidullahut.

Në fund, dëshirojmë që kjo vepër të përmbushë, bile, për së afërmi një kërkesë permanente të kohës: të shërbejë si lektyrë me vlerë për njohjen e bazave të fesë islame dhe për ngritjen e personalitetit musliman në dritën e burimeve islame: Kur'anit dhe Hadithit.

Me këtë rast na mbetet t'i shprehim mirënjohje të thella Kryesisë së Bashkësisë Fetare Islame në RM–Shkup, për iniciativën e botimeve të veprave të këtilla fetare dhe shpresojmë se edhe në të ardhmen do të vazhdojë këtë veprimtari dhe do të na ofrojë vepra të këtilla me vlerë. E falënderojmë Kryesinë për ndihmën e parezervë edhe në botimin e kësaj vepre. Iu jemi mirënjohës edhe të gjithë shokëve që na ndihmuan që kjo vepër të dalë në dritë.

Përkthyesit

Tetovë, Ramazan 1405/Qershor 1985

Shënime mbi autorin

Dr. Muhammed Hamidullah është i lindur më 1908 në Hajdarabad. Pasi kreu studimet universitare në vendlindje, doktoroi filozofinë në Bon, kurse letërsinë në Paris.

Veprimtaria e tij botuese e fjalës së shkruar fillon më 1924, ashtu që deri në fund të vitit 1981 kjo veprimtari tejkaloi mbi 700 artikuj të publikuar, ese, studime dhe dhjetëra vepra voluminoze. Gjer tani veprat e tij janë përkthyer në 18 gjuhë, ndërsa më të rëndësishmet janë: *“Diplomacia islame në kohën e Pejgamberit (a.s.) dhe të katër Halifëve të parë”*, *“Jetëshkrimi i Muhamedit (a.s.)”*, *“Hyrje në Islam”*, *“Haxhi në Mekë”*, *“Pse agjërime?”* etj.

Rëndësi të veçantë kanë punimet e tij nga historia islame, siç janë: *“Luftërat gjatë kohës së Pejgamberit (a.s.)”*, *“Letrat e Pejgamberit (a.s.) për Heraklitin”*, *“Bankat pa kama-të”*, *“Letrat origjinale të Pejgamberit (a.s.) për Kisrain”*, *“Raporti midis fesë dhe drejtësisë në Islam”*, *“Islami dhe Krishterimi”*, *“Kontributi i muslimanëve në shkencat historike”* etj.

Dr. Hamidullah si profesor i së drejtës ndërkom-bëtare ka mbajtur 14 vjet ligjërata në Hajdarabad dhe kur Hajdarabadi iu bashkangjiti Indisë, u shpërngul në Francë.

Edhe sot e kësaj dite jeton¹ në Francë dhe aktivi-sht vepron në Qendrën Kombëtare për Hulumtime

¹ Muhammed Hamidullahu ka ndërruar jetë më 17 dhjetor 2002. Redaksia.

Shkencore në Paris (CNRS), e cila i takon Ministrisë Kombëtare të Arsimit. Një kohë të gjatë mbante ligjë-rata të herëpashershme në shumë universitete: në Sta- mboll, ndërsa si mysafir në Ankara, në Konjë, në Kaj- ser, në Erzerum, në Këln, në Gotingen, në Bon, në Ku- ala-Lumpur, në Rijad, në Kolombo etj.

Kreu I

Hyrje

Në historinë botërore është i madh numri i atyre që jetën ua kanë kushtuar reformave shoqërore dhe zhvillimit fetar të popujve të vet. Këta reformatorë i hasim në të gjitha epokat dhe në të gjitha vendet. Në Indi janë ata që predikuan Vedën, atje gjendet edhe Buda i madh; Kina e ka Konfuçien e vet; Irani i ka reformatorët e vet që ia sollën Zen-Avestën; Babiloni ka dhënë një ndër rilindasit më të mëdhenj, Ibrahimin (a.s.) (e të mos flasim për paraardhësit e tij, Evnoshin dhe Nuhin); hebrenjtë mund të mburren me mjaft rilindas, ndër të cilët janë: Musai, Davudi, Sulejmani, Isai (a.s.) etj.

Dy gjëra duhet theksuar: të gjithë rilindasit janë thirrur në misionin e Zotit; kurse librat e shenjtë, që përmbanin rregulla të edukatës njerëzore, janë konsideruar si vepra të dërguara prej Zotit. Nga ana tjetër, luftërat vëllavrasëse, porosi të Zotit, që ato të humben krejtësisht. Fletushkat (suhufet) e Ibrahimit njihen vetëm sipas emrit. E sa i përket Librit të Musait (a.s.), ai shpesh ka qenë i shkatërruar dhe vetëm pjesërisht është ripërtërirë.

Nëse gjykojmë sipas mbeturinave më të vjetra të homosapiensit, njeriu gjithmonë ka qenë i ndërgjegjshëm se ekziston Qenia e përsosur, Zoti – Krijues i gjithçkasë . Pa marrë parasysh se lutjet kanë ndryshuar, njerëzit gjithmonë janë munduar që t'i nënshtrohen Allahut (xh. sh.), ndërsa dëshira e tyre që t'i

kryejnë detyrat ndaj Tij ka ngelur e pandryshuar. Gjithashtu, për një numër tejet të vogël njerëzish me urtësi të lartë e fisnike, të cilët ishin të ngarkuar me misionin hyjnor që ta udhëheqin popullin e vet kah porosinë e Allahut (xh. sh.) drejtuar përmes tyre, ka ekzistuar mundësia e kontaktimit direkt dhe gjithçka që është prezente dhe e padukshme me Allahun (xh. sh.). Ky kontakt a ka qenë në formë trupore apo është realizuar përmes inspirimit ose Shpalljes, qëllimi kryesor në çdo rast ka qenë udhëheqja e popullit. Është gjë e natyrshme që interpretimi i disa sistemeve morale të tregohet më vital dhe më bindës se sa të tjerët. Çdo sistem i mendimit metafizik, çdo religjion ka konceptet dhe shpjegimet e veta dhe është normale që para urtësisë disa koncepte dhe shpjegime të qëndrojnë më mirë nga të tjerat.

Jemi kah fundi i shekullit të gjashtë pas lindjes së Isait. Në atë kohë ka pasur religjione që haptazi proklamonin se ato janë të dedikuara vetëm për raca dhe grupe të veçanta njerëzish, duke lënë pjesën tjetër të njerëzimit pa ndihma nga e keqja që e ka goditur. Religjionet tjera, në realitet, insistojnë në univiersalitet, por ato konsiderojnë se shpëtim do të ketë vetëm ai njeri i cili iu shmanget të gjitha kënaqësive të kësaj bote. Ky lloj koncepti ka hasur në mirëkuptim vetëm te një numër i kufizuar i njerëzve. Më në fund, në vendet tjera mbretëron mosbesimi, materializmi në përgjithësi, ndërsa mungesa e çdo religjioni në këto vende solli gjer tek ajo që të mendohet vetëm për kënaqësitë personale, duke mos u kujdesur për nevojat e të tjerëve.

Arabia

Në hemisferën “më të madhe” (e cila ka më tepër tokë se ujë, d.m.th. në hartën e Evropës, Azisë dhe Afrikës, të njohur me emrin “Bota e Vjetër”), Gadishulli Arabik gjendet në mes. Kjo hapësirë e madhe shkretinore ishte njëkohësisht e banuar nga nomadët dhe bujqit, të cilët shpesh i takonin të njëjtit fis, të cilët i kishin ruajtur lidhjet familjare dhe dalloheshin krejtësisht për nga mënyra e jetesës. Mjetet jetësore i kishin të pakëta, ngase territori është më shumë shkretëtirë; tregtia ishte diçka më e zhvilluar në krahasim me bujqësinë ose industrinë. Banorët e këtyre fiseve shpesh udhëtonin jashtë Gadishullit, si në Siri, Egjipt, Irak, Indi dhe Etiopi.

Pak është ditur për lihamitët, që jetonin në Arabinë Qendrore, kurse vetëm Jemeni kishte plot të drejtë të quhej “Arabia e Lumtur”, pasi që ishte atdhe i civilizimeve të shndritshme sabe, muine, bile edhe para themelimit të Romës. Jemenasit ishin të aftë të pushtojnë territore nga Bizanti dhe Persia. Pas një kohe, Jemeni ndahet në principata; dikur ra nën sundimin e sasanidëve, kurse pjesa lindore e gadishullit i takonte Mbretërisë persiane.

Trazirat sociale – politike në Ktesifon patën jehonë në krahinat e pushtuara. Veriu i Arabisë nën Bizantin nuk dallohej shumë prej atij nën persianët, kurse vetëm Arabia qendrore ngeli e paokupuar nga të huajt.

Në atë qendër, trekëndëshi Mekë-Taif-Medinë ka qenë diçka më specifik. Meka, një vend shkretëtire, ku nuk rriten asfarë bimësh, fizikisht paraqet Afrikën dhe shkretëtirën e nxehtë të Saharasë; vetëm 74 kilometra më larg, Taifi paraqet Evropën me akullnajat e saj; Medina, në veri, nuk është më pak pjellore prej vendeve të Azisë; sikur Siria etj. Ky trekëndësh, i shtrirë në një hemisferë të gjerë paraqet në miniaturë tërë botën, më së shumti se çfarëdo vendi tjetër. Me prejardhje prej Ibrahimit (a.s.) (Babiloni), përmes Haxheres (egjiptase), Muhamedi (a.s.) i lindur në Mekë, dajët i kishte në Medine dhe Taif.

Religjioni

Populli arab për nga feja ishte idhujtar; të rrallë ishin ata që përqaftuan atë që ishte Krishterizëm, Mazdeizëm etj. Mekasit dinin për njësinë e të vetmit Zot, por ata i adhuronin idhujt; e, çka është më interesant, nuk besonin në ringjallje e as në jetën e botës tjetër. Ruajtën haxhillëkun në Qabe, të vetmin tempull të Zotit. Pra, haxhillëku nis të përfillet nga paraardhësi i tyre, Ibrahimit (a.s.). Dy mijë vjet që i ndanin nga Ibrahimit (a.s.), bënë që haxhillëku të shndërrohet në panair tregtar, në idhujtari të keqe, pa kurrfarë ndikimi në sjelljet personale; si në jetën shoqërore, ashtu edhe në pikëpamje të moralit.

Shoqëria

Nga tri pikat e këtij trekëndëshi, Meka edhe pse nuk kishte begati natyrore, prapëseprapë ishte më e zhvilluar. Ajo ishte e organizuar si qytet – shtet në vete; udhëhiqej nga këshilli prej dhjetë anëtarëve, të cilët e trashëgonin pozitën. Këshilli vetë i ndante pozitat: ministër i Punëve të Jashtme, ministër i Mbrojtjes së Tempullit, ministër i Profetizimit, ministër i Sakrificave (kurbanëve të Tempullit), ministër që caktonte lartësinë e dëmshpërblimit në raste të fatkeqësive; mbikëqyrës i Këshillit, që miratonte vendimet etj., derisa të tjerët merreshin me çështjet ushtarake; të kalorësisë e të ngjashme. Kalorësit e shkathtë, banorë të Mekës, shpesh kanë ditur të përfitojnë të drejtën nga mbretëritë fqinje (si Irani, Bizanti, Etiopia etj.) për eksportimin dhe importimin e mallrave. Ata siguronin përcjellje me armë për të huajt kur kalonin në territoret arabe, me të cilët mekasit ishin aleatë. Edhe pse krijimtarisë së tyre nuk i jepnin formë të shkruar, atyre shumë u interesonte arti dhe letërsia: poezia, retorika, tregimet popullore. Gruaja ka qenë në pozitë të mirë: ka pasur të drejtën e pronësisë, ka dhënë pëlqimin për kurorëzim, ka mundur me kontratë të kurorëzimit të sigurojë të drejtën e shkurorëzimit, si dhe të martohet pas shkurorëzimit ose pas vdekjes së burrit. Kanë pasur zakon që t'i varrosin foshnjat femra, por kjo ishte traditë e disa klasave dhe këto raste ishin mjaft të rralla.

Lindja

Në një mjedis të tillë lindi Muhamedi (a.s.) 570 vjet pas Isait (a.s.). Babai, Abdullahu, vdiq disa javë para se të lindte Muhamedi (a.s.), kurse gjyshi i tij pranon të kujdeset për të sipas traditës; nëna e dërgon fëmijën në fshat te një mëndeshë (nënë tambli), ku Muhamedi (a.s.) kaloi disa vjet. Biografët pajtohen se Muhamedi (a.s.) ka thithur vetëm një rën të sisë, duke ia lënë tjetrën vëllait të vet të gjirit. Posa u kthye në shtëpi, me nënën e tij Eminën shkuan në Medine për ta vizituar varrin e Abdullahut: mirëpo, duke u kthyer, nëna i vdes. Pasi përjetoi këto dhimbje të rënda, në moshën 8-vjeçare kalon te mixha i tij, Ebu Talibi. Ky kishte shumë fëmijë dhe ishte shumë i varfër, kështu që nuk mund t'ia plotësonte Muhamedit (a.s.) të gjitha dëshirat. Mu për këtë shkak Muhamedi (a.s.) detyrohet si djalosh të punojë për të siguruar mjete për jetesë. Në këtë moshë ruan delet e kushërinjve të vet. Ndërkaq, si dhjetëvjeçar (me një karvan tregtar) e përcjell mixhën e vet për në Siri. Nuk përmenden udhëtime të tjera të Ebu Talibit, por sipas ca të dhënave, mund të ketë pasur dyqan në Mekë. Me sa shihet, Muhamedi (a.s.) i ndihmoi axhës së tij në të gjitha punët. Kur i mbushi 25 vjet, sinqeriteti i Muhamedit (a.s.) ishte i njohur për gjithkënd mirë. Një vejushë pasanike mekase – Hatixheja ia beson mallrat e saj për t'ia shitur në Siri. E kënaqur me fitimin që ia solli nga tregtia, si dhe e mahnitur me cilësitë e tij të

larta, i propozoi që të martohet me të (thuhet se atëbotë Hatixheja ka pasur 40 vjet). Martohet për Muhamedin (a.s.) në një panair në Habashah (Jemen) dhe njëherë në vendin Abdul-Kaidha (Bahrein – Oman). Është për të besuar se këtu fjala është për panairot e mëdha në Dabi ku, sipas Ibn Kelbit, tregtarët e Kinës, Indisë, Sindit, Persisë, Lindjes dhe Perëndimit, disa nëpërmjet të detit e disa përmes rrugës tokësore, vinin çdo vjet. Gjithashtu, bëhet fjalë për një mekas me emrin Saib, i cili e shoqëronte Muhamedin (a.s.) në tregti; të dy këta shokë udhëtonin dhe shitnin në shtete të huaja. Në lidhje me këtë Saibi deklaroi: Sa herë që Muhamedi (a.s.) kthehej me karvanin, ai më parë pastronte llogaritë me mua, pastaj shkonte në shtëpi, e kur kthehesha unë nga udhëtimi, ai më pyeste vetëm për shëndetin tim.

Rendi trimërues

Tregtarët e huaj shpesh binin mallra për t'i shitur në Mekë. Njëherë një jemenas (prej fisit zabit) shkroi një poemë satirike kundër mekasve, për arsye se disa nuk ia paguajtën mallin e marrë, madje askush nuk erdhi që t'i ndihmonte. Zubejri, axha i Muhamedit (a.s.), ishte kryetar i fisit. Ai u prek pa masë nga kjo vjershë satirike e arsyeshme.

Në marrëveshje me shefat e tjerë të qytetit, thërret një tubim, me ç'rast duhej të vendosnin rendin trimërues, për t'i mbrojtur të shkelurit në Mekë, pa marrë

parasysh a janë vendas ose të huaj. Muhamedi (a.s.), djalosh i ri, e përkrah me zemërgjerësi këtë vendim dhe shpesh thoshte: “Unë kam marrë pjesë në këtë (rend) dhe nuk do të isha tërhequr prej këtij rendi as për një karvan deveshë; përkundrazi, nëse dikush më thërret, unë edhe tash jam i gatshëm që në emër të atij rendi të orvatem për t’i ofruar ndihmë”.

Paraqitja e ndërgjegjes religjioze

Mbi jetën fetare të Muhamedit (a.s.) deri në moshën 35-vjeçare nuk dihet shumë. Sipas pohimeve të biografëve të tij, asnjëherë nuk i ka adhuruar idhujt. Të përkujtojmë, ka pasur shumë mekas që kanë bërë të njëjtën gjë. Ata nuk u pajtuan me paganizmin e verbër, por ngelën besnikë ndaj Qabesë, tempullit të cilin Ibrahim (a.s.) ia kushtoi Zotit të Madh. Rreth vitit 605 pas Isait (a.s.) digjet mbulesa e Qabesë, kështu që kjo ndërtesë nuk mund t’i përballonte shiut të pareshtur, ashtu që u shkatërrua në tërësi dhe brenda një kohe të shkurtër tempulli u rindërtua. Këtë aksion e ndihmuan të gjithë qytetarët sipas mundësive të tyre, duke pasur kujdes që të pranohen vetëm ato ndihma që janë fituar në mënyrë të lejuar e të ndershme. Shumica kryenin punën e muratorëve. Në rindërtim mori pjesë edhe vetë Muhamedi (a.s.), i cili u lëndua në shpatull duke bartur gur. Në Qabe gjendet një gur i zi, i cili sinjalizon tavafin (rrotullimin) rreth tij; është më se e sigurt se ky gur daton nga Ibrahim (a.s.) Kur

arritën të vënë gurin e zi në vendin e duhur, shpërtheu mosmarrëveshja midis qytetarëve; kush do ta kishte nderin ta vinte gurin në vendin e vet? Bile, erdhi tek ajo që të ngrihen shpatat. Dikush propozoi që vendimi t'i lihet profetizuesit: le të vendos ai që do të hyjë i pari. Papritmas u paraqit Muhamedi (a.s.). Erdhi të punonte sikurse që e kishte traditë. Ishte i njohur me pseudonimin El-Emin (besnik); pranuan paluhatshëm të gjykojë për ndodhinë. Muhamedi (a.s.) shtriu çarshafin, vendosi në të gurin e zi, thirri të gjithë kryetarët e fiseve që ta ngrenë gjer te vendi i vet. Dhe, ashtu vepruan. Të gjithë ngelën të kënaqur me këtë zgjidhje.

Prej këtij momenti Muhamedi (a.s.) fillon të meditojë për çështje shpirtërore. Sikurse edhe gjyshi i tij, ai filloi të tërhiqet gjatë muajit të Ramazanit në shpellën e Xhebeli Nurit (Kodra e Dritës), e njohur me emrin "Gar Hira", ku falej dhe thellohej në mendime, duke ndarë furnizimet e pakta që i kishte me udhëtarët që kalonin atypari.

Shpallja

I kishte mbushur të katërdhjetat. Ishte viti i pestë që Muhamedi (a.s.) largohej prej njerëzve një herë në vit. Kah fundi i Ramazanit i paraqitet melaqja e i cila erdhi ta vizitonte. Melaqja e lajmëroi se Allahu e ka zgjedhur për peygamber të vetin, përkushtuar njerëzisë; ia mësoi rregullat e namazit, si duhet t'i lutet

Allahut dhe në fund ia transmeton porosinë e Allahut:

“Në emër të Allahut, Bamirësit, Mëshirëplotit!

Lexo në emër të Zotit Tënd, që të ka krijuar.

Që krijoi njeriun prej gjakut të trashë.

Lexo! Zoti yt është më i Ndershëm.

Që të mësoi penën.

Që mësoi njeriun çka nuk ka ditur”.

(Kur'an: 96:1-5)

I tronditur, kthehet në shtëpi dhe ia përshkruan gruas së vet çka përjetoi. U frikësua se mos punohet për ndonjë magji (sihir) ose ndikim të shpirtërave të këqinj. Gruaja e tij e qetësoi duke i thënë: *Ti ke qenë gjithmonë i mëshirueshëm, zemërgjerë, ke ndihmuar të varfrit, të vejat, të gjithë ata që kanë pasur nevojë për ndihmë, prandaj Allahu të mbron nga çdo e keqe.* Pas kësaj ndërpritet Shpallja për një periudhë prej tre vjetësh. Kjo ndërprerje duhej të ishte për Muhamedin (a.s.) qetësim pas tronditjes së parë, pastaj dëshirë, pritje, mosdurim, që ditë pas dite të bëhej më i durueshëm e më i fortë. Ky lajm u përhap. Pabesimtarët e Mekës filluan ta tallnin, filluan ta ofendonin, disa e përqeshnin duke i thënë se Zoti e ka larguar.

Brenda këtyre tre vjetëve të ndërprerjes dhe të pritjes, Muhamedi (a.s.) i është dhënë ibadetit dhe koncentrimit shpirtëror. Shpallja përsëri filloi: Allahu e bindi Muhamedin (a.s.) se asnjëherë nuk e ka larguar, përkundrazi Ai e ka drejtuar në rrugë të drejtë, derisa ai kujdesej për jetimët dhe fukaratë; derisa proklamonte mirësinë e Allahut. (Kur'an: sure 93).

Ky është urdhër për misionin hyjnor. Shpallja e dytë thërret Muhamedin (a.s.) që t'i lajmërojë njerëzit për dënimin që i pret nga punët e këqija, të adhurojnë vetëm Një Zot, të largohen nga gjërat që i ka ndaluar (Kur'an: 74:2,7). Shpallja tjetër urdhëron Muhamedin (a.s.) t'i thërret të afërmit e vet (Kur'an, 26:214): "Proklamo haptazi çka të është porositur; largohu prej idhujtarëve". (Kur'an, 15:94).

Sipas Ibn Is'hakut, Shpallja e parë i arriti Muhamedit (a.s.) në ëndërr, haptazi, për t'ia pakësuar çudinë. Shpalljet e mëvonshme i kanë zbritur me vetëdije të plotë.

Misioni

Muhamedi (a.s.) filloi fshehtazi të përhapte porosinë ndër miq e të afërt, pastaj në fisin e vet e më në fund në qytet dhe në rrethinë. Në thirrjet e veta sulmoi idhujtarinë, politeizmin dhe ateizmin: insistoi në domosdoshmërinë e besimit, thërret në bamirësi dhe mëshirë. Është kujdesur që shpalljet e pranuar të shkruhen dhe të mësohen përmendsh. Ky veprim i shkrimit të ajeteve ka vazhduar gjatë tërë jetës së tij, pasi që Kur'ani nuk zbriti komplet, menjëherë, por pjesë-pjesë, kurse çdo Shpallje ka qenë përgjigje e një çështjeje të veçantë. Rrethi i besimtarëve dalëngadalë zgjerohet, por shumica ngelën në besimin e stërgjyshërve të tyre. Kundërshtarët filluan ta kundërshtojnë Muhamedin (a.s.) dhe besimtarët e tij i vinin në rërën

e nxehtë të shkretëtirës, i plagosnin, i lidhnin me zinxhirë, disa bile i mbysnin, por asnjeri nuk u largua prej fesë që pranoi. Për habinë e udhëheqësve të qytetit, Pejgamberi i Allahut u propozoi ithtarëve të vet të largoheshin nga vendlindja dhe u propozoi të shkonin në Abisini: “Ku sundon perandori i drejtë, që nuk shtyp askend”. Dhjetëra besimtarë shkuan në Abisini, por jo të gjithë. Për shkak të emigrimeve, pritej që torturat të merrnin hov më të madh.

Feja që predikon Muhamedi (a.s.) quhet “Islam”, që do të thotë: T’i përulesh dëshirës së Allahut. Feja islame përmban dy parime karakteristike: 1) Vendin, drejtpeshimin mes materiales dhe shpirtërores; mes trupit dhe shpirtit; në këtë drejtim ajo lejon shfrytëzimin e begatave që na i dhuroi Allahu, por lyp që të kryhen detyrat ndaj Tij: namazi, agjërimi, zekati bëjnë që feja islame të pranohet si fe e masave të gjera, e jo e një grupi të kufizuar; 2) Thirrja e tij është universale, të gjithë besimtarët janë vëllezër, janë të barabartë, pa dallim klase, race apo gjuhe. Përparësia e njërit ndaj tjetrit është morale, e themeluar në devotshmëri.

Bojkot shoqëror

Pasi që u emigrua një numër i madh muslimanësh në Abisini, paria mekase i dërgoi një ultimatum fisit Beni Hashim. Ata lypën prej tyre t’ua dorëzojnë Muhamedin (a.s.) për ta zhdukur. Fisi i Muhamedit (a.s.) - si ata që kishin pranuar fenë, ashtu edhe ata që

nuk e kishin pranuar, e refuzuan këtë kërkesë të parisë mekase. Në këtë moment qyteti vendosi që ta bojkotojë plotësisht fisin e Muhamedit (a.s.). Askush nuk do të bisedojë me ta, as të mbajë lidhje tregtare e as të martohen prej tyre. Këtë bojkot e përkrahën fiset periferike që ishin në aleancë me mekasit. Bojkoti shkaktoi varfëri të madhe te njerëzit e pafajshëm, te fëmijët, gratë dhe pleqtë. Disa vdiqën nga uria, por askush nuk pranoi ta dorëzonte Muhamedin (a.s.).

Pas bojkotimit trevjetësh, disa anëtarë të fiseve të ndryshme, të cilët ishin më të njerëzishëm, shfaqën mospajtim me këtë bojkot të padrejtë. Në të njëjtën kohë, marrëveshja për bojkot, që ishte e varur në Qabe, u gjet siç parashikoi Muhamedi (a.s.) e ngrënë nga termitet; vetëm emri i Allahut dhe i Muhamedit (a.s.) kishin mbetur pa u dëmtuar. Bojkoti u ndërpre brenda një kohe të shkurtër. Muhamedit (a.s.) i vdiq axhë Ebu Talibi; axha tjetër, Lehebi, armiku më i turbuar i fesë islame, bëhet kryetar i fisit Beni Hashim.

Miraxhi

Në këtë kohë i ndodh Miraxhi Muhamedit (a.s.). Ai e përjetoi këtë mrekulli të Allahut (xh. sh.) dhe bëhet dëshmitar për çudirat e botës qiellore. Në të kthyer, ai si dhuratë nga Allahu (xh. sh.) sjell namazin, që do të thotë afrim shpirtëror i njeriut tek Allahu. Që të realizohet kjo lidhje e prezentimit real të Allahut, muslimani në pjesën përfundimtare të na-

mazit shërbehet me objekte jomateriale, që nuk është rasti te religjionet tjera, por me ndërrim të përshtënde-tjeve, siç ndodhi në momentin e Miraxhit ndërmjet Muhamedit (a.s.) dhe Allahut (xh. sh.).

"Përshtëndetja Allahut, të lartësuar.

-Paqja qoftë mbi ty, o i Dërguar, edhe mëshira prej Allahut.

-Paqja qoftë mbi ne dhe ata që i shërbejnë Allahut e që janë korrektë".

Lajmi për këtë takim (Miraxh) bëri që armiqtësia e idhujtarëve mekas të arrinte kulminacionin. Muhamedi (a.s.) detyrohet të lërë vendlindjen dhe të gjejë strehim diku tjetër. U drejtua për në Taif, te farefisi i vet, por e zunë idhujtarët e Taifit, e lënduan dhe e detyruan të kthehej në Mekë.

Shpërngulja në Medinë

Haxhillëku ishte shkas që arabët vinin në Qabe nga të gjitha anët e Gadishullit. Muhamedi (a.s.) kërkonte ndonjë fis që do t'i garantonte strehim dhe liri për ta kryer misionin e vet. Një pas një vizitoi 15 familje; e refuzuan duke e ofenduar: kush më shumë e kush më pak. Muhamedi (a.s.) nuk u dëshpërua: ai vazhdoi misionin e tij dhe më në fund takoi gjashtë medinas, të cilët si fqinj të hebrenjve dhe të të krishterëve kishin dëgjuar për pejgamberët e Allahut

dhe për Shpalljet. Dinin gjithashtu se këta popuj të li-brave të shenjtë prisnin ardhjen e një pejgamberi, shpëtimtarin e fundit. Prandaj, deshën ta shfrytëzojnë këtë rast para të tjerëve. Pranuan fenë e Muhamedit (a.s.), lidhën besë se do të gjejnë në Medine ithtarë të tjerë, garantuan përkrahjen e nevojshme. Vitin e ardhshëm dhjetë medinas dhanë betimin për besnikëri, lypën nga Muhamedi (a.s.) një mësues që t'i mësojë. Muhamedi (a.s.) dërgoi Mus'abin. Aktiviteti i tij qe i suksesshëm, saqë vitin e ardhshëm (në kohën e haxhit) kryesoi një grup prej 63 muslimanëve . Këta thirrën Muhamedin (a.s.) dhe muslimanët e tjerë që të shpërngulen në Medine, duke iu premtuar mbrojtje dhe furnizim të barabartë si familjeve të veta. Fshehtazi dhe në grupe, u shpërngul numri më i madh i muslimanëve për në Medine. Idhujtarët jo vetëm që i plaçkitën pasuritë e të shpërngulurve, por përgatitën komplete për të mbytur Muhamedin (a.s.), kështu që Muhamedi (a.s.) nuk guxonte më tej të ngelte në shtëpi. Të përmendim: edhe pse idhujtarët armiqësi-sht e penguan misionin e Muhamedit (a.s.), prapëse-prapë ata kishin besimin e plotë në drejtësinë e tij. Madje, shumica prej tyre kursimet e veta ia besonin Muhamedit (a.s.).

Këto amanete Muhamedi (a.s.) ia dorëzoi një të afërmi të vet, që t'ua kthejë pronarëve të tyre. Një natë, fshehurazi i shoqëruar nga miku më besnik, Ebu Bekri, lëshoi qytetin e lindjes dhe, pas shumë vuajtjesh dramatike, mbërrin në Medine gjallë e shëndoshë. Kjo ndodhi në vitin 622. Prej këtu fillon epoka e Hixhretit.

Riorganizimi i shoqërisë

Për t'i bashkuar më mirë muhaxhirët me vendësit, Muhamedi (a.s.) lidhi kontratë me një numër të konsiderueshëm të familjeve muhaxhire, me më të pasurit e Medines. Familjet e vëllazëruara bashkëri-sht fitonin, ndihmonin njëra-tjetrën në çdo pikë-pamje. Më vonë ai proklamoi se zhvillimi i plotë njerëzor do të arrihet nëse harmonizohet feja dhe politika, si dy pjesë përbërëse të integritetit. Muhamedi (a.s.) thirri delegatin e muslimanëve dhe delegatë të jomuslimanëve të asaj treve: arabë, hebrenj, të krishterë e të tjerë dhe u propozoi të themelojnë qytetin – shtet të Medines. Në marrëveshje me ta urdhëroi të shkruhet kushtetuta e parë e këtij lloji shteti në botë, ku ceken detyrat dhe të drejtat e qytetarëve, si dhe të drejtat e qytetarëve e të kryetarit të shtetit. Për kryetar njerëzit zgjodhën Muhamedin (a.s.). Ndërprijet tradita e mëparshme, sipas së cilës çdokush personalisht mendohej t'i realizonte të drejtat; kjo kokëçarje prej tash ngel në kompetencën e organit qendror. Në Kushtetutë qartazi përcaktohen parimet e mbrojtjes dhe politikës së jashtme, vendoset sistemi i sigurimit në rast të dëmeve të mëdha; ndërsa Muhamedit (a.s.) i lihet në kompetencë të japë fjalën e fundit në të gjitha kontestet: ka qenë i pakufizuar autorizimi në miratimin e ligjeve. Garantohet liria e të gjitha religjioneve, e veçanërisht për hebrenjtë: atyre me akt kushtetutar iu gara-

ntohet barabarësia me muslimanët në të gjitha çështjet e jetës së përditshme.

Pas kësaj Muhamedi (a.s.) bën një varg kontaktesh me fiset fqinje, me qëllim që t'i përfitojë, të lidh kontrata për aleancë dhe ndihmë reciproke. Në bashkëpunim me ta vendosi t'u bëjë presione ekonomike idhujtarëve të Mekës, sepse kishin uzurpuar pasuritë e muhaxhirëve dhe u kishin shkaktuar dëme të shumta. Vështirësitë në kalimin e karvanëve tregtarë nga Mekja nëpër territorin e Medines i nxitën idhujtarët të vazhdojnë me luftën gjakësore kundër muslimanëve. Në rrethanat e mbrojtjes së interesave materiale të bashkësisë, as ana shpirtërore nuk është lënë pasdore; një vit pas emigrimit në Medine hyri në fuqi disiplina më rigoroze shpirtërore: agjërimi i muajit të Ramazanit bëhet detyrë e domosdoshme për të rriturit; si për meshkujt, ashtu edhe për femrat.

Lufta kundër padurueshmërisë dhe mosbesimit

Të pakënaqur me emigrimin e muslimanëve, mekasit iu dërguan një ultimatum medinasve që të ndërprejnë mbrojtjen e Muhamedit (a.s.) dhe ithtarëve të tij, ose t'i përzanë. Mirëpo, pa sukses. Ca muaj pas kësaj kërkese (dy vjet pas Hixhretit) dërguan një ushtri të fuqishme kundër Muhamedit (a.s.). Beteja u zhvillua në vendin e quajtur Bedër. Paganët, edhe pse trefish më shumë në krahasim me ushtrinë muslimane, të cilën e udhëhiqte Muhamedi (a.s.), pësuan hu-

mbje të rëndë. Pas një përgatitje njëvjeçare, mekasit sulmuan Medinen, që të hakmerren për dështimin në Bedër. Armiku numerikisht ishte katërfish më shumë se muslimanët. Pas betejës së përgjakshme në Uhud, u tërhoq pa zgjidhur kurrgjë. Ushtria e paguar idhujtare nuk deshi të rrezikonte .

Ndërkohë, hebrenjtë filluan t'u nxjerrin telashe muslimanëve. Pas fitores në Bedër, një kryetar hebraik, i quajtur Ka'b ibn Eshref, udhëtoi në Mekë që të solidarizohej me idhujtarët dhe t'i nxiste në luftë hakmarrëse. Pas betejës së Uhudit, hebrenjtë ndërmorën një komplot për ta mbytur Muhamedin (a.s.). Këtë u munduan ta realizojnë duke lëshuar një gur mulliri nga kalaja, kur Muhamedi kthehej prej vizitës që ua bëri. Pas të gjitha të këqijave që i bënë hebrenjtë Muhamedit (a.s.), ai kërkoi prej pjesëtarëve të fiseve hebraike që ta lëshojnë Medinen e të marrin me vete pasurinë e tyre, kurse pasurinë e patundshme ta shesin për t'i paguar borxhet. Butësia solli telashe të papritura: të ikurit, duke filluar prej hebrenjve, vunë kontakte jo vetëm me mekasit, por edhe me ca fise në veri, në jug dhe në lindje të Medines. Blenë ndihmat e tyre ushtarake dhe sulmuan Medinen me forcë katërfish më të madhe se sa në Uhud. Muslimanët u përgatitën për mbrojtje, gërmuan hendeqe, iu rrezistuan vështirësive të ashpra; mirëpo, tradhtia e hebrenjve që nge lën në qytet e çrregulloi tërë strategjinë. Një diplomat i shkathët arriti t'i përçante radhët e bashkuara të armiqve, të cilët u tërhoqën njëri pas tjetrit.

Në këtë kohë zbriti ndalesa e pijeve alkoolike dhe e lojrave të bixhozit.

Pajtimi

Muhamedi (a.s.) mundohet të pajtohet me mekasit, prandaj udhëtoi në Hudejbi, afër Mekës. Kalimi i karvanëve tregtarë në veri u ndërpre, e kjo e dëmtoi tregtinë e tyre. Në marrëveshjen e Hudejbisë Pejgamberi (a.s.) iu premtoi kalim të sigurt, dorëzim të të ikurve nga Mekja dhe të gjitha kushtet që lypën ata. Pranoi të kthehej në Medine pa e vizituar Qabenë. Të dy palët premtuan jo vetëm paqe, por edhe neutralitet në konflikte me palën e tretë.

Duke e shfrytëzuar paqen, Pejgamberi (a.s.) zhbi-llloi aktivitet të gjerë në propagimin e fesë. Përveç aktivitetit në Arabi, ai iu dërgoi letra (mesazhe) misionare perandorëve të shteteve fqinje: Bizantit, Iranit, Abisinisë etj. Një klerik prej udhëheqësve të Bizantit pranoi fenë islame, kështu që u linçua nga masa (u zhduk pa ligj); prefektin nga Meani (Palestina) për të njëjtën gjë mbreti e mbyt dhe e kryqëzon. Një delegat musliman u vra në Palestinë – Siri, dhe në vend që të dënohet fajtori, mbreti shpejtoi ushtrinë që të mbronte (fajtorin) nga ekspedita ushtarake, e cila u dërgua nga Muhamedi (a.s.) (lufta e Mut'asë).

Paganët e Mekës shfrytëzuan vështirësitë e muslimanëve dhe e prishën kontratën e paqes. Muhamedi (a.s.) personalisht niset me 10.000 njerëz dhe befasoi Mekën, të cilën e pushtoi me sulmin e parë. Si fitimtar i urtë, ai i tuboi qytetarët, iu përkujtoi veprat e tyre të liga, rrëmbimin e besimtarëve, plaçkitjen e pasurisë së

tyre në mënyrë të padrejtë, sulmet e pandërprera, armiqësinë njëzetvjeçare, mandej i pyeti: “Çka prisni prej meje”? Kur të gjithë ulën kokat nga turpi, Muhamedi (a.s.) u tha: “Allahu ju faltë. Shkoni në paqe; asfarë padie kundër jush sot nuk pranoi; ju jeni të lirë”. Muhamedi (a.s.), bile, i refuzoi pasuritë e muslimanëve që ua plaçkitën idhujtarët. Ky qëndrim e ndryshoi gjendjen psikologjike; një epror mekas i afrohet Muhamedit (a.s.) i prekur në shpirt nga fjalimi që mbajti, pranoi Islamit, ndërsa Muhamedi (a.s.) i tha: “Të emëroj për guvernator të Mekës”. Pejgamberi (a.s.), pastaj kthehet në Medine, duke mos lënë asnjë ushtar në Mekë. Islamizimi i Mekës përfundoi brenda disa orësh dhe ishte plotësisht i vërtetë. Në këtë kohë Taifi përgatitej për luftë kundër Muhamedit (a.s.). Me disa vështirësi, një armatë armike do të thyhej në rrafshinën e Hunejnit. Por, muslimanët me dëshirë ndërprejnë bllokadën e Taifit, duke dëshiruar që në mënyrë paqësore të zbrapset sulmi në këtë territor. Pas më pak se një vit, delegacioni i Taifit arriti në Medine dhe lajmëroi pranimin e Islamit. Ky delegacion së pari lypsi të lirohen prej namazit, zeqatit, shërbimit ushtarak. Gjithashtu, lypën legalizimin e prostitucionit, përdorimin e verës dhe ruajtjen e idolit Latë në Taif. Islami nuk ishte lëvizje oportuniste amorale; delegacioni mbeti i turpëruar me kërkesat e veta, kështu që Pejgamberi (a.s.) bëri lëshime në pikëpamje të zeqatit dhe të obligimit ushtarak, duke shtuar: “Ju nuk duhet që me duart tuaja t’i shkatërroni putat, por prej këtu ne do të dërgojmë njerëz të bëjnë atë; nëse do të ketë pasoja, do t’i goditin ata”. Kështu, Muhamedi (a.s.) iu

sqaroi ca lehtësime që lejohen për ata që shpejt kanë hyrë në fe. Rikthimi i popullsisë së Taifit ishte aq i sinkertë, sa që pas disa muajsh ata i refuzuan lehtësimet që iu dhanë. E, kjo shihet nga fakti se vetë Muhamedi (a.s.) emëroi mbledhësin e zeqatit sikur në krahinat tjera islame.

Gjatë zhvillimit të këtyre “luftërave”, në periudhën dhjetëvjeçare pabesimtarët humbën në fushëbetja gjithsej 250 njerëz; ndërkaq muslimanët, më pak. Gadishullin Arabik e përfshiu një rilindje e vërtetë, që njëherit shpëtoi nga stuhia e pamoralit. Gjatë këtyre dhjetë vjet lufte të gjithë popujt e Gadishullit Arabik, si dhe disa territore kontinentale të Palestinës e të Irakut, me dëshirë pranuan fenë; (disa grupe krishtere, abreje dhe mage, dëshironin të ngelin në besimet e veta; atyre iu lejua liria fetare, si dhe autonomia juridike dhe gjyqësore).

Vitin e dhjetë sipas Hixhretit Muhamedi (a.s.) erdhi të kryente haxhin. Aty takoi 140.000 fetarë nga vende të ndryshme të Arabisë, të cilët kishin ardhur që t’i bashkoheshin atij në haxhillëk. Në këtë rast Muhamedi (a.s.) mbajti një fjalim dhe në pika të shkurtra e sqaroi ideologjinë e vet: besimi në Një Zot, pa idhuj dhe simbole të tjera, barabarësi ndërmjet besimtarëve, pa dallim race dhe klase, pa përparësi personale, përveç asaj të bazuar në religjiozitet; mbrojtja e jetës, mbrojtja e pasurisë dhe e nderit për të gjitha krijesat; heqja e kamatës, ndërprerja e hakmarrjes, vetëndihmat private; trajtimi adekuat i femrës, ndarja e domosdoshme e trashëgimisë anëtarëve më të afërt të familjes, ndërprerja e mundësive të pasurimit të një grupi

të vogël; preferon që Kur'ani dhe Hadithi të jenë parime për çdo çështje jetësore.

Me t'u kthyer në Medine, ai sëmuret dhe disa javë më vonë, i kënaqur që e plotësoi misionin e vet dhe që njerëzimit i shpjegoi porositë e Allahut, ndërroi jetë.

I la njerëzimit një fe të pastër monoteiste; themeloi shtetin e çliruar nga anarkia – *bellum omnium contra omnes* (luftë e të gjithëve kundër të gjithëve), vendosi ekuilibrin harmonik mes shpirtit dhe trupit, mes xhamisë dhe shtetit; vendosi sistemin e ri juridik, i cili lyp drejtësi objektive, ku kryetari i shtetit iu nënshtrohet të gjitha parimeve sikurse të tjerët; ku tolerimi fetar është i gjerë, saqë jomuslimani në shtetin islam gëzon plotësisht të drejtën juridike, autonominë gjyqësore dhe kulturore. Sa u përket të ardhurave shtetërore, Kur'ani thekson: Larg asaj se ato janë pronë e kryetarit të shtetit, ato kryesisht duhet të shërbejnë për të vobegtit.

Në fund shtojmë se Muhamedi (a.s.) ka qenë shembull i përsosur i të mësuarit individual.

Kreu II

Ruajtja e besimeve burimore

Nuk ka asgjë të përbashkët mes rrenës dhe të vërtetës. Kurrjë më tepër në botë nuk dallohet se sa këto të dyja. Madje, në çështjet me të ndjeshme nga jeta e përditshme shihet se sa e ligë është rrena, sa nuk duhet përfillur dhe sa duhet braktisur. E, pra, çka të themi kur flitet për shpëtimin e përjetshëm të besimit, mësimin burimor dhe themelor të fesë!

Nëse nuk ka vështirësi që një njeri i mençëm e i ndershëm të gjykojë, a ka pasur ndonjë mësim të vërtetë ose jo, të pranueshëm ose jo, nuk është i njëjtë rasti me mësimin e pastër dogmatik: këtu kriteri gjendet, para së gjithash, te vetë personi që flet ; nëse ai e meriton besimin, njerëzit do t'i besojnë atij dhe, nëse ka ndonjë paqartësi, ata do t'i ngarkojnë vetes edhe kufizimeve vetjake ; nuk do ta injorojnë fjalën e atij që i besohet. Çështja e autenticitetit në atë rast – sidomos nëse autori është i vdekur – bëhet diçka që ka rëndësi më të madhe.

Të gjitha religjionet botërore bazohen në libra të shenjtë, të përcaktuar, që shpeshherë proklamohen shpallje hyjnore. Do të ishte tragjike nëse, fatkeqësisht, do të humbej origjinali i shpalljes, pasi që zëvendësimi nuk do të ishte plotësisht identik me atë që është humbur. Megjithatë, brahmanët, budistët, të krishterët, magët, hebrenjtë mësimin fillestar të religjionit të tyre mund ta ruajnë dhe ta krahasojnë me mësimet përkatëse të muslimanëve; kush i shkroi ata libra,

kush i transmetoi prej gjenerate në gjeneratë, a është ajo origjinale ose është vetëm përkthim? A s'ka në të kundërthënie të brendshme? Vallë, s'janë të humbur kapitujt që përmenden në kapitujt tjerë? E kështu me radhë. Këto janë pyetje të cilat patjetër duhet t'i parashtrijë gjithkush që ndershmërisht gjurmon drejt së vërtetës dhe të fitojë për ato përgjigje të kënaqshme.

Mënyra e ruajtjes

Në kohën kur u paraqitën religjionet e mëdha, njeriu nuk posedonte vetëm me të mbajturit mend, por pati edhe mënyrën e konservimit d.m.th. shkrimin, i cili është më i qëndrueshëm sesa memorja e individit, e cila humbet bashkë me jetën e tij.

Por, në thelb, as njëra as tjetra, prej të dy mënyrave, nuk është e pagabueshme: përvoja e përditshme na mëson se kur shkruhet diçka dhe përsëri kontrollohet, ajo që është shkruar, hetohet pak a shumë një numër i madh i gabimeve të padashura: mungesa e shkronjave, madje edhe e fjalës, përsëritja, zëvendësimi i një shprehje me tjetrën, gabimet gramatikore etj. e të mos bisedohet për ndërrimin e mendimit të autorit, i cili e korrigjon stilin e vet, mendimin e vet, argumentet e veta, duke e hedhur ndonjëherë gjithë atë që e ka shkruar dhe duke filluar sërish tekstin e ri. Kjo, gjithashtu, vlen edhe për të mbajtur mend: ai që e ka këtë detyrë ose zakon të mësojë diçka përmendsh, që dikur ta recitojë, sidomos nëse është fjala për tekst

të gjatë, bindet se herë pas here të mbajturit mend e tradhton: kapërcen një fragment, e përziën njërin me tjetrin ose nuk i kujtohen të gjitha pjesët tjera: ndonjë-herë teksti i vërtetë mbetet në ndërdije, pastaj përsëri rikthehet, ose në herën tjetër, pas kthjelljes së rëndom- të të mbajturit mend, me ndihmën e suflerit ose të tekstit të shkruar, përtërihet të mbajturit mend.

Pejgamberi i fesë islame, Muhamedi (a.s.), njëko- hësisht pranon të dyja metodat, të cilat në mes vete ndihmohen, që të përfitohet konsekuenca dhe mu- ndësia që gabimet të vijnë në minimum.

Burimet e Islamit

Mësimi islam kryesisht bazohet në Kur'an dhe në Hadith, dhe, sikur do të shohim, të dyjat janë të the- meluara në frymëzimet e Allahut (xh. sh.) (53:3,4). Sa i përket Kur'anit, Pejgamberi Muhamed (a.s.) vetë i ka diktuar tekstet në periudhën prej 23 vitesh dhe thotë: "Kjo është Fjala e Allahut, që më është Shpallur mua pëmes engjëllit Xhibril". Hadithi është koleksion të cilat vetë Muhamedi (a.s.) i ka thënë ose i ka punuar, mirëpo nuk ka urdhëruar t'i bashkangjiten Kur'anit. Regjistrimin e fjalëve dhe përshkrimin e veprave të tij i kanë kryer bashkëpunëtorët e tij, me iniciativën e tyre, sipas aftësive të veta. Nëse, eventualisht, brenda kohës nuk i ka ardhur inspirimi hyjnor, atëherë është konsultuar me shokët – bashkëpunëtorët. Sipas kësaj,

dallojmë Muhamedin (a.s.) si qenie njerëzore dhe Muhamedin (a.s.) si bartës i Shpalljes Hyjnore.

Historia e Kur'anit

Kur'an tekstualisht do të thotë LEXIM ose RECITIM. Duke ua dedikuar besimtarëve, Muhamedi (a.s.) përcaktonte radhitjen e disa fjalëve (ajeteve). Ai nuk i diktoi të gjitha megjëherë, sepse Shpalljet i vinin pjesërisht dhe kohë pas kohe. Pasi e pranonte menjëherë, ua komunikonte dhe lypte prej ithtarëve të tij jo vetëm t'i mësojnë përmendsh e ta lexojnë në namaz, por edhe ta shkruajnë e ta shumëzojnë. Secilës Shpallje të re ai ia caktonte vendin që do të merrte në tekstin e ri në tërësi; ai nuk donte një ndarje mekanike kronologjike. Kurdo që i Shpallej pjesa e Kur'anit, ai jo vetëm që ia diktonte njërit prej ithtarëve të tij, por në fund lypte që t'ia lexojnë atë që kanë shkruar, që të mund t'ua përmirësonte gabimet eventuale. Ne nuk mund të përfillim deri në atë masë kujdesin kushtuar ruajtjes së tekstit, kur kemi parasysh nivelin kulturor të Arabisë së atëhershme.

Është e kuptueshme se Shpalljet e para që i kanë ardhur Pejgamberit (a.s.) nuk janë përgatitur menjëherë në formë të shkruar, sepse ai atëherë nuk kishte as besimtarë e as ithtarë të vet. Përvç kësaj, tekstet e para nuk kanë qenë as të gjatë e as të shumtë. Nuk paraqiste rrezik t'i harronte Pejgamberi (a.s.), sepse ai ato i lexonte në namaz dhe në diskutim me masën që posa kishte pranuar fenë.

Pa dyshim, për këtë na tregojnë faktet historike se si ka ndodhur kjo: Omeri konsiderohet si personi i 40-të që e pranoi Islamin; këtu është fjala për vitin e tetë para Hixhretit (shpërnguljes), viti i pestë i Pejgamberisë. Tanimë në fazën fillestare gjendeshin tekste të kuptimeve të ndryshme në formë të shkruar. Leximi i një teksti të tillë e bindi Omerin të pranonte Islamin siç na lajmëron Ibn Hishami. Sa vjet është vënë në jetë kjo praktikë e përshkrimit nuk mund të precizohet, mirëpo nuk ka dyshim se brenda 18 viteve të jetës së Muhamedit (a.s.) numri i muslimanëve, në të vërtetë edhe kopjet e Librit të Shenjtë, rritej prej dite në ditë. Pejgamberi (a.s.) i ka pranuar Shpalljet pjesë-pjesë. Krejtësisht është e natyrshme se përmbajtja e Shpalljes ka pasë të bëjë me shqyrtimin e ndonjë problemi aktual: nëse vdes ndonjë prej shokëve të tij, nevojitet Shpallja për të shpjeguar çështjet e trashëgimisë, e jo ta zëmë për pijet alkoolike, për vrasjet etj. Shpallja vazhdoi gjatë tërë pjesës së jetës së pejgamberllëkut të Muhamedit (a.s.) - 13 në Mekë dhe 10 vjet në Medine. Shpallja nganjëherë përmbante një kaptinë të tërë, të shkurtër ose të gjatë; herën tjetër vetëm një numër të konsiderueshëm ajetesh.

Karakterit i Shpalljes kërkonte nga Pejgamberi (a.s.) që të mbajë në mend çdo imtësi, prandaj shpeshherë i është përsëritur Shpallja. Burimet vërtetojnë se në çdo vit gjatë muajit të Ramazanit Muhamedi (a.s.) para Xhibrilit (melaqes) ka përsëritur pjesën e Shpallur të Kur'anit (pastaj Muhamedi (a.s.) e ka lexuar para shokëve ose ka kërkuar që ata të lexojnë para tij). Kështu që në vitin e fundit Xhibrili ka kërkuar që ta

përsërit dy herë – prej së cilës Muhamedi (a.s.) kuptoi se së shpejti do të vdiste . Sado e rëndësishme që ishte kjo ndihmë shpirtërore e melaqes ndaj Pejgamberit (a.s.), prapëseprapë as’habët e tij merrnin pjesë në këto lexime publike (të quajtura ‘ardah, kurse leximi i fundit quhet ‘ardah ahireh) ata i korrigjuan kopjet e tyre private të Kur’anit. Kështu që Muhamedi (a.s.) i ushtronte gjatë muajit të Ramazanit t’i lexojnë ajetet dhe kaptinat (suret) sipas radhitjes së vërtetë. Kjo ishte e domosdoshme për shkak të kontinuitetit të Shpalljeve të reja. Ndonjëherë e tërë surja shpallej, ndonjëherë pjesë të së njëjtës sure pandërprerje, mirëpo edhe kjo nuk paraqiste ndonjë problem. Mirëpo, kjo nuk ishte e rastit po qe se disa sure zbrisnin në të njëjtën kohë pjesë-pjesë. Në atë rast ishte e domosdoshme t’i shkruanin këto materiale doracake përkohësisht në eshtra, në gjethe të hurmës, pllaka gurësh etj. dhe pasi zbriste surja e tërë sekretarët i radhisnin këto shkrime nën udhëheqjen e vetë Muhamedit (a.s.) dhe përgatitnin kopjen e saktë. (Tirmidhi, Ibn Hambeli, Ibn Kethiri etj.). Gjithashtu, dihet që Pejgamberi (a.s.) gjatë muajit të Ramazanit i mësonte as’habët të falnin namazin e posaçëm për çdo natë, ndonjëherë edhe me xhemat, ku dhe lexonte Kur’anin prej fillimi deri në fund, duke e përfunduar gjatë atij muaji. Ky namaz (teravia) kryhet me përkushtime të mëdha edhe sot.

Kur Muhamedi (a.s.) vdiq, plasi kryengritja, në të cilën muslimanët humbën një numër të madh prej atyre që konsideroheshin njohës të mirë të Kur’anit. Kjo dha shkas që i tërë Kur’ani të përshkruhet në një broshurë komplete. Kjo vepër kryhet vetëm ca muaj

pas vdekjes së vetë Muhamedit (a.s.), i cili personalisht e kishte caktuar Zejd ibn Thabitin si shkruer të vet kryesor, të cilit ia diktonte Shpalljet kur'anore. Të njëjtin Halifi i parë e detyron të përgatit një kopje komplete të tekstit në formë të librit. Në Medine kishte një numër të konsiderueshëm të hafëzash (ashtu quhen ata që e dinë Kur'anin përmendsh), ndër të cilët ishte edhe ky, Zejd ibn Thabiti. Halifi i dha një detyrë që të gjente dy kopje të njëjta për çdo ajet para se ta shkruante në kopjen e fundit. Sipas kërkesës së Halifit, banorët e Medines i dorëzonin pjesët e shkruara që i kishin: pasanikët i jepnin të përpunuara në pergamenë ose në fasha të lëkurës; të varfrit në pllaka të gurit ose në copëza të drurit. Burimet tregojnë se vetëm dy ajete janë gjetur te një njeri. Ndërkaq, të gjithë të tjerët kanë qenë në përputhshmëri të plotë me shumë dokumente të diktuar drejtpërdrejt prej Muhamedit (a.s.).

Kopja e quajtur *Mus'haf* (fletë të tubuara) ishte nën rojën e Ebu Bekrit, e pas tij, nën kujdesin e trashëgimtarit të tij – Omerit. Halif Omeri e pa të nevojshme të dërgohet nga një kopje në çdo qendër të botës islame, që të shmangeshin gabimet eventuale. Këtë e bëri edhe trashëgimtari i tij, Othmani, i shtyrë nga rrethanat që vijojnë: njëri prej mëkëmbësve të tij kthehet prej Armenisë së largët, me ç'rast i tregon se atje janë lajmëruar shkrime të ndryshme të Kur'anit, bile edhe përlëshje mes mësuesve. Othmani menjëherë e sjell shkrimin që e kishte (përpiluar) gjatë kohës së Ebu Bekrit dhe ia besoi komisionit, në krye të të cilit ishte Zejd ibn Thabiti. Ai lyp prej komisionit që të përpunonte shtatë kopje dhe t'i korrigjonte me kopjen (e

parë) të origjinalit. Pastaj, Halifi urdhëron që të lexohet publikisht para hafëzëve më të njohur të Kur'anit nga kryeqyteti, para shokëve të Muhamedit (a.s.), që më vonë këto kopje t'i dërgojnë në qendra të ndryshme të shtetit islam, duke urdhëruar që në të ardhmen Kur'ani të bazohet vetëm në botimin burimor. Bile, urdhëroi të digjen të gjitha kopjet që nuk ishin të njëjta me përmbajtjen e botimit zyrtar.

Pas zgjerimit të kufijve të shtetit islam, kuptohet se iu dha mundësia edhe dyfytirshave të pronojnë Islamin, e njëkohësisht iu bë e mundur që heshtazi ta dëmtojnë Atë. Aq më keq, se ata kishin mundësi të përkthejnë Kur'anin në mënyrë jokorrekte dhe me deformime e me shtime të papranueshme. Urdhri i Halifit Othman, që të zhduken shkrimet që nuk përputhen me Kur'anin, iu dha shkas hipokritëve të llojlojshëm në realizimin e qëllimeve të tyre.

Dihet se disa pjesë të shpallura më herët janë plotësuar përgjithmonë pas shpalljeve të mëvonshme. Ka pasur besimtarë të cilët kishin përvetësuar versionin e parë, por nuk kanë arritur të bëjnë plotësimin, sepse kanë vdekur. Madje, ka pasur të tillë që kanë jetuar jashtë Medines. Por, të dy palët kanë pasur mundësi t'ua lënë stërnipërve të tyre shënimet autentike të paplotësuar.

Ca muslimanë kanë arritur t'i qëndrojnë besnik tekstit autentik, sepse kishin mësuar të lypin prej Pejgamberit (a.s.) shpjegime për termat e pakuptuar në tekstin e shenjtë dhe, ndërkohë, regjistrin (shpjegimet) në fletët e shkruara të Kur'anit që të mos t'i harrojnë. Këto kopje të shkruara më vonë, të mbë-

shtetura në bazë të shpjegimeve, në disa raste kanë mundur të shkaktojnë përzierjen e tekstit me shpjegimin. Edhe përkundër urdhrit të Halifit Othman që të digjen tekstet joidentike, ende ekzistonin dokumente të muslimanët e shekullit III dhe IV sipas Hixhretit ku shihej se ato shkrime nuk janë djegur, për të cilën mund të përgatitet një vepër e madhe në temën: “Variantet për shkrimin e Kur’anit”. Këto dokumente ende ekzistojnë kurse studimi i tyre tregon se ato versione ishin rrjedhim i përzierjes së shpjegimeve me tekstin autentik ose i “shpjegimeve” a i gabimeve që janë bërë në leximin e shkrimit të vjetër, i cili nuk kishte as vokale e as bëhej dallimi i mjaftueshëm mes shkronjave (tashmë është aplikuar sistemi i interpunkcionit). Shtojmë se në pjesët e ndryshme të Arabisë fliteshin dialekte të ndryshme. Edhe Muhamedi (a.s.) u lejoi muslimanëve të rajoneve të ndryshme Kur’anin ta lexojnë sipas asaj që janë mësuar, bile edhe fjalët që i kanë pasur të pakuptueshme t’i zëvendsojnë me sinonime që i njihnin më mirë. Leximet publike në kohën e h. Othmanit ishin mjaft të përhapura dhe të zhvilluara. Ishte e pëlqyer që vetëm në një dialekt të lexohet, edhe atë në dialektin që foli vetë Pejgamberi (a.s.), meqë ato shkaktuan devijime jo të rëndësishme. Kopjet e Kur’anit që Othmani i dërgoi nëpër qendrat e krahinave njëra pas tjetrës u humbën brenda shekujve që pasuan; e vetmja që ishte ruajtur gjer më sot është ajo e Tashkentit. Pushteti rus në kohën e perandorëve pati bërë riprodhimin (faksimilen), që tregon identitetin e plotë të atij dokumenti dhe teksti kudoqoftë. Kjo vlen edhe për dorëshkrimet

tjera, pjesërisht ose krejtësisht, të cilat rrjedhin prej shekullit të parë dhe të mëvonshëm.

Praktika e mësimit të tekstit të Kur'anit përmendsh rrjedh prej kohës së Pejgamberit (a.s.). Halifët dhe sunduesit e shteteve islame gjithmonë i janë përmbajtur asaj tradite. Koincidenca e këtillë e ka përforcuar këtë traditë. Muslimanët qysh prej kohëve më të hershme e kanë pasur traditë që veprën para se ta lajmërojnë e kanë lexuar para autorit (ose nxënësve të tij), ashtu që prej tij të formojë bindje për autenticitetin: lexuesit dhe mësuesit e Kur'anit e bënin të njëjtën, duke dhënë të njëjtin shembull. Kjo traditë është ruajtur gjer më sot me këto veçori të rëndësishme që secili lexim autentik për mësuesin, por ajo është e njëjta me atë që ai vetë e ka mësuar prej mësuesit të vet dhe kështu vazhdon deri te Pejgamberi (a.s.). Shkruesi i këtyre rreshtave Kur'anin e ka studiuar në Medine, te sheh Hasan Shairi, ndërsa dëftesën që e ka ai, mësues pas mësuesi thotë se i fundit prej tyre e ka kryer shkencën në të njëjtën kohë tek Othmani, Aliu, Ibn Mes'udi, Ubej ibn Ka'bi dhe Zejd ibn Thabiti (të gjithë shokë të Pejgamberit (a.s.)) dhe se të gjithë kanë studiuar të njëjtin tekst. Numri i hafëzëve në botë është më shumë se njëqind mijë. Ndërkaq, kopje të Kur'anit mund të gjenden në katër anët e botës. Është befasi e këndshme të vërtetojmë se nuk ka kurrfarë dallimi midis tekstit që mësohet përmendsh dhe teksteve të shfrytëzuara.

Është e ditur se origjinali i Kur'anit në gjuhën arabe është ai tekst që është në përdorim të përditshëm. Ka përkthime në të gjitha gjuhët kryesore të

botës – përkthime pak a shumë të mira – që të mund të shërbehen ata që nuk e dinë gjuhën arabe; mirëpo, duhet të ceket se origjinali i vërtetë është ai që është në formën integrale: nuk ka kurrfarë nevojë të përkthehet përsëri në gjuhën arabe duke marrë për bazë ndonjë të mëvonshme.

Gjuhët kanë tendencë që gradualisht të ndërrohen dhe brenda kohës mbeten të pakuptueshme nga njerëzit. Anglishten e 1400-tës sot nuk e njeh në Angli kush, veç atyre që e specializojnë anglishten e vetër. Kjo vlen për të gjitha gjuhët e botës, të vjetra apo të reja: për greqishten, për latinishten, për frëngjishten, për gjermanishten, për rusishten etj. Përjashtim bën vetëm arabishtja, e cila 1500 vjet nuk ka ndërruar as në fjalor, as në gramatikë, as në shkrim; bile, edhe në shqiptime. Po të ketë ndryshime, kjo do të thotë se më herët ka pasur dy forma; njëra formë ka dominuar dhe tjetra ka dalë jashtë përdorimit. Vallë, a nuk është kjo rrethanë fatlume që Allahu (xh. sh.) e zgjodhi gjuhën e pandryshueshme për mesazhin e përhershëm të Tij!

Teksti në gjuhën origjinale, përshkrimi nën mbrojtjen e vetë Pejgamberit (a.s.), ruajtja e pandërprerë u bë në tri mënyra: memorjes, shkrimit dhe mësimit para mësuesve të zgjedhur nga ndërrimet e gjithfarëshme të tekstit – janë disa nga tiparet e rëndësishme të Kur’anit – Librit të Shenjtë të muslimanëve.

Përmbajtja e Kur'anit

Ashtu si thamë, muslimanët besojnë se Kur'ani është fjala e Allahut (xh. sh.), që i është Shpallur Pejgamberit të Tij, Muhamedit (a.s.). Pejgamberi është vetëm ndërmjetësues i rëndomtë; ai e pranon Shpalljen dhe e transmeton; në të asnjëherë nuk ka luajtur rol tjetër, as si autor, as si redaktor. Nëse Muhamedi (a.s.) ndonjëherë ka lajmëruar plotësimin e ndonjë ajeti, ajo është bërë vetëm pas Shpalljes së re, e cila i vinte prej Allahut.

Allahu është transhendenti (i padukshmi), jashtë kufizimeve fizike të njeriut. Përmes melaqes Xhibril Allahu Shpalli Dëshirën e Tij, Urdhrat e Tij, Pejgamberit të vet kushtuar njerëzimit. Meqenëse Allahun nuk mund ta përshkruajë gjuha, mirëpo në mënyrë metaforike mund të thuhet: Pejgamberët janë kandil, ndërsa Shpallja është energji elektrike, e cila qarkullon nëpër to; në kontakt me rrymën, llamba elektrike jep dritën sipas voltazhit dhe ngjyrës së vet; gjuha materiale e ndonjë pejgamberi është e ngjashme, të themi ashtu, me dritën e llambës. Fuqia e llambës elektrike ose e qarkut elektrik si për gjithë punët tjera, janë të caktuara verëm prej Allahut: zëri i njeriut është vetëm një mjet trasmetimi, një ndërmjetësues.

Sipas Islamit, Kur'ani është Fjalë e Allahut, ndërsa vetë Kur'ani përsërit që besimtarit patjetër duhet të lexojë natën e ditën, kur të mundet. Mistikët shumë mirë e kanë shpjeguar këtë duke thënë se leximi i

Kur'anit për njeriun është udhëtim i njerit drejt Allahut me ndihmën e Fjalës së Zotit, sipas së cilës Fjalën e Zotit mund ta vështrojmë si një rrugë të gjerë, sikurse është energjia elektrike rruga e dritës që arrin deri te llamba në elektranë. Këto nuk janë fjalë boshe. Në të vërtetë, Pejgamberi Muhamed rekomandoi që tërë Kur'anin ta lexojmë një herë në javë. Kjo e solli që Kur'ani të ndahet në shtatë pjesë të quajtura menzil. Kur'ani ka 114 kaptina, të cilat quhen *sure* e që kanë numrin e caktuar, që quhen *ajete*. Menzil në arabisht do të thotë stacion pas udhëtimit ditor; *sure* do të thotë një hapësirë e rrethuar (dhomë), ndërsa rrënja *ava*, prej së cilës rrjedh fjala *ajet*, do të thotë shkuarje në gjumë. Stacioni, dhoma, shtrati janë tre elemente kryesore të udhëtimit qoftë shpirtëror ose trupor. Udhëtari i cili merr rrugën e gjatë shpirtërore duhet të ndalet në ndonjë stacion pas udhëtimit ditor, i nevojitet dhoma dhe shtrati të pushojë para se të fillojë rrugën e gjatë të ditës së ardhshme, e cila e çon në rrugën e përhershme, të përvjetshme dhe të pakufi.

Kur'ani i është dërguar njerëzisë, pa dallim racës, vendit ose kohës: bile, më tepër, ai insiston të udhëheqë njeriun në të gjithë lëmenjtë e jetës shpirtërore, trupore, personale, shoqërore. Këto janë udhëzime për qeverisjen e shefit të shtetit, si dhe për nënshtetasin e rëndomtë, për të pasurit dhe për të varfrit, në situata të luftës dhe të paqes, për kulturën shpirtërore, si dhe për tregtinë dhe gjendjen e mirë materiale. Kur'ani pikësëpari synon konformimin e personalitetit të individit. Secila krijesë do të përgjigjet vetë para Krijuesit: për këtë qëllim, jo vetëm se udhëzon Kur'ani,

por edhe orvatet të bindë: ai i dedikohet mendjes njerëzore, përmban histori, parabolla, metafora. Aty gjendet e vërteta për cilësitë e Allahut (xh. sh.), i cili është Krijues i Vetëm i gjithçkasë i Gjithdijshëm, i Gjithfuqishëm, i Aftë të na rikthejë në jetë pas vdekjes dhe të na i lyp llogaritë për qëndrimet tona në tokë, Mëshirëplotë, i Drejtë etj. Aty gjendet edhe i tërë mësimi dhe mënyra e madhërimit të Zotit, për ibadetin më të mirë për detyrat e njeriut ndaj Zotit, ndaj krijesave tjera, ndaj vetvetes: ne nuk i takojmë vetëm vetvetes, por i takojmë edhe Zotit. Kur’ani përshkruan rregullat kryesore për jetën shoqërore: tregtinë, martesën, hixhiin, ligjet ndëshkuese, ligjet ndërkombëtare etj. Mirëpo, Kur’ani nuk është libër kallëp në kuptimin e fjalës, Ai është përmbledhje e Fjalëve të Allahut, të Shpallura kohë pas kohe brenda 23 viteve të Muhamedit (a.s.) prej Allahut (xh. sh.) dedikuar tërë njerëzisë: Zoti ia ka Shpallu mësimet e Veta zëdhënësit të Tij.

Në lidhje me këtë ka mendime të fshehura, përsëritje, bile ndryshime në formë narracioni. Zoti nganjëherë flet në vetën e parë, nganjëherë në veten e tretë. Ai do të thotë: “Unë” siç do të thotë “Ne”, ose “Ai”, por kurrë nuk do të thotë: “Ata”. Këtu është një tubë Shpalljesh të volitshme. Gjithmonë duhet ta kemi në mend faktin kur një fillestar zë të lexojë Kur’anin, duhet ta lexojë e ta përsërit ta lexojë derisa të mundet më së miri të kuptohet domethënia e urdhërave të Tija; udhëzim për çdokend, gjithkund dhe gjithmonë.

Gjuha dhe stili i Kur’anit janë të jashtëzakonshëm dhe të denja origjinës së saj Hyjnore. Leximi i Kur’anit

trazon shpirtin bile edhe të atyre që e ndëgjojnë pa e kuptuar Ate. Kalimthi përkjtojmë se Kur'ani duke u mbështetur në gjenezën Hyjnore të Tij, iu drejtohet me këtë thirrje: “Edhe njerëzit edhe exhinet të tubohen që të shkruajnë një Kur'an të ngjashëm”. Kjo thirrje sot e kësaj dite mbetet e papërgjigjur!

Hadithi

Fjalët dhe qëndrimet e Muhamedit (a.s.) quhen HADITH, qofshin ato fjalët e tij, punët, madje edhe reagimet në sjelljet e shokëve të tij: lajmet apo vendimet në heshtje e kanë gjithashtu autoritetin për lejimin e këtyre punëve, aqsa edhe fjalët e tij, ose praktika e tij personale. Vetë Kur'ani shumë herë e përkujton rëndësinë ligjore të hadithit: “Nënshtrojuni Allahut dhe pejgamberit të Tij” (Kur'an, 4:58), “...dhe, atë çka ju sjell Pejgamberi, merreni dhe përmbahuni prej atyre që u ndalon...” (Kur'an, 59:70), “Ai nuk flet sipas dëshirës; ai flet vetëm atë që i është urdhëruar” (Kur'an, 53:3 – 4), “Te Pejgamberi i Allahut keni shembuj të mirë për secilin që mbështetet në Zot dhe në Ditën e Gjykimit, dhe për ata të cilët shpesh e përmendin Allahun”. (Kur'an, 33:21). Kështu që, gjithçka që porositi Muhamedi (a.s.) na e ka dërguar. Ka pasur raste kur, duke mos pranuar Shpalljen, atëherë vetë Pejgamberi (a.s.) ka vendosur duke u bazuar në mendjen e tij të shëndoshë, kur atë Allahu nuk e ka lejuar, ka intervenuar me Shpallje, që e ka përmirësuar ven-

dimin e Muhamedit (a.s.). Ky udhëzim indirekt, i cili pas ndodhisë i ka ardhur bashkësisë, nuk ka pasur pasoja. Mirëpo, Hadithi ka rëndësi tjetër e që është:

Kur'ani është një përmbledhje, prandaj në të njëjtën kohë praktika e Muhamedit (a.s.) ka treguar metodën dhe mënyrën e aplikimit në detaje dhe i ka dhënë shpjegimet e duhura. P.sh. Kur'ani vetëm thotë: "Falni namazin...", pa e shpjeguar formën dhe mënyrën se si dhe detajet tjera. Pejgamberi (a.s.) me fjalë nuk ka mundur të përshkruajë tërë detajet, si dhe detyrat, prandaj besimtarëve iu thotë: "Falni namazin siç më shihni mua se si falem".

Vlera e Hadithit për muslimanët ngrihet sipas fakteve se Muhamedi (a.s.) jo vetëm që i ka mësuar, por ka pasur raste kur mësimin e ka praktikuar në vepra gjatë jetës. Ai jetoi 23 vjet pasi thirret prej Allahut që të kryejë misionin profetik. Ai bashkësisë së vet i urdhëroi fenë të cilën në mënyrë më të vetëdijshme e praktikoi gjatë tërë jetës së vetë, themeloi shtetin ku ishte edhe sundimtar suprem, siguroi paqe dhe rend të brendshëm, udhëheqte ushtrinë për mbrojtje, u dha fund grindjeve të nënshtetasve të vet duke i dënua kriminelët dhe vuri ligje për çdo çështje të jetës njerëzore. Ai u martua dhe dha praktikën më të pastër për jetën bashkëshortore. Fakt i rëndësishëm është: nuk ka tejkualuar personalisht ligjet që i ka proklamuar për të tjerët. Sjellja e tij nuk ka qenë çështje private, por praktikë e pastër dhe shpjegim publik i mësimëve të tij.

Muhamedi (a.s.), si njeri, ishte shumë i kujdesshëm në qëndrimet e tij; aqsa edhe modest: si pejgamber i Allahut (xh. sh.), ndërmoi gjithçka që është

e domosdoshme që të mund të sigurojë jo vetëm komunikimin, por edhe ruajtjen e urdhrave të Allahut, të Kur'anit. Për Hadithin nuk duhej të kujdesej shumë, pasi që e shkruanin shokët e tij. Mbrojtja e Hadithit ka histori krejtësisht tjetër prej asaj që shpjegohet në lidhje me ruajtjen e Kur'anit.

Dokumente zyrtare

Ka një numër të konsiderueshëm hadithesh , të cilat mu për shkak të natyrës së tyre duheshin të ishin të shkruara: dokumentet origjinale prej kohës së Pejgamberit (a.s.).

Në një shkrim nga “Tarihu” i Tabariut mësojmë se muslimanëve nga Meka, të cilët kanë qenë të ndjekur prej bashkëqytetarëve, në kohën kur shkuan për strehim në Abisini, Pejgamberi iu dha një letër drejtuar Nexhashiut. I përshkruhen edhe ca dokumente të tjera, gjithashtu para Hixhretit. Mirëpo, kur e pati në duar sundimin shtetëror, numri dhe përmbajtja e dokumenteve të shkruara rritej për çdo ditë.

Me ardhjen në Medine, Muhamedi (a.s.) pati sukses të formojë qytet-shtet, të përbërë prej muslimanëve dhe jomuslimanëve, i dhuroi kushtetutën e shkruar, ku përveç tjerash përmenden detyrat dhe të drejtat e sunduesit të shtetit dhe banorëve të tij. Ai dokument është ruajtur. Pejgamberi (a.s.) i përcaktoi kufijtë e qytetit – shtetit të vet gjithashtu me shkrim. Në të njëjtën kohë, urdhëron të shkruhen emrat e tërë

muslimanëve. Sipas këtij regjistrimi, bashkësia numëronte 1500 njerëz, siç thotë Buhariu.

Përveç kësaj, këtu gjejmë kontratën për aleancë ose paqe të nënshkruar me shumë fise të Arabisë; ndonjëherë, siç tregojnë burimet, kanë qenë të shkruara në dy kopje; nga një për secilën palë të kontraktuar. Ka dokumente të shkruara mbi sigurinë, që u është garantuar krerëve të nënshtruar, ose për sigurimin e pasurisë pronarëve të tyre të mëparshëm: tokës, burimeve të ujit etj. Me zgjerimin e shtetit islam, është e natyrshme se paraqitet letërkëmbimi me guvernatorët krahinorë: komunikimi i ligjeve të reja ose dispozitave administrative që iu përkisnin p.sh. tatimeve, intervenimeve për korrigjimin e disa urdhrave gjyqësorë apo administrativë ose vendime të funksionarëve, përgjigje në pyetje të parashtruara nga ana e atyre funksionarëve të pushtetit qendror etj.

Gjithashtu, ka shkrime apelative (misionare) që iu janë drejtuar sunduesve dhe mbretërve të ndryshëm, si thirrje për të pranuar Islam: të parëve të fiseve arabe, mbretërve të Bizantit, të Persisë, të Abisinisë etj.

Janë të regjistruara edhe lista e vullnetarëve për ekspedita ushtarako-luftarake; gjithashtu, lista e konfiskimeve (plaçka e luftës) që do të mundësonte ndarjen e drejtë ndërmjet të gjithë anëtarëve të marshit.

Lirimi i robërve, si dhe zënien rob dhe shitjen e robërve, gjithashtu janë kryer në formë të letrës së shkruar sidomos, dy dokumente të këtij lloji e të cilat rrjedhin prej Pejgamberit janë të ruajtura.

Interesant është fakti se: në ditën e triumfit në Mekë, në vitin e tetë të Hixhretit, Pejgamberi (a.s.) ka

mbajtur një fjalim me rëndësi, ku gjithashtu ka folur për disa ligje. Sipas kërkesës së një shoku të tij, Ebu Shah, i lindur prej Jemeni, Pejgamberi (a.s.) urdhëron të regjistrohet ky fjalim dhe t'i dorëzohet Ebu Shahut.

Në fund, të themi diçka për përkthimin e Kur'anit. Pejgamberi (a.s.) ka përcaktuar që namazi të falet në gjuhën arabe. Ca persianë, duke pranuar fenë islame, donin të lënë pas dore namazin për gjatë kohë, derisa të mësojnë tekstin e Kur'anit përmendsh. Pas lejes së Pejgamberit (a.s.) një personi, Selman Fari-siu përktheu në gjuhën persiane kaptinën e parë të Kur'anit dhe kështu ua bënë të mundur atyre që posa kishin pranuar fenë, ta falin namazin në gjuhën persiane, gjersa ta mësojnë tekstin në gjuhën arabe (Serahsi, Mebsut, 1,37).

Shkrimet e tubuara të këtij lloji të dokumenteve prej kohës së Pejgamberit (a.s.) përbëjnë qindra faqe.

Duhet të përkujtojmë se Pejgamberi (a.s.) posaçërisht i ka dhënë rëndësi arsimimit publik. Shpesh thotë: "Allahu më ka dërguar si mësues". Me ardhjen në Medine, punë e tij e parë publike ishte të ndërtonte xhaminë në të cilën një pjesë ishte e përgatitur për shkollë (e njohur si safallëk), e cila ka shërbyer si fjetore gjatë natës, ndërsa si mësojtore gjatë ditës për ata që kishin nevojë. Vitin e dytë sipas Hixhretit (624 sipas Krishtit), pas hyrjes së ushtrisë së paganëve të Mekës në Bedër, u zunë rob një numër i konsiderueshëm armiqsh. Pejgamberi (a.s.) urdhëron që të gjithë robërit e luftës të cilët dinë të shkruajnë e të lexojnë mund ta shpaguejnë robërinë me punë: secili prej tyre duhet t'ua mësojë shkrim-leximin dhjetë fëmijëve të

muslimanëve. Kur'ani urdhëron që kontratat tregtare për veresi të vërtetohen në formë të shkruar, ku më së paku dy dëshmitarë duhet të vënë gisht (ta nënshkruajën). Kjo urdhëresë dhe të tjera të ngjashme ndihmu-an shtimin rapid të njohësve të shkrim-leximit ndër muslimanët. Pra, të mos na habit pse shokët e Pejgamberit (a.s.) gjithmonë kanë qenë të interesuar për të ruajtur fjalët e udhëheqësit të tyre në formë të shkruar. Si te të gjithë ithtarët e rinj në një religjion, kthimi i të cilëve është rezultat i bindjes, religjioziteti ka qenë shumë më i madh. Të përmendim një shembull tipik: Omeri tregon se me ardhjen e tij në Medine është bërë shok me një musliman nga Medina – brenda kohës së kontratës së njohur për vëllazërimin, të vendosur prej Muhamedit (a.s.), për të lehtësuar pikëllimin e mërgimtarëve të Mekës dhe për t'u bashkangjitur në ekonominë e Medines. Omeri dhe vëllai i tij kanë punuar, herë njëri e herë tjetri, për mbjelljen e një palmishteje. Ditën kur duhej të punonte Omeri, shoku i tij shkante te Muhamedi (a.s.), ndërsa natën ai i tregonte Omerit gjithçka kishte dëgjuar dhe çka kishte parë te Muhamedi (a.s.). Kur i vinte radha Omerit, e bënte të njëjtën, kështu që të dy gjithmonë kanë përcjellë atë që ndodhte te Muhamedi (a.s.): shpalljen e ligjeve të reja, çështjen e mbrojtjes etj. Sa për tubimin e shkrimeve mbi jetën e Pejgamberit (a.s.) na tregon shembulli që vijon.

Kompilimi në kohën e Pejgamberit

Termidhiu njofton: Një ditë, një ensarij (musliman i Medines) ankohet te Muhamedi (a.s.) se mbajtjen në mend e ka të dobët, duke thënë se ka harruar shumë fjalë të Pejgamberit (a.s.). Pejgamberi (a.s.) i përgjigjet: “Përdore dorën tënde të djathtë”. (Që do të thotë: shkruaje atë që do të mbash në mend).

Në një numër të madh burimesh (të Tirmidhiut, të Ebu Davudit etj.) përmendet se Abdullah ibn Amër ibn El-As, një mekas i ri, e kishte zakon të shkruante atë që Pejgamberi (a.s.) kishte folur. Një ditë shokët i thanë: “Pejgamberi (a.s.) është njeri; ndonjëherë është i kënaqur, ndonjëherë hidhërohet; nuk duhet t’i shkruash të gjitha, pa bërë dallimin se çka thotë ai”. Abdullahu shkon te Pejgamberi (a.s.) dhe e pyet se a mund të regjistrojë gjithçka që thotë ai. “Po”, iu përgjigj Pejgamberi (a.s.) Që të bindet plotësisht, Abdullahu thotë: “Njësoj, edhe kur të jesh i kënaqur, edhe i hidhëruar? Pejgamberi i përgjigjet: “Sigurisht, pasha Allahun; prej gojës time kurrë nuk do të dalë ndonjë rrenë”. Abdullahu kompilacionin e vet e quajti “Sahifetu Sadika” (fletushka të vërteta). Nga gjenerata në gjeneratë ajo është transmetuar si vepër e pavarur, kështu që më vonë të mund të përfshihet në përmbledhjet kryesore të Hadithit, të redaktuara nga Ibn Hambeli etj. Darimiu e Ebul-Hakemi tregojnë: “Më vonë, në një rast kur Abdullahu ishte i rrethuar prej nxënësve të vet, njëri prej tyre e pyeti: ‘Cili prej dy

qyteteve do të pushtohet i pari, Roma apo Konstantinopoja?’ Abdullahu e sjell një sënduk të vjetër, nxjerr prej aty librin dhe pasi e shfletoi, lexoi prej tij: Një ditë ishim ulur rreth Pejgamberit (a.s.) dhe shkruanim gjithçka që ai fliste. Dikush e pyeti: Cili prej këtyre dy qyteteve më së pari do të humb, Roma apo Stambolli? Pejgamberi (a.s.) u përgjigj: “Qyteti i pasardhësve të Heraklitëve”. Ky hadith tregon se si një numër i madh i shokëve të Pejgamberit (a.s.) kanë qenë të interesuar për ta ruajtur fjalën e tij edhe gjatë jetës së tij.

Edhe më i rëndësishëm është rasti i Enesit. Enesi ka ditur të lexonte dhe të shkruante qysh në moshën dhjetëvjeçare. Ky ishte një rast i rrallë te medinasit në atë kohë. Kur Pejgamberi (a.s.) erdhi në Medine, prindërit e Enesit, në shenjë besnikërie, ia dhanë Enesin që t’i shërbejë personalisht Pejgamberit (a.s.). Enesi nuk u nda nga Pejgamberi (a.s.) gjer në vdekje dhe, duke ndenjur pranë tij natë e ditë, ka pasur mundësi ta përcjellë dhe ta dëgjojë pandërprerë në çdo rast. Një nxënës i tij na tregon: “Më vonë, kur ne lypnim, Enesi i nxirrte fletët e mbështjella dhe thoshte: Këto janë fjalët e Pejgamberit (a.s.), të cilat i kam regjistruar, pastaj i kam treguar (për t’i korrigjuar nëse rastësisht kam gabuar në shkrim)”. Kjo që thamë më lart tregon jo vetëm rregullimin e të dhënave për jetën e Pejgamberit (a.s.) por, gjithashtu, edhe për kontrollin e kryer nga ana e Pejgamberit (a.s.) në atë që i është përshkruar. Këtë fakt e vërtetojnë shumë shkrihtarë klasikë: Ramhurmizi (vdiq rreth vitit 360 sipas Hixhretit), Hakimi (vdiq rreth v. 406 sipas Hixhretit), Katib Bagdadi (vdiq rreth v. 463 sipas Hixhretit), të

cilët të dhënat i kanë nxjerrë në bazë të burimeve më të hershme.

*Redaktimet nga koha e shokëve të
Pejgamberit (a.s.)*

Kuptohet se pas vdekjes së Pejgamberit (a.s.) shtohet edhe më tepër interesimi për biografinë e tij: bashkëkohanikët e Muhamedit (a.s.) u patën lënë pasardhësve të tyre atë që kanë ditur për udhëheqësin e tyre të paharruar. Ata që pranuan rishtazi fenë, ndjenin etjen e madhe për të ditur burimet e fesë së tyre. Vdekja për çdo ditë e pakësonte numrin e atyre që direkt e njihnin Hadithin, që i detyroi të gjallët t'i kushtojnë rëndësi ruajtjes së kujtimeve të veta. Kështu që, një numër i madh i haditheve rreth Pejgamberit (a.s.), të shkruara në kujtimet e pasardhësve të tij, pas vdekjes së Muhamedit (a.s.) paraqesin dokumente të dorës së parë.

Kur Pejgamberi (a.s.) e emëroi Amër ibn Hazmin për sundues të Jemenit, i dorëzoi instruksionet e shkruara në letër, të cilat përmbanin detyrat zyrtare. Amri jo vetëm që e ruajti këtë dokument, por i përgatiti edhe 21 kopje të dokumenteve tjera, të cilat rridhnin nga Pejgamberi (a.s.) (të dërguara fiseve të Xhihajnit, të Xhurdhamit, të Tajit, të Thekifit etj.) dhe i klasifikoi në përmbledhjen e dokumenteve të rëndësishme. Kjo vepër është ruajtur gjer më sot.

Në Sahinin e Muslimit mund të lexojmë si Xhabir ibn Abdullahu ka përpiluar një libërth për haxhin në

Mekë. Paramendohet se ai ka përshkruar haxhin e fundit të Muhamedit (a.s.), duke përmendur aty edhe Fjalimin e njohur të Lamtumirës të mbajtur në atë rast. Shumë burime historike flasin për veprën e Xhabirit (Sanifa), të cilën nxënësit e tij e mësuan përmendsh. Këtu me siguri kemi të bëjmë me përkujtimet e jetës dhe fjalës së Pejgamberit (a.s.).

Ndër shokët e Pejgamberit (a.s.) që kanë tubuar kujtimet e veta, për nevojat e fëmijëve të tyre, janë edhe Kamire ibn Xhindab dhe Sa'd ibn Ubejde. Ibn Haxheri, i cili flet në lidhje me të, përmend se vepra e Samurahit ka qenë ndër më të mëdhatë. Ibn Abasi, i cili në kohën e vdekjes së Pejgamberit (a.s.) ka qenë i ri, ka mësuar shumë gjëra nga shokët më të vjetër dhe i ka radhitur në një numër të madh veprash; flitej: "Ibn Abasi i ka përpiluar shkrimet e veta, të cilat mezi do t'i bartte një deve". Gjithashtu, edhe Ibn Mes'udi e ka përpiluar një përmbledhje.

Buhariu përmend se Abdullah ibn Halef, Ebu Bekr dhe El-Mugire ibn Ka'b ua kanë mësuar hadithet njerëzve përmes shkrimeve. Nëse dikush i pyeste për ndonjë të dhënë për Pejgamberin (a.s.), do t'i përgjigjeshin ose e merrnin iniciativën dhe lajmëronin funksionarët dhe shokët për ndonjë ndodhi në lidhje me Pejgamberin.

Edhe më edukativ është rasti që vijon, i cili transmetohet në shumë burime: "Një ditë, një nxënës i thotë Ebu Hurejres: 'Ti na e ke treguar këtë e këtë gjë'. Ebu Hurejrja (sigurisht në kohën e pleqërisë) refuzon të pranojë atë. Mirëpo, pasi që nxënësi i tij insistoi se ajo që i ka mësuar ka qenë mirë, Ebu Hurejrja përgji-

gjet: “Nëse këtë e ke dëgjuar prej meje, atëherë patjetër duhet të gjendet në shkrimet e mia’. E rroku për dore, e solli në shtëpinë e vet dhe atje i tregoi shumë libra mbi hadithet e Pejgamberit (a.s.), ku e gjeti ngjarjen në fjalë. Atëherë tha: Mirë të kam thënë; nëse diçka të shpjegoj, patjetër të gjendet në shkrimet e mia”. Ebu Hurejreja ka vdekur në vitin 59 sipas Hixhretit. Njërit prej nxënësve të tij, Haman ibn Muhabiut, i ka diktuar (ose ia ka dhënë në dorëshkrim) një libërth prej 138 haditheve për Pejgamberin (a.s.). Kjo vepër, prej gjysmës së parë të shekullit islam, është e ruajtur. Ajo na mundëson ta krahasojmë me kompilationet e mëvonshme dhe të shohim se kujtimet e të vjetërve për Hadhithet kanë qenë të ruajtura me interesim të madh nga gjeneratat e mëvonshme.

Dhehebiu përmend: “Halifi Ebu Bekër ka redaktuar një vepër me 500 hadithe prej Pejgamberit (a.s.) Këtë vepër ia ka dhuruar vajzës së vet, Ajshes, mirëpo të nesërmen përsëri ia merr dhe e zhdruk, duke thënë: “Kam shkruar atë që tekstualisht e ka thënë Pejgamberi (a.s.)”. Përsa i përket Omerit, Muamer ibn Rashidi thotë: Gjatë kohës së halifatit të tij, Omeri është këshilluar me shokët e Pejgamberit (a.s.) që të dijë se a duhet të kodifikohet Hadithi. Të gjithë janë përgjigjur vendosmërisht, mirëpo Omeri ka vazhduar të luhatet dhe t’i lutet Allahut tërë muajin që t’i tregohet zgjidhja e vërtetë. Pas kësaj vendos të mos bëjë asgjë, duke shtuar se të tjerët kanë lënë pasdore Shpalljen e Librit të Allahut në favor të sjelljeve të pejgamberëve dhe se ai (Omeri) nuk dëshiron të bëjë konfuzion mes Kur’anit dhe Hadithit. Hulumtimet e fundit tregojnë

se raportet për regjistrimin e Hadithit iu përkasin 50 shokëve të Pejgamberit (a.s.). Detajet këtu do të na shpienin shumë larg.

Ndalimi i shkrimit të hadithit

Këto dy ndodhi të fundit mbi Ebu Bekrin dhe Omerin janë të rëndësishme mu për atë se shpjegojnë të vërtetën e traditës, e cila thotë se Pejgamberi (a.s.) ka ndaluar të shkruarit e fjalëve të tij. Me sa di, të vetmit që tregojnë se Pejgamberi ka ndaluar të shkruhet gjithçka përveç Kur'anit janë Ebu Saidi, Zejd ibn Thabiti dhe Ebu Hurejrja. Nuk dihet as shpjegimi e as shkaku i kësaj urdhërese, mirëpo është për t'u theksuar se Ebu Seid el-Hudariu dhe Zejd ibn Thabiti kanë qenë shumë të rinj: Në vitin e pestë të Hixhretit kishin vetëm 15 vjet. Edhe pse ishin inteligjentë, është e kuptueshme se Pejgamberi i ka ndaluar në fillim të Hixhretit të regjistrojnë fjalët e tij. Përsa i përket Ebu Hurejres, do të shohim se ai personalisht ka shkruar "shumë libra për hadithet". – Ai ishte si njeri i devotshëm, puritan dhe i rreptë. Prandaj, nuk mund të mendohet se ai mund të thyejë këtë urdhër të Pejgamberit (a.s.) vetëm nëse më vonë ka dëgjuar për anulimin e urdhëresës. Ebu Hurejrja prej Jemenit është kthyer në Medine në vitin e shtatë pas Hixhretit që të pranojë Islamin. Është e mundur që prej fillimit Pejgamberi (a.s.) ia ka ndaluar të shkruajë diçka tjetër përveç Kur'anit; kur e mësoi Kur'anin dhe dinte ta

dallonte prej Hadithit, ndalimi më s'kishte nevojë të ishte i plotfuqishëm. Edhe diçka: Gjithashtu, ka të dhëna se Ibn Abasi e ka pasur të ndaluar, mirëpo ajo ka qenë mendim i tij personal e jo direktivë e Pejgamberit (a.s.) se nuk duhet të shkruhet Hadithi; mirëpo, gjithashtu e pamë se ai ka qenë në krye të atyre që shkruanin Hadithin, duke lënë pas vetes shkrime të cilat i përgjigjen barrës së një deveje. Këto kundërthënie mes fjalëve dhe praktikës nga ana e atyre që janë për devotshmërinë e tyre dhe për kryerjen e urdhrave edhe më të vogla e të rëndomta të Pejgamberit (a.s.), vërtetojnë konkluzionin tonë se ndalesa e shkrimit të Hadithit ka pasur shkaqet e veta, të cilat rrëfyesit nuk i përmendin, se rëndësia e tyre ka qenë e kufizuar dhe duhet lypur shpjegimet të cilat mund t'i pajtojnë ato dy ndalesa të kundërta, më mirë sesa të hidhet njëra prej tyre.

Tri zgjidhje duhet t'i kemi parasysht:

1)Ndalesa ka qenë individuale për disa persona; kjo vlente për ata që posa kishin mësuar të shkruanin, ose për ata që posa kishin pranuar Islamin dhe ende nuk kanë qenë në gjendje të dallojnë Kur'anin prej Hadithit. Ndalesa dalëngadalë është tërhequr kur ata persona kanë vërtetuar se janë ngritur intelektualisht.

2)Ndalesa kishte për qëllim vetëm të pengonte shkrimin e Hadithit në kopjet e Kur'anit, që t'i largohen përzjerjes së tekstit dhe shpjegimeve të tyre; Ebu Seid el-Hudariu aludon rreth kësaj, ndërkaq ne e dimë që halif Omeri vendosmërisht e ka ndaluar këtë lloj shkrimi.

3)Definitivisht, ndoshta fjala është vetëm për një bisedë të përcaktuar, si p.sh. atë ditë kur Pejgamberi

(a.s.) paralajmëroi të ardhmen e Islamit dhe fitoret e tij të panumërta shpirtërore e politike. Qëllimi i ndalesës ishte që t'i shmangej dekurajimit të një pjese të muslimanëve; objektivi ishin fitoret, prandaj disa kanë mundur ta komentojnë se më nuk ka nevojë për përpjekje dhe sakrifica të cilat ishin të nevojshme. Janë të mundshme edhe zgjidhje të tjera, mirëpo edhe këto do të mjaftojnë.

Në shekujt e mëvonshëm

Ishte normale që në fillim, pasi që kujtimet për Hadithin e Pejgamberit (a.s.) ishin të shkurtra dhe individualë, secili shok i Muhamedit (a.s.) të regjistronte kujtimet e veta. Në gjeneratën e dytë, kur studentët kanë marrë pjesë në orët e mësuesve të ndryshëm, kanë marrë pjesë në orët e ndryshme t'i unifikojnë në një të vetme, duke u kujdesur që me atë rast t'i dallojnë burimet e ndryshme. Pas disa gjeneratave, kujtimet e shokëve të Muhamedit (a.s.) përsëri u tubuan; kujdeseshin që t'i klasifikojnë sipas përmbledhjes dhe prej aty të nxjerrin, mes tjerash, konkluzionet e vërteta. Ashtu si për Kur'anin, kërkohej të mësohej teksti i çdo hadithi përmendsh; e që të mësohej sa më lehtë, shfrytëzohej edhe shkrimi. Kjo masë e dyfishtë e sigurimit është përmbushur rreptësisht nga njëra palë, e më pak nga pala tjetër, prej nga rrjedh rëndësia relative e mësuesve të ndryshëm për sa i përket besueshmërisë në tregimet e tyre.

Pak kohë pas vdekjes së Muhamedit (a.s.), rrëfyesit e Hadithit filluan të praktikojnë e të përmendin jo vetëm emrin e Pejgamberit (a.s.) si burim të vërtetë për udhëzimet e shpërndara, por edhe kahet që mundësonin njohjen e atyre mësimëve, tërë zinxhirin e transmetimit. P.sh. Buhariu thotë: “Mësuesi im më ka thënë: Unë kam dëgjuar prej mësuesit tim, Abdurrezakut; ai thotë: Mësuesi im, Muamer ibn Rushidi, më ka thënë...; unë kam dëgjuar nga mësuesi im Hamadi kur më tha; unë kam dëgjuar nga Pejgamberi (a.s.) këtë e këtë”. Për çdo citat të Pejgamberit (a.s.) ekziston ai lloj i lajmërimeve të hollësishme. Në zinxhirin e rrëfyesve (tregimtarëve) që i përmendim ne hasim jo vetëm Sahihun e Buhariut, por edhe Musnedin e Ibn Hambelit; Musanafin e Abdurrezakut, Xhami’ të e Ma’marit, Sahifet e Hamanit, të cilin e ka diktuar Ebu Hurejrja, shok i Pejgamberit (a.s.).

Do të gjejmë të njëjtat hadithe në të gjitha veprat me të njëjtat shprehje. Në këto burime të shumta e suksesive do të ishte shpifje e cekët të thuhet, p. sh., që Buhariu i ka trilluar të gjitha këto hadithe dhe i ka paraqitur si të Muhamedit (a.s.), duke krijuar vetë zinxhirin e tregimtarëve të shumtë, ose thjesht ka shkruar urtinë popullore të kohës së vet e pastaj atë e prezantoi si të Pejgamberit (a.s.).

Përfundim

Të mësosh tekstin përmendsh, t'i japësh formë të shkruar dhe të verifikosh para mësuesit kompetent – këto janë tri masa të sigurimit, prej të cilave secili prej tyre i ndihmon tjetrës – të cilat na i kanë ruajtur mësimin fetar islam në formën e vet burimore. Kjo është e vërteta për Kur'anin, gjithashtu edhe për Hadithin, e cila përfshin kujtimet e pasardhësve të Muhamedit (a.s.) në atë që ai vetë e ka thënë, e ka punuar ose heshtazi e ka lejuar të punohet në mesin e besimtarëve. Të përkujtojmë, kalimthi, se Muhamedi (a.s.) si mësues i Islamit pati sukses të madh. Në vitin e dhjetë sipas Hixhretit ai shkon për në Mekë, me masën e haxhilerëve që numëronte se ka pasur afër 140.000 vetë (edhe pse në atë vit shumica e muslimanëve nuk kanë udhëtuar për në Mekë). Biografët e tregimtarëve të Hadithit theksojnë se numri i shokëve të Pejgamberit (a.s.), të cilët përmendin bile vetëm një hadith të Pejgamberit (a.s.), arrin në më shumë se 100.000 veta. Në mesin e tyre me siguri ka pasur përsëritje të të njëjtave ngjarje, njoftime të shumëfishta për të cilat flitet, duke mos llogaritur përsëritjet. Në dispozicion kemi 2000 hadithe vetëm për Pejgamberin (a.s.), hadithe të cilat iu përkasin aspekteve të dedikuara besimtarëve të tij, njësoj si për çështjet shpirtërore, ashtu dhe për çështjet materiale.

Kreu III

Koncepti i jetës

Aftësia jetësore e një shoqërie, e një populli, e një civilizimi, varet në masën më të madhe nga filozofia të cilën kjo shoqëri, ky popull, e praktikon në jetë dhe në ç'mënyrë e praktikon. Në shoqërinë primitive njeriu mendonte vetëm për vete dhe për të afërmit e vet. Mirëpo, në çdo periudhë historike që e njeh njeriu, jetojnë grupe njerëzish që dallohen nga të tjerët. Janë të njohura grupet e njëzet civilizimeve, por është e mundshme që së shpejti të gjendemi para një civilizimi të ri. Nga ana tjetër, civilizimi i një grupi, nuk do të thotë se pjesa tjetër e njerëzimit gjendet në nivelin primitiv, të egërsisë. Siç shihet, këtu është fjala për një përparësi relative në krahasim me grupacionet tjera, të cilat, varësisht nga niveli i tyre, janë radhitur në shkallët e civilizimit, për shembull në kohën e fenikaseve, shtetet tjera kanë pasur përafërsisht civilizim të ngjashëm, por iu mungonte vetëm rasti dhe fusha e veprimit. Në epokën arabe – islame, grekët, romakët, kinezët, indianët etj. kanë poseduar të gjitha cilësitë e popujve të civilizuar, por jo në atë nivel që të konsiderohen bartës të civilizimit të asaj kohe. Gjithashtu, në kohën tonë, edhe pse SHBA dhe Rusia iu prijnë fuqive nukleare, anglezët, francezët, gjermanët nuk ngelin shumë prapa tyre, por edhe në gjysmën e dytë të shekullit XX ekziston një shkallë e civilizimit, e cila

gradualisht shtrihet në stadin e egërsisë, siç vërejmë te disa fise që jetojnë të izoluara.

Parashtrohet pyetja: Përse përparimi i njëjës palë është i shpejtë, kurse i tjetrës i ngadalshëm? Pse kur Greqia kishte arritur kulmin e civilizimit, Evropa Perëndimore ishte barbare? Përse Rusia ishte barbare në epokën e lulëzimit arab? Përse është kështu në të gjitha vendet dhe në të gjitha kohët? A thua janë të rastësishme rrethanat që e kushtëzojnë, apo është meritë e disa personave të dalluar që lindin në njërin grupacion, ndërsa i mungojnë grupacionit tjetër? Gjithsesi, ka edhe sqarime të tjera të mundshme, më të ndërlikuara, të cilat varen nga një varg shkaqesh të njëkohësishme, që kushtëzojnë suksesin e njërit e mosp suksesin, bile edhe shkatërrimin, e grupacionit tjetër.

Është edhe një pyetje që lidhet ngushtë me të parën: Përse një popull, pas ngritjes dinamike, bie në mjerim, në mos edhe në gjendje barbare? Do të përpiqemi të shkoqisim këtë pyetje nga këndvështrimi i Islamit bashkëkohor, nëse është e mundur që t'i mësojmë gjasat për kapërcimin e kësaj. Sipas Ibn Haldunit, ligjet biologjike do të ishin shkaktarët kryesorë të dekadencës së civilizimit. Në mbarim të një gjeneratë të caktuar, raca shkatërrohet; që të përtërihet, nevojiten ndërrime radikale.

Kjo teori, që bazohet te raca, mund t'i befasojë civilizimet etnike dhe religjionet që nuk pranojnë ithtarë të rinj. Nga ky aspekt Islami mund t'i ikë procesit të dekadencës; ai ka ithtarë në të gjitha racat dhe vazhdon të përparojë pak a shumë çdo kund në botë. Islami, siç pranojnë të gjithë, eliminoi gati kre-

jtësisht paragjykimet racore brenda rrethit të bashkësisë së vet, e që i bën të mundur çdo race pa kurrfarë luhatshmërie të marrë pjesë në udhëheqësinë e saj. Emancipimi sistematik i robërve, të cilin e urdhëron Kur'ani, na jep këtë shembull të qartë: në historinë islame shënon gjenerata mbretërisht që rrjedhin nga robërit e posaçliruar.

Jeta apo vdekja e një civilizimi mund të varet gjithashtu nga karakteri fillestar i mësimit të tij. Nëse ky u apelon ithtarëve të vet të tërhiqen nga jeta, shpirti me siguri do të bëjë një përparim të madh, mirëpo elementi tjetër (fizik) njeriut, trupi i tij, aftësitë e tija intelektuale etj. nuk do të kryenin asnjë herë funksionin e vet natyror dhe do të zhdukej para se të zhbillohen. Nëse civilizimi e vë theksin vetëm në aspektin material, njeriu do të arrijë në ca fusha, në dëm të sektorëve të tjerë, kurse civilizimi do të shndërrohet në bumerang dhe do të shkaktojë vdekjen e vetë individit. Sepse, materializmi shpesh shkakton egoizëm, mungesë për të nderuar të drejtat e tjetrit. Ai krijon armiq, të cilët mezi presin shansin e tyre: rezultati është shfarosja mes vete. Është i njohur tregimi mbi dy vjedhësit, të cilët vodhën një pasuri: Njëri prej tyre shkoi në qytet të blente ushqim, tjetri shkoi për dru; mirëpo, çdonjëri fshehurazi vendos ta zhdukë tjetrin, që t'i mbetet krejt pasuria. Ai që shkoi të blente ushqimin, e helmoi tjetrin, kurse tjetri përgatiti pusinë që ta mbyste në të kthyer; por, kur ai filloi të hante, nuk u vonua shumë që ta shoqëronte në botën tjetër.

Edhe një mungesë mund të përvidhet te civilizimi: nëse ai absolutisht nuk posedon aftësi për t'u

zhvilluar dhe për t'iu adaptuar rrethanave, mësimi i tij, sado që të jetë i përsosur në një kontekst historik, nuk do të jetë në tjetrin dhe mjerë për ata që robërohen aty! Si p.sh. në kohën kur nuk kishte rrymë elektrike; t'i japësh një qiri faltores ku mbahen lutjet natën, do të ishte vepër devotshmërie. Nuk ka arsye të mos besojmë se një akt i këtillë devotshmërie nga ana e një të penduari mund t'ia falë gabimet e bëra ndaj Zotit ose ndaj njeriut. Mirëpo, në kohën kur shkëlqejnë llambat elektrike, të vazhdohet me ndezjen e një qiriri, a nuk do të ishte harxhim i kotë?

Të studiojmë tani Islamin në lidhje me këto kërkesa të shumta.

Ideologjia islame

Dihet se parimet islame, në thelb, nënkuptojnë mirëqenie në këtë botë dhe mirëqenie në të botën e përherëshme (formulë e Kur'anit). Kjo devizë qartazi hedh konceptet ekstreme të ultra-spiritualistëve (të cilët krejtësisht e refuzojnë këtë botë) dhe ultra-materialiste. Këtë formulë mund të praktikojë shumica e njerëzimit, e cila përpiqet të zhvillojë njëkohësisht trupin dhe shpirtin, duke vënë një ekuilibër harmonik, krejtësisht njerëzor. Islami jo vetëm që insiston në këto dy lloje të ekzistencës (trup-shpirt), por edhe në plotësimin reciprok, ashtu që njëri të mos bëhet fli për tjetrin. Islami kur urdhëron detyrat shpirtërore dhe mënyrat e jetës, ai synon edhe në përparësitë materia-

le; kur lëvdon një vepër të dobishme të kësaj bote, ai tregon sesi kjo vepër mund të jetë burim i zhvillimit shpirtëror. Disa shembuj:

Qëllimi i jetës shpirtërore është të na afrojë tek Allahu, Krijuesi ynë dhe të fitojmë simpatinë e Tij. Orvatet të “ngjyroset me ngjyrën e Zotit”, siç thotë Kur’ani; të shikojë me sytë e Tij, të flasë me gojën e Tij, të sillet plotësisht me vullnetin e Tij; derisa t’i përulet, aq sa lejon dobësia njerëzore. Pra, të marrim shembull çështjen e agjërimit. Besimtari duhet të rrijë urët në kohë të caktuar, të cilën e parasheh Kur’ani; kjo është rregull e Allahut. T’i përulesh përcaktimit të Allahut, është vepër devotshmërie, mirëpo konstatohet se agjërimi për njeriun ka përparësi të dyfishtë, shpirtërore dhe materiale. Duke e lodhur trupin për një kohë, forcohet shpirti, çlirohet nga epshet e kësaj bote; njeriu atëherë deri-diku u përngjan krijesave shpirtërore të cilat nuk hanë. Njeriu më së miri i vëren dobësitë personale, ai e kujton Allahun dhe gjithë atë që bëri për njeriun, këto janë vetëm aspektet shpirtërore. Shikuar në pikëpamje shëndetësore, agjërimi nuk është më pak i dobishëm; thartirat që i tajojnë gjëndrat për shkak të urisë dhe etjes, zhdukim shumë mikrobe në stomak; agjërimi zhvillon te njeriu aftësi të durojë në kohë të krizës, e njëkohësisht t’i kryejë detyrat e rregullta që i ka. Nëse agjërohet për shkaqe shëndetësore ky nuk ka asfarë vlere shpirtërore, mirëpo nëse agjërohet për kënaqësinë e Allahut, përparësitë fizike (shëndetësore) aspak nuk janë humbur. Pa mos hyrë në analizë më të thellë, mund të themi se të gjitha format e praktikës islame kanë gjithashtu kara-

kte të dyfishtë, shpirtëror dhe material. Kështu është te namazi vetëm ose në xhemat, të penduarit gjatë haxhillëkut, lëmosha për të vobektit dhe te detyrat tjera shpirtërore, të kryera jashtë obligimit minimal. Me fjalë të tjera, vepra e kryer apostafat në emër të Allahut, ka vlerë të dyfishtë; ajo sjellë dobi shpirtërore, e të mos humbet kurgjë nga interesi material. Anasjellstas, vepra e kryer për qëllime materiale mund të mbërrijë qëllimin e vet, mirëpo dobia shpirtërore humb krejtësisht. Të përmendim thënien e famshme të Muhamedit (a.s.): “Me të vërtetë, vlera e sjelljes së njeriut para së gjithash varet nga qëllimet dhe ajo çka e shtyn”.

Çka është me veprat e kësaj bote, si tatimi ose obligimi luftarak? Shtetit i paguet tatim, mirëpo në Islam ky “obligim shoqëror” është një shtyllë fetare nga pesë të tjerat, me rëndësi të barabartë sikurse dhe besimi, namazi, agjërimi e haxhi. Islami e bashkon njësoj shpirtëroren dhe materialen. Besimtari, kur paguan zeqatin, nuk e kryen atë sa për të kryer detyrën apo obligimin; ai, para së gjithash, lyp simpatinë e Allahut. Kur ky obligim i të paguarit të tatimit (zeqatit) konsiderohet gjë e shenjtë, si detyrë ndaj Allahut, të cilit nuk mund t’i fshihet kurgjë, Atij që është në gjendje të ngjallë të vdekurin dhe t’i lyp llogarinë, lehtë është të kuptojmë se besimtari sa kujdes i kushton kryerjes së këtij obligimi. Lufta sipas Islamit është e ndaluar, përveç “luftës në rrugë të Allahut”, luftës prej së cilës ushtari nuk shpreson asfarë dobie materiale; në këtë rast, luftëtari është më i aftë që gjatë një lufte për jetë a vdekje të mbetet njeri. Duke i spiritualizuar (shpirtëruar) obligimet e kësaj bote, Islami

anon të përforcojë vlerat shpirtërore të njeriut, që nuk ndjek një interes material, por mundohet të mbërrijë kënaqësinë e Allahut (xh. sh.). Mistiku i madh Gazaliu assesi nuk e teproi kur tha: Nëse dikush agjëron ose lutet për sy e faqe, kjo është shirk (politeizëm); sepse, ai adhuron vetveten, jo Allahun. Njeriu t'i plotësojë detyrat bashkëshortore e ky akt të mos ketë kryekëput vetëm qëllimin e dëfrimit e të kënaqësisë, por nga dëshira që të plotësojë një vepër të cilën ia lyp Allahu - një e drejtë e bashkëshortes, një detyrë e vërtetë e bashkëshortit konsiderohet devotshmëri dhe meriton simpatinë e Allahut dhe shpërblimin e Tij. Pohimin për këtë koncept universal jetësor Kur'ani shpeshherë e përdor si formulë të dyfishuar: "Besoni dhe bëni punë të mira". Angazhimi i thjeshtë me fe, pa e zbatuar në praktikë, nuk ka vlerë të duhur. Kryerja e veprave të mira pa besimin tek Allahu, nga aspekti shoqëror, sigurisht është më e pëlqyer prej veprave të këqija, mirëpo, nga aspekti shpirtëror, një vepër e mirë pa besim nuk sjell shpëtim në Botën tjetër. Nëse është rëndësia e tillë, atëherë gjithashtu është me rëndësi të dallojmë të mirën prej të keqes. Çfarë kriteri do të ketë këtu? Në rend të parë, ai është Ligji i Shpallur nga Allahu, por tek e fundit edhe ndërgjegjja e personit mund të jetë arbitrare. Të ballafaquar me ndonjë problem, mund të kthehemi drejtpërdrejt në Ligjin Islam; nëse jemi të aftë vetë ose me ndihmën e ekspertit nëse ka nevojë. Mirëpo, juristi do të japë përgjigje në bazë të fakteve që i ka përpara; nëse i fshihen faktet materiale, padrejtësia që vjen si pasojë e saj nuk mund t'i përshkruhet ligjit. Të përmendim fja-

limin e shkurtër e të shkëlqyer të Muhamedit (a.s.) në lidhje me këtë: “O popull, ankesat që mbërrijnë tek unë i shqyrtoj vetëm në bazë të fakteve që më janë dhënë; nëse në bazë të fakteve të pakompletuara ose të devijuara dikujt ia jap atë që nuk i takon, le ta dijë ai se i kam dhënë zjarrin e xhehenemit”. . Një rregull juridike islame jashtëzakonisht e përfshin këtë mësim: “Pyete ndërgjegjen tënde, edhe pse të kanë dhënë të drejtë juristët”.

Të mendosh vetëm për veten, nuk është njerëzi, por shtazëri; të mendosh për nevojat e tjetrit, pasi i ke plotësuar nevojat personale, kjo është normale, e lejuar; mirëpo, Kur’ani i lavdëron ata njerëz që iu “... dhe u japin përparësi, madje edhe kur kanë nevojë për vete. ...”. (Kur’an, 59:9). E qartë, kjo është vetëm porosi, por jo obligim për njeriun e rëndomtë: nëse nuk vepron sipas kësaj, nuk do të konsiderohet mëkatar. Në këtë grup të porosive është thënia e njohur e Pejgamberit (a.s.): “Më i miri ndër njerëzit është ai që është bamirës ndaj të tjerëve”.

Karakteristikë islame mund të konsiderohet kjo thirrje e Kur’anit: “...për bamirësit e Allahut tënd trego...” Pejgamberi (a.s.) këtë e sqaron në mënyrë ekspresive: “Zoti dëshiron t’i shohë gjurmët e bamirësisë së Vet te robi i Vet”. Me këto fjalë synon një mik të vetin, i cili edhe pse është pasanik, u paraqit në një gjendje të mjeruar. Në pyetjen e Pejgamberit (a.s.), njeriu u përgjigj se ‘këtë nuk e bëra nga koprracia, por se dua më tepër fukentë se veten’. Muhamedi (a.s.) ia tërhoqi vërejtjen, se të dhënat kanë kufi, e që nuk duhet të tejkalohet mesatarja. Kur’ani (28:77) urdhëron:

“...por, mos harro as pjesën tënde (përgjegjësinë tënde) në këtë botë...” (Mos lë pasdore punët tua personale). Islami nuk lejon që njeriu të ndërprejë punën dhe të bëhet parazit: përkundrazi, ai duhet të provojë të gjitha aftësitë që të shfrytëzojë atë që ka krijuar Allahu, duhet të fitojë aq sa është e mundur: ajo që tejkalon nevojat personale, duhet të shpenzohet në dobi të atyre të cilëve iu mungojnë gjërat elementare. Pejgamberi (a.s.) këtë e ka thënë pa ngurim: “Më mirë është që të afërmit tuaj t’i lini në begati sesa ata të detyrohen të lypin prej të tjerëve”. Duke urdhëruar jetë të lumtur shpirtërore, Islami, bile, rastësisht nuk lejon pasivitetin e as varfërinë me dëshirë, përkundrazi, ai e gjykon këtë të fundit, duke thënë: “Thuaj: ‘Kush i ka ndaluar stolitë e Allahut dhe ushqimet e mira, të cilat Ai i ka bërë për robërit e vet?’ Thuaj: Këto janë posaçërisht për besimtarët, të cilët në këtë botë e kanë besuar Ditën e Kiametit. Ja, ashtu ne ua shpjegojmë argumentet njerëzve që dinë” (7:32). Ka gjëra të lejuara me Ligjin e Allahut; t’ia ndalosh vetes këto, nuk është gjithmonë akt devotshmërie, sikur të largohesh prej gjërave të ndaluara me Ligjin islam.

Besimi tek Allahu (xh. sh.)

Si duket, njeriun qysh herët e ka interesuar njohja e Krijuesit dhe nevoja për t’iu përrulur Atij. Përfaqësuesit më të mëdhenj religjioz të të gjitha epokave, civilizimeve, kanë vërtetuar ca rregulla që i çojnë

njerëzit në këtë drejtim: primitivët kanë adhuruar manifestimin e fuqisë dhe bamirësinë e Zotit, duke shpresuar se në këtë mënyrë do ta kënaqin. Ca popuj kanë besuar në dy zota të veçantë, një zot të së mirës dhe një të së keqes, duke mos u kujdesur për pasojat logjike të këtij dallimi, i cili shkakton luftë mes zotave. Të tjerët kishin besime misterioze, të cilat nganjëherë e fshihnin personalitetin e zotit; të tjerët nuk ndienin nevojën për simbole, formula dhe lëvizje – fenë e tyre e përmbushnin ashtu që mezi mund të dallohej nga idhujtaria dhe politeizmi.

Islami për këtë ka formulë të posaçme – besimin absolut në Allahun Një; Ai cakton një mënyrë të lutjes dhe adhurimit, që nuk lejon fotografi e as simbole (këto quhen gjurmë të idhujtarisë dhe të primitivizmit). Zoti është transcendental dhe jomaterial, jashtë çdo nocioni fizik; Ai është gjithkund prezent dhe i gjithëfuqishëm. Marrëdhëniet mes njeriut dhe Zotit të tij janë direkte, pa ndërmjetësim. Personat më të shenjtë, siç janë pejgamberët, janë vetëm udhëheqës dhe të dërguar. Njeriu e ka për detyrë të zgjedh: ai është përgjegjës i drejtpërdrejtë para Allahut.

Do të shohim se si Islami në këtë aspekt kërkon që të zhvillohet personaliteti i njeriut: ai e ka lehtë të kuptojë se është i dobët dhe se paraqet fushë lufte mes së mirës dhe së keqes. Por, në Islam nuk ka mëkat fillestar (të trashëguar). Kjo do të ishte e padrejtë. Nëse Ademi (a.s.) gaboi, kjo nuk do të thotë se të gjithë pasardhësit e tij janë përgjegjës, pasi çdokush përgjigjet për veprat e veta. Njeriu për shkak të dobësive të veta mund të gabojë ndaj Allahut, si dhe ndaj

të tjerëve. Çdo gabim, në esencë, ka dënimin përkatës, mirëpo Islami ka lënë mundësi faljeje. Këtë e përbëjnë: pendimi dhe përmirësimi. Dëmi i bërë ndaj njerëzve lypset kompensuar sa është e mundur; i dëmtuari mund ta falë pa kompensim, ose në ndonjë mënyrë tjetër. Sa i takon gabimit ndaj Allahut, njeriu mund të arrijë shpëtimin me një pendim të vërtetë, ose me të fituarit falje nga ana e Allahut. Gjithashtu, Islami nuk pranon se Allahu do ta gjykojë të pafajshmin, për t'i falur mëkatet e fajtorëve të penduar, meqë kjo do të ishte e padrejtë.

Shoqëria

Duke zhvilluar njerëzit ndjenjën e personaliteti, Islami gjithashtu kërkon që ata të ndihen anëtarë të bashkësisë së cilës i takojnë. Kjo shihet në të gjithë normat e tij, fetare e jetësore. Falja e namazit, përgjithësisht, është kolektive. Haxhillëku është shembull konkret, meqë fetarët e mbarë botës takohen në një vend. Aspekti kolektiv i agjërimit qëndron në faktin se ai mbahet në të njëjtën kohë, për të gjithë muslimanët e botës. Nevoja për një halif, obligimi për taim-zeqat, dedikuar nevojave të përbashkëta, etj. e tërë kjo të çon në një qëllim të përbashkët. Kuptohet se në këtë kolektiv solidar ekziston një fuqi të cilën po ata njerëz individualisht nuk e kanë.

Zoti, nga shkaqet që i di vetëm Ai, individëve u ka falur dhunti të ndryshme: dy fëmijë të një çifti, dy nxë-

nës të një klase - nuk kanë gjithmonë aftësi dhe kualitet të njëjtë. Të gjitha arat nuk janë njësoj pjellore; klima gjithashtu dallon. Dy pemë të një lloji nuk japin fryt të barabartë e as me cilësi të njëjta. Çdo qenie, çdo pjesë e një qenie, ka cilësitë e veta. Duke nxjerrë përfundim nga ky fakt natyror, Islami vërteton barazinë burimore për të gjithë dhe llojshmërinë individuale; të gjitha krijesat janë të të njëjtit Zot, ndërsa për të fituar simpatinë e Tij, nuk vendos superioriteti material. Kriteri i vetëm i autoritetit të individit është devotshmëria. Më në fund, jeta në këtë botë është kalimtare, kërkohet të bëhet dallimi në sjellje midis njeriut dhe shtazës.

Kombësia

Islami refuzon që në "lindje" (prejardhje) të parashohë bazën për solidaritetin ndërnjerëzor. Përkushtimi ndaj farefist, ndaj vendlindjes, është i natyrshëm, mirëpo interesat e racës njerëzore kërkojnë tolerancë ndaj grupeve të tjera. Ndarja e pabarabartë e pasurive natyrore sjell varshmërinë. Patjetër del që të ndiqet kredoja "të jetosh dhe të lësh të tjerët të jetojnë", përndryshe hakmarrjet e pafund do të mbaronin me shkatërrim të njëres e të tjetres.

Kombësia e bazuar në gjuhë, racë, ngjyrë, vendlindje është shumë primitive; aty ka fatalitet, rrugë pa shtegdalje, diçka ku njeriu nuk ka asfarë zgjedhje. Kombësia islame është progresive dhe bazohet vetëm në zgjedhje individuale, sepse ofron bashkim për të

gjithë ata që i besojnë ideologjisë së përbashkët, pa marrë parasysh racën, gjuhën, vendbanimin. Pasi që refuzon të robërojë dhe të nënshtrojë të tjerët, asimilimi ngel rrugë e vetme e drejtë. Vallë, cila mënyrë e asimilimit të vërtetë do të ishte më efikase përveç besimit në një ideologji? Ideologjia islame është jashtëzakonisht e qartë në këtë drejtim. Islami jo vetëm që realizon sintezën mes dukurive trupore dhe shpirtërore, por ai është gati i vetmi prej religjioneve të “mëdha” që lejon tolerancën. Islami sqaron se Allahu pandërprerë dërgoi peygamberë në të gjitha epokat dhe në popuj të ndryshëm (që do të thotë, vetëm fuqi rigjenerimi, përtërirjeje dhe përforcimi të Shpalljeve të Zotit, të përsëritura aq herë prej aq peygamberëve). Islami ndalon çdo dhunim për formimin e besimit; dhe, sado që të duket e pabesueshme, ai obligohet me obligim fetar – t’u japë autonomi jomuslimanëve në mesin e shtetit musliman. Kur’ani, Hadithi dhe praktika e përditshme dëshirojnë që jomuslimanët të drejtat e tyre t’i realizojnë në gjyqet e tyre, nga gjykatësit e tyre, pa kurrfarë përzierje të pushtetit islam, qoftë për çështje fetare apo shoqërore.

Jeta ekonomike

Rëndësia e çështjeve ekonomike është shumë evidente. Kur’ani thotë se baza materiale është “kusht për ekzistencën e njerëzimit”. Nëse çdokush do të mendonte vetë për vete, shoqëria do të shkonte ditë për

ditë në rrezik; logjikisht, në të gjithmonë do të ishte pak pasanikë e shumë të vobegët. Në momentet e luftës për ekzistencë, shumica e të vobektëve do ta zhduknin pakicën e pasanikëve. Mund të durohen shumë vetëmohime, por jo edhe ato që i përkasin ushqimit. Qëndrimi i Islamit në këto çështje është mirë i njohur: ndarja e parasë dhe qarkullimi i pasurisë kombëtare. Të vobektit lirohen nga tatimi, ndërsa të pasurit janë të detyruar të japin në favor të fukarenjve; ekzistojnë ligje për ndarjen e trashëgimisë, të cilat ndalojnë akumulimin e kapitalit te një numër i vogël, ligje që përshkruajnë harxhimin e të ardhurave shtetërore, ligje që kanë për detyrë shpërndarjen e të ardhurave për qëllime humanitare, ku të vobektit janë në rend të parë.

Kur është vendosur kjo rregull, Islami lejoi mjete dhe metoda të ndryshme sipas territoreve, epokave dhe rrethanave përkatëse që të arrihet qëllimi.

Mund të lejohet gara (licitimi) e ndërmarrjeve private, me kusht që të mos shndërrohen në eksploatues dhe zhdukës të dobësive ekonomike; gjithashtu, mund të lejohen edhe plane të përbashkëta, kur ato janë të domosdoshme për shkak të rrethanave të zhbillimit ekonomik ose demografik. Në çdo rast, duhet ruajtur nga shkapërderdhja e begative dhe e energjisë, si dhe duhet zgjedhur mjete të cilat më së miri iu përshkatan nevojave momentale.

Liria e vullnetit dhe fati

Kjo do të na çojë në pyetjen filozofike të vullnetit të lirë. Kjo dilemë e përjetshme nuk do të zgjidhet asnjëherë në mënyrën që të kënaq logjikën, për shkak se nëse njeriu do të kishte lirinë e zgjedhjes në të gjitha sjelljet e veta, fuqia e Zotit do të ishte gjymtuar; anasjelltas, nëse Zoti përcakton, përse njeriu përgjigjet për veprat e veta? Pejgamberi i Allahut i këshillonte besimtarët që të mos diskutojnë për këtë temë, “e cila i ka dërguar në qorrsoqak ata para jush”. Ai i ka daluar dy pyetje: fuqinë e plotfuqishme të Allahut dhe përgjegjësinë njerëzore. Dashuria nuk ka logjikë, ndërkaq muslimani që e do Krijuesin e vet nuk do të pranojë se Zoti ka të meta. Zoti është jo vetëm i fuqishëm dhe i logjikshëm, por gjithashtu i drejtë dhe i mëshirshëm në gradën më të lartë. Duke dalluar veprat e Zotit nga çështje të ekzistencës së njeriut në këtë botë, Islami ithtarëve të vet iu thekson nevojën e veprimtarisë; pasi që vullneti i Allahut do të ngelë fshehtësi për njeriun, është detyrë e njeriut që asnjëherë të mos humbet shpresën, të punojë dhe të mundohet gjersa të realizojë qëllimin, ose të ngelë i parelizuar. Në momentin – kur është krejt gati për sukses – ndërmjetëson të kuptuarit e fatit sipas Islamit, që ta qetësojë dhe ngushëllojë njeriun; kjo është dëshira e Allahut! Vallë, suksezi ose mossuksezi në këtë botë nuk është me rëndësi për shpëtim të përjetshëm, ku do të gjykojë Allahu sipas qëllimit dhe mundit, e jo sipas rezultateve dhe sukseseve.

Në Kur'an (53:36,42) Allahu na njofton për pejgamberët e dërguar: A nuk mjafton ajo që është në Suhufet e Musait dhe të Ibrahimit, i cili zbatonte çdo obligim; Dhe asnjë mëkatar nuk do të bart mëkatet e tjetrit, Dhe se njeriu ka vetëm atë që e punon vet, Dhe se munda i tij do të shihet, pastaj do të shpërblehet me shpërblim të merituar; Dhe se, te Zoti yt do të kthehen". Kuptohet, nëse njeriu nuk do të konsiderohej përgjegjës për veprat e këqija dhe për mëkatet, para fuqisë së Allahut ai nuk duhet të kërkojë as shpërblim për sjelljet e mëshiruara. Shkurt, pasi që Islami në tërësi i ndan këto dy çështje të parashtruara, nuk e ka rëndë t'i pranojë nevojat e njeriut, mundimet, ndërjegjen e përgjegjësisë dhe të drejtat e Allahut, me gjithë cilësitë e Tij, duke përfshirë edhe fuqinë e përcaktimit.

Përcaktimi në Islam ka një aspekt tjetër, jo më pak të rëndësishëm: Allahu është Ai që përcakton se a është vepra e njeriut e mirë apo e keqe. Allahu është burim i çdo ligji. Ajo ku duhet pasur kujdes në çdo sjellje tonë është rregull e Allahut, është rregull të cilën Ai e proklamonte nëpërmjet pejgamberëve të vet të zgjedhur, prej të cilëve Muhamedi (a.s.) jo që është vetëm i fundit, por mësimi i tij është ruajtur në tërësi. Origjinalet e Shpalljeve të vjetra nuk ekzistojnë. Ato kanë humbur gjatë luftërave fatale, vëllavrasëse dhe dëbimeve. Kur'ani jo vetëm që është veçori, por ai paraqet porosinë e fundit të Allahut, Kushtetutën më të re, e cila, siç dihet, revokon dispozitat e vjetra po të atij Ligjdhënësi.

Të mbarojmë me një karakteristikë tjetër të jetës islame: obligimi i muslimanit është jo vetëm t'i përm-

bahet Ligjit të Allahut në jetën e përditshme, në atë personale dhe shoqërore, në çështjet e kësaj bote materiale e shpirtërore, por edhe sipas aftësive dhe mundësive të veta të kontribuojë për përhapjen e kësaj ideologjie të bazuar në Shpalljen e Allahut, me qëllim të shpëtimit dhe të prosperitetit në mbarë botën.

Do të shohim se kjo tërësi ndikon në tërë jetën – materiale dhe shpirtërore – të njeriut, i cili, tekefundit, këtu, në tokë, vetëm duhet të përgatitet për atë botë.

Kreu IV

Njeriu dhe besimet e tij

Besimet e njeriut janë shumë të ndryshme: nga një anë, në të hyn e vërteta dhe gjithçka që ka lidhje me të; nga ana tjetër, besëtytnitë dhe lajthitjet tjera. Në besim, përveç faktorëve tjerë, mund të ndikojnë koha e jetës dhe përvoja. Mirëpo, ka besime të përbashkëta për të gjitha grupet. Në këtë aspekt pyetja kryesore të cilën njeriu ia parashtron vetes është: prej nga ka ardhur? E kështu me radhë. Metafizika përpiket të përgjigjet në këto pyetje të vështira. Thënë shkurtimisht, aty edhe ngërthehet thelbi i fesë. Në të vërtetë, besimi është çështje personale, mirëpo historia e gjinisë njerëzore njih shumë akte të vëllavrasjes, të dhunës dhe të akteve shtazarake, për shkak të atyre besimeve, të atyre dhunime, prej të cilave edhe shtazët do të ishin turpëruar. Parimi themelor islam në lidhje me këtë çështje përshtrohet në ajetin e Kur'anit (2:256): “Në fe nuk ka detyrim – rruga e drejtë dallohet qartazi prej të gabuarës! Ai që nuk i beson shejtanit dhe i beson Allahut – ai mbahet në lidhje më të fortë, e cila nuk do të këputet kurrë. Ndërkaq, Allahu të gjithë i dëgjon dhe i di”. Në te qëndron mëshira, bile edhe flijimi, që të tjerët të udhëheqin dhe të zhvillohet lufta për të thyer gabimin e të tjerëve, pa dhunuar çfarëdo forme të jetë ajo. Ky është qëllimi i Islamit.

Njohuritë dhe inteligjenca njerëzore gjithmonë i janë nënshtruar procesit të zhvillimit. Dituria e medi-

cinës ose e matematikës e një Galeni ose e një Euklidi sot mezi mjafton për të dhënë provimin e maturës; studentët e universitetit patjetër duhet të dinë më tepër. Sipas dogmave të religjionit, njeriu primitiv ndoshta ka qenë i paaftë të mendojë Zotin në mënyrën abstrakte, adhurimi i të cilit nuk do të kishte lypur as simbolet, as paraqitjen materiale. Bile, gjuha e tij ka qenë e paaftë të shqiptojë idetë e larta, të mos jetë detyruar të përdorë termat që nuk u përgjigjen mendimeve abstrakte.

Islami e potencon me të madhe faktin se njeriu është i përbërë prej dy elementeve: prej trupit dhe shpirtit dhe se nuk i lejohet të lërë pasdore njërin element në të mirë të tjetrit. T'u kushtohesh vetëm nevojave shpirtërore, do të kuptohej se duam të bëhemi engjëj (melaqe, ndërsa Allahu i ka krijuar engjëjt). T'u kushtohesh vetëm kënaqësive trupore, do të kuptohej se kemi rënë në nivelin e shtazëve, të bimëve, po qe se je në nivelin e dreqit (shejtanit, ndërsa Allahu ka krijuar krijesat tjera që e kanë këtë funksion). Qëllimi i krijimit të njeriut me natyrën e tij të dyfishtë, materiale e shpirtërore, nuk do të mund të arrihet nëse njeriu nuk e mban ekuilibrin harmonik mes nevojave trupore dhe nevojave shpirtërore.

Me një rast, në pyetjen “çka është feja?” Muhamedi (a.s.) është përgjigjur: “Të besosh në Një Allah, në melaqet (engjëjt) e Tij, në Librat e Shpallur të Tij, në Ditën e Gjykimit dhe në përcaktimet e Allahut, të mira apo të këqija qofshin ato”. Në të njëjtën kohë, Muhamedi (a.s.) sqaroi çka do të thotë praktikisht t'i

përulesh Allahut (xh. sh.), për të cilën gjë do të flasim në dy kaptinat e ardhshme.

Allahu (xh. sh.)

Muslimanët nuk kanë kurrnjë të përbashkët me ateistët, me politeistët dhe me ata që Allahut i bëjnë shok zota të tjerë. Fjala arabe për Zotin e vetëm është Allah, e cila nuk ka as gjini femërore as shumës. Njeriu më i rëndomtë, madje edhe më primitivi dhe më i padituri e di se nuk mund ta krijojë vetveten, se duhet të ekzistojë Krijuesi i të gjithë neve, i tërë botës. Ateizmi nuk e kënaq këtë nevojë të logjikës.

Feja në shumë zota përmban në vete këtë përfundim: ndarjen e pushtetit midis zotave të ndryshëm, madje edhe luftë mes tyre. Lehtë mund të vëmë re se gjithçka që gjendet në botë është e varur mes vete. P.sh., njeriut i duhet ndihma e bimëve, e metaleve, e shtazëve, bile edhe yjeve, siç është për secilin prej tyre e nevojshme ndihma e të tjerëve në këtë ose atë mënyrë. Ndarja e fuqisë hyjnore, kështu, është e paralizueshme.

Në bregat e veta të arsyeshme që të mos i shkruajmë të keqen Zotit, një numër i mendimtarëve deshën të kenë dy zota, njërin për të Mirë, kurse tjetrin për të Keq. Mirëpo, parashtrahet pyetja a thua se ata dy zota veprojnë sipas marrëveshjes ose midis tyre mbretëron gjithmonë përleshja? Në rastin e parë dyshi i zotit (qenies hyjnore) bëhet e tepërt, nëse zoti i së

Mirës i lejon zotit të së Keqes, ai bëhet pjesëmarrës i tij dhe kështu dyshi e humb qëllimin e vet personal. Në rastin tjetër, mund ta zëmë se zoti i së Keqes shpesh do të jetë fitues dhe se do ta mund zotin e së Mirës. Vallë, a mund të besohet në zotin i cili do të ishte i dobët, i mundur?! Përveç kësaj, e keqja është çështje relative; gjithçka që është e keqe për dikënd, për tjetrin është e mirë, dhe mbasi që e keqja absolute nuk ekziston, atëherë nuk mund t'i atribuohet e keqja zotit. Vetëm monoteizmi i pastër dhe pa përzjerje mund të kënaqë mendjen, Zoti është Një, mirëpo mund të veprojë në të gjithë mënyrat. Andaj, rrjedhin atributet e Tij të shumëfishta. Zoti nuk është vetëm krijues, por edhe sundues i të gjithëve: ai sundon qiej dhe në tokë; asgjë nuk sillet pa dijen e Tij dhe lejen e Tij. Pejgamberi (a.s.) thotë se Zoti ka nëntëdhjetenëntë emra “më të mirë” që u përgjigjen nëntëdhjetenëntëtributeve. Ai është krijues, burim i jetës së të gjithëve, i Urtë, i drejtë, i mëshirshëm, i pranishëm gjithkund, i gjithëfuqishëm, i gjithëdijshëm, i përcakton të gjitha. Në duart e Tij është jeta, ringjallja e të gjitha qenieve, e kështu me radhë.

Prej kësaj përfundojmë se njerëz të ndryshëm kanë zot të ndryshëm; një filozof nuk mendon me të njëjtën mënyrë sikur një njeri i rëndomtë. Pejgamberi (a.s.) kënaqej me besimin e zjarrtë të njerëzve të rëndomtë dhe shpesh, për shembull, përmendte “besimin e grave të vjetra”, të parrënueshme dhe përplot me besim të singertë. Shumë mirë është e njohur përallëza e bukur për elefantin dhe grupin e të verbërve; ata kurrë nuk kanë dëgjuar asgjë për elefantin. Kur

erdhi një ditë në fshatin e tyre, secili prej tyre iu afrua shtazës së parëndomtë. Njëri pati sukses të vinte dorën në feçkën e elefantit, tjetri i preku veshin, i treti këmbën, i katërti gishtin e kështu me radhë. Më vonë ata ëndërruan përshtypjet e tyre dhe secili e përshkroi elefantin në mënyrën e vet dhe sipas përjetimit të vet. Kështu që elefanti dukej si një direk i lakuar (feçka), si fletë (veshi), si diçka e lëmueshme (dhëmbët), në formë të cilindrit të hollë (bishti)... Secili kishte të drejtë, mirëpo asnjëri nuk e dinte tërë të vërtetën, e cila ishte jashtë aftësive të vrojtimit të tyre. Nëse të verbërit e përrallzës sonë i zëvendësojmë me kërkesat e Zotit të padukshëm, lehtë do t'i pasqyrojmë vetes relativitetin e të vërtetës së përvojave njerëzore. Një mistik prej ditëve të para të Islamit ka vërejtur: "Ekziston e vërteta për Zotin të cilën e njeh njeriu i rrugës; ekziston tjetra, të cilën e njohin të udhëzuarit; të tretën, të cilën e kanë peygamberët e frymëzuar nga Zoti dhe, pas të gjithave, të vërtetën të cilën e di vetë Zoti. Nga kjo që u tha më lart e i atribuohet Muhamedit (a.s.) ka mjaft elasticitet se si të plotësohen nevojat e kategorive të ndryshme të njerëzve, të të shkolluarve, si dhe të të thjeshtëve, të inteligjentëve, si dhe pak të talentuar, poetëve, artistëve, juristëve, teologëve dhe të gjithë të tjerëve. Pikëpamja dhe këndi i vështrimit mund të ndërrojë sipas çdo individ, mirëpo objekti i vrojtimit mbetet i pandryshuar.

Muslimanët e arsimuar e kanë ngritur tërë sistemin e tyre mbi baza të drejtësisë, ku e drejta dhe obligimet plotësohen mes vete. Ne kemi organe dhe aftësi të cilat na i ka falur Zoti, ndërsa çdo dhunti ku-

shtëzohet me obligime të posaçme. Të adhurosh Zotin, t'i jesh falënderues, t'i jesh i dëgjueshëm, t'i largohesh çdo gjëje që nuk i përgjigjet qenies së Tij universale, e tërë kjo paraqet detyrë për çdokënd, për çka secili veçanërisht dhe personalisht do të përgjigjet.

Engjëjt (melaqet)

Zoti nuk duket dhe gjendet në anën tjetër të çdo perceptimi fizik. Ishte e nevojshme të krijohen mjete të kontaktit mes Zotit dhe njeriut. Pa këtë, njeriu nuk do të ishte e mundur të dëgjonte Dëshirën e Zotit. Zoti jo vetëm që e krijoi trupin tonë, por edhe aftësitë tona, të cilat janë të ndryshme dhe të cilat aq mund të zhvillohen. Ai na jep intuitën, ndërjegjjen morale, si dhe mjetet tjera përmes të cilave mbahemi në rrugën e drejtë. Shpirti njerëzor është i aftë për dy lloj inspirimesh, për inspirime të mira dhe të këqija. Nga mesi i botës së rëndomtë, njerëzit e mirë janë të aftë nga njëherë të pranojnë inspirime të këqija (provim), sikur që njerëzit e këqij janë në gjendje të marrin frymëzimet e mira. Njeriu mund t'i marrë frymëzimet edhe prej anëve të tjera, përveç nga ana e Zotit, si p.sh. nxitjet e këqija vijnë prej djallit. Me dëshirën e Zotit na është dhënë fuqia e të kuptuarit tonë, që të mundemi të dallojmë atë që është e lartësuar dhe e kryejmë me respekt, nga ajo që është djallëzore dhe duhet t'i ikim.

Ekzistojnë shumë mënyra që të vendoset lidhja apo kontakti mes njeriut dhe zotit. Mënyra më e mirë

do të ishte inarknimi (personifikimi); mirëpo, kjo mënyrë e ka anën e vet të dobët, prandaj Islami e ka hedhur poshtë: për Zotin transcendent, do të ishte e tepërt dhe degradim të bëhej që njeriu të hante, të pinte, të ishte i munduar prej krijesave të veta, madje edhe të vritet. Pa marrë parasysh se sa mund të afrohet në rrugën e tij të Zotit, njeriu edhe në nivelin më të lartë mbetet njeri dhe ende është shumë larg Zotit. Njeriu mund ta zhdukë UNIN e tij, si thonë mistikët, dhe krejtësisht të shkatërrojë individualitetin e vet në orvatje për të vepruar sipas dëshirës së Zotit; mirëpo, përkundër kësaj – këtë e përsërisin – njeriu gjithmonë mbetet njeri dhe iu nënshtrohet dobësive të veta , ndërsa Zoti është mbi të gjitha këto të meta, Ai nuk ka të meta.

Përveç mjeteve të tjera të lidhshmërisë mes njeriut dhe Zotit, të cilat i ka në dispozicion njeriu, mjeti më i dobët ndoshta është ëndrra. Sipas Pejgamberit të Allahut, Muhamedit (a.s.), ëndrrat e mira paraqesin frymëzimin e Zotit dhe e çojnë njeriun në drejtim të mbarë.

Një mjet është “Ilka” (fjalë për fjalë, do të thotë: ajo që i hidhet dikujt tjetër), një lloj auto-sugjestionit, intuitë, parandjenjë për të marrë vendime në situata pa rrugëdalje, me probleme të pazgjidhura ose në raste të vështira.

Gjithashtu, ekziston “Ilhami”, që mund të përkthehet si “inspirim hyjnor”. “Inspirohet zemra (shpirti) i njeriut, shpirti i të cilit është zhvilluar mbi bazë të virtyteve të së drejtës. Kur dikush i dorëzohet Zotit dhe orvatet ta harrojë veten, ka orë – në të vërtetë shumë të shkurtra – kur prania e Zotit ndriçon sikur

rrufeja, mirëpo kjo është gjendja të cilën pa mund të madh kuptohen çështjet të cilat njeriu nuk mund t'i kuptojë edhe pas përpjekjeve më të mëdha. Ashtu është shpirti i njeriut – ose zemra e tij, siç thoshin të vjetrit e ndritur, prandaj njeriu ka ndjenja të sigurisë, të kënaqësisë dhe të zbulimit të së vërtetës; Zoti e udhëheq dhe e kontrollon në mendimet e tij, si dhe në veprat e tij. Përveç tjerave, edhe pejgamberët, do të thotë të dërguarit e Zotit – e pranojnë këtë lloj të udhëheqjes. Për çdo rast, mbetet mundësia e errësirës në arsyetimin dhe kuptimin nga ana e njeriut. Mistikët pretendojnë se herë pas here edhe njerëzit më të devotshëm ndonjëherë pa dashur gabojnë, për shkak të ekzistimit të vet dhe nuk mund të zbulojnë impulsin e ulët që i vë në sprovë.

Gradën më të lartë të kontaktit, mjetin më të sigurt dhe më të pagabuar për lidhjen mes njeriut dhe Krijuesit të tij Muhamedi (a.s.) e quan “Vahj”. Ajo nuk është frymëzim i thjeshtë, por Shpallje e vërtetë, të cilën Zoti ia jep njeriut; ajo është Shpallje e Shenjtë. Njeriu është materie; Zoti, përkundër kësaj, është, bile, edhe më lart se shpirti, pra në anën tjetër të çdo mundësie të lidhjes direkte, fizike, me njeriun. Zoti është transcendent (shumë i lartë), sikur që thotë Kur’ani (6:103): “Shikimi njerëzor nuk mund të arrijë deri tek Ai, por Ai arrin deri te të gjitha shikimet; ai është i mëshirshëm dhe i informuar për gjithçka”. Zoti, gjithashtu, është çdokund, i përhershëm, siç thotë Kur’ani (50:16) “...Na jemi më afër njeriut se sa delli i qafës”. Mirëpo, asnjë takim fizik nuk është i mundur me Të. Prandaj engjëlli – fjalë që sikur edhe

ekuivalenti i saj islam melaqe do të thotë lajmëtar – paraqet lajmëtarinë e Zotit, melaqen. Megjithatë, duhet të përkujtojmë se në Islam Pejgamberi i Zotit nuk është pejgamber i cili profetizon, i cili parasheh, por vetëm pejgamber i Zotit, njeri i cili popullit të vet ia tregon Shpalljen e Zotit. Për sa iu përket melaqeve, mjafton të dimë se ato sjellin vetëm lajmin e ne hyjmë në diskutime të pafrytshme, a thua se këtu është fjala për qenien shpirtërore, të cilat dallohen prej qenieve materiale të botës, apo për diçka tjetër.

Sipas Kur’anit, lajmëtari i Zotit, që i sjell Shpalljen Pejgamberit, quhet Xhibril, që në kuptimin etimologjik do të thotë Fuqia e Zotit. Kur’ani gjithashtu flet për melaqen Mikail, duke mos përmendur funksionin e saj . Rojtar i Xhehenemit është Maliki (fjaë për fjale: sundues). Kur’ani flet edhe për melaqet tjera, duke mos i përmendur emrat e tyre e as atributet – cilësitë, mirëpo – ato të gjitha i kryejnë urdhrat e Zotit. Sipas kuptimit islam, Xhebraili, të cilin Kur’ani gjithashtu e quan “Ruhul – Eminë”, shpirti i denjë për besim, e ka gradën më të lartë se melaqet tjera. Sipas fjalëve të Muhamedit (a.s.), e dimë se kjo melaqe, Xhebraili, nuk i është paraqitur Pejgamberit (a.s.) gjithmonë në të njëjtën formë. Në një rivajet, të cilin e transmeton Ibn Hambeli, përmendet se një ditë para një grupi njerëzish Muhamedit (a.s.) i paraqitet një njeri i panjohur dhe i parashtron disa pyetje – prej të cilave disa i kemi përmendur në tekstet e lartpërmendura, pastaj largohet duke mos lënë prapa kurrfarë gjurmësh. Disa ditë pas kësaj ngjarjeje, Pejgamberi (a.s.) u thotë shokëve të vet: “Jam i bindur se njeriu që atë ditë m’i

parashtroui pyetjet nuk ishte askush tjetër veçse Xhebraili, i cili erdhi t'ua mësojë juve fenë tuaj. Kurrë nuk e kam parë në atë formë”.

Mënyrën në të cilën vinte Shpallja mund ta kuptojmë prej lajmeve që vijojnë, në të cilat vetë Pejgamberi (a.s.) (ose shokët e tij) atë e kanë përshkruar: “Nganjëherë Shpallja më vjen si tringëllimë e ziles – ky për mua është përjetim më i rëndë – kur ajo ndalet thellë e mbaj në kujtesën time, të gdhendur krejt çka më është thënë: ndonjëherë melaqja më paraqitet në formën e ndonjë njeriu, më flet dhe unë e mbaj në mend atë çka thotë ajo”. (Buhariu). Te Hambeli për të njëjtën çështje thuhet: “Dëgjoj jehonë të zërit, pastaj mbretëron qetësia: nuk ka raste të Shpalljes e të mos frikësohem se do të më dalë shpirti”. Shokët e tij i paraqesin vrojtimit e tyre kështu: “E kudo që i vinte Shpallja, e kaplonte një lloj palëvizshmërie”. (Ibn Hambel). Ose: “Kudo që i vinte Shpallja Pejgamberit (a.s.), ishte në një gjendje të veçantë, sikur të ishte i mpirë”. (Ibn Sa’d). Ose: “Shpallja i vinte në një ditë shumë të ftohtë; kur ajo kalonte, balli i Pejgamberit ishte mbushur me pika të djersës”. (Buhariu). Ose: “Njëherë, kur erdhi koha (e Shpalljes), ai e fuste kokën dhe fillonte të gërhiste; shpejt ajo gjendje i kalonte”. (Buhariu). Ose: “Kurdo që vinte Shpallja, ai mundohej dhe fytyra e tij ngrysej”. (Ibn Sa’d). Ose: “Kur do t’i vinte Shpallja në afërsi të tij, dëgjonim diçka si zukamë të bletës”. (Ibn Hambel dhe Ibn Nua’in). Ose: “Pejgamberi i duronte dhimbjet e mëdha kur do t’i vinte Shpallja dhe zakonisht në atë moment ai ndiente një peshë shumë të rëndë”. Dhe

thonë: “E pashë Pejgamberin (a.s.) kur i erdhi Shpallja, derisa ishte në deve: devja filloi të shkumohet nga tërbimi dhe të shtrihej, saqë mendoja se këmbët do t’i thyheshin. Në të vërtetë, devja nganjëherë qëndronte me kokëfortësi, donte të qëndronte më këmbë, me këmbët e shtërnguara si hunj dhe kjo vazhdonte gjersa të kalonte kjo gjendje (e Shpalljes), ndërkaq djerësa sikur kishte vesuar në ballin e tij”. (Ibn Sa’d). Ose: “Pesha që e kishte Pejgamberi (a.s.) në momentin kur i vinte Shpallja) gati ia thyente këmbët devesë”. Zejd ibn Thabiti transmeton përvojën e vet për një ditë, duke thënë: “Këmba e tij ishte në kofshën time; aq ishte e rëndë, saqë më dukej se do të më pëlçiste ashti i kofshës”. (Buhariu). Në një version tjetër ka këtë shtesë: “... sikur të mos punohej për Pejgamberin (a.s.), do të piskatja dhe do ta hiqja këmbën time”. Lajmet tjera thonë: “Njëherë Shpallja i erdhi duke qenë në xhami e Pejgamberi (a.s.) ishte në minder; ai mbeti i palëvizshëm”. (Ibn Hambel). Ose: “Në dorë mbante një copë mishi (në kohën e ushqimit); kur i erdhi Shpallja (dhe kur ajo gjendje kaloi), copa e mishit ende ishte në dorën e tij”. (Ibn Hambel). Në këto raste, ndonjëherë njerëzit e shtëpisë, për nderim, ia mbulonin fytyrën me pëlhurë. Mirëpo, asnjëherë nuk e humbi vetëdijen e as vetëkontrollin. Në fillim të misionit të vet e kishte traditë që me zë të përsëriste, gjatë Shpalljes, atë që i ishte shpallur, mirëpo së shpejti, gjersa ishte në Mekë, e la këtë shprehje që të përsëriste aty për aty, por rrinte i qetë gjer në fund të kohës së Shpalljes e pastaj ia lajmëronte Shpalljen e Zotit shkruesit të vet, që ta shkruante (siç thuhet edhe

në Kur'an 75:16). "Mos e shqipto Kur'anin në gjuhën tënde që sa më parë ta mbash në mend. Ne jemi të obliguar ta mbledhim që ta lexosh ti". Edhe në një vend tjetër (20:214): "Mos shpejto me leximin e Kur'anit para se të përfundojë Shpallja dhe thuaj: O Zoti im, më zgjero dijen time". Kur Pejgamberi kthehej në gjendjen normale, ua diktonte shkruesve të vet pjesët e Kur'anit, të cilat posa i kishte pranuar që t'ua lajmërojë muslimanëve dhe t'i shumëzojë kopjet. Në librin El-Mebhathu vel-Megazi, Ibn Is'haki thotë: "Kur do që një pjesë e Kur'anit i shpallej Pejgamberit (a.s.), ai së pari ua recitonte burrave pastaj edhe grave".

Librat e shpallur

Mbasi që Zoti është sundues i tokës dhe i qiejve, është detyrë e njeriut që të jetë i dëgjueshëm ndaj Tij, madje, aq më tepër, Zoti për të shprehur Mëshirën e vet, për të mirën e njerëzimit dërgon pejgamberët e vet. Zoti është drejtues dhe burim i çdo ligji, si i atij fizik, edhe i atij shpirtëror. Ne pikërisht folëm për Shpalljen dhe për lajmërimin e dëshirës së Zotit në lidhje me njeriun. Librat e Shpallur paraqesin përmbledhjen dhe kodifikimin e atyre Shpalljeve.

Formula e fesë që mësoi Pejgamberi Muhamed flet për Librat e jo për Librin, gjë që, në rastin e fundit, do t'i përkiste vetëm Kur'anit. Ky tolerim dhe gjerësia e shpirtit është karakteristike për mësimin e tij. Kur'ani për këtë flet në shumë vende. P.sh. (2:285)

“...secili prej tyre (Muhamedi dhe muslimanët) besuan në Zot, në melaqet e Tij dhe në Pejgamberët e Tij (duke thënë): nuk bëjmë dallim mes pejgamberëve të Tij”. Gjithashtu (35:24): “...nuk ka asnjë bashkësi ku nuk ka ardhur Lajmëtari”. Gjithashtu (10:78): “Me të vërtetë, Ne (O Muhamed) para teje kemi dërguar pejgamberë; për disa të kemi treguar, por ka që nuk të kemi treguar...”. Kur’ani përmend dhe i pranon Fletushkat e Ibrahimit, Tevratin e Musait, Zeburin e Davudit dhe Inxhilin e Isait si Libra të Shpallur prej Zotit.

Është e vërtetë se nuk gjenden gjurmë për “Fletushkat” e Ibrahimit. Është e njohur historia e vrazhdtë e Shpalljes së Musait se si shumë herë ka qenë i shkatërruar prej atyre që nuk e njohin Zotin (babilonasve, romakëve etj.); përsa i përket Isait, ai nuk pati kohë të reduktojë ose të dikojë atë që iu Shpall. Nxënësit dhe pasardhësit e tij i patën tubuar thëniet e tij dhe ua transmetuan pasardhësve me një numër të konsiderueshëm recenzimesh, prej të cilave shumica janë ruajtur dhe konsiderohen si apokrifë. Sido që të jetë, në suaza të besimit islam bën pjesë edhe dogma – sharti që të besohet jo vetëm në Kur’an, por edhe në Shpalljet e pejgamberëve të tjerë. Pejgamberi i fesë islame nuk ka folur me emra për Budën dhe për themeluesit e Brahmanizmit. Prandaj, muslimanët nuk janë të autorizuar që kategorikisht të folin për prejardhjen hyjnore të Vedës hinduse, mirëpo ata as kategorikisht nuk mund t’i hedhin poshtë mundësitë se ato janë të bazuara në Shpalljen Hyjnore – siç vërtetojnë Brahmanët – dhe se kanë përjetuar fatin e ngjashëm të Tevratit të Musait. Kjo do të thotë se as Kina e as Greqia, e asnjë

vend tjetër, kushdo që të jetë në botë, nuk mund të përjashtohet prej mundësisë që tek ta të jetë paraqitur pejgamber i Zotit dhe t'i jenë shpallur librat hyjnorë.

Pejgamberët e Zotit

Melaqja e sjell Lajmin e Zotit deri te njeriu i zgjedhur, kurse ai e ka për detyrë t'ia komunikojë popullit të vet si njeri i zgjedhur. Sipas terminologjisë islame quhet Nebijj (i zgjedhur), Resul (lajmërues), Mursel (pejgamber), Beshhir (paralajmërues), Nedhir (përkujtues) etj. Mirëpo, të gjitha këto shprehje paraqesin sinonime.

Pejgamberët e Zotit janë njerëz shumë të devotshëm, shembulli më i mirë si i sjelljeve të veta, ashtu edhe të shoqërisë. Nuk është e thënë që ata doemos kanë nevojë për muxhize (mrekulli), edhe pse historia thujtse të gjithëve u përshkruan ato, por pejgamberët kanë treguar se muxhizet janë vepër e Zotit; mësimi i tyre paraqet kriterin unik të vërtetësisë së tyre.

Sipas Kur'anit, ka një numër të konsiderueshëm të pejgamberëve të cilët kanë pranuar Shpalljen e Librave të Zotit, edhe pse ka prej tyre që nuk e kanë pranuar personalisht Shpalljen e Librit, por kanë vazhduar me Shpalljen e pejgamberit pararendës. Pejgamberët e Zotit asnjëherë nuk janë dalluar sipas të vërtetave themelore, siç është Zoti Një, ndalimi i veprave të këqija, urdhërimi për vepra të mira etj. Mirëpo, pejgamberët mund të dallohen për sa u përket

rregullave të sundimit shoqëror që i sjell ai, varësisht sipas nivelit të evolucionit shoqëror që e ka arritur një popull. Dërgimi i peygamberëve njëri pas tjetrit argumenton se direktivat e mëparshme janë tërhequr dhe janë ndërruar me të tjera, madje sa u përket disa rregullave, ndërsa të tjerat janë ruajtur ashtu siç kanë qenë edhe sipas formës, edhe sipas përmbajtjes.

Disa peygamberë kishin për detyrë të mësonin anëtarët e vetëm një “shtëpie” (fisi ose klani), vetëm të një race ose të një rrethine; të tjerët kishin mision më të gjerë, që përfshinë tërë njerëzimin dhe të gjitha kohët. Ky kualitet haptazi bën fjalë për peygamberin e fundit.

Kur’ani i përmend disa peygamberë me emër, si: Ademin, Nuhin, Ibrahimin, Jakupin, Davudin, Musanë, Salihun, Nuhin, Isanë, Jahjanë dhe Muhamedin (a.s.). Por, Kur’ani kategorikisht lajmëron se ka pasur edhe të tjerë përpara. Muhamedi (a.s.) është vula e të gjithëve.

Eskatologjia (ringjallja)

Muhamedi (a.s.) gjithashty lypi prej nxënësve të vet të besojnë në Ditën e Gjykimit. Njeriu do të ringjallet pas vdekjes dhe Zoti do ta gjykojë për atë që ka punuar gjatë jetës në këtë botë dhe sipas tyre do ta shpërblejë - për veprat e mira dhe do ta dënojë - për të këqijat. Një ditë kjo botë do të shkatërrohet me urdhrin e Zotit dhe pas një kohe të shkurtër, Ai që na krijoi neve herën e parë, do të na rikthejë përsëri në

jetë. Xheneti – parajsa si shpërblim dhe Xhehenemi – ferri si dënim paraqesin emrat simbolikë, detyra e të cilëve është të na paraqesin në mënyrë të kuptueshme gjendjen që nuk mund të shprehet me nocionet e kësaj bote (jete). Kur’ani (32:177) në lidhje me këtë flet kështu: “Askush nuk e di se çfarë gëzimi është përgatitur për veprat e tyre”. Gjithashtu (9:72): “Besimtarëve dhe besimtareve Zoti iu ka premtuar kopshte që kanë plot lumenj – ata këtu gjithmonë do të banojnë – dhe pallate të këndshme në kopshtijet e Parajsës. Por, kënaqësia hyjnore është shpërblim shumë më i madh sesa vetë kopshtijet e Parajsës. Ai është sukses i madh”. Shihet se kënaqësia e Zotit për veprat tona është dhurata më e madhe. Në një vend tjetër (10:26) Kur’ani vërteton: “Ata që kanë bërë punë të mira, do të kenë mirësi; madje, edhe më tepër prej saj”. Muslimi, Termidhiu dhe ekspertët tjerë të Hadithit tregojnë se Pejgamberi (a.s.) ka pasur si zakon të thirrej në këtë ajet kur fliste se si pas Parajsës të devotshmëve dhurata më e madhe dhe e fundit do të jetë pamja e Allahut (xh. sh.). Për sa i përket Xhenetit, për këtë është thënia e Pejgamberit (a.s.) ku thotë: Në xhenet ka sende të tilla që kurrë nuk janë parë me sy, as janë dëgjuar me veshë, as nuk janë paramenduar me mend”. Për sa i përket asaj që është më madhështore prej vetë Xhenetit, Muslimi dhe të tjerët lajmërojnë fjalët e Pejgamberit: “Kur ata që e meritojnë hyjnë në xhenet, Allahu do t’i pyet: “A ju duhet edhe diçka më e madhe që Unë mund t’ju jap? Secili do të habitet dhe nuk do të dijë çka të lypë. Atëherë vetë Allahu do të marrë iniciativën dhe do të heqë perden e Vet dhe, asgjë që më

parë është fituar nuk do të jetë e çmuar sikur që është shikimi i Allahut tonë". Kjo është ajo, thotë Muhamedi (a.s.), që aludon ajeti i Kur'anit (10:26): "Do të ketë mirësi dhe më tepër prej saj". Në një version tjetër, që e transmeton Buhariu dhe Muslimi, lexojmë: "Përveç petkut të Tij madhështor (Rida el-Kibrija), asgjë nuk do ta ndajë Allahun prej shikimit të njerëzve". Me fjalë të tjera, mundësia për të parë Allahun paraqet dhuratën më të lartë dhe më të vërtetë për besimtarin, që u takon atyre që janë të aftë të kujtojnë e të çmojnë të dhënat abstrakte për atë botë. Njeriu sillet rreth Allahut, drejt pafundësisë, e në atë rrugë janë Xheneti e Xhehenemi vetëm stacione në kalim. Në dritën e shpjegimit të tillë, e cila bazohet në vetë autoritetin e Pejgamberit (a.s.), duhet kuptuar të gjithë atë që pandërprerë e përshkruan Kur'ani e Hadithi për njeriun e rëndomtë, për sa i përket Xhenetit dhe kënaqësisë në të, dhe Xhehenemit dhe tmerrit në të. Ato përshkrime shfrytëzohen me emrat e mjeteve që neve na rrethojnë në këtë botë: Në Xhenet ka kopshtije, lumenj; në Xhenet ka hyri të reja e të bukura, ka qilima, tesha luksoze, margaritarë, pemë, pije dhe gjithë çka njeriu mund të dëshirojë. Kurse në Xhehenem ka zjarr, gjarpërinj, ujë të vluar e ndëshkime të tjera: gjithashtu, ekziston edhe reparti i akullt, dhe përsëri nuk do të ketë vdekje. E gjithë kjo lehtë kuptohet kur mendohet se shumicën e njerëzimit e përbëjnë njerëzit e rëndomtë, me dije dhe arsimim solid; ndërsa Shpallja e Allahut duhet të jetë e kuptuar edhe për njeriun më të rëndomtë. Është e pamundur t'i flitet secilit sipas inteligjencës së tij. Një ditë Muhamedi (a.s.) iu

fliste shokëve të vet për Xhenetin dhe gëzimet e tij; në mes tjerash, edhe për fronet fluturuese. Një beduin e pyeti: “A do të ketë atje edhe kamila (deve)?” Pejgamberi buzëqeshi dhe ëmbël iu përgjigj: “Do të ketë gjithë çka të duam”. Kur Kur’ani flet për Xhenetin dhe Xhehenemin, kjo është mjet për të bindur njerëzit që të kalojnë një jetë të drejtë dhe të ndershme dhe të shkojnë rrugës së vërtetë. Ai nuk u kushton kurrfarë rëndësie detajeve, pa mos shpjeguar këtu se a është fjala për vendet dhe gjendjet. Diç më tepër në lidhje me këtë nuk duhet të na interesojë.

Nuk duhet as të përmendet se Xheneti është i përhershëm. Kur njeriu në të do të hyjë njëherë, ai më prej aty nuk do të largohet asnjëherë. Kur’ani është plotësisht kategorik në këtë pikëpamje (15:48). Disa në të do të hyjnë menjëherë, të tjerët për një kohë më të gjatë ose më të shkurtër, patjetër do të qëndrojnë në Xhehenem para se të meritojnë që të hyjnë në Xhenet. Mirëpo, parashtrohet pyetja a thua se Xhehenemi do të jetë i përjetshëm për mosbesimtarët. Për këtë pyetje mendimi i teologëve muslimanë është i ndryshëm, por shumica e tyre vërtetojnë në bazë të ajeteve kur’anore 4:38 dhe 4:116) se Allahu – nëse do – do t’ua falë të gjitha gjynahet dhe të gjitha deliktet, në përjashtim të mosbesimit në Allahun dhe se dënimi për këtë mëkatin e fundit (të mosbesimit) do të jetë i përjetshëm.

Përcaktimi dhe dëshira e lirë

Në interpretimin e vet për fenë, Pejgamberi Muhamed (a.s.) pastaj lypj që të besohet në përcaktimin (kader) e gjithçkasë - edhe të mirës, edhe të keqes - nga ana e Zotit. A do të thotë kjo se për njeriun gjithçka është e përcaktuar, apo po ky konstatim do të thotë vetëm se Zoti është Ai që paragjykon se ndonjë vepër është e mirë apo e keqe? Me fjalë të tjera, asgjë nuk është e mirë as e keqe vetëvetiu, por ajo është e tillë sepse Zoti e konsideron si të tillë. Detyrë e vetme e njeriut është që rreptësisht t'u përmbahet atyre përcaktimeve.

Me thënë të vërtetën, këtu ekziston një dilemë mes teologëve. Nëse ai deklaron se njeriu është përgjegjës për veprat e veta, ajo nuk do të përputhet me përcaktimet e veprave të tij. Gjithashtu, nëse ai pohon se njeriu në formë të lirë i kryen veprat e veta, përfundojmë se Zoti nuk ka fuqi mbi atë që e kryen njeriu, bile edhe nuk e di se ai do të punojë. Përkundrazi, nëse krejt veprat e njeriut janë të përcaktuara, si do ta konsiderojmë përgjegjës për ato vepra? Të dyja zgjedhjet janë njësoj të vështira për t'i pranuar. Duam që Zotit t'i përshkruajmë jo vetëm drejtësinë, por edhe gjithëfuqinë dhe gjithëdijen. Muhamedi (a.s.) e qesh këtë diskutim që nuk mund të ketë rrugëdalje dhe ai kategorikisht ua ndaloi nxënësve të vet që për këtë çështje të mos humbin kohë, duke thënë: "Popujt, para jush janë katandisur për shkak të këtij diskuti-

mi". Ai pranon dhe cilësinë e Tij të gjithëfuqishmërisë – gjithëdijsshmërisë, mirëpo në të njëjtën kohë vërteton se njeriu do të përgjigjet për veprat e veta. Ai nuk do të lidh njërën me tjetrën. Në njëfarë dore ai këtë diskutim e konsideron gjithashtu të pa qëllim, siç është edhe polemika se a është më e vjetër pula a veja.

Përveç kësaj, e mira dhe e keqja vetëm janë nocione relative. Ujku e gjuan lepurin për t'u ushqyer. Ajo që është e mirë (gjallëri) për njërin, është keq (vdekje) për tjetrin. Prandaj, ajo që na ndodh si e keqe, e keqe është se vetëm natyra e jonë ashtu e quan. Qe, mu prej këtij shkakut është e nevojshme që Zoti të caktojë për dikend ndonjë akt që duhet të paraqet të mirën e për tjetrin të keqen. Përveç kësaj, nuk duhet harruar se nocioni "përgjegjësi" është i kësaj jete, ndërsa "shpërblimet dhe dënimet e Zotit" i takojnë jetës tjetër. Ne vetëm shqetësohemi kur këto dy kategori i vëmë në të njëjtën radhë. Të veprosh kështu është vetëm marrëzi e kurrgjë tjetër.

Të përkujtojmë edhe atë se ai besim dualist në gjithëfuqinë e Allahut dhe në tërë përgjegjësinë personale të njeriut e nxit muslimanin për në punë, siç i jep fuqi të durojë lehtë fatkeqësinë së cilës nuk mund t'i iket. Larg asaj që ta bëjë të palëvizshëm, ajo, përkundrazi, të shtyn për dinamizëm. Për të argumentuar këtë, vetëm duhet të përkujtojmë veprat trimërore të muslimanëve të parë, të cilat më së miri se çdokush praktikuan në jetë mësimin e Muhamedit (a.s.) në lidhje me këtë çështje.

Përfundim

Ja rezymeja e plotë praktike e gjithë asaj që muslimani duhet të besojë. Deklarimi mbi përkatësinë fetare është dhënë në formën më koncize: “Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi (a.s.) është peygamber dhe rob i Tij”. Kjo do të mundësojë të përkujtojmë se Islami nuk është vetëm fe, por dhe mënyrë e jetesës, morale dhe fizike. Në realitet, Islami është ligj i plotë, detyra e të cilit është të rregullojë jetën njerëzore.

Kreu V

Kryerja e detyrave fetare

Islami shkon kah ajo që të formojë tërësinë që e përfshin tërë jetën dhe nuk lë pasdore, bile, asnjë fushë veprimi të njeriut. Përveç kësaj, ai përpiket t'i harmonizojë të gjitha këto sfera. Kjo dëshirë për "centralizim" ka për qëllim që të gjitha detyrat fetare, njëkohësisht, të shërbejnë për të mirën e trupit dhe të shpirtit. Jo vetëm kaq, bile edhe detyrat profane (që nuk janë të degës) do të kenë karakter etik, në harmoni të plotë me rregullat e Allahut, madje edhe ceremonitë shpirtërore nga ana e vet kanë dobi materiale, e që është në harmoni me rregullat e Allahut.

Duhet përmendur se rregullat e sjelljes, si ato me karakter moral, si ato me karakter fizik, rrjedhin prej një burimi, prej Kur'anit, prej Fjalëve të Allahut. Nga kjo, domosdo, duhet kuptuar fjalën "imam", e cila thekson drejtuesin suprem të botës islame, që përdoret jo vetëm për prijësin e ceremonive fetare në xhami, por për shefin e shtetit islam. Në një thënie të njohur, Muhamedi (a.s.) e ka definuar besimin (imanimin) si përkushtim (Islam) dhe mënyrë më e mirë (ihsanin) që çon drejt saj. Në kreun e mëparshëm sqarimet e materies, të cilat i diskutojmë, jashtëzakonisht qartë do të përgjigjen për qëllimet tona, që të cekim dhe të komentojmë atë që e ka thënë ai për pikën e dytë. Ai ka deklaruar: Përkushtimi ndaj Allahut (Islam) kërkon që të falim rregullisht namazin, të

agjërojmë gjatë muajit të Ramazanit, të kryejmë haxhin dhe të japim zeqatin.

Namazi

“Namazi është shtylla e fesë”, ka thënë Muhamedi (a.s.). Kur ani flet mbi këtë në më tepër se njëqind vende dhe namazit i jep emra të ndryshëm: Salat (të vësh fytyrën në tokë), dua (thirrje, lutje), dhikr (përkujtim, përlavdërim), ibadet (nënshtrim) etj.

Në përpjekjen e vet që në tokë të realizojë mbretërinë e Allahut, Islami për çdo ditë ka caktuar pesë namaze grupore: duhet të kryhen para lindjes së diellit – para dhe pas mesditës, në mbrëmje dhe gjatë natës. Kjo lyp që për ca minuta (për çdo namaz) të largohemi nga interesat materiale e t’i shprehim nënshtrimin dhe falënderimin Krijuesit tonë. Namazi i mesditës për çdo të premte (xhuma) shndërrohet në namaz javor, i cili është më madhështori dhe më i rëndësishmi, me ç’rast imami i çdo vendi mban fjalimin para se të kryejë namazin. Islami themeloi dy festa gjatë vitit: njërën në fund të muajit të agjërimit, ndërsa tjetrën në kohën e kryerjes së haxhit në Mekë. Të dyja këto festa karakterizohen me namaz të posaçëm, që iu bashkangjitet pesë namazeve të rregullta. Njerëzit tubohen në mëngjes, në namaz kolektiv, pas së cilës imami mban hutben. Është edhe një namaz, i cili nuk është i obliguar për të gjithë, kurse kryhet para se të varroset i vdekuri.

Duke folur për fshehtësitë e namazit, mistiku i madh Velijullah ed-Dehlevi ka thënë: “Dije që njeriu nganjëherë ngrihet në lartësi të mëdha, rrufeshëm. Në atë vend te njeriu lëshohet dëshira e Allahut, e cila mbretëron në shpirtin e njeriut. Ai aty sheh dhe dëgjon gjëra që gjuha e njeriut nuk është në gjendje t’i përshkruajë. Rrufeja pastaj kalon, njeriu kthehet në gjendjen e parë, i pikëlluar për humbjen e këtij entuziazmi. Ai mundohet të kthejë atë që i iku dhe në kushtet e kësaj bote që sa më tepër t’i afrohet Zotit dhe sa më mirë ta njohë Atë. Ky është kusht nderimi, përkushtim dhe gati bisedë direkte me Zotin, kusht të cilin e përcjell me vepra dhe fjalë përkatëse. Namazi, në esencë, përbëhet prej tri elementeve: pikësëpari, aty është cilësia njerëzore në prezantimin madhështor para Allahut (xh. sh.), pastaj vjen prezenca përkatëse dhe, më në fund, përvetësimi i nderit të obliguar për trupin dhe për të gjithë organet e tij. Që të tregojmë respekt dhe nder ndaj dikujt, ngrihemi dhe kthehemi kah ai. Atë që e nderojmë më tepër, i përulemi dhe e lakojmë kryet në shenjë nderimi... Por, kulminacioni i përuljes dhe i nderit është ulja e kryes - me të cilën në gradë më të lartë arrihet kur “Uni” dhe ndjenjat tona – e prekin dheun para atij që e nderojmë. Pasi njeriu kulminacionin e zhvillimit të vet shpirtëror mund ta mbërrijë gradualisht, kjo ngritje patjetër duhet të posedojë tri etapa: namazi i plotë do të përbëhet prej tri pozitive - qëndrimi në këmbë, përulja e trupit dhe vënia e ballit në tokë. E tërë kjo, që ta mbërrijmë ngritjen e duhur shpirtërore, që ta ndiejmë lartësinë e Allahut dhe

përvujtuninë njerëzore para Allahut.” (Huxhetull-Llah el-Baligah, pj.I, kreu “Fshehtësitë e lutjes”).

Në një sure të Kur’anit (22:18) thuhet kështu: “A nuk sheh se Allahut i përuken ata në qiej e në tokë; edhe Dielli edhe Hëna; edhe yjet, edhe malet, edhe drurët, edhe shtazët, si dhe shumë njerëz; mirëpo, shumica e meritojnë edhe dënimin. Atë që e poshtëron Allahu, askush nuk mund ta bëjë të ndershëm; Allahu bën çka të dojë”. Gjithmonë përsërisim aktin e ngritjes dhe të uljes: kodrat ngelin vertikalisht, kafshët ngelin të disponuara. E dimë që druri e gjen ushqimin përmes rrënjëve: mirëpo, “kryet” e drurëve gjithmonë bie në sexhde. Uji pastron (mendohet për avdesin): e sipas fjalëve të Kur’anit: (13:13): “Edhe murmurima e lartëson me lavdatën e vet Atë” ...”Zogjtë përmes fluturimit adhurojnë Allahun” (Kur’an, 24:41), siç duhet të veprojnë njerëzit kur i luten Allahut bashkërisht. Sikur hija (Kur’an, 13:15) që zgjattet dhe shkurtohet gjatë paraqitjes së vet dhe dëgjueshmërisë ndaj Allahut, ashtu edhe njeriu qëndron drejt, lakohet në ruku dhe bie në sexhde para Allahut. Lutjet islame paraqesin sintezën e llojeve të ndryshme kushtuar Allahut, të cilat me siguri çojnë në qëllimin e dëshiruar. Të përkujtojmë se në Islam fjala “adhurim” (ibadet) ka rrënjën e njëjtë sikurse fjala “abd”, që do të thotë rob. Me fjalë të tjera, adhurim quhet veprimtaria e robit, shërbim të cilin e lyp Allahu prej tij. Allahu prej kodrave lyp që të qëndrojnë, prej zogjve që të ngelin të përukur (instinktivisht), ndërsa prej bimëve të ngelin të shtrira para Tij dhe ky është shërbimi i tyre. Prej çdokujt kërkohet ajo që i përshtatet atij dhe

çka e lyp zotëriu i tij. Natyrisht, edhe prej njeriut kërkohet ajo që i takon një qenie racionale, qenie më të dalluar prej të gjithë krijesave, si mëkëmbës i Allahut.

Avdesi si larje rituale dhe pastrim fizik është parakusht për të vlerësuar namazin, siç do të shohim më vonë. Një thënie e Muhamedit (a.s.) e sqaron kuptimin e tij. Për këtë pastrim ritual duhet larë duart, gojën, hundën, fytyrën, krahët, kryet, veshët dhe këmbët. Larja e këtyre gjymtyrëve nuk është vetëm pastrim i jashtëm; ky është pendim për të kaluarën e vendosmëri për të ardhmen. Pendimi i lan mëkatet e mëparshme, përmes lypjes së ndihmës nga Allahu për atë që ka të bëjë gjatë jetës, kurse kjo ka lidhje me organet kryesore të veprimit. Duart sulmojnë, goja flet, hunda merr erë, fytyra ose paraqitja e zymtë shfaq përshtypje të keqe, duart mbajnë, koka mendon dhe intrigon, veshët dëgjojnë, këmbët ndoshta ecin në rrugën që e ka ndaluar Allahu. Të mos flasim për mëkatet seksuale, të cilat lypset të ndërpriten para se të merret avdesi e patjetër lypet të pastrohemi pas kryerjes së nevojës natyrore.

Ky aspekt simbolik dhe mistik ose pastrim vërehet qartazi në thëniet (duatë) që e përcjellin larjen e çdo organi. Para se të hyjmë në nevojtoare themi: “O Zot, pastroje zemrën time nga hipokrizia, ndërsa organin tim seksual nga veprat e turpshme dhe imorale”. Nijetin e avdesit e shprehim me këto fjalë: “Lavdata i qoftë Allahut që e krijoi ujin të pastër dhe pastrues”. Kur e lajmë fytyrën, i lutemi Allahut: “Shkëlqema fytyrën time, në Ditën e Gjykimit mos ma nxij”. Në larjen e duarve: “Shfrytëzomë në vepra të mira e

jo në të këqija, dorëzomi librat e mi në Ditën e Gjykimit kah krahu i djathtë e jo në krahun e majtë, lehtësoma llogarinë e mos ma rëndo". Në fshirjen e kryes: "Më mëso dije të dobishme". Për veshët: "Ma bëj të mundur ta dëgjoj Fjalën Tënde dhe të Pejgamberit Tënd". E për këmbët: "Forcomi këmbët e mia gjatë kalimit mbi ferr dhe të mos më rrëshqasin në atë Ditë kur do të ngelin të përforcuara këmbët e dashamirësve Tu, ndërsa do të rrëshqasin Këmbët e armiqve Tu".

Pesë kohët e namazit u janë urdhëruar muslimanëve në kohën e Miraxhit. Muhamedi (a.s.) përveç tjerash ka deklaruar se namazi i çdo besimtari është ngritje e tij personale, ku ai gjendet në prezencën e Allahut. Kjo nuk është e paarsyeshme: të shohim se çka bën muslimani gjatë kohës së namazit. Më parë ai qëndron drejt, i çon duart dhe deklaron: "Allahu është më i madh". Kështu njeriu mohon çdokënd tjetër, përveç Allahut dhe i përulet dëshirës së Një Zoti. Pasi i radhit lëvdatat drejtuar Allahut; ai ndihet aq modest para madhërisë së Tij, saqë përulet, e ul kokën në shenjë nderimi duke deklaruar: "Lavdëruar qoftë Zoti im, që është i vetmi, më i Madhërishmi". Pastaj drejtohet dhe e falënderon Allahun që e pa; ai pastaj mendon i entuziazmuar me madhësitinë e Allahut, në atë masë sa që ndjen nevojë të lëshohet dhe ta vë kryet në tokë, i përulur dhe në atë rast thotë: "Madhëria i qoftë Zotit tim, i cili është i vetmi, më i lartësuar". Ai përsërit këto gjeste sikur do të ushtrojë (t'ia bëjë shprehi) trupin e vet për ta lartësuar, ashtu që dalëngadalë të bëhet i denjë e të kalojë prej botës materiale në sfera të larta, në prezencën e Allahut.

Aty ai përshëndet Allahun dhe e pranon përgjigjen e përshëndetjes së vet. Pikërisht në këtë shkëmbim përshëndetjesh ai shërbehet me të njëjtat formula që kanë të bëjnë me Miraxhin, me ngritjen dhe takimin e Muhamedit (a.s.) me Allahun (xh. sh.): “Përshëndetje Allahut, paqja qoftë për ty, o Pejgamber, dhe mëshira e bekimi – paqja mbi ne dhe mbi ata robër të Tij që janë shpirtëpastër”. Pa farë simbolesh materiale, fetari – ashtu të themi – bën ngritjen e vet tek Allahu.

Ky është aspekti shpirtëror i namazit. Dobitë e namazit janë të shumta, bile edhe nga aspekti material: namazi pesë herë në ditë i tubon banorët e një lagjeje, iu mundëson të shkarkohen për disa minuta nga detyrat monotone të çështjeve të përditshme të çdo individi, i tubon anëtarët karakteristikë dhe modest të bashkësisë në barabarësi të plotë (udhëheqësi i lagjes duhet të prijë në namaz, ndërsa në kryeqendër, në xhaminë kryesore duhet të prijë kryetari i shtetit). Kështu që kemi gjasa të bashkojmë jo vetëm anëtarët e bashkësisë, por edhe funksionarët përgjegjës të vendit, të krahinës ose të shtetit. Takohemi drejtpërdrejt, pa formalitete dhe pa pengesa. Namazi në Islam, pra, ka strukturë solide, i menduar ashtu që fetarët rreth vetes të ndiejnë sundimin e Allahut. Aty ka disiplinë gati se ushtarake. Me thirrjen e myezinit, njerëzit shpejtojnë në xhami; rreshtohen pas imamit, bëjnë lëvizje të përbashkët me të tjerët në një harmoni interesante. Përveç kësaj, besimtarët nga të gjithë anët e rruzullit tokësor i drejtohen një pike qendrore, Qabesë, tempullit të shenjtë në Mekë. Kjo përkujton bashkimin e bashkësisë botërore, pa dallime klasore, ra-

core ose rajonale. Namazi më i mirë – në të cilin janë plotësuar të gjithë kushtet formale – është namazi me xhemat. Në raste të pamundësisë që të kryhet namazi në këtë mënyrë, mashkulli apo femra e kryen atë individualisht. Sidoqoftë, me pesë namazet e ditës bëhet fjalë për një detyrë minimale: brenda 24 orëve duhet rezervuar 24 minuta, përafërsisht, për të kaluar kohën në prezencën e Allahut. Mirëpo, të themi të vërtetën, besimtari për çdo moment patjetër duhet të mendojë Allahun: në lumturi, si dhe në fatkeqësi, kur punon, kur është i shtrirë, kur kryen punë të tjera etj. Kur’ani për këtë thotë (3:190, 191): “Për ata që e përmendin Allahun edhe në këmbë, edhe ulur, edhe ratë dhe mendojnë thellë në krijimin e qiejve dhe të tokës, ‘O Zoti ynë, Ti nuk e ke krijuar këtë më kot, qofsh i lartësuar! Dhe, ruajna prej dënimit të zjarrit (të xheheneimit)”. Allahu njeriut ia nënshtroi gjithësinë për dobi të tij. Por, këtë shfrytëzim doemos duhet përcjellë me falënderim dhe dëgjueshmëri e assesi me kryelartësi kundër Zotit, ose me padrejtësi ndaj qenieve të tjera. Sipërfaqësisht të përmendim, në momentin kur themelohej institucioni i namazit, për mirësinë shpirtërore të njeriut zbriti ajeti i Kur’anit (2:286): “Allahu askënd nuk e ngarkon përtej mundësive të veta...” Për Zotin është me rëndësi qëllimi dhe dëshira, e jo sasia dhe forma e jashtme e kryerjes së obligimeve. Nëse ndonjë fetar, në të vërtetë, konsideron se nuk mund të kryejë namazin pesë herë në ditë, le ta kryejë në katër herë, në tri herë, bile menjëherë, le të vazhdojë në këtë mënyrë derisa t’i paraqiten pengesa, le ta kryejë sipas mundësive dhe rrethanava objektive. Me rëndësi

është të mos e harrojë detyrën shpirtërore gjatë preokupimeve të përditshme materiale të kësaj bote. Këto përjashtime lejohen në kushte jonormale, p.sh. kur njeriu është i sëmurë ose shpeshherë e humb vetëdijen, ose në ca raste tjera, për të cilat flasin hadithet e Muhamedit (a.s.).

Kështu, p.sh. në Luftën e Hendekut ai gjatë natës vonë e fali namazin e drekës, të iqindisë, të akshamit dhe të jacisë, pasi që armiku nuk e la të qetë të kryente namazin në kohën kur duhej. Kjo do të thotë se ai pesë kohë të namazit i ka falur në dy termine kohore: në agim dhe vonë natën. Në një transmetim tjetër të Buhariut e të Muslimit e gjejmë edhe këtë të Ibn Abasit: “Pejgamberi i Allahut bashkërisht (në një kohë) e fali namazin e drekës dhe të iqindisë, gjithashtu akshamin dhe jacinë, edhe pse në atë rast nuk kishte rrezik nga armiku e as që gjendeshin në udhëtim (në rrugë)”, kurse transmetuesi transmeton: “Deshi t’u ikte shqetësimeve të tepërta për anëtarët e bashkësisë së vet”. Kjo, pra, flet për tri namaze në ditë. Haptazi varet nga ndërgjegjja e besimtarit, i cili është personalisht përgjegjës para Allahut (xh. sh.), që nuk mund të mashtrohet dhe para të cilit nuk mund të fshihet asgjë. Mbetet e hapur pyetja për kohën e kryerjes së namazit: dihet se dielli në vende të ndryshme të botës lind dhe perëndon në kohë të ndryshme dhe gjatësia e ditës dallon varësisht nga gjerësia gjeografike. El-Biruni e ka ditur se në pole dielli gjashtë muaj qëndron mbi horizont, kurse gjashtë muaj nën horizont (përveç dy ditëve të barabarta). Juristët dhe teologët muslimanë kryesisht vërtetojnë se koha e na-

mazit e cila vlen për paralelen 45 ngel në fuqi deri në paralelen e 90-të, ajo është gjer te polet: në zonat mes 45-tës dhe 90-tës patjetër duhet të përcillet lëvizja e orës e jo e diellit. Kjo rregull nuk vlen vetëm për namazin gjatë menstruacionit dhe 40 ditëve pas lindjes së fëmijës.

Agjërimi

Detyrë e dytë islame për besimtarin është agjërimi një muaj për çdo vit. Çdo ditë në muajin e Ramazanit duhet t'i shmangemi ushqimit, konsumimit të duhanit dhe çfarëdo lloji të pijeve – e ndaluar është, bile, edhe marrja e injeksioneve pa nevojë – prej agjërimit e deri në perëndim në shtetet ekuatoriale dhe tropike (dhe për atë kohë përkatëse, në rajonet më të largëta nga qendra e globit që e merr për bazë kohën e caktuar për paralelen 45, siç thamë). Për sa u përket të sëmurëve, do të bëjmë fjalë më vonë. Vetvetiu kuptohet se agjërimi e humb vleftën edukative-shpirtërore nëse njeriu nuk tërhiqet nga dëfrimet, bile edhe me mendime. Për këtë nevojitet disiplinë rigorozë, e cila në sy të ithtarëve të tregon përvoja shekullore, bile edhe besimtarët e rinj shumë shpejt e bëjnë shprehi këtë disiplinë.

Agjërimi vazhdon plot një muaj. Siç dihet, Islami i përmbahet vitit lunar. Pra, ndodh që Ramazani të bie në çdo stinë të vitit: në vjeshtë, në dimër, në pranverë, në verë. Njeriu mësohet me këtë vetëmohim si në të

nxehstin e madh, ashtu edhe në të ftohtin e madh. Agjërimi, disiplina shpirtërore, duhet të kryhet patjetër në formë të dëgjueshmërisë ndaj Allahut. Edhe pse prej agjërimit, sikurse dhe prej namazit, kemi dobi materiale (në pikëpamje të higjienës), prapëseprapë, në esencë, agjërimi është detyrë fetare, ushtrim shpirtëror që njeriun e afron tek Allahu. Kushdo që agjëron në bazë të porosisë së mjekut ose për ndonjë shkak të kësaj bote, agjërimi në fjalë nuk i pranohet si ibadet fetar.

Sikurse që nuk iu lejohej falja e namazit grave që kanë menstruacione, ashtu edhe agjërimi nuk iu lejohet, mirëpo agjërimi kryhet apo vazhdohet pasi të kalojë menstruacioni, madje i agjëron ditët që i kanë mbetur pa agjëruar pasi të kalojë muaji i Ramazanit. Kalimthi të përmendim se Muhamedi (a.s.) ndaloi agjërimin pandërprerje dhe atyre që nga vullneti i zjarrtë dëshirojnë të agjërojnë, duke dashur me të të përgatiten shpirtërisht. Duke kërkuar ai sa më tepër bekime në këtë mënyrë, ka thënë: “Ti ke detyra edhe ndaj vetvetes”. Krahas agjërimit të obliguar në kohën e Ramazanit, sipas dëshirës personale – mund të agjërohet kohë pas kohe. Përsa i takon agjërimin vullnetar, Pejgamberi (a.s.) porositi të agjërohen dy ditë njëra pas tjetrës. Nga aspekti medicinal është konstatuar se agjërimi i përhershëm bëhet shprehi e cila nuk e ka efektin e njëjtë sikurse që e ka ndërprerja kohë pas kohe e mënyrës së stabilizuar të jetës; dhe se agjërimi më pak se një muaj nuk sjell dobi të mëdha, kurse agjërimi mbi 40 ditë shndërrohet në shprehi. Është trillim të vërtetohet se agjërimi në kuptimin e shmangi-

es nga haja dhe pija në zonat e ftohta klimatike është në kundërshtim me kërkesat e shëndetit të njeriut.

Vrojtimet biologjike tregojnë se egërsirat praktikisht nuk hanë asgjë, e veçanërisht kur bie borë. Ato flejnë, ose në ndonjë mënyrë tjetër e kalojnë kohën e vet duke agjëruar dhe paraqiten të përmirësuar në pranverë. E njëjta gjë vlen edhe për drurët, që gjatë dimrit krejtësisht i humbin gjethet dhe flejnë, pa i ujitur, mirëpo pas disa muaj agjërimi ato përtërihen në pranverë dhe bëhen më të fuqishme se më parë. Siç mund ta hetojë çdokush edhe të gjethet edhe te lulet në kopshtin e vet.

Në realitet, sikur të gjitha organeve jetësore, organeve të tretjes gjithashtu iu nevojitet pushim; agjërimi është metodë e vetme e paramenduar mirë për këtë. Medicina bashkëkohore në të gjitha shtetet e Perëndimit i shëron posaçërisht sëmundjet kronike me një periudhë të shkurtër ose të gjatë agjërimi. Është ide e vjetër në shoqërinë njerëzore për t'i afruar Allahut një pjesë nga të mirat e veta; një shembull është largimi prej drithrave. Agjërimi është në një mënyrë ofrim i ushqimeve tona Allahut (xh. sh.). Mendimi (i vërtetuar me Kur'an, 6:160): "Kush bën një vepër të mirë do të shpërblehet dhjetëfish për të...", nënkupton që Allahu veprën e mirë e shpërblen me dhjetë shpërblime. Këtë e sqaron thënia e Pejgamberit (a.s.): "Kush do të agjërojë një muaj Ramazan dhe gjashtë ditë të muajit që vjen, Sheval, kjo i llogaritet sikur ta ketë agjëruar tërë vitin". Me të vërtetë, viti lunar, i cili përdoret në Islam, numëron 355 ditë, ose për çdo muaj nga 29 ose 30 ditë. Pra, nëse muslimani për çdo vit

agjëron 35 ose 36 ditë, nëse merret dhjetëfish, 350 ose 360 ditë, ndërsa mesatarisht është 355 ditë, aq sa numëron viti lunar. Mistikët vërejnë se forca animale natyrore e pengon përsosmërinë shpirtërore të njeriut. Që t'i nënshtrohet trupi shpirtit, duhet t'i shmanget fuqisë trupore, që të mund të shtojmë fuqinë shpirtërore. Është konstatuar se në këtë drejtim nuk ka asgjë më efikase prej urisë, etjes, shmangies prej ledhatimeve trupore, duke kontrolluar gjuhën, zemrën, mendimet dhe organet tjera. Një nga mënyrat e përsosmërisë së njeriut është t'ia nënshtrosh natyrën shtazore logjikës, shpirtit; natyra ndonjëherë është në situatë rebelimi, kurse ndonjëherë në situatë nënshttrimi. Njeriu, pra, ka nevojë për ushtrime të ashpra, siç është agjërimi, për t'i mposhtur epshet e veta. Nëse gabon, pendimi dhe lodhja prej agjërimit e ngushëllojnë dhe e pastrojnë shpirtin, e përveç kësaj forcohet vendosmëria e tij që të mos i përsërit gabimet dhe të metat e veta.

Gjithashtu, theksohet se me shmangie prej ngrënies dhe pijes karakterizohet natyra e melaqeve. Duke i imponuar vetvetes këtë regjim, njeriu u përngjan melaqeve, pasi që ai këtë e bëri me qëllim që t'i nënshtrohet Allahut, ai i afrohet Allahut dhe e përfiton bekimin e Tij, gjë që paraqet qëllimin përfundimtar të njeriut.

Haxhi

“Haxh” fjalë për fjale do të thotë: nisje e njëkohshme (kah zotëriu) dhe orvatje për të mposhtur diçka (në këtë rast, vetveten). Tradicionalisht kjo fjalë përkthehet si “haxhillëk”, edhe pse kjo nuk është domethënia adekuate e fjalës haxh. Haxhi është detyra e tretë e muslimanit. Ai është obligim për të gjithë muslimanët pa dallim gjinie, së paku një herë në jetë për të shkuar në Mekë e të orvatet që të shkrijë vetveten në Plotfuqinë dhe Vullnetin e Allahut. Ata që nuk kanë mjete materiale për këtë udhëtim lirohen prej këtij obligimi. Mirëpo, cili musliman nuk mundet, pak nga pak, të tubojë mjete të mjaftueshme e një ditë ta vizitojë qendrën e fesë së vet, Qabenë, bejtull-llahun? Kur’ani (3:96) thotë se Qabeja është “shtëpia” më e vjetër që i kushtohet Zotit, kultit monoteist. Bile, mos është edhe më e vjetër se Ibrahim (a.s.), i cili sipas transmetimit islam ka qenë vetëm rindërtues i ndërtesës të cilën e ngriti Ademi (a.s.). Në këtë rast Qabeja do të ishte tempulli më i vjetër prej atij të Jerusalemit, të cilin e ngriti Sulejmani (a.s.). Nuk dihet ndonjë qendër tjetër kulturore që funksionon edhe sot e të jetë më e vjetër se Qabeja në Mekë.

Ceremonitë (shartet) e haxhit shkurtimisht janë siç vijon: në kufirin e territorit të shenjtë, rreth Mekës, zhvishen teshat e rëndomta e të gjithë haxhilerët veshin dy copa të pëlhurës – përparsë dhe gunë mbi krahë, uniformë e cila është e obligueshme vetëm për

meshkujt – kryeshtruar, ata do të mundohen të harrojnë vetveten për ca ditë të haxhit. Niset për në Arafat, periferi e Mekës, që të kalojnë një ditë të thelluar në mendime. Para mbrëmjes niset prej aty në drejtim të Mekës. Natën e kalon në Muzdelife, kurse në agimin e hershëm niset për në Minaa, e cila gjendet shumë afër Mekës. Aty mbeten tri ditë dhe gjatë kësaj kohe për çdo ditë gjuhen gurët, vepër që simbolikisht paraqet gjuajtjen e shejtanit. Brenda këtyre tri ditëve të qëndrimit në Minaa theret kurban dhe shkohet në qytetin e Mekës, që të kryhet ceremoniali i tavafit dhe i sa'jit (7 herë), duke kaluar luginën në mes dy kodrinave përballë Qabesë, e që quhen Safa e Merve. Të gjitha këto rituale fetare kanë domethënien e vet; prapavijën e tyre simbolike do ta japim në vazhdim të tekstit.

Kur e humbën të drejtën e qëndrimit në Xhenet, Ademi dhe Hava, u degëdisën larg njëri-tjetrit; orvateshin që të takoheshin dhe me ndihmën e Allahut u takuan në kodrinën e quajtur Arafat. Në shenjë falënderimi dhe nderimi ndaj Allahut (xh. sh.), pasardhësit e Ademit dhe të Havasë nisen për në Arafat dhe orvaten të harrojnë veten dhe të shkrihen në presencën e Allahut e të lutën për faljen e gabimeve në të kaluarën, udhëzim dhe ndihmë në të ardhmen.

Për sa i përket gjuajtjes së shejtanit, të përmendim se Ibrahim (a.s.) deklaroi se nuk e do kend më shumë se Allahun (xh. sh.), mirëpo Allahu e vuri në sprovë dhe lypi prej tij të verifikonte dashurinë, ta bëjë kurban birin e dashur. Djalli tri herë erdhi që ta largonte nga ky akt – flitet se kjo ndodhi në Minaa – Ibrahim për çdo herë e përzinte djallin, duke e gjuajtur me

gur. Ky gjest simbolik përsëritet në shenjë vendosmërie kundër trillimeve të shejtanit gjatë jetës.

Vizitën e shtëpisë së Zotit është shumë lehtë ta shpjegojmë: për ta dokumentuar dëgjimin e vet, njeriu nisat drejt saj me respekt dhe përulësi të plotë. Sipas një adeti shumë të vjetër, të sillesh rreth dikuj do të thotë të përgatitesh të sakrifikosh për të, sepse ai është objekt i dashurisë dhe i besnikërisë tënde.

Guri i zi duhet të përmendet posaçërisht, për shkak të kuptimeve shumë të gabuara në lidhje me të. Ai nuk është meteor, por gur i zi. Roli i tij praktik është të shënojë pikënisjen e tavafit, mirëpo me ngjyerën e vet bie në sy të ndërtesës. E dyta, ky gur nuk adhurohet kurrë, as që muslimanët bien në sexhde drejt gurit, pasi që bëhet sexhde përballë çdo pjese të Qabesë, mirëpo guri, siç thamë, shërben vetëm për pikënisje të tavafit. Të përkujtojmë se Kermanitët në vitin 318 sipas hixhrit, 930 të erës së re, e shkatërruan Mekën dhe e morën me vete gurin e zi për plaçkë, ku ngeli plotësisht 21 vjet. Gjatë kësaj periudhe asnjë prej muslimanëve nuk u drejtua kah vendi ku gjendej guri i zi (Oman), por të gjithë edhe më tej drejtoheshin kah Qabeja. Bile, edhe ndërtesa e Qabesë nuk është me rëndësi: nëse, p.sh. ndërtesa meremetohet ose rindërtohet, muslimanët do të drejtoheshin drejt vendit të saj pa marrë parasysh se a gjendet aty Qabeja me gurin e zi apo jo. Siç thamë, roli kryesor i gurit të zi është të sinjalizojë fillimin dhe mbarimin e tavafit, edhe pse ka edhe rëndësinë simbolike.

Mbetet të sqarojmë aktin e vrapimit shtatë herë mes kodrinave të Safasë dhe Merves. Transmetimi

thotë: kur Ibrahim (a.s.) pati lënë gruan e vet, Haxheren, me fëmijën për gjiri, Ismailin, në vendin e quajtur Mekë (Meka në atë kohë ishte shkretëtirë dhe e pababuar), ujin që ua la Ibrahim u harxhua, Haxhereja nga dashuria e vet prindërore vrapoi majtas dhe djathtas të gjente ujë për fëmijën e vet të etshëm. Atëherë filloi të gufonte burimi i Zemzemit. Ky gjest i saj përsëritet që të shprehet nderimi ndaj dashurisë prindërore dhe falënderimi ndaj mëshirës së Allahut (xh. sh.).

Rëndësia sociale e haxhit nuk është më pak e rëndësishme: vëllazërimi botëror musliman këtu manifestohet dukshëm - besimtarët pa dallim race, gjuhe, kombësie dhe klase vijnë këtu për të kryer obligimin e vet, përzihen në mes vete të vëllazëruar, jetojnë bashkërisht dhe i kryejnë detyrat fetare. Në kohë të caktuar njerëzit udhëtojnë, ndalen, kalojnë nën çadra ose jashtë disa ditë të caktuara. Edhe diçka më tepër prej detyrave të përditshme fetare: haxhi i kalit fetarët për jetë të disiplinuar, si u ka hije udhëtarëve të Allahut.

Në një haxhillëk të tij Muhamedi (a.s.) mbajti një fjalim, i cili është i njohur me emrin "Fjalim i Lamtumirës", pasi që ai vdiq tre muaj pas këtij haxhillëku. Atje takoi 140.000 muslimanë, të cilët kishin ardhur nga të gjitha vendet e Arabisë dhe nga vendet fqinje. Ai ua përkujtoi elementet esenciale të Islamit; besimin në Një Allah pa ikone dhe simbole të tjera, barabarësinë mes vete, pa dallim klase e race, pa dallim mes njerëzve, përveç vleftës personale, e cila bazohet në nder dhe devotshmëri; mbrojtja e tri të drejtave të të gjithë njerëzve: jeta, pasuria dhe nderi; pastaj zhdukja e kamatës, e hakmarrjes, sjellje më korrekte ndaj grave,

shpërndarja dhe qarkullimi i të ardhurave pa i mundësuar as edhe një grupi të vogël që të akumulojë kapital (kjo arrihet duke iu falënderuar Ligjit të trashëgimit dhe testamentit); dhe, në fund, i porositi që vetëm Shpalljen e Allahut ta kenë Ligj të vet në të gjithë lëmenjtë e jetës. Sot e kësaj dite ai Fjalim solemn mbahet para haxhilerëve, të cilët për çdo vit në Arafat tubohen më 9 të Dhulhixhes.

Mund të besohet se te gjeneratat e para muslimane ishte ruajtur një traditë paraislame: është shfrytëzuar rasti i këtyre tubimeve që të mbahet kongresi vjetor për letërsi. Poetët paraqiteshin me vjersha të reja, pehliuanët i mahnitnin shikuesit, ndërsa tregtarët sillnin lloje të ndryshme mallrash.

Halif Omeri i ka dhënë këtij tubimi edhe një karakteristikë shumë të dobishme, nga ana e pushtetit: aty ai mban sesionin e gjyqit suprem, të apelit, kundrejt guvernatorëve të vet dhe komandantit të ushtrisë. Gjithashtu, ka mbajtur këshillime publike për vendime të rëndësishme që i ka pasur ndër mend t'i ndër-marrë. Të përsërisim edhe një herë: në Islam e shenjta dhe profania (laikja), e kësaj jete fizike dhe shpirtërore, jetojnë së bashku, bile në mes vete bashkëpunojnë harmonikisht.

Zeqati

Njerëzit e rëndomtë sot me fjalën zeqat nënkuptojnë përqindjen e përcaktuar të të hollave të grum-

bulluara që duhet dhënë fukarenjve për çdo vit. Mirëpo, në Kur'an, Hadith si dhe në praktikën islame, në të kaluarën, zeqati (gjithashtu është quajtur sadak dhe hakk) kërkonte të gjithë ndihmat të cilat i pranonte shteti islam prej shtetasve muslimanë: zeqat për prodhimet bujqësore, për shfrytëzimin e punëtoreve, për kapitalin komercial, për kafshët shtëpiake të cilat kullojnë nëpër kullota të përbashkëta, për të holla të gatshme, etj. Në fillim të gjitha këto ndihma i janë paguar drejtpërdrejt qeverisë. Në kohët e Halifit Othman u vendos që muslimanëve t'u mundësohet ta japin zeqatin drejtpërdrejt shfrytëzuesve të cilët i përmend Kur'ani (9:60) pa ndërmjetësimin e qeverisë.

Kur'ani thekson se pasuria është element esencial për ekzistencë. Për këtë arsye nuk duhet të habitemi pse Pejgamberi (a.s.) dhënien e zeqatit të qeverisë e ngriti në rang të shtyllave themelore fetare, krahas namazit, agjërimit, dhe haxhillëkut.

Në Islam "haraxhi" – tatimi nuk i jepet kryetarit të qytetit për luksin e tij personal, por i jepet vetëm ajo që i takon si e drejtë legjitime, të cilën ia ka caktuar bashkësia. Zeqati u jepet para së gjithash, nevojtarëve me qëllim "të ngritjes" së personalitetit (të dhënies së zeqatit) dhe "pastrimit" të vetvetit, e që është kuptimi real i fjalës zeqat. Pejgamberi (a.s.) ka thënë: "Sunduesi i një populli, në realitet, është shërbëtor i tij". Për ta dokumentuar të vërtetën e kësaj thënie dhe zhdukjen e interesave personale në udhëhëqësinë e popullit të vet – si prijës fetar dhe shtetëror – Pejgamberi (a.s.) deklaroi se të ardhurat e shtetit islam, të cilat arrijnë prej zeqatit që i paguajnë musli-

manët, sipas fesë janë rreptësisht të ndaluara për Pejgamberin (a.s.) dhe për të gjithë anëtarët e familjes së tij. Nëse shefi i shtetit nuk e keqpërdor besimin e masës, kjo i detyron të tjerët të kenë shumë kujdes në kryerjen e detyrave të tyre.

Në kohën e Muhamedit (a.s.) dhe hulefai rashidinėve në shtetin musliman për muslimanët nuk kishte të dhëna të tjera përveç zeqatit. Larg asaj që të jenë lëmoshë, zeqati paraqet ndihmë civile; dhënie e obligueshme dhe e sanksionuar me norma juridike, e nëse dikush e refuzon, mund të merren masa të tjera, nëse ka nevojë edhe me luftë.

Që t'ua potencojmë besimtarëve rëndësinë e kësja dhënie, Kur'ani e shpalli detyrë fetare, të rëndësishme sa edhe besimi në Një Zot, sa namazi, sa agjërimi dhe haxhi. Nëse besimi është detyrë shpirtërore; namazi, agjërimi dhe haxhi detyra trupore, dhënia e zeqatit është detyrë materiale. Juristët e quajnë: "Ibadet malije" (adhurim me pasuri). Fakt është se Islami e barazon tërë jetën e njerëzve në një tërësi, që të mbajë ekuilibër harmonik në mes trupit dhe shpirtit, duke mos i dhënë asnjërës përparësi dhe duke mos lënë pas dore asnjë prej elementeve të cilat e përbëjnë jetën njerëzore. Kur'ani paralelisht përdorë më tepër termine për këtë termin: zeqat (që njëkohësisht do të thotë edhe rritje dhe pastrim; do të thotë se duhet dhënë një pjesë prej të ardhurave që t'i rrisim dhe pastrojmë), sadaka (e cila don të thotë dashuri ndaj të vërtetës dhe dhembshuri, e kjo është: të argumentojmë të vërtetën e mëshirës sonë, lypset dhënë sadaka), hakk (e drejtë: nëse ajo është e drejtë e tjetrit, atëherë është

detyrë e atij që e posedon. E drejta dhe obligimi paraqesin plotësimin reciprok që nevojiten për çfarëdo bashkëpunim dhe, njëkohësisht, paraqesin bazë të veprimtarisë për cilëndo shoqëri.

Në këtë mënyrë janë tatimuar kursimet, korrjet, tregtia, bagtitë që kullosin nëpër fusha, xehet, prodhimet e detit... Tarifat janë të ndryshme, mirëpo ato pa dallim quhen zeqat, hakk ose sadaka. Me sa shihet, tarifat prej kohës së Pejgamberit (a.s.) nuk kanë qenë të ashpra dhe të pandryshueshme. Pamë qysh më lart se Muhamedi (a.s.) i liroi banorët e Taifit që mos paguajmë zeqatin (ka edhe shumë shembuj për territoret tjera).

Halifi i madh Omeri, siç lajmëron Ebu Ubejdeja, e pakësoi doganën e importit të mallrave ushqimorë në Medine.

Gjatë vet jetës së Muhamedit (a.s.) është detyruar në ca raste të marrë të dhëna të jashtëzakonshme, si p.sh. për qëllim të mbrojtjes nga armiku. Në bazë të kësaj, juristët kanë vendosur që qeverisë t'i mundësohet të caktojë taksa (tatime) të reja e të përkohshme (të quajtur NAVAIB), ose t'i rritë tatimet derisa të vazhdojë ndonjë krizë. Heshtja e Kur'anit në pikëpamje të tatimeve juristëve iu jep njëfarë lirie në këtë drejtim.

Mirëpo, Kur'ani detajisht flet për parimet e harxhimeve të pasurisë publike, për buxhetin e të dalave shtetërore: "Sadaka (zeqati) u takon vetëm të varfërve dhe të mjerëve, edhe atyre që e tubojnë edhe atyre zemrat e të cilëve duhet përfituar, edhe për lirimin e robërve, dhe të ngarkuarve me borxhe, edhe luftëtarëve për hir të rrugës së Allahut, edhe të udhëtarëve –

mysafirë, si obligim nga Allahu. Kurse Allahu i di të tëra dhe është i urtë.”

Siç u tha më lart, sadaka dhe zeqati janë sinonime me këtë domethënie: obligim i shtetasit musliman. Ajo që është obligim për jomuslimanët, si haraxhi, plaçka e luftës, etj. nuk i bashkangjiten zeqatit; kurse shfrytëzuesit e tyre gjithashtu dallohen.

Ligjdhënësit tjerë përqendrohen kryesisht në grumbullimin e të ardhurave, kurse shfrytëzuesit e tyre gjithashtu dallohen.

Ligjdhënësit tjerë përqendrohen kryesisht për grumbullimin e të ardhurave, kurse Kur’ani iu kush-ton kujdes kryesor vendosjes së parimit të harxhimit të këtyre të ardhurave. Prej tetë kategorive, të cilave u takon sadaka, siç u përmend në ajetin e lartëshënuar, do të vërejmë se nuk përmendet Muhamedi (a.s.). Disa sqarime do të jenë të dobishme që të kuptohet më mirë rëndësia e ajetit, i cili mbron shfrytëzuesit e këtij zeqati, duke i përjashtuar të gjithë të tjerët.

Sipas komentimit të Omerit, njërit prej autoriteteve më të larta, fjala “të vobektit, nevojtarët” (fukarenj) emëron muslimanët, kurse “të mjerët” (mesakin) është termin përafërsisht identik me të parin, porse me të emërohen të vobektit jomuslimanë, të cilët e gëzojnë mbrojtjen e shtetit islam.

Duhet të theksojmë se sadakaja nuk i përfshin të ardhurat e jomuslimanëve, mirëpo mes shfrytëzuesve të saj Islami i numëron edhe jomuslimanët, edhe pse këtë zeqat e paguajnë vetëm muslimanët.

“Ata që e tubojnë sadakanë” – janë ata që angazhohen për tubimin e të ardhurave, në procesin e

evidentimit, në radhitjen e harxhimeve, në kontrollimin e të hyrave dhe të dalave, në rregullimin e llogarive – praktikisht përfaqësojnë tërë administratën civile dhe ushtarake. Qëllimi është që në këtë grup të “shfrytëzuesve” të përfshihen të gjitha shërbimet administrative të shtetit.

“Zemrat e të cilëve duhet përfituar”, janë kategori të ndryshme. Një jurist i famshëm islam, Ebul A’la el-Ferra, në lidhje me këtë çështje thotë: “Për sa u përket atyre zemrat e të cilëve duhet të përfitohen, ata janë katër grupesh:

1. Ata që duhet t’i përfitojmë e t’u ndihmojmë muslimanëve,

2. Ata që simpatinë e të cilëve e dëshirojmë e të mos mund t’iu sjellin dëme muslimanëve,

3. Ata përmes të cilëve do të mund t’i përfitojmë popujt ose fiset e tyre. Lejohet, pra, që çdonjërit prej këtyre kategorive t’u bëhet e mundshme shfrytëzimi i sadakasë nëse duhet t’u përfitohen zemrat e tyre, pa marrë parasysh a është fjala për muslimanë apo për politeistë”.

“Për lirimimin e robërve” – gjithmonë është quajtur çlirimi i robërve dhe shpagimi i robërve të luftës, të cilët i robëroi armiku – nëse ata ishin shtetas të shtetit islam, në daçi le të jenë muslimanë apo jomuslimanë. Ca fjalë për sa u përket robërve do të ishin të nevojshme të përmendim. Siç shihet, asnjë religjion më herët nuk është kujdesur për përmirësimin e pozitës së robërve. Pejgamberi (a.s.), siç transmeton Seraksiu, krejtësisht iu ka ndaluar arabëve që t’i nënshtrohen robërisë; sa u përket robërve të tjerë, Kur’ani (24:33)

urdhëron siç vijon: Nëse robi është i gatshëm të shpaguehet, dhe nëse meriton të shpaguehet, zotëriu i tij nuk mund ta refuzojë këtë ofertë. Përkundrazi, gjyqi do të detyrojë atë t'i mundësojë robrit të fitojë dhe të kursejë të holla të nevojshme për të shpague vetveten. Përveç kësaj, siç thamë, shteti islam është i obliguar që në buxhetin vjetor të parashohë shumë të hollash për t'u ndihmuar robërve brenda mundësive për qëllim të lirimt të tyre. Qëllimi i legalitetit të robërisë nuk qëndron në atë që ta shfrytëzojmë këtë qenie të pafat, që është sikurse ne. Larg saj. Qëllimi i tij është, në rend të parë, të sigurohet strehim për robërit të cilët i kanë humbur të gjitha dhe të cilët nganjëherë për ndonjë shkak nuk mund të kthehen në vendlindjen e tyre. Në rend të dytë, do të bëhet përpjekje që të edukohen ata dhe t'u jepet rasti ta pëlqejnë kulturën në mesin islam dhe në pushtetin që sundon sipas Ligjit të Allahut. Robërit fitohen vetëm në luftë legjitime, të cilën e shpall qeveria islame. Ekspedita, plaçka private, invazion në territor të huaj për kidnapimin e njerëzve, ose shitja e fëmijëve nga vetë prindërit, absolutisht nuk kanë bazë ligjore në Islam.

Për t'u ndihmuar "atyre që i kanë mbuluar borxhet" mund të realizohet në mënyra të ndryshme. Ne vërejmë se si halifi Omeri organizoi rregullore të posaçme zyrtare për të dhënë kredi pa kamatë.

Termimi "në rrugë të Zotit" përfshin çdo sadaka dhe juristët muslimanë nuk kanë nguruar të dedikojnë sadakanë për pajime ushtarake, për mbrojtje të fesë, pasi që Islami mundohet që të vendos drejtësinë e Allahut në tokë.

Më në fund, mund t'i ofrohet ndihmë “udhëtarit”, jo vetëm me mikpritje, por me sigurinë shëndetësore dhe të rehatisë: sigurim i rrugëve dhe i të gjitha masave për rehatinë e kalimtarëve nëpër një territor; si për vendasit, ashtu edhe për të huajt, për muslimanët dhe për jomuslimanët.

Përfundim

Ky komentim i detyrave fetare mjaft qartë tregon – mirë është të përsërisim – parimin elementar, që e përshkruan tërë jetën muslimane: të zhvillohet në tërësi dhe të harmonizohen pjesët. Kur’ani në shumë vende na rikujton: “Falni namazin dhe jepni zeqatin”. A ka diçka më të rëndësishme se të bësh një trupin e shpirtin! Detyrat shpirtërore kanë në vete vlerën shpirtërore. Përveç kësaj, krejt varet prej qëllimeve dhe motiveve, të cilat qëndrojnë mbi bazat e kryerjes së detyrave fetare.

Kreu VI

Kujdesi për jetën shpirtërore

Islami i ofron njeriut disiplinë për tërë jetën e vet, si atë fizike, ashtu dhe atë shpirtërore. Kjo nuk i pengon individit që, sipas përvojave të ndryshme, të specializojë në lëmenj të ndryshëm dhe në to të dallohet prej të tjerëve. Madje, edhe nëse njeriu koncentrohet në anën e jetës shpirtërore, ai nuk mund të heqë dorë nga aktivitetet tjera të jetës, nuk mund të heqë dorë nga ngrënia, nuk mund të heqë dorë nga interesat më të larta të shoqërisë së cilës i takon etj.

Në ekspozeun e vet të famshëm mbi besimin, mbi përruljen ndaj dëshirës së Zotit, mbi mënyrën më të mirë të asaj përruljeje, Pejgamberi Muhamed (a.s.) e ka formuluar çështjen e fundit me këtë fjalë: "Ihsan" (ose zbulim i gjithçkasë) është të adhurosh Allahun ashtu sikurse e sheh; nëse ti nuk e sheh Atë, Ai të sheh ty gjithsesi". Ky fisnikërim i gjithçkasë që na rrethon, kjo mënyrë më e mirë e devocionit (adhurimit), kjo formë e shërbimit të Zotit është kultura shpirtërore islame . Duhet cekur se t'i shërbesh Zotit, nuk do të thotë të kryesh vetëm shërbimet fetare, nuk nënkupton vetëm lidhjen mes njeriut e Zotit, por gjithashtu – siç është rregulluar sipas pikëpamjeve islame të jetës, përshtatje e njeriut ligjeve hyjnore në të gjitha sferat e jetës së vet. Më i edukuar nga aspekti i jetës së vet, më i edukuar nga aspekti i jetës shpirtërore, është ai i cili me sjelljet e tij në mënyrë konsekuente e ndjek dëshirën e Zotit.

Çështjet e këtij lloji hyjnë në lëmin e misticizmit. Ky term në Islam ka disa nocione: IHSAN (të cilin e gjejmë te thëniet e Pejgamberit (a.s.), të cituar në tekstin e lartpërmendur; KURB (ose të afruarit afër Zotit); Tarikat (ose rruga që shpie drejt Zotit), Suluk (ose rruga drejt Zotit); Tesavuf (që etimologjikisht do të thotë: të vishesh me stof të leshtë). Shprehja e fundit është ndër më të zakonshmet, por nuk dihet se pse është e tillë.

Është e vërtetë se mistikët muslimanë – si dhe mistikët e civilizimeve të tjera – nuk duan t’i zgjerojnë ceremonitë dhe veçantitë e tyre jashtë rrethit të ngushtë të nxënësve dhe të sivëllezërve të tyre. Jo për shkak se aty do të ndodhin fshehtësira skandaloze, por sigurisht pse njerëzit e rëndomtë nuk mund të kuptojnë pse dikush “më kot” mundohet dhe heq dorë nga ëmbëlsitë e kësaj jete dhe, gjithashtu, nga ajo pse zakonisht nuk kanë besim në vetë jetën e mistikëve. Pra, më mirë është krejt atë ta fshehin prej atyre që nuk janë në gjendje që atë ta respektojnë. Të themi kalimthi, ndodh që kur fshehtësia dhe misteri e rrethojnë një gjë, ajo bëhet më e rëndësishme dhe më e çmueshme në sy të atyre që e lypin, edhe pse atë nuk e njohin.

Ndryshimi i njerëzve për nga karakteri ekziston prej kohësh. Merita e Islamit qëndron në atë se diti t’i gjejë çështjet që u interesonin të gjithëve e që të gjithë së bashku e praktikojnë, si program i nevojshëm minimal, i cili njëkohësisht i prek nevojat shpirtërore dhe fizike të njeriut. Që të vërejmë saktësinë e këtij konstatimi, mjafton t’i hedhim një vështrim biografisë së muslimanëve të parë, shokëve të Muhamedit (a.s.), të cilët sipas mendimit të përgjithshëm kanë qenë musli-

manët më të mirë. Çfarë karakteresh kanë qenë muslimanët më të mirë. Çfarë karakteresh të ndryshme! U bë Halidi luftëtar, ushtar i guximshëm, të cilin Muhamedi (a.s.) e quajti “Shpata e Zotit”. Othmani dhe Ibn Av’fi ishin tregtarë të pasur dhe Pejgamberi lajmëroi se ata bëjnë pjesë të njerëzisë së Xhenetit. Ishte Ebu Dherri, i cili nuk i përfillte të hollat dhe tepër e donte jetën e aksetit, duke e mundur vetveten me vetëdashje. Vlen të përkujtojmë rastin e një beduini nomad, i cili një ditë u paraqiti para Pejgamberit (a.s.) dhe e luti që t’ia numëronte detyrat kryesore që njeriu mund ta çojnë në xhenet. Pejgamberi (a.s.) iu përgjigj: “Besimi në Një Zot, pesë kohët e namazit, agjërimi i muajit të Ramazanit, kryerja e Haxhit dhe dhënia e Zeqatit, nëse njeriu për të ka mjete”. Beduini pranon Islamin duke u gjunjëzuar (betuar): “Pasha Zotin, unë nuk do të punoj as më shumë e as më pak prej asaj që është porositur”. Pasi që ky shkoi, Pejgamberi (a.s.) tha: “Kush do që ta shohë banorin e Xhenetit, ky është ai”. As luftëtari Halid, as më i pasuri Othman, nuk kanë lënë pasdore asnjë detyrë kryesore të Islamit; asgjë më pak se Ebu Dherri, Selmani, Ebu Derdaa e të tjerë, të cilët e donin asketizmin, të cilëve Pejgamberi (a.s.) nuk iu lejoi, për shembull, të jetojnë të izoluar, të agjërojnë përherë, të tredhen prej frikës së kënaqësive trupore. Pejgamberi (a.s.), bile, iu rekomandon që të marrohen, duke shtuar: “Ti ke detyra edhe ndaj trupit tënd”. Sipas Islamit, njeriu nuk i takon vetëm vetvetes; ai i takon Zotit dhe nuk është e lejuar ta keqtrajtojë atë që na është lënë peng, që na e besoi Zoti; ky peng është personaliteti ynë.

Sofa

Në xhaminë e madhe të Medines në kohën e Pejgamberit (a.s.), jashtë vendit të caktuar për namaz, ekzistonte pjesa e xhamisë që quhej *sofa*. Ai ishte vend shkollimi dhe edukimi, ku punohej nën kontrollin e vetë Pejgamberit (a.s.). Këtu tubohej një numër i madh muslimanësh. Ata për çdo ditë ia kushtonin një pjesë të kohës së vet mësimi, që të njihen me jetën islame si në pikëpamje të detyrave ndaj Zotit, gjithashtu edhe për detyrat që kishin ndaj shokëve të tyre, anëtarëve të bashkësisë islame. Ata së bashku punojnë të fitojnë pjesën minimale për jetë, të mos bëhen parazitë dhe barrë e anëtarëve të tjerë të bashkësisë. Gjatë natës ata mjaft kohë kalonin si mistikë më të mirë, në kryerjen e ibadetit, që nuk e kishin detyrë, as edhe mendimet. Ky institucion quhej *Ku-vend* (teqe) ose me çfarëdo emri tjetër. Nuk ka dyshim se pjesëtarët e sofasë më tepër i ishin kushtuar jetës shpirtërore sesa kokëçarjeve materiale. Ndoshta nuk do të mund t'ju informojmë detajisht për ceremonitë me të cilat Pejgamberi (a.s.) i ka mësuar mistikët e parë muslimanë, ceremoni të cilat sigurisht ndryshonin sipas natyrës dhe aftësive të çdo personi, pasi që caku është i caktuar, është lënë mjaft liri për zgjedhjen e mjeteve që të arrihet deri tek ai! Kalimthi të përmendim një thënie të Pejgamberit (a.s.): “Urtësia është virtyt i humbur i besimtarit; le ta marrë ku ta gjejë”.

Thelbi i misticizmit

Me fjalën misticizëm (sufizëm), Islami nënkupton besimin e drejtë, përmirësimin e ritualeve fetare, përzgjedhjen e jetës së Pejgamberit (a.s.) si shembull që duhet ndjekur në të gjitha situatat e jetës dhe kryerjen e obligimeve që i ka përshkruar Islami.

Misticizmi nuk ka kurrfarë lidhje me ardhjene fuqisë me të cilën njihen sendet e padukshme, të bëhen çudira, që t'u imponohet dëshira njerëzve të tjerë me ndihmën e mjeteve misterioze psikike. Ai gjithashtu nuk ka kurrgjë të përbashkët me asketizmin, me vetëmundimin, mbylljen në dhomë, të menduarit dhe ndjenjat murgore (të cilat herë pas here mund të jenë mjet, por asnjëherë qëllim), as me ndonjë lloj të besimit në qeniet e Zotit (panteizëm etj.) Ai gjithashtu nuk ka asgjë të përbashkët me pohimet e ca mashtruesve se mistiku është mbi ligjet islame dhe minimumit të duhur të detyrave islame.

Në mungesën e shprehjes më të mirë, mund të thuhet se misticizmi është metoda më e mirë për sjelljet vetjake: mënyra në të cilën arrihet kontrolli mbi vetveten, sinqeritetin, realizimin e pranisë së përhershme të Zotit në veprat tona, përpjekje për ta dashur Zotin, shumë e më shumë.

Edukata islame përfshin një numër të konsiderueshëm detyrash me manifestime të jashtme, si është namazi, agjërimi, mëshira, largimi prej të keqes dhe veprave të këqija etj., por ajo përfshin edhe ca detyra

të brendshme shpirtërore, siç është besimi, falënderimi ndaj Zotit, sinqeriteti, largimi i egoizmit e kështu me radhë. Misticizmi është ushtrim për aspektin tjetër të jetës. Mirëpo, edhe detyrat e jashtme kanë për qëllim pastrimin e shpirtit, që paraqet të vetmen mënyrë për të arritur shpëtimin e përhershëm. Marrë në përgjithësi, mistiku me ushtrimet e veta shpirtërore zhbi-llon disa aftësi të cilat njeriut të rëndomtë i duken të çuditshme, mistike, por mistiku aspak nuk i do, bile, edhe i përbuzë. Njohja e sendeve të padukshme, edhe pse për ca njerëz është e mundshme, si rezultat i disa ushtrimeve shpirtërore, nuk është e preferuar për mistikun, sepse ato janë fshetësi të Zotit: zbulimi i hershëm i tyre mund të jetë, madje, rrezik për njeriun. Prandaj, mistiku nuk shërbehet me ato aftësi; edhe nëse arrin t'i zhvillojë. Qëllimi i tij gjithmonë mbetet pastrimi i shpirtit të vet, se si t'i bëhet më i pëlqyeshëm para Krijuesit të vet. Duhet përmendur se njeriu më i përsosur është ai që fisnikëron jo vetëm pamjen e vet të jashtme, por edhe brendinë e vet, ose si thonë mistikët: trupin e vet dhe zemrën e vet. Përsa i përket aspektit të jashtëm, ai rregullohet nëpërmjet fikhut (i cili përfshin rregullat e gjithmbarshme të jetës së jashtme: kulti, marrëdhëniet kontraktuese, e drejta ndëshkimore etj.), ndërsa aspekti i brendshëm hyn në sferën e misticizmit. Ana e jashtme ceremoniale e ibadetit rrjedh prej fikhut, mirëpo sinqeriteti dhe adhurimi i vërtetë hyn në virtytet tona të brendshme dhe i interesojnë misticizmit. Të përmendim në lidhje me këtë çështje dy ajete të Kur'anit: "Po, ata janë në fitim, besimtarët të cilët me devotshmëri kryejnë namazin e

vet". (23:1,2), ndërsa "hipokritët kur çohen të kryejnë namazin, ata çohen me përtaci; ata vetëm paraqiten para njerëzve të tjerë". (4:142). Kryerja e mirë dhe e keqe e detyrave fetare, siç është përshkruar në ajetet e lartpërmendura, na mundëson që vetvetes t'i parashtrojmë se çka lyp Islami prej besimtarëve të vet në tërë qëndrimet e jetës së tyre.

Tradita islame e detyron Halifin ose shefin e shtetit islam jo vetëm të merret me politikë (duke përfshi edhe kryerjen e detyrës së gjyqtarit), por edhe obligimet fetare, që do të thotë praktikimi publik i fesë siç është namazi, agjërimi, haxhi. E tërë kjo hyn në lëmin e fikhut (drejtësisë islame), të cilën e kanë zhvilluar shkollat e ndryshme. Në këtë lëm monopolin e pushtetit kryekëput është ngarkim, edhe pse kjo është shumë pak me rëndësi përse i përket pjesës së jetës sonë. Dallime sektare ekzistojnë midis muslimanëve. Pas vdekjes së Pejgamberit (a.s.), në pikëpamje të çështjes se kush ka të drejtë të trashëgojë Pejgamberin (a.s.) në kryerjen e pushtetit në lëmin e politikës dhe detyrave fetare publike. Vendimin për këtë ia lëmë Allahut në Ditën e Gjykimit dhe të rrekemi me problemin e ardhmërisë sonë dhe mbrojtjen nga armiqtë e Zotit. Përse i përket jetës së brendshme, që pikërisht e përcakton shpëtimin në Ahretin e Përherhëm, në këtë lëm nuk ka kurrfarë varësie; ca individë mundën dhe, në të vërtetë, e trashëguan Pejgamberin (a.s.). Derisa rendi mistik i Nekberit (a.s.) përmes Ebu Bekrit, rendi i Kaderijve dhe Suhraverdive, për shembull, gjithashtu lypin të njëjtën përmes Aliut, kurse të gjithë janë sunit, prej të cilëve vetëm Ebu Bekri është

trashëgues i drejtpërdrejtë i Pejgamberit (a.s.) në fushën e politikës. Kjo sferë shpirtërore, e cila i bashkon sunitët me shiitët, nuk është abstraksion i zbrazët; ajo ka pavarësinë e vet personale, oerorganizatën administrative. Caktimi i Abdullahut dhe i Autadit, ose i prijesve shpirtërorë dhe i administratorëve, bëhej me rekomandimin e vetë Pejgamberit (a.s.), siç mund të shohim, madje, herët te një autor i tillë siç është Ibn Sa'di. Një monografi prej Sujutiut paraqet një koleksion të tërë të haditheve mbi Kutbin, Abdullanë dhe Autadanë. Këtu nuk ka nevojë të hymë në detaje.

Simpatia e Zotit

Njerëzit e rëndomtë duan që Zoti t'i dojë, por me dashurinë ashtu siç e kuptojnë ata: Zoti t'iu sigurojë mirëqenie. Mirëpo, të duash atë, ta dëgjosh Atë, ja Kur'ani çka na mëson: "Kështu, pra, ata që besojnë janë më të fortë në dashurinë ndaj Zotit". (2:165). Në një vend tjetër, Kur'ani (5:24) përshkruan karakteristikat e njerëzve më të mirë: "...populli që Atë e do e që Ai do".

Mirëqenia materiale nuk është shprehje e dashamirësisë se Zoti ua jep mirënjohjen atyre që do t'i provojë sa do të jenë mirënjohës. Në të dy këto raste, për njeriun është më me rëndësi të tregojë devotshmërinë e vet, besnikërinë e vet ndaj Krijuesit. Kjo lyp, nga një anë, shtypjen e egoizmit të vet dhe zhytje në Dëshirën e Zotit, kurse nga ana tjetër, gjithmonë të ndiejmë praninë e vërtetë të Zotit.

Të ndrydhurit e unit personal nuk ka kurrëgjë të përbashkët me besimin filozofik panteistik. Për mistikun, deklarimi intelektual për këtë nevojë të domosdoshme nuk ka kurrfarë vlere: atë që ai e do, është jo që krejtësisht ta përvetësojë, që në atë të jetojë si në realitetin e vet. Me fjalë të tjera, dallimi mësimor panteist në kuptimin e unitetit jetësor, ose panteizmi si vizioni i përbashkët, për mistikun e vërtetë paraqet vetëm dërdëllitje me fjalë, e cila besimtarin udhëtar e largon prej rrugës së tij dhe e ngadalëson arritjen e tij deri te caku i përcaktuar.

Ndoshta këtu është e nevojshme të përmendim se nocioni “panteizëm islam” nuk çon kah bashkimi i sërishëm i njeriut me Zotin. Sado që njeriu t’i afrohet Zotit, përsëri mbetet njëfarë largësie, një ndarje, një dallim mes Krijuesit dhe krijesës. Shkatërrohet uni personal, por jo personaliteti i tij. Sa më e lartë të jetë shkalla që kemi arritur, aq më tepër Zoti flet përmes gojës sonë, më tepër punon me duart tona, më tepër do me zemrën tonë. Ekziston ngjitja e njeriut dhe rruga drejt Zotit, por asnjëherë uniteti i vërtetë. Prandaj, muslimani nuk e përdor shprehjen “Communion”, me të cilën përfshihet fjala unitet (bashkim); por, ekziston rreziku që të përfshijë fuzionin (shkrirjen) dhe konfuzionin (përzierjen). Muslimanët rrugën shpirtërore e emërtojnë me shprehjen “Mi’raxh”, që do të thotë shkallë, ngjitje e që ndërron varësisht sipas individit dhe cilësive e aftësive të tij. Grada më e lartë e paramenduar, të cilën njeriu mund ta arrijë, është ajo që e arriti Pejgamberi (a.s.). Prandaj, përjetimi i tij quhet “Mi’raxh”. Duke qenë në vetëdije të plotë, do të

thotë derisa ishte i zgjuar, Pejgamberi (a.s.) pati vizonin "Ru'ja" se është bartës në sfera të larta dhe ka qenë i gostitur me praninë e Zotit. Dhe, në atë gjendje, jashtë kohës dhe hapësirës, Kur'ani thotë se mes Pejgamberit (a.s.) dhe Zotit (xh. sh.) mbeti një largësi e vogël (53:9): "Ai ishte shumë afër..." Kjo është shprehje me të cilën, në të njëjtën kohë, dëshirohet të theksohet edhe afërsia edhe largësia. Të theksojmë kalimthi që Pejgamberi Muhamed (a.s.) personalisht e ka përdorur shprehjen "Mi'raxh", bile, edhe për besimtarët e rëndomtë, sepse ka deklaruar se "Namazi është mi'raxh i besimtarit". Dukshëm, secilit sipas aftësive dhe meritave të tij.

Rruga shpirtërore ka një seri etapashdhe ato kalohen vetëm gradualisht. Ne shohim në jetën e Pejgamberit (a.s.) se edhe ai ka filluar duke u tërhequr në shpellën e kodrinës Hira. Gjatë periudhës së Mekës për të kishte vetëm mundime dhe vetëmohim për misionin hyjnor dhe vetëm pas Hixhretit atij i lejohet – përsëri me urdhrin e Zotit – që t'i kundërvihet të padrejtës me anë të fuqisë. Krejtësisht është e mundur që dikush të paraqitet si dervish, në realitet ai të jetë sa për sy e faqe, do të thotë të paraqet ujkun në lëkurën e qengjit. Ndërkaq, gjithashtu është e mundur që një mbret, me tërë fuqinë dhe pasurinë e tij në arkat e tij gjatë jetës të jetë njeri fisnik, i cili, duke hequr dorë nga komoditeti i vet, nuk i shfrytëzon pasuritë e veta dhe bën sakrificat të mëdha vetëm e vetëm që të kryejë detyrën e vet.

Që të mposhtet egoizmi, në rend të parë duhet të zhvillohet ndjenja e thjeshtësisë dhe përunjësisë. Krenaria konsiderohet si mëkati më i madh ndaj Allahut.

Sipas fjalëve të Gazaliut, mburrja është devotshmëri ndaj vetvetes, pra një lloj idhujtarie.

Sjelljet e njerëzve janë të ndryshme. Prandaj, edhe rrugët ndryshojnë. Kështu që Islami pikërisht në atë insiston – ka nevojë për udhëheqës, mësues. Nuk jepet leja e mjekut një njeriu që është autodidakt në mjekësi; atij nuk i jepet mundësia që të marrë pjesë në këshillimet e atyre që kanë përvojë aty. Të rralla janë rastet kur njeriu i sheh të metat e veta. Edhe më të rralla janë rastet kur njeriu përmirësohet vetvetiu, madje menjëherë. Misioni i mësuesit na nevojitet që ai të na tregojë gabimet tona dhe mënyrën se si t'i evitojmë ato gabime. Ekziston zhvillimi i përhershëm, evolucioni i pandërprerë, kurse mësuesi neve na çliron prej një vargu tentimesh të padobishme. Nëse nuk shfrytëzohet përvoja e së kaluarës dhe nëse secili njeri i lindur nuk e shfrytëzon atë përvojë, por në mënyrë të pavarur niset prej vetvetes, atëherë nuk do të kishte më as kulturë e as civilizim. Ato bazohen në njohuritë e akumuluarra dhe në praktikën e të parëve tanë. Ndaj gjykimeve dhe këshillimeve të mësuesit të vet nxënësi ka tjetër konsideratë, në krahasim me këshillat dhe mendimet e shokëve të tij të një rangu. Sipas studimeve teorike, njeriu e kalon një kohë në stazh dhe praktikë. Siç vlen kjo për shkencat materiale, ashtu vlen edhe për shkencat natyrore. Ka shumë gjëra të cilat kurrë nuk do të jenë të mësuara me anë të betimit dhe dëgjimit: zbatimi nën mbikëqyrjen e mësuesit me përvojë gjithmonë është e dobishme, të mos themi e domosdoshme. Njohja nuk mjafton: duhet të asimilohet, duhet të bëhet detyra jonë e dytë.

Mistikët rekomandojnë sidomos katër kushte: të hash më pak, të flesh më pak, të flasësh më pak dhe të shkosh në ndeja sa më pak. Megjithatë, duhet të përmendim se “më pak”, nuk do të thotë ta lësh krejtësisht pasdore: ajo herë-herë është e pamundur (si tek ushqimi dhe fjetja) e gjithmonë është e padëshirueshme; te të gjithat duhet maturi. Të hash sa për të jetuar e jo të jetosh për të ngrënë. Të hash aq sa të kesh fuqi për të kryer urdhrat dhe dëshirën e Zotit; kjo, bile, është akt devotshmërie. Të pakësosh ushqimin dhe të dobësohesh aq sa të zvogëlohet aftësia shpirtërore, kjo do të ishte mëkat. Gjumi nevojitet për mbajtjen e shëndetit; kjo është detyrë për njeriun, mirëpo gjumi i tepërt e dobëson rritjen e shpirtit. Të flesh më pak, kjo do të thotë të pakësosh numrin e fjalëve banale, do të thotë krejtësisht të ikësh prej tyre, e nëse është e mundur, prej çdo fjale të keqe. Njerëzit shpesh kanë zakon që të tjerëve t’u japin këshillime të mira, e në të njëjtën kohë ata harrojnë që së pari t’i zbatojnë në jetën e tyre. T’i vizitosh sa më pak njerëzit, kjo do të thotë: të mos u shkosh pa nevojë. Mirëpo, t’iu kryesh shërbimet të tjerëve, të merresh me gjëra prej të cilave është i kënaqur Zoti ynë, këto janë lëvizje të njeriut që meritojnë lëvdata. Megjithatë, nuk duhet të harrohet se nevojat e njerëzve ndryshojnë sipas gradës së zhvillimit të tyre. Mësuesit me nevojë nuk i jepet e njëjta këshillë që i jepet dikujt që është fillestar. Vizita njerëzve sjell prova, shkakton humbjen e kohës së çmuar dhe shpeshherë është shkas që të harrojmë detyrat më me rëndësi dhe më të vyeshme. Mund të shtojmë edhe këshillën e pestë: të

harxhosh më pak, fjala është për gjërat luksoze, në ko-
ketime, në kënaqësitë personale... Të hollat e kursyera
mund t'i shfrytëzojmë për qëllimet tona të dashura,
por duke pasur shprehinë për të harxhuar, del se nuk
kemi para. Këto pesë këshilla mund të paraqesin pesë
parime të ekonomizimit në Islam, si në pikëpamje
shpirtërore, ashtu dhe në pikëpamje materiale.

Aktet e veçanta

Duhet të orvatemi që ta kujtojmë Zotin në çdo
moment. Është me rëndësi që ta përkujtojmë me
zemër. Mirëpo, pasi që koncentrimi nuk mund të jetë
i përhershëm, praktikohen metodat fizike, se si të
shtohet prania e shpirtit, koncentrimi i mendimit për
Zotin. Kur'ani thotë (33:41, 42): "O besimtarë, përsëri-
tni shpesh emrin e Zotit dhe lëvdojeni Atë në mëngjes
e në mbrëmje". Gjithashtu: "...të cilët në këmbë, ulur,
të shtrirë e përmendin Allahun dhe mendojnë mbi
krijimin e qiejve dhe të tokës duke thënë: Krijues i
ynë! Ti këtë nuk e ke krijuar për kot. Faleminderit, na
mbro neve prej zjarrit të Xhehenemit". Ka ibadete në
të cilat gjithmonë përsëriten të njëjtat formula dhe të
cilat thuhet për çdo ditë, si shprehi. Ato shqiptohen
me zë ose në vete, mirëpo duhet të ceket se këtu gjith-
monë fjala është për Zotin, për Qenien e Tij, për
cilësitë e Tij, për Atributet (sifatet) e Tij dhe kurrsesi
për krijesat. Nëse është fjala për të Dërguarin, Muha-
medin (a.s.), ai gjithmonë përmendet për mënyrën e

të drejtuarit kah Zoti, p.sh.: “O Zot, mëshiroje Muhamedin dhe shpëtoje atë”. Ose: “O Zot, ringjalle Muhamedin në vendin e lavdishëm që ia ke premtuar dhe pranoje ndërmjetësimin e tij për ne” e kështu me radhë. Që sa më tepër të mund t’i koncetrojnë mendimet e veta, mistikët herë-herë vetmohen, tërhiqen prej njerëzve, e ndërpresin frymëmarrjen për disa çaste, mbyllin sytë dhe ia tërheqin vërejtjen e të rrahurave të zemrës, gjithmonë duke menduar për Zotin etj. Ata thonë se gjatë të menduarit për Zotin ekzistojnë tri shkallë: të përkujtosh emrat e Tij, të përkujtosh krijesat e Tij, duke filluar prej emrave të Tij dhe, në fund, të përkujtosh krijesat e Tij pa pasur nevojë të mendosh emrat e Tij dhe pa pasur nevojë për ndonjë mjet tjetër përkujtimi. Këto qëndrime sikur t’i kish rekomanduar Pejgamberi (a.s.) dhe ato nuk e kanë prejardhjen prej të huajve. Mund të përkujtojmë se si Ebu Hurejra kishte bërë tespihë prej perit, me 2000 nyja që shërbenin si kokrra dhe ai për çdo natë e përsëriste një lloj lutje. (Ibn Fadlall-llah el-Ummari, Mesalik el-Ebsar, t.5, Stamboll).

Mes tjerash, mund të përmendim jetën askete, mundimin e vetvetes dhe të menduarit vetëm për vdekjen dhe për Ditën e Gjykimit. Për Islamin sjelljet e tilla nuk janë qëllime, por vetëm mjete, edhe ate të përkohshme dhe kalimtare, të cilat ndihmojnë që njeriu të sundojë dhe të nënshtrojë vetveten. Gjithçka që na i lejojmë vetes në jetë ndahet në të nevojshme dhe luksoze. Kurrë nuk mund t’ia ndalojmë vetes atë që është e nevojshme, sepse kjo do të thoshte vetëvrasje. Vetëvrasja sipas fesë islame është e ndaluar rrept-

ësisht, sepse ne nuk i takojmë vetvetes, por Zotit. Të shkatërrosh diçka para se të shteret, do të thotë t'i kundërvihesh dëshirës së Zotit. Përsa i përket luksozes, nëse ai nuk bëhet qëllim i jetës sonë, është i lejuar. Mund të heqim dorë që të mund t'u ndihmojmë atyre që nuk janë në gjendje të kënaqin as nevojat fillestare të jetës, ose që të mund të pendohemi. Mirëpo, nuk është e lejueshme të tejkalohet masa. Njeriu burrë i cili mundohet të jetë i përlur, është më i meritueshëm prej atij që i shkatërron dëshirat e natyrshme, p.sh. me intervenim kirurgjik. Ai i cili nuk është i aftë të bëjë mëkat nuk ka merita sikur ai që është plotësisht i aftë për të, mirëpo prej asaj vullnetarisht përmbahet nga respekti që ka ndaj Zotit.

Mundimi i vetvetes, përmbajtja prej kënaqësive të ndryshme dhe ushtrimet tjera shpirtërore i shtojnë disa aftësi, por vetëm zhvillimi i atyre aftësive, sado që të jenë të rëndësishme, nuk është vetëm qëllimi i afrimit kah Zoti dhe insistohet që të kryhen disa vepra e jo ndjenjat të cilat rrjedhin prej tyre, në një lloj autokratizmi. Madje, edhe jobesimtari mund të zhbi-llojë disa veti të të shenjtëve, mirëpo shpëtimin mund të zhvillojnë disa veti të të shenjtëve, mirëpo shpëtimin përfundimtar. Mistiku gjithmonë shkon kah qëllimi i tij, kurrë nuk merret me imtësi të cilat ndodhin në atë drejtim.

Jeta e një dervishi, e një mistiku fillon me pendimin e mëkateve të kaluara dhe me përmirësimin, sa të jetë ajo e mundur të dëmeve që u ka bërë njerëzve. Zotit i takon e drejta t'i falë gabimet e kryera ndaj Tij, mirëpo padrejtësitë ndaj krijesave Zoti nuk i fal, por

vetë ato krijesa. Lutjet drejtuar Zotit nuk e lirojnë njeriun nga mëkatet që i ka bërë ndaj krijesave të Zotit. Vetëm atëherë mund të nisemi rrugës që çon kah Zoti. Ajo nuk është monopol i askujt. Është e mundur që çdokush, por jo vetëm e mundur: është detyrë e secilit njeri të nisët në atë rrugë. Rruga ka dy karakteristika: dëgjueshmëri Zotit dhe të menduarit e përhershëm për Zotin. Dëgjueshmëria është më e lehtë, duke marrë parasysh atë se dimë çka duhet të punojmë dhe çka është dëshira e Zotit. Zoti dëshirën e tij dhe rregullat i Shpalli përmes Pejgamberit të Tij, që këto t'ua komunikojë njerëzve.

Zoti ka dërguar pejgamberë të panumërt. Por, mësimet e tyre kanë ndërruar në disa detaje specifike. Kjo nuk do të thotë se Zoti ka ndërruar mendimin. Përkundrazi, kjo do të thotë se Ai në urtësinë dhe mëshirën e Tij konsideronte se zhvillimi ose prapambeturia e aftësive tona njerëzore ka nxitur nevojën që të ndërrojnë rregullat në ca detaje specifike. Edhe pse në pjesët qenësore të mësimëve të veta, veçanërisht në pikëpamje të relacioneve mes njeriut dhe Zotit, pejgamberët mes vete nuk dallojnë - Islami këtë veçanërisht e thekson - njeriu që iu përulet urdhrave të Zotit të vet jetën e vet mund ta pajtojë me urdhrat më të reja të dëshirës së vet. Nëse Zoti iu ka lajmëruar njerëzve diçka përmes pejgamberit Ibrahim, kjo nuk do të thotë se është i padëgjueshëm ai që i përshtatet mësimet të Musait (a.s.), sepse ai na ka sjellë për kohën e vet urdhrat e fundit të të njëjtit Zot; por, edhe mospërfillja e urdhrave të Musait dhe përkrahja e mësimëve të Ibrahimit nuk paraqet mosrespektim flagrant ndaj

Zotit. Ashtu është dashur, njerëzit të zbatojnë në jetën e tyre Shpalljet e Zotit që i kanë sjellë pejgamberët njëri pas tjetrit, prej të cilëve i fundit është Muhamedi (a.s.). Prandaj muslimani, edhe pse i respekton plotësisht pejgamberët e mëparshëm, përvetëson urdhrat e fundit të Zotit që i janë lajmëruar njerëzimit. Muslimani beson në prejardhjen hyjnore të Tevratit, Suhu-feve, Inxhilit, por i përulet mesazhit të fundit dhe më të ri të Zotit, Kur'anit. Kush mbetet i lidhur për ligjet e kaluara, nga ana e Ligdhënësit nuk mund të konsiderohet respektues i ligjit.

Përfundim

Pasi që njeriu në të njëjtën kohë është i përbërë prej trupit dhe shpirtit, jashtësisë dhe brendësisë, progresi harmonik dhe zhvillimi i ekuilibruar kërkohet në kujdes të njëjtë për të dyja këto anë të qenies njerëzore. Misticizmi, ose kultura shpirtërore, në Islam paraqitet si zvogëlim i saj që quhet UNË, me shtimin në të njëjtën kohë të pranisë së Zotit në ne. Të zhyturit në Dëshirën e Zotit në asnjë rast nuk do të thotë palëvizshmëri, larg asaj. Kur'anit në shumë ajete përmend se njeriu duhet të veprojë, bile edhe të bëjë "gara" me të tjerët në kërkimin e mbështetjeve në Zotin përmes "veprave të mira". Të mos vazhdojë pas dëshirave vetëvrasëse, por t'i përmbahet dëshirës së Zotit, të mos shkojë deri në letargji dhe mosaktivitet. Ndodh vetëm ajo që Zoti lyp prej nesh; por, nëse nje-

riu nuk i njeh kërkesat e Zotit, të cilat i mbeten të fshehta, gjithmonë duhet të vazhdojë me përpjekjet e veta që të arrijë te caku të cilin ai e konsideron fisnik dhe në përputhje me urdhrat e Zotit. Ky koncept dinamik i destilimit është i rezymuar në këto ajete të Kur'anit (57:22, 23): “Asfarë fatkeqësie nuk mund t’ju gjejë në tokë e ajo të mos (ketë qenë) në Libër (Levhi Mahfudh) para se ta krijojmë Ne atë (fatkeqësinë). Me të vërtetë ajo është lehtë për Allahun (ta bëjë). Ju njoftojmë juve mbi atë që të mos dekurajoheni për atë që u ka kaluar dhe që të mos gëzoheni (për tepër) për shkak të asaj që ju ka dhënë Zoti. Zoti nuk i do mburacakët e as mendjemëdhenjtë”.

Njeriu gjithmonë duhet ta kujtojë Madhërinë e Zotit dhe, në të njëjtën kohë, vogëlsinë e vet, ashtu si do të jetë në Ditën e Ringjalljes, kur Zoti do të lyp prej të gjithëve që të japin llogaritë për jetën e tyre. Kur’ani thotë: “Për sa u përket atyre që luftojnë në rrugën Tonë, me siguri Ne do t’i udhëzojmë rrugëve Tona. Me të vërtetë, Zoti është me ata që bëjnë vepra të mira” (29:60).

Kreu VII

Etika islame

Njerëzit mund të ndahen në tri grupe kryesore:

1. Në ata që janë nga natyra të mirë, të cilët sprovimet nuk mund t'i prishin (asgjësojnë), prej vet natyrës së tyre rrjedh vetëm mirësi dhe bamirësi.

2. Në ata që, përkundrazi, janë të këqinj dhe të përmirësueshëm dhe

3. Në ata që i takojnë grupit të mesëm, të cilët sillen si duhet në qoftë se janë të detyruar, me mbikëqyrje ose presion, se përndryshe bëjnë vepra të këqija dhe sillen armiqësisht ndaj të tjerëve.

Kjo kategori e tretë përfshin pjesën më të madhe të gjinisë njerëzore, gjersa dy kategoritë tjera numërojnë relativisht një numër të vogël ithtarësh. Kategoria e parë (njerëz-melaqe) nuk ka nevojë për kurrfarë udhëzimesh dhe për asfarë kontrollimi. Duhet përdorur të gjitha mjetet përkatëse që të ndalohen nga e keqja ithtarët e kategorisë së dytë (njerëzit-lanetë); e më tepër duhet të angazhohemi me kategorinë e tretë të njerëzve të rëndomtë. Kategorisë së tretë i takojnë ata që në një aspekt iu ngjajnë shtazëve: ata janë të qetë dhe të kënaqur me atë që kanë gjersa te të tjerët nuk vërejnë diçka më të mirë, ose gjersa nuk dyshojnë se të tjerët dëshirojnë t'u bëjnë ndonjë të keqe. Ky inatnkt i keq, i cili i nxit sprovimet, i paraqet problemet shoqërore prej kohësh: babai i pengon fëmijët e vet, kryetarët - familjet, fiset, qytetet, shtetet ose ca grupe

të tjera njerëzore. Mundohen që të nënshtruarit e vet t'i detyrojnë të kënaqen me atë që kanë, që të mos e rrëmbejnë me fuqi atë që të tjerët e kanë fituar në mënyrë të ndershme.

Shoqëria njerëzore ndoshta nuk ka qëllim tjetër përveç që t'i kontrollojë sprovimet dhe t'i përmirësojë padrejtësitë e bëra. Gjithë njerëzit, bile të të njëjtit komb, nuk mbërrijnë asnjëherë në nivel të njëjtë të zhvillimit; shpirti fisnik është i gatshëm të sakrifikojë, të jetë i mëshirshëm; shpirti inteligjent sheh më larg dhe pasojat nga shkatërrimi i fitimit të drejtpërdrejtë e pengojnë të mos bëjë keq, por, gjithashtu, nuk është i gatshëm të sakrifikojë në dëm të vet. Shpirti i rëndomtë jo vetëm që nuk është i gatshëm të mëshirojë, por i lejon vetes të pasurohet në llogari të të tjerëve, me përjashtim të rastit kur frikësohet prej reagimit të drejtpërdrejtë nga ana e atij që e dëmtoi, ose prej shoqërisë ose prej ndonjë fuqie tjetër. Njeriu kokëtrashë nuk do të ndalet, bile, edhe në raste frike dhe ai ecën deri në fund në përpjekjet e veta kriminele, derisa të mos pengohet në veprimtarinë e vet nga ana e shoqërisë me vdekje ose me burg.

Të gjitha ligjet, religjionet, filozofitë përpiqen t'i bindin masat, kategorinë e mesme të njerëzve, që të sillen si duhet, bile të bëjnë sakrifica vullnetare, t'i ndihmojnë të vobegët, të mjerët dhe atyre që pa dashje kanë rënë në vështirësi dhe nuk kanë fuqi të shpëtojnë prej saj.

Pikat karakteristike të Islamit

Islami është mënyrë complete e jetës: ai urdhëron jo vetë besimin, por edhe rregullat shoqërore të sjelljes. Përveç kësaj, ai kujdeset për praktikimin dhe funksionin e ligjit të vet. Dimë që Islami nuk pranon që kjo jetë të jetë qëllim në vete, e as që beson se trupi nuk ka asfarë lidhje me shpirtin. Islami, përkundrazi, mëson se duhet të besojmë në jetën e përhershme. Motoja e tij themelore, të cilën e shpalli Kur'ani, thotë: "...për këtë botë, të mira dhe për Ahiret, të mira...". Kështu, ai nuk kufizohet të lavdërojë të mirën dhe të kritikojë të keqen, por përcakton shpërblime dhe dënime, si shpirtërore ashtu dhe materiale. Përsa u përket ndalimeve, Islami përpiqet të mbjellë në shpirt të njeriut frikërespekt ndaj Zotit, prej gjykimit të mbarmë pas ringjalljes, prej dënimit me zjarr të Xhehennemit; mirëpo, ai nuk kënaqet vetëm me atë: ai ndër-merr të gjitha mjetet e mundshme në fushën e sanksioneve materiale që të pengojë njeriun të mos bëjë padrejtësi dhe t'i shkelë të drejtat e tjerëve. Kështu, besimtari lutet dhe agjëron, bile atëherë kur askush nuk e detyron; ai e jep zeqatin, bile atëherë kur qeveria nuk e di sasinë e pasurisë së tij, ose nuk është në gjendje që ta tubojë zeqatin me forcë.

Themelet e moralit

Shpesh ndodh që motivet dhe rrethanat prej themeli t'i ndërrojnë veprat të cilat në shikim të parë janë të ngjashme: vdekja prej dorës së hajnit, prej anës së budallës, ose prej fëmijës së mitur, prej anës së njeriut që vetëm mbrohet, prej ushtarit që e mbron atdheun nga invazioni, tërë këto vdekje janë të ndryshme. Vrasja në ca raste dënohet rreptësisht, e ca herë lehtë, nganjëherë falet, nganjëherë konsiderohet detyrë normale që nuk tërheq as lavdatë e as qortim, nganjëherë meriton lavdëratat dhe nderimet më të larta. Tërë jeta njerëzore përbëhet prej veprave të mira dhe të këqija, të cilat janë relative. Mu për këtë Muhamedi (a.s.) shpeshherë ka përmendur se “veprat e njeriut do të gjykohen sipas qëllimeve”.

Islami themelohet në besimin e Shpallur të Zotit që i kushtohet njerëzimit, të udhëzuar përmes pejgamberëve të Allahut. Ligji i Tij, morali i Tij dhe besimi i Tij themel kanë urdhrat e Allahut. Mund të ndodh që, përsa i përket çështjes së moralit, mendja e njeriut të mbërrijë në të njëjtat përfundime sikurse ato të Ligjit të Shpallur, vetëmse në Islam është me rëndësi Ligji i Shpallur, e jo mendimet e një filozofi, juristi apo moralisti. Kjo është me rëndësi aq më tepër pasi rezonimet e njerëzve të ndryshëm mund të jenë mes vete të ndryshme dhe ata mund të mbërrijnë në përfundime krejtësisht kontradiktore. Nganjëherë në themel të ca

detyrave qëndron motivi i disiplinës, kurse në shikim të parë kjo detyrë duket e tepërt.

Veprat njerëzore, në rend të parë, mund të ndahen në të mira dhe në të këqija, në obligime dhe ndalime, kurse veprat prej të cilave njerëzit duhen të tërhiqen ndahen në dy kategori të mëdha: në ato që përveç dënimit në Ditën e Gjykimit ekziston edhe sanksion i kësaj bote, dënimi material, dhe vepra për të cilat Islami nuk parasheh dënim tjetër përveç atij në Ditën e Gjykimit.

Në një deklaratë të Pejgamberit (a.s.) (të cilën e transmeton Ijadi në librin e vet *Kifa*) ne shohim se çfarë koncepti jetësor ka Islami. Aliu (r. a.) një ditë e pyeti Pejgamberin (a.s.) për sjelljen e tij të përgjithshme. Ai u përgjegj: “Njohuria (mençuria) është kapitali im, kurse mendja (arsyeja) është themeli i besimit tim; dashuria është themeli im, dëshira është kali i shalës për mua; ta kujtoj Allahun është detyrë imja, besnikëria është pasuria ime; kujdesi është shoku im, dituria është arma ime; durimin e kam mbrojtje, modestia është fitim për mua, thjeshtësia është krenaria ime; të shmangem prej dëfrimeve është mjeshtri imja, siguria është ushqimi im; e vërteta është bashkëbiseduesi im, dëgjueshmërinë e kam cilësi, luftën shprehi; ndërkaq, gëzimi i zemrës sime është namazi”.

Në një rast tjetër Muhamedi (a.s.) ka thënë: “Kulmi i lumturisë është t’i frikësohesh Allahut”. Morali islam fillon me largimin prej çdo adhurimi, përveç adhurimit në Një Allah (xh. sh.) si: adhurim i vetvetes (egoizëm), adhurim i prodhimeve të duarve tona

(idhuj, besime të kota) dhe largim prej tërë asaj që e degradon njerëzimin (pabesi, padrejtësi etj.).

Duke e çrrënjosur pabarazinë mes njerëzve, e cila bazohet në racë, në ngjyrë, në gjuhë, në vendlindje – Islami ka shpallur (dhe e ka realizuar më shumë se të gjithë të tjerët) se vlefata e njeriut bazohet në vleftën e moralit të tij, gjë që çdo njeri, pa dallim, mund ta mbërrijë (gjersa ai nuk mund ta ndërrojë ngjyrën e lëkurës së vet, gjuhën, kombësinë etj.). Kështu, Kur’ani thotë: “O njerëz, Ne ju kemi krijuar juve prej një mashkulli dhe një femre dhe ju kemi bërë popuj e fise që ta njihni njëri-tjetrin. Më fisnik tek Allahu është ai që më së shumti i ruhet Atij; Allahu me të vërtetë është shumë i dijshtëm dhe i Urtë” (49:13).

Në një ajet tjetër (17:23-39) Kur’ani bashkësinë islame e urdhëron kështu: “Zoti yt ka përcaktuar që të mos adhuronit tjetër përveç Atij dhe të silleni mirë me prindërit. Nëse njëri prej tyre, ose të dy, përjetojnë pleqëri te ti, mos iu thuaj “of” – e as mos iu fol me zë të lartë, por t’iu drejtohesh me fjalë respekti të plotë. Shtriji përpara tyre krahët e përulësisë dhe thuaj: “O Zoti im, kij mëshirë ndaj tyre, siç kanë pasur ata kujdes ndaj meje në vegjëli!” Zoti juaj e di më së miri se ç’ka në shpirtin tuaj. Nëse jeni të mirë – ani, Allahu njëmend ua fal atyre që pendohen. Jepja të drejtën e vet të afërmit tënd dhe të afërmit e udhëtarit – mysafir, por mos harxho shumë, sepse harxhuesit janë shokë të djallit, e djalli është mohues i Zotit të vet. Dhe, nëse gjithsesi do t’u kthesh shpinën, sepse edhe vetë nga Zoti yt kërkon mëshirë dhe shpreson për të, atëherë thuaju ndonjë fjalë të mirë. Mos e rrudh dorën

fort, por as mos e lësho krejtësisht e të mbetesh i qortuar dhe pa asgjë. Zoti yt kujt të dojë i afron furnizim të majmë, por edhe e kufizon. Ai është me të vërtetë i informuar për robërit e vet. Jo, mos i mbytni fëmijët tuaj nga frika e skamjes. Ne i ushqejmë edhe ata edhe juve; mbytja e tyre me të vërtetë është mëkat i madh. Dhe, mos iu afroni imoralitetit, është punë e fëlliqur; eh sa rrugë e shëmtuar që është! Dhe, mos e mbytni askë që e ka ndaluar Allahu, përveç kur e kërkon e drejta. Por, nëse dikush, pa pikë faji, vritet, atëherë trashëgimtarit të tij i japim pushtet, por as ai le të mos e teprojë në vrasje! Ai është me të vërtetë i ndihmuar. Edhe pasurisë së bonjakut mos iu qasni fare! Përveçse me qëllim të mirë, derisa të bëhet madhor. Dhe, përmbushni obligimet, sepse obligimet kanë me siguri përgjegjësi. Edhe masën plotësojeni kur të peshoni me litër, madje peshoni drejt edhe me terezi! Kjo është më mirë dhe përfundimi më i bukur. Mos e ndiq atë që nuk e di! Edhe të pamit, edhe të dëgjuarit, edhe kuptuarit, për të gjitha këto, me siguri ka përgjegjësi. Mos ec mendjemadh nëpër tokë, sepse ti tokën nuk mund ta çash e as t'i arrish malet e larta. E keqja e tërë këtyre është e urrejtur te Zoti yt. Kjo është urtësi, që ty po ta shpall Zoti yt. Dhe, mos i shto Allahut tjetër zot e të hidhesh në xhehenem i qortuar dhe i larguar nga mëshira e Tij”.

Këto urdhra, duke i krahasuar me ato që iu dhanë Musait (a.s.), janë më përmbledhëse, e i janë shpallur Pejgamberit (a.s.) në Miraxh.

Do të ishte e tepërt që të përmendim të gjitha paralajmërimet dhe vërejtjet e Kur’anit, por do të

përmendim edhe një prej tyre (4:36, 37, 38): “Adhurojeni Allahun dhe asnjë send mos e trajtoni të barabar të me Të! Jini të mirë me prindërit dhe të afërmit, edhe me bonjakët dhe të varfrit e ngratë, edhe me fqinjët e afërt dhe me fqinjët e largët, edhe me shokët përrreth dhe me udhëtarët, edhe me ata që janë nën kujdesin tuaj. Allahu, pa dyshim, nuk i do ata që janë mendjemëdhenj dhe arrogantë. Ata që janë kopracë dhe i adhurojnë të tjerët për kopraci dhe që fshehin atë që Allahu iu ka dhënë nga begatia e vet. Ne mosbesimtarëve iu kemi përgatitur dënim të tmerrshëm. Edhe atyre që e shpenzojnë pasurinë e tyre për t’u reklamuar para botë dhe nuk i besojnë Allahut e as botës tjetër. Pra, kush e ka djallin shok, shok të keq ai ka!”

Në një ajet tjetër Kur’ani përshkruan karakteristikat e bashkësisë muslimane: “Pa dyshim, besimtarët janë vëllezër, prandaj pajtoni dy vëllezër tuaj dhe kini frikë e ruajuni Allahut, ndoshta ju mëshiron. O besimtarë, mos të tallen burrat njëri me tjetrin, mbase ata janë më të mirë se këta; por as gratë njëra me tjetrën, ndoshta ato janë më të mira se këto. Mos e shkarkoni vetveten dhe mos i ngjitni njëri-tjetrit llagape (të këqija)! Sipas besimit, është shumë keq vënia e llagapit të keq. Dhe, ata që nuk pendohen – ata janë mizorë. O besimtarë, shmanguni nga një mori parashikimesh! Disa prashikime me të vërtetë janë mëkat. Dhe, mos e spiunoni njëri-tjetrin e as mos e përqeshni njëri-tjetrin! A do dikush prej jush të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur? Ju atë e dini, se është shumë keq – prandaj, ruajuni Allahut, Allahu vërtet i pranon pendimet dhe është shumë i mëshirshëm” (49:10-12).

Mëkati dhe falja e tij

Askush nuk do të ishte ngritur kundër këtyre këshillave të mira të ajeteve të lartpërmendura, mirëpo njeriu i ka dobësitë e veta: ai njëkohësisht përbëhet prej elementeve të mira dhe të këqija. Të metat e tij natyrore e hudhin në hidhërim, e shtyjnë në sprovime dhe t'iu bëjë keq atyre që janë më të dobët se ai dhe nuk kanë mundësi të pengojnë në të, ose t'i hakmerren për të. Përkundrazi, ndjenjat fisnike të tij e shtyjnë në pendim pasi të kryejë veprën dhe varësisht prej ndjenjave të tij fisnike ai përpiket që pak a shumë të përmirësojë të keqen e bërë.

Islami i ndanë mëkatet në dy kategori të mëdha: mëkate të cilat bëhen kundër së drejtës së Allahut (pabesia, mosfalja e namazit etj.) dhe mëkatet të cilat i rrezikojnë të drejtat e të tjerëve. Vetvetiu kuptohet që Allahu nuk e ka adet t'i falë mëkatet që i bën njeriu ndaj njerëzve të tjerë; kjo e drejtë i takon personit të dëmtuar dhe askujt tjetër. Ndërkaq, të bërit keq ndaj ndonjë krijese tjetër, njeriut, shtazës etj. konsiderohet, në realitet, vepër dyfish e keqe: jo vetëm kundër atij që është dëmtuar, por edhe kundër Zotit, pasi që sjellja gjakësore paraqet shkelje të dispozitave të Zotit.

Prandaj, ca të padrejta ose punë të këqija të bëra ndaj një krijese lypin jo vetëm orvatje për t'u kompensuar dëmi, duke i kthyer të dëmtuarit në të drejtën e shkelur me dhunë, por gjithashtu kërkohet që të lyp falje edhe prej Allahut (xh. sh.) Në një Hadith Pejga-

mberi (a.s.) paralajmëroi se në Ditën e Gjykimit dikush do të hudhet në xhehenem për shkak se e lidhi macen dhe e la të ngordhte, duke mos i dhënë të hante e as e lejoi që vetë të gjente ushqim. Sipas një transmetimi tjetër, Muhamedi (a.s.) ka cekur se Allahu do të dënojë, bile, edhe ata njerëz që nuk i plotësojnë detyrat e veta ndaj kafshëve: nëse nuk i ushqejnë sa duhet, nëse i ngarkojnë aq sa nuk mund të mbajnë etj. Pejgamberi (a.s.), bile, e ndaloi të priten drurët pa nevojë. Njeriu duhet të shfrytëzojë gjithçka që krijoi Allahu (xh. sh.), por me masë të duhur, pa shkapërderdhje.

Gabimi i bërë ndaj të tjerëve ka shumë mënyra që të përmirësohet: nganjëherë mjafton të lypet falje prej atij. Mënyra e dytë, që të kthehet e drejta e uzurpuar, të kompensohet ajo që nuk mund të kthehet etj.

Të jesh i durueshëm ndaj të tjerëve dhe të falësh, është cilësi fisnike, në të cilën Islami gjithmonë ka insistuar. Duke e lavdëruar këtë cilësi, Kur'ani thotë: "Dhe, shpejtoni për të kërkuar falje nga Zoti juaj dhe për në xhenet, gjerësia e të cilit kap qiej dhe tokën, e është përgatitur për të devotshmit. Të cilët japin lëmshë edhe kur kanë edhe kur janë në skamje, të cilët e mposhtin hidhërimin dhe i falin njerëzit. Edhe Allahu i do punëmirët" (3:333, 134).

Porositet të falurit, mirëpo (duke marrë parasysh njeriun e rëndomtë) lejohet edhe revanshimi. Këtë domethënie e ka edhe ky ajet: "Shpërblimi i së keqes është e keqja në të njëjtën masë, por kush fal dhe pajtohet, shpërblimi i tij është tek Allahu, Ai me të vërtetë nuk i do kriminelët" (42:40).

Ndër emrat e Allahut është dhe Rrahman (mëshirues), Tevab (ai i cili pranon penotimet), Afuv (ai që i fshin mëkatet), Gaf-far (falës i madh) etj. Ata që bëjnë mëkat ndaj Allahut, pastaj pendohen dhe largohen prej gabimeve të veta, do të gjejnë tek Allahu mirëkuptim të plotë. Dy ajete të Kur'anit do të na japin parafytyrimin islam mbi mëshirën e Allahut (xh. sh.):

a)"Jo, Allahu nuk ta fal nëse Atij i shoqëron zota të tjerë. Të gjithë të tjerat i fal kujt të dojë Ai".

b)"...O robërit e Mi! Ju, të cilët punuat padrejtë ndaj vetvetit, mos i humbni shpresat në mëshirën e Allahut. Me të vërtetë Allahu i fal të gjithë mëkatet. Ai është mëshirues dhe falës i pakufishëm".

Sikur njerëzit të largohen nga pabesimi dhe sikur të drejtohen kah Allahu (xh. sh.) dhe ta lutin për T'i falur, mund të shpresojmë se do të jetë mëshirues ndaj tyre. Njeriu është i dobët dhe shpesh i nderon vendimet e veta: e drejta e të penduarit gjithmonë mund të përfitojë mëshirën e Allahut ndaj tij. Nuk ekziston asnjë mënyrë që të përfitohet falja nga ana e Allahut me ndërmjetësimin e njerëzve të tjerë: duhet t'i paraqitemi drejtpërdrejt Allahut, t'i shprehim pendim të sinqertë drejt për drejtë (Munaxhat), Atij i cili i di të gjitha gjërat dhe prej të cilit nuk mund të fshehim asgjë.

"Dashuria e Allahut ndaj krijesave të Tij është njëqind herë më e madhe prej dashurisë së nënës ndaj fëmijës së saj", tha Pejgamberi (a.s.) në një rast.

Në një rast tjetër Muhamedi (a.s.) tha: "Allahu mëshirën e vet e ndau në 100 pjesë, prej së cilës ai mbajti 99 kurse një pjesë ua ndau të gjithë krijesave në

tokë; mëshira reciproke mes krijesave është me pre-jardhje të njëjtë”.

Në një thënie tjetër (hadithi kudsi) Pejgamberi (a.s.) thotë: “Allahu tha: “Kush do të mundohet të më afrohet për një pëllëmbë, Unë i afrohem për një bërryl; kush do të Më afrohet për një bërryl, Unë i afrohem për një pash; kush do të më afrohet me ecje, Unë i vrapoj në takim”. Kur’ani (11:114) thotë: “Me të vërtetë, veprat e mira i fshijnë veprat e këqija”.

Mëshira dhe dhembshuria janë, pa dyshim, të porositura, por, prapëseprapë, nuk mundësojnë automatikisht faljen e Allahut për ndonjë gabim; ato mes vete janë të pavarura dhe Allahu (xh. sh.) e ka dëshirën absolute.

Ndalimet

Kur’ani shpesh i përdor dy terma karakteristike që të sinjalizojë të mirën dhe të keqen; maëruf, që sinjalizon të mirën, të cilën e njeh tërë bota dhe, si të tillë, e pranon dhe do të thotë: “i përshtatshëm”; munker, do të thotë “i pazakonshëm”, (e keqe) të cilën e njeh e tërë bota dhe e konsideron të tillë, e don të thotë: për dënim. Me fjalë të tjera, Kur’ani ka besueshmëri në natyrën e njeriut, në mendjen e shëndoshë të tij: asnjëherë në natyrën e njeriut, në mendjen e shëndoshë të tij: asnjëherë nuk do të pajtohet me të keqen, edhe pse ca punojnë në atë drejtim. Kur’ani besimtarët e vet i quan “bashkësi më e mirë” (3:110) dhe

atë e sqaron në mënyrën siç vijon: “Ju jeni populli më i mirë se të gjithë të tjerët që janë paraqitur ndonjëherë; kërkoni të bëhen vepra të mira dhe pengoni nga të pamirat dhe i besoni Allahut”. Në një ajet tjetër është më kategorik: “Pasha kohën! Njeriu me siguri është në humbje, përveç atyre, të cilët besojnë dhe bëjnë vepra të mira dhe, të porosisin për drejtësi dhe i rekomandojnë njëri-tjetrit durim” (103:1-3).

Gjithashtu, ekzistojnë edhe urdhra që iu takojnë veprave të këqija. Siç u tha, ekzistojnë vepra të cilat i përcjellin ca saksione, ca dënime publike dhe vepra për të cilat njerëzit do të dënohen në botën tjetër: autoriteti publik nuk angazhohet në këtë të fundit në përjashtim të rasteve që janë jashtëzakonisht të rënda.

Në fjalimin e vet të famshëm, në Haxhin e Lam-tumirës, Pejgamberi (a.s.) deklaroi se assesi nuk është lejuar të shkelet e drejta e njeriut në këto tri kategori të së drejtave: personaliteti, pasuria dhe nderi. Mu për këtë, ligji islam i merr parasysh këto krime: vrasjen, lëndimet trupore, prostitucionin, shkatërrimin e jetës bashkëshortore (këto janë krime kundër personalitetit); vjedhja, plaçkitja (sulm në pasuri); shpifja kundër nderit të dikujt, përdorimi i pijeve alkoolike (cenim i nderit). Këto krime hakmerren në këtë mënyrë:

Për cenimet kundër personalitetit, parashihet revanshimi: jetë për jetë, sy për sy, dhëmb për dhëmb. Së paku, parimisht sepse merret parasysh motivi: a thua vepra është kryer me qëllim, ose vetëm rastësisht? Përveç kësaj, ekziston mundësia që i dëmtuari (ose trashëgimtarët e tij) të mund të pranojnë shpëgjimin në të holla ose t’ia falë dëmin e bërë. Nëse është

dokumentuar me gjyq se vepra është kryer me tendencë, autoriteti qeveritar nuk ka të drejtë t'ia falë; kjo e drejtë i takon vetëm të dëmtuarit.

Krejtësisht është ndryshe çështja e prostitucionit dhe e shkeljes së kurorës: marrëveshja e palëve të dëmtuara nuk e lehtëson peshën e veprës. Pejgamberi (a.s.) në këtë mënyrë ka arritur të zhvillojë ide drejtësie dhe autokritike në zemrat e shokëve të vet – të cilët më shumë kanë dëshiruar të dënohen publikisht në këtë botë se në botën tjetër – ata vetë kanë ardhur te Pejgamberi (a.s.) t'i pranojnë mëkatet e bëra dhe të lypin dënimin. (Për sa u takon delikteve seksuale, kur ekziston marrëveshja e të dy palëve, është vështirë të gjendet fakti konkret pa pranimin e tyre. Këtu është më mirë të mbështetemi në fenë islame). Për t'i pakësuar dukuritë negative, Islami ka paraparë masa të tjera preventive: i ka ndaluar përzierjet dhe takimet e pakontrolluara të gjinive të të rinjve, nëse nuk janë në lidhje të ngushtë familjare. Këtu është porosia për mbulesën e fytyrës kur gruaja del në rrugë, ose takohet me të huajt. Në vend që të tërheq shikimet e huaja, me bukurinë e vet muslimania e ka për detyrë ta ruajë bukurinë vet për bashkëshortin e vet.

Nuk ka nevojë të ndalemi në aspekte të ndryshme të vjedhjeve ose plaçkitjeve, ose kundër krimeve të tjera në pasuri. Është karakteristike për Islamin se ka paraparë dënime ligjore për shpifjet kundër grave të ndershme. Nëse mendojmë se me sa naivitet njerëzit e mashtrojnë njëri-tjetrin, sa naivë janë kur bisedojnë njëri me tjetrin duke i dhënë liri të madhe gjuhës, patjetër e kemi t'i pranojmë vendimet, në interes të

shoqërisë, që plotësisht e arsyetojnë frenimin dhe kontrollimin e gjuhës. Nëse dëshirojmë ta padisim ndonjë grua, patjetër duhet të paraqesim fakte të cilat gjyqi i konsideron të pranuar. Nëse nuk jemi në gjendje atëherë të gjithë shpifjet e drejtuara kundër nderit të ndonjë femre, rreptësisht gjykohen – dënohen nga ana e gjyqit.

Ndalimi i pijeve alkoolike është ndër karakteristikat më të njohura islame. Islami këtë ndalesë e ka futur gradualisht: “Të pyesin ty për verën dhe bixhozin; thuaju, ato janë mëkat i madh, por në to ka edhe dobi, mirëpo mëkati është më i madh se dobitë”. Pastaj: “O besimtarë, mos u falni kur të jeni të dehur, derisa nuk e dini se çka thoni” (4:43); dhe në fund: “O besimtarë, nuk ka dyshim se alkooli, edhe loja me para, edhe idolatria, edhe shigjetat për fall janë të ndyra, nga punët e djallit, prandaj largohuni prej tyre, që të jeni të shpëtuar! Djalli dëshiron që me anë të alkoolit dhe të lojës me fat (bixhozit) të fusë ndërmjet jush armiqësi e urrejtje dhe t’ju largojë nga përmendja e Allahut dhe falja e namazit. Ani apo hiqni dorë?” (5:90, 91).

Shumë mirë u pa në ajetin e fundit, që Kur’ani vë në të njëjtën kategori pijet alkoolike dhe idhujtarinë. Gjatë jetës së vet, Muhamedi (a.s.) i dënonte me 40 rënie me kamxhik ata që e shkelnin këtë ndalesë. Halifi Umer e dyfishoi këtë dënim, duke argumentuar se të dehurit të shpie në llomotitje të turpshme me të cilën mund të përlyhet nderi i gruas. Pasi që, sipas Kur’anit, parashihet dënim me 80 rrahje me kamxhik për ofendimin e nderit të ndonjë gruaje, vendimi i Omerit është që edhe përdorimi i pijeve alkoolike të

dënohet me të njëjtin dënim. Sa humbje të mëdha do të ishin evituar; në sa shtëpi do të ishte kthyer rehatia sikur njerëzit të fillonin të largoheshin prej pijeve alkoolike, të cilat janë aq të rrezikshme për shëndetin dhe moralin?!

Ndër veprat që i lihen gjykatësit që vetë ta marrë vendimin, e përmendim bixhozin, me të gjitha llojet e tij (lotarinë, bastin /kaullin në gara etj.). Kush nuk i ka të njohura tragjeditë që ndodhin në vendet e kumarit? Sa shtëpi rrezikohen duke shpresuar fitimin e lehtë (në lojë të ndaluar)? Lotaritë me karakter nacional gradualisht shkaktojnë pabarazi në ndarjet e të ardhurave nacionale; kjo pabarazi shkakton ngushtësi ekonomike, bile edhe politike.

Duke u përpjekur që ta pastrojë shoqërinë, veçmas aparatin shtetëror prej korrupsionit, Pejgamberi (a.s.) ka përdorur fjalë më të rrepta duke thënë: “Ai që pranon, si dhe ai që jep ryshfet do të hyjë në Xhehenem”. Një ditë, një prej tubuesve të zeqatit erdhi te Muhamedi (a.s.) t’i japë llogarinë dhe i tha: “Ja të ardhurat për arkën shtetërore, kurse këtë shumë ma kanë dhënë mua personalisht dhuratë”. I hidhëruar, Pejgamberi (a.s.) u ngrit në xhami dhe mbajti një fjalim ku tha: “Këta tubues le të rrinë nëpër shtëpitë e veta, pastaj le të shohim se a do t’ju mbërrijnë dhuratat”. Pa mos ditur burri, gruaja e Halifit Omer i dërgoi pas një emisari që udhëtoi për në Bizant një dhuratë mbretëreshës së atij shteti. Ajo për revansh i dërgoi një qafore të çmuar. Kur halifi e kuptoi këtë, ai e konfiskoi qaforen, e ktheu në arkën shtetërore, kurse gruas së vet ia pagoi sa e kishte vlerën.

Duke u përpjekur ta përmirësonte moralin, Pejgamberi (a.s.) një ditë tha: “Mos e nëmëni kohën; me këtë nëmëni Zotin, sepse ndërrimi i kohës, i ditës dhe i natës vjen vetëm prej Zotit”. Ja vërejtja që vlen edhe sot e kësaj dite. Fundi i fundit, çfarë dobie na sjell nëma e kohës disa herë në ditë, kur dihet se me këtë vepër argumentojmë budallakinë tonë personale.

Islami nuk lyp atë që është e pamundur, por gjithmonë anon kah përmirësimi i moralit në gjithë lëmenjtë e jetës, e me të gjitha mjetet që janë të përshtatshme për individët dhe tërë shoqërinë. Edhe përgjegjësia do të ngelë te vetë individi, siç thotë edhe Kur’ani: “Secilit i takon ajo që e ka fituar; bile edhe ajo që u fitua kundër dëshirës së lirë të atij që fitoi (2:286). Shpirti fisnik nuk i lejon vetes të bëjë keq, duke u arsyetuar se edhe të tjerët bëjnë keq. Në vend që të imitojmë të metat e të tjerëve, duhet dhënë njerëzve shembull të mirë dhe të karakterit të lartë.

Të përfundojmë me ca shënime mbi jetën shoqërore në përgjithësi:

Në pikëpamje të detyrave fqinjësore, Muhamedi (a.s.) ka thënë: “Xhibrili shumë herë më ka përmendur për të drejtën e fqinjit, saqë u frikësova mos t’i japë pjesëmarrje në trashëgim sikurse që është rasti me akrabanë e të vdekurit”. Pejgamberi na ka dhënë shembull se si duhet të sillemi ndaj fqinjit, bile edhe nëse ai nuk është musliman. Tregohet se ai ka banuar në Medine pranë një hebreti, të cilit shpeshherë i ka bërë shërbime me kënaqësi dhe është kujdesur për të në raste të sëmundjes, e ka vizituar pandërprerë etj. Në aspektin për marrëdhëniet me të tjerët, Pejgamberi

(a.s.) ka thënë: “Askush prej jush nuk është besimtar nëse për vëllanë e vet nuk dëshiron atë që ia dëshiron vetes”. Ose më tutje: “Njeri më i mirë është ai që bën vepra të mira”. Kur’ani (59:9) flet për një rast konkret në lidhje me muslimanët e Medines, të cilët pranuan për miq muslimanët e Mekës dhe i përmend për shembull të gjallë dhe praktik të fesë islame.

“...ata me fisnikërinë e tyre iu dhanë përparësi atyre, edhe pse vetë ishin të varfër...”.

Të përfundojmë: “O besimtarë, jini përherë të drejtë, dëshmoni për Allahun, qoftë edhe në dëmin tuaj ose në dëm të prindërve dhe të afërmëve, qoftë i pasur a i varfër, se Allahu është më i parë se ato të dy palët. Prandaj, të jeni të drejtë dhe mos i ndiqni epshet. Po, në qoftë se dëshmoni padrejtësisht ose i shmangeni dëshmisë, ani, Allahu vërtet është i njoftuar se çka punoni”.

Kreu VIII

Sistemi politik në Islam

Pasi që koncepti i jetës në Islam është në harmoni të trupit e të shpirtit, është e natyrshme të realizohet lidhja shumë e ngushtë ndërmjet fesë dhe politikës, ndërmjet xhamisë dhe fortifikatës. Sipas konceptit të vet për shoqërinë, Islami është sistem i përbashkët: ai i jep përparësi jetës së stabilizuar, ai lyp të kryhet namazi bashkërisht, duke u kthyer drejt vendit të përbashkët (Qabesë), ai agjërimin dhe festën e lyp në të njëjtën kohë – në të njëjtin moment për besimtarët në të gjitha anët e botës dhe vizitën e shtëpisë së Zotit (Qabesë) si një prej detyrave kryesore për çdo musliman, qoftë ai burrë ose grua. Ai e vë theksin rreptësisht në përgjegjësinë e vet dhe nuk e harron zhvillimin e personalitetit, atë e organizon një nga një, në një tërësi/bashkësi të pandarë muslimane. I njëjti ligj vlen për të gjithë, në çfarëdo klase shoqërore ose në çfarëdo vendi të punohet; dhe, siç do të shohim, vetëm kryetari, Halifi, pranon betimin prej të gjithë besimtarëve të botës.

Nacionalizmi

Në shoqërinë njerëzore vërehen dy tendenca të kundërta, të cilat shkëmbehen: njëra prej tyre është centripetale e tjetra centrifugale. Në një anë, njësi të

veçanta grupohen: në çifte, në familje, qytete – shtete, shtete, perandori, ndonjëherë vullnetarisht, ndonjëherë detyrimisht. Nga ana tjetër, i njëjti çift rrjedh prej të njëjtëve prindër, grupet ndahen prej grupeve më të mëdha, që të jetojnë të ndara, të pavarura, larg prej kushërinjve të tjerë. Herë pas here ato në ndarje detyrohen nga shkaqe miqësore, me qëllim që në vendin tjetër të gjejnë mjete për të jetuar dhe ta lehtësojnë barrën e jetës së atyre që mbeten në copën e tokës së vogël, e cila nuk mund t'i ushqejë të gjithë. Ndonjëherë, përsëri, ndarja është rezultat i dëshirës së madhe, i grindjes ose i shkaqeve të tjera.

Përpos, përafërsisht, tërë ndërgjegjes unanime të njerëzve për atë se kemi prejardhje të përbashkët, dy faktorë kanë kontribuar në ndarjen e njerëzve: janë këto vdekja dhe largësia. Njeriu parandjen lidhjen e vet me të afërmit e vet, me paraardhësit e vet, mirëpo lidhshmëria zhduket me vdekjen e të parëve dhe gjiri i anëtarëve të rinj të bashkësisë familjare, numri i të cilëve shumëzohet prej dite në ditë, gradualisht humb për nga domethënia dhe ndikimi. Për sa i përket largësisë, ajo jo ndikon që ndikon që të harrohen lidhjet familjare, por, sikurse na tregon historia, ajo krijon pengesa të pathyeshme: nuk flitet më e njëjta gjuhë, interesat më nuk janë të njëjta, as njerëzit nuk luftojnë për të njëjtat interesa.

Kur u paraqit Islami, në shekullin VII sipas Krishtit, paragjykimet gjuhësore, qoftë në pikëpamje të vendlindjes e tjera, më parë ishin rregulla se sa përjashtime; ishte ide e cila rrënjët i kishte thellë e që nuk mbeti vetvetiu diçka e kuptueshme. Kjo mbretëronte gjithku-

nd në botë; në Arabi, në Evropë, në Afrikë, në Azi, në Amerikë, gjithkund. Islami gjykimet e tilla i numëroi në shprehitë e këqija dhe kujdesej të gjente ilaçin.

Duke i bashkuar lidhjet familjare, kooperativat, bile edhe fiset, as prej së largu nuk mjaftonin për nevojat e mbrojtjes e të sigurisë në një botë ku egoizmi dhe lakmia e bënë të domosdoshme luftën – të gjithë kundër të gjithëve. Prandaj, grupet në fise herë pas here formoheshin për nevojë, që përbënin luftëtarët dhe pushtuesit, por që nuk ishin të aftë të realizonin interesat e përbashkëta të të gjithë pjesëtarëve të bashkësisë. Prandaj, gjithmonë ekzistonte kërcënimi për shkatërrimin e asaj bashkësie artificiale.

Duke mos hyrë në historinë e ngjarjeve në vitet e zhvillimit nga aspekti shoqëror, mjafton që si shembull të përmendet nocioni ynë bashkëkohor “kombësi”, që është, sa për sye e faqe, në gjendje t’i shërbejë qëllimit për mbrojtje dhe siguri të qytetarëve. Nëse kombësia themelohet në identitetin e gjuhës, të racës ose të vendlindjes, vetvetiu kuptohet se në atë rast gjithmonë do të mbetet çështja hapur për të huajt. Secila kombësi, e kuptuar në atë mënyrë, është e kufizuar tepër që kurrë nuk do të mund t’i përfshijë banorët e tërë botës. Me fjalë të tjera, gjithmonë do të ketë rrezik prej luftërave dhe konflikteve. Ndër të tjera, ajo lidhje përmes kombësisë as nuk është mjaft e sigurt: dy vëllezër mund të jenë armiq, sikurse dhe dy të huaj me ideologji të përbashkët mund të jenë miq.

Kur’ani e hedh poshtë secilin superioritet në bazë të gjuhës, ngjyrës së lëkurës ose çfarëdo karakteristike tjetër të natyrës e cila vetvetiu na është dhënë dhe

pranon vetëm superioritetin e vet, e cila themelohet në devotshmërinë e vet. Ideologjia e përbashkët është baza e “kombësisë” tek Islami (pasi që Islami nga vetvetja është ajo ideologji). Nuk flasim për religjionet të cilat nuk lejojnë asnjë prozelitizëm; nga religjionet tjera me domethënie botërore, Islami dallohet me atë se nuk lyp prej ithtarëve të vet që ta braktisin këtë botë, por në të njëjtën kohë merr parasysh edhe trupin edhe shpirtin. Historia tregon se gjer në çfarë shkalle janë arsimuar muslimanët në pikëpamje të vëllazërimit, më tepër sesa në pikëpamje të racës e të kombit. Kjo ndjenjë tek ata nuk është as sot më pak e gjallë sesa ishte dikur.

Sot vërejmë se natyralizimi praktikohet te të gjitha “kombet”; mirëpo të natyralizohesh sipas gjuhës së re, ngjyrës së re të lëkurës, vendlindjes së re, as më pak e as më shumë nuk mund ta mposhtësh vetëmohimin që, në të vërtetë, do të thotë ta pranosh një ideologji të re. Kombësia te të tjerët, në esencë, është çështje e prandryshuar e natyrës; kombësia islame është çështje e cila varet vetëm nga dëshira dhe zgjedhja e çdo individi.

Mjetet për realizimin e universalitetit

Përveç mjeteve që i përmendëm – uniteti i fesë për të gjithë, orientimi me rastin e faljes së namazit, vendi i përgjithshëm për kryerjen e haxhit etj. – për të arritur universalitetin Islami ka me një institucion krejtësisht të veçantë: ky është halifati botëror.

Muhamedi (a.s.) shpalli se ai është Pejgamber i Allahut, i dërguar për të gjithë njerëzimin (krahaso 34:38) dhe se është pejgamber i fundit (shih: 33:40) dhe, sipas asaj, për të gjitha kohët, deri në mbarim të botës. Shkenca e tij e ndërpreu pabarabarësinë, e cila rrjedh prej asaj që i takon një race ose ndonjë klase. Përveç kësaj, Muhamedi (a.s.) i kreu të gjitha llojet e sundimit: shpirtëror, të shenjtë e të tjera në bashkësinë të cilën ai e organizoi si shtet, që i ka të gjitha funksionet. Tërë kjo bashkësi e sundimeve pas vdekjes së tij kaloi tek pasardhësit e tij, të cilët e morën timonin shtetëror, me atë dallim që pasardhësit e tij nuk janë pejgamberë të Allahut, që do të thotë se atyre nuk iu është bërë Shpallja e Zotit. Muhamedi (a.s.) gjithmonë insistonte në nevojën e jetës kolektive, për këtë shkoi aq larg sa tha se ai që vdes duke mos e pranuar halifin e vet (imamin), vdes si pagan. Ai gjithashtu insistoi në një bashkësi islame, duke thënë: “Ai që ndahet prej bashkësisë islame shkon në Xhehenem”.

Gjatë kohës së Muhamedit (a.s.) kishte individë, bile edhe grupe që vullnetarisht ose pa dëshirë jetonin jashtë kufijve të shtetit islam, si për shembull në Abisini ose në Mekë (para se të pushtonte atë qytet Pejgamberi /a. s./). Ca vende jomuslimane nuk kanë ditur për tolerimin e fesë islame dhe i përzinin muslimanët (p.sh. qyteti – shtet Meka, Mbretëria Bizantine e kështu me radhë); ca vende të tjera, si p. sh. Abisinia krishtere, udhëhiqnin politikë liberale për sa i përket lirisë së ndërgjegjes.

Siç pamë praktikisht, halifi prej Pejgamberit (a.s.) trashëgoi sundimin e dyfishtë, shenjtor dhe shpirtë-

ror: sikur Pejgamberi, edhe ai udhëhiqte namazet bashkërisht në xhami dhe, në të njëjtën kohë, ishte shef i shtetit në çështjet e kësaj bote.

Pejgamberi (a.s.) është pranuar përmes betimit (Bej'a) ose kontratës për dëgjueshmëri; u është dhënë betimi halifëve në kohën e zgjedhjeve të tyre. Baza e organizatës shtetërore është kontrata që kanë lidhur shtetasit me sovranin e tyre. Në praktikë, betimin e japin vetë shtetasit më autoritativë të bashkësisë. Të emëruarit në sundim, sipas kontratës, nënkupton mundësinë për prishjen e kontratës, do të thotë përmbyshjen e shefit të shtetit sipas vendimit të po atyre që janë autoritativë.

Muhamedi (a.s.) bashkësinë e vet e udhëhiqte në cilësinë e Pejgamberit të Zotit. Ligji të cilin ai e themeloi dhe ua la pas gjeneratave të ardhshme gjithashtu buronte prej Shpalljes së Zotit për pasardhësit e tij. Sovraniteti hyjnor edhe më tutje ekzistonte si realitet në fushën e autorizimeve të tyre: ata janë pasardhës të Pejgamberit të Zotit, mirëpo ata nuk mund të pranojnë shpallje nga Zoti, që do të thotë autorizimet e tyre në pikëpamje të legjislacionit janë të kufizuara: ata nuk mund t'i tërheqin ligjet që i ka themeluar Pejgamberi (a.s.) në emër të Allahut; ata ato ligje jo vetëm mund t'i komentojnë, por edhe mund të nxjerrin ligje në rast se nuk ka ligje të përcaktuara prej kohës së Pejgamberit (a.s.). Me fjalë të tjera, halifi nuk mund të jetë despot, madje për sa i përket ligjit: ai është shef i kushtëzuar i shtetit dhe, në të njëjtën kohë, shtetas i ligjit si çdo qytetar tjetër. Dorëzimi që ka mbetur prej kohës së Pejgamberit (a.s.) lyp që shefi i shtetit islam

të mos jetë jashtë ligjit: historia dëshmon se halifët kanë qenë të thirrur para gjyqeve, bile edhe nga ana e qytetarëve më të thjeshtë, e edhe nga jomuslimanët, prej kohës së Ebu Bekrit e deri më sot.

Teoria dhe praktika e halifatit nuk kanë shkuar gjithmonë baras në kuadër të bashkësisë islame; një shikim i shkurtër i historisë së tyre do të jetë i dobishëm që të mund të kuptohet gjendja e tanishme.

Historia e halifatit

Në politikë Kur'ani parasheh vetëm hipotezën e monarkisë – ai flet për mbretëritë e mira e të këqija – dhe kurrë nuk deklarohet për format tjera të shtetit, si p.sh. për republikë. Vetëm fakti se kanë ekzistuar mendime të ndryshme me rastin e vdekjes së Pejgamberit (a.s.), tregon se ai nuk ka lënë institucione precize për çështjen e trashëgimit. Disa grupe atëherë dëshën që sundimin shtetëror ta mbajnë si trashëgim në vetë familjen e Pejgamberit (a.s.). Pasi ai nuk pati djalë, Aliu, si kushëri më i afërt i tij, duhej ta trashëgoonte, sipas mendimit të tyre. Të tjerët lypën që të bëhet zgjedhja e sundimit dhe pse nuk janë pajtuar për kandidatin e atij vendi. Pjesa më e madhe e muslimanëve iu bashkuan atyre që lypnin të bëhej zgjedhja. Duhet të vërehet se tipi i qeverisë, i vendosur në atë mënyrë, paraqet një formë kalimtare nga monarkia në republikë: Halifi është i zgjedhur përjetësisht; zgjedhja e ka afruar kah republika, kurse afati i sundimit

kah monarkia. Qysh në fillim kishte të atillë që nuk u pajtuan me zgjedhjen e halifit; kurse më vonë, madje, rivalët pretendentë prej kohës në kohë shkaktuan gjakderdhje në kuadër të bashkësisë islame. Kështu, më në fund, praktikisht erdhi deri te formimi i dinastive. Por, kur Emevijtë i zëvendësuan Abasijtë, ata mundën t'ua impononin sundimin e tyre vendeve të largëta islame, si Spanjës, ku dinastitë e pavarura të sunduesve muslimanë e kishin sundimin sovran, mirëpo përsëri nuk mund të shpalleshin halifë (të vetëpavarur). Duhej të kalonin dy shekuj që në botën islame, në të njëjtën kohë, të mund të paraqiteshin njëkohësisht shumë halifë: në Bagdad, në Kordovë, në Kajro (Fatimijtë). Turqit, duke pranuar Islamin, sollën një element të ri: ata të parët i dhanë oborrit mbretëror ushtarët, pastaj komandantët, do të thotë aparaturnën e shtetit. Përveç halifit, "komandantit suprem", "sulltani" kryente sundimin mbi shtetin, që do të thotë se sulltani drejtonte shtetin në emër të halifit. Kjo gjendje shkaktoi lakminë e aventuristëve, provincat pavarësoheshin, duke i dhënë "DINASTISË" mëkëmbësin, të cilët nga ana e tyre zëvendësoheshin nga aventuristët tjerë dhe halifit nuk i mbetej kurrgjë tjetër vetëm se të vërtetonte aktin e kryer. halifi fatimij i Kajros u humb, ndërsa mbretëria e tij kaloi në duart e një dinastie turke, e cila e pranoi halifin e Bagdadit. Kur qytetin e shkatërruan tatarët, selia e halifit kaloi përsëri në Kajro. Këtu turqit otomanë më vonë morën sundimin në duart e tyre dhe rrëzuan dinastinë abasije dhe halifin e saj. Më vonë, halifati i Spanjës ia lëshoi vendin e pushtuesve krishterë dhe tërhiqet në

Marok, ku themelon halifatin e ri. Stambolli (turk) dhe Delhi (mogul) gjithashtu përfituan për vete të drejtën në halifat; sado që këto mbretëri të kenë qenë të mëdha, pretendimet e tyre në halifat ishin të pranuar ve-tëm në suazat e juridiksionit të tyre. Para tyre respe-ctohej kushti që halifi të jetë vetëm prej fisit kurejshit (pasaardhësit e arabëve të Mekës prej kohës së Muha-medit /a. s./). As turqit e as mogulët nuk e kanë plotësuar këtë kusht; mirëpo ne për këtë do të flasim më vonë. Mogulët anglezët i përzunë nga India; Halifin e Turqisë në Stamboll e rrëzuan qytetarët e vet, të cilët jo vetëm që e zgjodhën formën e shtetit republikan, ma-dje nuk donin që për shef të shtetit të tyre të mbajnë madhështinë e halifëve. Autorizimet dhe prerogativat e halifatit janë transmetuar në Kuvendin e madh popu-llor (në Ankara), mirëpo ky as i lypj as i ndërmori. Halifi i fundit turk, Abdul Mexhidi II, i njëqindti halif pas Pejgamberit (a.s.), vdiq në mërgim, në Paris. Ndër-kohë, Kalifati Maroken u bë protektorat i Francës.

Këtu do të jenë të dobishme disa vërejtje. Pejgam-beri (a.s.) ka paralajmëruar se pas tij halifati do të ekzistojë vetëm tridhjet vjet dhe, sipas kësaj, musli-manët do ta kenë vetëm “durueshmëri të rëndë” mbretërinë. Mendohet se prej Pejgamberit (a.s.) gjithashtu ekziston thënia se halifati i takon fisit Ku-rejshit. Nuk dihet teksti i vërtetë i asaj direktive; e as vetë qëndrimet e Pejgamberit (a.s.) nuk vërtetojnë se ajo është e domosdoshme. Me fjalë të tjera, historia tregon se pas ardhjes së tij në Medine dhe themelimit të Shtetit, Muhamedi (a.s.) 25 herë e lëshoi kryeqyte-tin dhe shkoi në anë të ndryshme të Arabisë, qoftë për

qëllime luftarake, qoftë për qëllime paqësore (haxhi) dhe çdo herë e ka emëruar zëvendësin e vet, që mbejti në Medine. Ai nuk e zgjidhte çdo herë të njëjtin person për zëvendës të vet: ne këtu do të gjejmë medinelij, kurejshij, kinanij e të tjerë. Në largimin e tij të fundit, tre muaj para vdekjes, kur u nis për në Haxh të Lamtumirës, ai "halifatin" në metropol ia besoi një të verbëti (edhe ai nuk ishte i vetmi rast i llojit të tillë). Edhe një moment: kur u zgjodh Ebu Bekri për halif, u propozua një lloj udhëheqësie e dyfishtë - dy halifë të sundojnë në të njëjtën kohë. Për shkaqe praktike ai propozim është hedhur poshtë. Ajo mënyrë e sundimit përsëri mbetet si një prej formave që lejohet në Islam, sepse e pranon Kur'ani (i cili flet për Harunin si bashkësundues i Musait), pasi vetë Pejgamberi (a.s.) e ka mbajtur atë lloj të sundimit në Oran (ku bashkërisht kanë sunduar Xhu Feiri dhe Abdi-u pasi pranuan Islamin).

Në kohën tonë, në botën islame nuk ka një halifat universal. Por, masat edhe më tutje insistojnë. Vetë fakti se ekzistojnë vende të pavarura islame, tregon se shkohet përsëri kah rivendosja e halifatit. Para se të rivendoset përsëri halifati botëror, që t'u ikim dyshimeve dhe rivalitetit lokal – mund të shërbehemi me formulat *mutatis mutandis*, që janë shfrytëzuar në kohën e Pejgamerit (a.s.), do të thotë këshillat e halifit, me të cilat do të merrnin pjesë të gjithë shefat e shteteve islame, si ato sunite ashtu edhe ato shiite e harixhite, kurejshite dhe jokurejshite, dhe do të kryesohej, të themi, brenda një viti, duke marrë pjesë në këtë tubim nga një anëtar i atij këshilli.

Funksionimi i shtetit islam

Si duket, detyrat e shtetit islam mund të ndahen në katër kategori: pushteti ekzekutiv (i cili përfshin drejtoratin ushtarak e civil), pushteti ligjdhënës, drejtorati gjyqësor dhe drejtorati kulturor.

Roli i pushtetit ekzekutiv kryesisht është i njëjtë në Islam, si dhe në të gjitha vendet tjera të botës. Pra, nuk ka nevojë që për atë të flitet vetëm që të ceket se këtu sovraniteti i takon Zotit dhe se ai është në duart e një njeriu vetëm si autorizim për të udhëhequr, për të krijuar mirëqenien e të gjithë qytetarëve pa përjashtim.

Për sa i përket pushtetit ligjdhënës, ai është, kemi thënë, i mbështetur në Kur'an, në Fjalën e Allahut si burim dhe bazë të të gjitha ligjeve të kësaj bote dhe çështjeve shpirtërore të kësaj jete. Për këtë shkak, ai ka fushatën e veprimit të kufizuar.

Pushteti gjyqësor bazohet në barazinë e të gjithë njerëzve para ligjit, barazi e cila kemi thënë – nuk e përjashton as shefin e shtetit prej përgjegjësisë ligjore, Kur'ani ka dhënë edhe urdhër shumë të rëndësishëm: banorët jomuslimanë të shtetit islam e kanë autonominë gjyqësore: secila bashkësi e ka gjykatën e vet, gjykatësit e vet, të cilët gjykojnë sipas ligjeve të asaj bashkësie si në të drejtat civile, ashtu edhe në çështjet penale. Kur'ani nga hebrejtë lyp që t'u përmbahen ligjeve të veta, të bazuara në Evangjelinë. Vetvetiu kuptohet se dalin vështirësitë në rastet kur palët me përkatësi fetare të ndryshme paditen, për të cilën gjë për

asi raste janë paraparë rregulla të veçanta. Ato raste vendosen sipas rregullave të së drejtës ndërkombëtare private.

Funksioni kulturor është shkaku kryesor që ekziston shteti musliman. Me këtë ne kuptojmë transmetimin dhe vendosjen e Fjalës së Allahut në këtë botë. Detyrë e çdo muslimani, e sidomos e shtetit musliman, është që jo vetëm të përshtat ligjet e Zotit në jetën e përditshme, por gjithashtu të formojë aksione misionare në vendet e huaja, që të njoftojnë me atë që mëson Islami. Këtu parimi themelor është ai që jep Kur’ani në ajetin që vijon (3:256): “Nuk ka dhunë në fe”. Ky parim jo vetëm që nuk shkakton letargjinë dhe dremitjen (qesatllëkun), por përkundrazi, thirr në luftë të përhershme dhe altruiste, luftë me të bindur.

Forma e sundimit

Islami nuk i jep asnjë rëndësi formës së jashtme të sundimit; ai është i kënaqur nëse arrihet mirëqenia e njeriut në të dy botët dhe nëse praktikohet ligji i Zotit. Kështu, çështja kushtetutare e merr vendin sekondar dhe kemi përmendur, republika, monarkia dhe sundimi i përbashkët, format tjera, janë të vlefshme në bashkësinë islame.

Nëse ky qëllim arrihet përmes vetëm një sunduesi, kjo është e pranueshme. Nëse në një kohë në një mjedis të gjitha cilësitë e nevojshme “të sunduesit besimdrejtë” ose të halifit nuk janë të njësuara te një

individ, vullnetarisht pranohet ndarja e sundimit, me qëllim që sa më mirë të funksionojë sundimi. Për këtë mund të bazohemi në rastin e njohur që e përmend Kur'ani (2:246, 247): "Një pejgamberit të parë populli i tij ia mbushi mendjen që të zgjidhte mbretin pranë vetvetes si pejgamber, që të mund të luftonin nën udhëheqjen e tij kundër armikut që i pati përzënë nga shtëpitë e tyre dhe i kishte ndarë nga familjet e tyre. Emërimi i mbretit në kohën (e njëjtë) kur ishte pejgamberi, madje me ndërmjetësimin e tij, tregon se sa larg mund të shkohet në këtë drejtim. Kështu është bërë ndarja mes funksioneve shpirtërore dhe profane, mirëpo nuk tolerohet sundimi autokrat i cilitdo prej tyre: politika dhe mbreti i mbeten të nënshtruar Ligjit të Zotit aq sa lypin dispozitat fetare dhe pejgamberi. Burimi i autoritetit dhe i ligjit mbetet i njëjtë, vetëm zbatimi i ligjit dhe kryerja e dispozitave të nevojshme ka të bëjë me individë të ndryshëm. Kjo është më tepër çështje specializimi sesa ndarje mes dy mënyrave të jetës.

Këshillimi dhe kontakti me popullin

Kurrë nuk do të jetë e mjaftueshme rëndësia dhe dobia e theksuar e këshillimeve në politikë. Kur'ani pandërprerë lyp prej muslimanëve që vendimet e tyre t'i bien vetëm pas këshillimeve, qoftë kur punohet për probleme private apo publike. Qëndrimet e Muhamedit (a.s.) edhe më tepër e kanë përforcuar një qëndrim

të tillë: me gjithë kualitetet e tij të jashtëzakonshme si njeri, i udhëhequr nga Shpallja e Zotit, Muhamedi (a.s.) gjithmonë lypte këshillat e shokëve të vet, si dhe të përfaqësuesve të fiseve besimtare para se të merrte ndonjë vendim. Gjithashtu, kalifët e parë rreptësisht i përmbaheshin institucionit të këshillimit.

Kur'ani nuk parasheh as metodat për sa i përket numrit të vendeve të delegatëve në parlament, mënyrën e zgjedhjeve, vazhdimin e monarkisë etj. E tërë kjo i është lënë së drejtës së diskrecionit të çdo sistemi dhe të çdo vendi. Kryesore është që sunduesi të rrethohet me individë reprezentativë, të cilët kanë besim tek ata që i përfaqësojnë dhe të cilët janë të njohur dhe me karakter të dalluar.

Duke përmendur rastin kur Musai i zgjodhi 70 veta, prej mesit të popullit të vet, që ta përcillnin në Turi Sina, Kur'ani (7:155) aludon në një lloj përfaqësimi proporcional (Kur'an, 7:160), se për 12 fise shpërthen uji prej 12 burimeve, kur Musai i ra me shtagë shkëmbit. Duhet të përmendim se qëllimi i çdo përfaqësuesi, qoftë kur është fjala për përfaqësuesin zyrtar ose për përfaqësuesit e zgjedhur në zgjedhjet e përkohshme, që sundimi të jetë në kontakt me mendimin e opinionit dhe gjithmonë të kontrollojë si sillen funksionarët e tij, me mundësi që gjithmonë të korrigjohen gabimet në gjykime, si dhe padrejtësitë që rrjedhin nga kokëfortësia. Ky cak në mënyrë të përsosur arrihet në Islam, me institucionin e namazeve të përbashkëta pesë herë në ditë, si dhe brenda javës në ditën e pushimit. Çdo musliman e muslimane duhet të kryejë salatet (namazet) në parim bashkërisht, ndë-

rsa funksionari më i lartë i pushtetit në atë vend duhet të jetë imam. Vetvetiu kuptohet që ajo iu jep rastin banorëve të atij vendi, madje edhe më të varfërve, të gjenden me udhëheqësin e atij vendi në çdo moment dhe t'i ankohen për ndonjë padrejtësi. Nëse ajo ankesë nuk jep rezultat, ekziston mundësia që të ankohen te funksionari më i lartë i pushtetit, në ndonjë vend më të largët, deri te shefi i shtetit në kryeqytet, i cili gjithashtu udhëheq namazin (bënë detyrën e imamit).

Politika e jashtme

Marrëdhëniet me vendet e huaja bazohen në atë që quhet “e drejtë ndërkombëtare”. Rregullat e sjelljeve në atë aspekt kanë pasur zhvillim shumë më të ngadalshëm sesa rregullat e sjelljeve mes vete, brenda një grupi shoqëror. Në kohën para Islamit e drejta ndërkombëtare nuk ka ekzistuar si institucion i pavarur: ajo ishte pjesë e politikës dhe varej nga diskrecioni i së drejtës së shefit të shtetit. Shumë pak iu pranoheshin të drejtat të huajve, e sidomos armiqve.

Mund të cekim faktin historik se muslimanët ishin të parët që jo vetëm që e zhvilluan shkencën për të drejtat ndërkombëtare si disiplinë të pavarur, por gjithashtu e përfshin në vetë të drejtën; janë punuar jo vetëm monografi speciale për “zjarrin” (të drejtën ndërkombëtare), por për të është folur gjithashtu prej fillimit të shekullit II të Hixhretit, d.m.th. prej shekullit VIII sipas erës së Krishtit, e kanë lidhur çështjen e

luftës me të drejtën ndëshkimore. Pasi folën për hajdutëritë e nisura ndërmjet vendasve dhe bashkëqytetarëve, është e logjikshme të vazhdojnë në atë aspekt të merren me sulmet e pushtuesve të huaj, me operacionet që kërkojnë angazhim më të madh të forcave të vendit. Mirëpo, vetë fakti se lufta radhitet në fushën e së drejtës ndëshkimore, tregon pa mëdyshje se këtu punohet për çështjen juridike ku i akuzuari ka të drejtë, si dhe çdo i akuzuar tjetër, që të mbrohet para gjyqit.

Parimin themelor të marrëdhënieve ndërkombëtare, siç i kupton Islami, juristët islamë e kanë shprehur me fjalët që vijojnë: “Muslimanët dhe jomuslimanët janë të njëjtë për sa u përket vuajtjeve në këtë botë”. Në epokën antike, grekët p.sh. kanë pasur ide për të drejtën ndërkombëtare; mirëpo ajo i ka rregulluar marrëdhëniet ndërnjerëzore vetëm për qytetet greke. Për sa u përket barbarëve (jogrekëve), ata sipas Aristotelit janë të lindur vetëm për t’u shërbyer grekëve; qëndrimi ndaj tyre rregullohej sipas vlerësimeve të lira të grekëve (e drejta e diskrecionit), e jo në bazë të së drejtës. Romakët kanë njohur një lloj të drejte në lidhje me miqtë e huaj, kurse ndaj pjesës tjetër të botës ekzistonte vetëm vendimi i lirë, i cili ndryshonte varësisht prej komandimit dhe epokës. Drejtësia hebraike dihet shumë mirë se si i shfaroste popujt që nuk dinin Zot, popujt e Palestinës (amalesitë me prejardhje arabe). Johebrejve nuk iu jepnin kurrfarë të drejte, vetëm e vetëm që të shërbejnë si rob. Për sa i përket epokës moderne, të krishterët gjer në vitin 1856 kanë mbajtur beneficinin e së drejtës ndërkombëtare vetëm për popujt e krishterë. Ata pastaj pak e zgjeruan,

por duke u ruajtur mirë që t'i heqin dallimet, mes tjerash dobët të definuara, ndërmjet të civilizuarve dhe jo të civilizuarve, duke mos iu dhënë këtyre të fundit kurrfarë të drejtash. Në historinë e të drejtës ndërkombëtare muslimanët janë të parët, dhe gjer në këtë moment të vetmit, që iu sigurojnë të drejta të huajve pa kurrfarë diskriminimi dhe rezerve, si në gjendje të luftës, ashtu edhe në gjendje të paqes.

Shtetin e parë musliman e themeloi Muhamedi (a.s.) dhe ai e udhëhoqi atë. Ai shtet ishte qyteti-shtet Medina, konfederatë e fshatrave autonome të banuara me muslimanë, hebregj dhe idhujtar arabë. Vetë natyra e shtetit lypte tolerancë fetare, e cila edhe formalisht është e pranuar në kushtetutën e atij shteti, dokumentet e të cilit janë ruajtur deri më sot. Marrëveshjet e para për mbrojtjen aleate janë lidhur me jomuslimanët dhe me ndërgegje janë respektuar. Kur'ani kryekëput insiston në obligimet që plotësojnë premtimet e dhëna, në kryerjen e tyre me nder dhe duke qenë të drejtë (duke tërhequr vërejtjen me dënim të botës së ardhshme nëse ajo thyhet).

Ekzistojnë burime të ndryshme të rregullave për sjelljet ndërkombëtare: këtu nuk është fjala vetëm për jurisprudencën, por edhe për marrëveshjet me të huajt etj. Në bazë të shembujve vijues deri diku mund t'ia parashtrijmë vetvetes rreptësinë që e zbaton Islami për veprën dhe fjalën e dhënë. Juristët vërtetojnë sa vijon: ndonjë i huaj është i autorizuar të qëndrojë një kohë të caktuar në territorin e muslimanëve dhe nëse ndërkohë shpërthen lufta mes dy vendeve të tyre, ai i huaji nuk do të jetë i shqetësuar gjatë kohës gjerasa

vazhdon viza e pastaj, jo vetëm se do të mund të kthehet në vendin e vet nën sigurinë e plotë, por gjithashtu me vete do të mund të nxjerrë fitimin dhe pasurinë, ndërsa gjatë tërë kohës së qëndrimit (madje edhe gjatë luftës) ai do të gëzojë mbrojtjen e gjyqeve muslimane. Ambasadori gëzon imunitet të plotë; madje, edhe nëse sjell porositë më të papëlqyeshme, ai gëzon lirinë e fesë, sigurinë e qëndrimit dhe të kthimit.

Legjislacioni gjithashtu ka specifikën e vet: të huajt që qëndrojnë në vendin islam i nënshtrohen juridikacionit të muslimanëve, por jo edhe drejtësisë islame, sepse Islami në territorin e vet toleron që secila bashkësi të ketë autonominë juridike. Pra, i huaji është nën juridiksionin e gjyqit të konfesionit që i takon. Nëse ai është i krishterë, hebre, ose diçka tjetër, edhe nëse pala kundërshtarë është i fesë së tij, nuk është me rëndësi se a është pala tjetër nënshtetas islam ose jo, rasti do të vendoset para gjyqit fetar sipas ligjeve të veta. Në rregullat, në rastet e këtilla, nuk bëhet dallimi mes padive civile dhe kriminale. (Ne folëm më për rastet kur kemi të bëjmë me palët që u takojnë bashkësive fetare të ndryshme). Mirëpo, jo-muslimanëve gjithmonë iu lejohet që t'u shmangen këtyre privilegjeve dhe t'i drejtohen gjyqit të muslimanëve nëse palët kundërshtarë pajtohen; në atë rast aplikohet ligji islam. Është e lejuar që gjyqtari musliman, madje, të aplikojë ligjin e huaj për palët në kundërshtim, siç shihet haptazi nga praktika e vet Muhamedit (a.s.). Dy hebrejt t e akuzuar për prostitucion i sollën besimtarët e tyre; Pejgamberi (a.s.) lypsi Ungjillin dhe e aplikoi ligjin hebraik tek ata, siç e

përmend Buhariu. Juristët muslimanë janë unaninë në atë pikëpamje. Muhamed esh-Shejbani, nxënësi i Ebu Hanifes, madje regjistroi thënien e Muhamedit (a.s.), që i jep përmbajtje këtij ligji: “Atija ibn Kajs el-Kilabi transmeton se Pejgamberi (a.s.) ka thënë: Nëse dikush strehohet në një vend armik pasi që ta bëjë vrasjen, imoralitetin seksual ose vjedhjen dhe më vonë kthehet pasi të marrë kalimin e lirë, ai prapëse-prapë do të gjykohet për atë që ka ikur, por nëse ka bërë vrasjen, aktin seksual kundërligjor ose vjedhjen në territorin e armikut e më vonë kthehet me vizë, asnjë dënim nuk do t’i shqyrtohet për atë që ka bërë në territorin e armikut.

Ligji islam nuk lejon që të përjashtohet shefi i shtetit. Ai i nënshtrohet ligjit dhe juridiksionit të gjyqeve si çdo qytetar tjetër. Nëse vetë shefi i shtetit musliman nuk i gëzon privilegjet e shtetit të vet (të cilat, në realitet, paraqesin padrejtësinë dhe mbeturinat e pabarazisë së klasave), nuk mund të presim përjashtimin e sunduesve të huaj, as të ambasadorëve. Atyre iu ofrohet i tërë kujdesi, i cili iu takon si ndaj miqve dhe ndaj rangut të tyre, mirëpo ata nuk vihen mbi ligjin dhe mbi drejtësinë.

Shumë raste prej epokës klasike tregojnë edhe një veçori të qëndrimit islam ndaj drejtësisë: si peng për zbatimin e marrëveshjes është bërë ndërrimi reciprok i pengjeve, me marrëveshjen e fortë: nëse njëra anë i vret pengjet, edhe ana tjetër ka të drejtë ta bëjë të njëjtën. Mirëpo, ndodhte që pengjet muslimane të ishin vrarë në mënyrë tradhtare, nga ana e kontraktuesit, kurse pengjet e kundërshtarëve të kishin qenë plotësi-

sht të siguruara në shtetin musliman. Juristët muslimanë kanë konsideruar se ato nuk mund të vriten – dhe pse kategorikisht e kanë ndaluar që dikush të vritet për krimin që e ka bërë tjetërkush.

Madje, edhe lufta patjetër duhet t'i nënshtrohet ligjit: ai ligj është human në Islam. Luftëtari dhe ana luftarake dallohen; nuk lejohet vrasja e fëmijëve, e grave, e pleqve dhe e murgjve (kallogjerëve). Borxhet në dobi të pjesëtarit të kundërshtarit nuk shuhen me shpalljen e luftës. Është e ndaluar çdo vrasje dhe shkatërrim jashtë minimumit të domosdoshëm e të nevojshëm; me luftëtarët duhet të sillet mirë dhe veprat e tyre luftarake nuk konsiderohen si krime. Që të pengohet prova e ushtarit pushtues, plaçka e luftës nuk iu takon atyre që kanë pushtuar, por pushtetit, i cili e mbledh tërë plaçkën e luftës, pastaj katër të pestat ua ndanë pjesëtarëve të ekspeditës, kurse një të pestën e mban në arkën e shtetit. Ushtari i thjeshtë dhe komandanti marrin pjesë të barabarta të plaçkës.

Në një kaptinë interesante Kur'ani (47:35) urdhëron paqe me këto fjalë: “Mos u bëni të dobët, mirëpo thirrni në paqe kur jeni të fortë. Allahu është me ju dhe nuk do t'i zvogëlojë veprat tuaja”. Ai kthehet në të (8:61) dhe thotë: “Nëse ata të ofrojnë paqen, edhe ti ofro paqen dhe mbështetu tek Allahu”. Ashtu veproi Muhamedi (a.s.) pasi e pushtoi Mekën dhe banorëve të saj iu tha: “Shkoni, jeni të lirë”.

Kur'ani i jep shumë rëndësi fjalës së dhënë (8:72): ajo të mos luhatet, mirëpo ajo, madje, të vihet para interesave materiale të bashkësisë islame. Kështu na mëson për konceptin islam të ligjit mbi neutralitetin:

“.. për sa iu përket atyre besimtarëve që nuk janë shpërngulur ende (në vendin islam), ju nuk mund t’i mbronni gjersa të shpërngulen. Nëse ata lypin që në emër të fesë t’i ndihmoni, keni për borxh t’i ndihmoni, por jo kundër popullit që me ju ka nënshkruar marrëveshjen. Zoti sheh çka punoni ju”.

Përfundim

Shkurtimisht, Islami mundohet të mëkëmb bashkësinë botërore, me të cilën të gjithë popujt do të ishin të barabartë dhe në të cilën nuk do të kishte klasa, raca, ose territore. Ai mundohet të përvetësojë zemrat e njerëzve me bindje: ai nuk lejon kurrfarë dhune në fe, sepse secili individ vetë do të përgjigjet para Zotit. Për atë, detyra e pushtetit qëndron te besimi, detyra e tij është t’i shërbejë popullit. Sipas Islamit, është detyrë e çdo besimtarit që gjithmonë të japë mundin për mirësi dhe të pengojë të keqen. Ndërkaq, Zoti neve na çmon sipas qëllimeve tona dhe veprave tona.

Kreu IX

Sistemi juridik islam

Kontributi i veçantë i muslimanëve

Në shoqërinë njerëzore prej kohësh ekzistojnë ligjet. Të gjitha racat, të gjitha territoret, të gjitha grupet e njerëzve kanë dhënë njëfarë kontributi në këtë lëm. Kontributi i muslimanëve sa është i vëllimshëm, aq është edhe i vlefshëm.

Shkenca juridike

Të gjithë popujt e vjetër kanë pasur ligjet e veta të posaçme, mirëpo asnjë popull nuk ka pasur shkencë juridike me ligje abstrakte dhe të qarta; kodet nuk kanë ekzistuar para Shafiut (150-204 h./767-820 e.s.). Në veprën e tij me emrin “Risale”, ai këtë shkencë e quan “Rrënjët e ligjit”, rrënjë prej të cilave zhvillohen degët e rregullave të sjelljeve njerëzore. Ajo shkencë, më vonë u quajt usuli Fikh, me parime ligdhënëse, interpretim dhe aplikim të teksteve juridike të muslimanët. Vetë ligjet janë degë të këtij “druri”.

Haptazi, këta autorë me zgjedhjen e këtyre termave kanë qenë të inspiruar nga ajetet e Kur’anit (14:24, 25): “A nuk sheh se Allahu sjell shembull fjalën

e mirë sikur pemën e mirë, rrënja e së cilës është e ngulur fort me degët kah qielli. Me leje të Zotit të vet i jep frytet e veta në çdo kohë – dhe Allahu iu sjell she-mbull njerëzve, ndoshta do të mendojnë.”

Motivi (qëllimi) dhe vepra

Ndër risitë që i solli Islami në lëmin e kuptimeve themelore juridike përmendet rëndësia e qëllimeve, motiveve në një vepër (nijeti). Kjo ide themelohet në një thënie të Muhamedit (a.s.): “Veprat gjykohen sipas qëllimeve”. Sipas saj, një gabim ose një kundërvajtje me qëllime dhe një gabim ose kundërvajtje pa qëllim, nuk mund të trajtohen njësoj para gjyqit.

Kushtetuta e shkruar

Indikativ është fakti që veçanërisht lëvdata e penës, si mjet mësimi dhe dhunti e Allahut, ishte porosia e parë (Kur’an, 96:1-5) drejtuar lajmëtarit islam, i cili, ndërkaq, ishte analfabet. Të mos habitemi: Muhamedi (a.s.) duke i dhënë popullit të vet një aparat shtetëror me të gjitha pjesët e tij, njëkohësisht shpalli edhe kushtetutën e shkruar për atë shtet. Në fillim u aplikua në qytet – shtetin e posaformuar, mirëpo dhjetë vjet më vonë, në kohën e vdekjes së themeluesit të tij, ai përfshiu tërë Gadishullin Arabik, me pjesët

jugore të Palestinës dhe të Irakut; e 15 vjet më vonë, gjatë kohës së Uthmanit, armata muslimane depërtoi në Spanjë, në njërin anë, dhe në Transaksoninë Kinëze, nga ana tjetër, duke kaluar nëpër shtetet mes tyre. Ajo kushtetutë e shkruar, të cilën e hartoi Muhamedi (a.s.), përfshinte 52 nene dhe është ruajtur plotësisht. Ajo flet për çështje të ndryshme, siç janë: të drejtat dhe obligimet e sunduesit dhe nënshtetasve, legjislatura, organizimi i gjykatës, organizimi i mbrojtjes në bazë të ndihmës reciproke, sjellja ndaj jomuslimanëve, sigurimi social etj., pra për të gjitha çështjet aktuale të cilat iu përgjigjeshin nevojave të atëhershme. Ky akt daton prej vitit 622 sipas kalendarit kristian, respektivisht prej vitit të parë të Hixhretit.

E drejta e përgjithshme ndërkombëtare

Situata e luftës është moment shumë i vështirë për individin të sillet brenda normave të arsyes dhe të drejtësisë. Pasi është fjala për vdekje ose gjallëri, mbi luftën për ekzistim, ku edhe gabimi më i vogël lë pas vete pasoja dhe lajthime të papërmirësueshme, mbretërit ose kryetarët gjithmonë kanë kërkuar të drejtën që lirisht të vendosin për qëndrimin që do ta marrin ndaj kundërshtarëve. Shkenca mbi sjelljet ndërmjet sunduesve të pavarur ekziston nga kohët më të hershme, mirëpo ajo përbën pjesë të politikës, vendosje e lirë, e udhëhequr vetëm me përvojë. Si duket, muslimanët janë të parët të cilët i dhanë nocionin “e drejta

e përgjithshme ndërkombëtare”, në bazë të pastër juridike. Ata na kanë lënë vepra më të hershme në histori mbi të drejtën ndërkombëtare, të cilën e kanë përpunuar si shkencë të pavarur (ajo quhet “sijer”, fjaë për fjale “sjellje”, që do të thotë sjellje e sunduesit ndaj të huajve). Por, më tepër në përmbledhjet e punimeve ligjore flitet për *sijerin* si pjesë e së drejtës civile. Ndër autorët më eminentë janë: Ebu Hanife, Maliku, Euzaiju, Ebu Jusuf, Muhamed esh-Shejbani, Zufer, el-Vakidiu etj. Të gjithë ata këtë lëndë e kanë quajtur *sijer*. Më tutje, në përmbledhjen ligjore – si vepër më e hershme e ruajtur, që zë fill prej Zejd ibn Aliut, i cili vdiq në vitin 120 ose 122 sipas Hixhretit, flitet për këtë lëndë si pjesë përbërëse e ligjit shtetëror. Në realitet, për këtë çështje flitet pas çështjes së plaçkitjes në rrugë, sipas asaj mund të arsyetohet në të njëjtat shkaqe sikurse aksioni policor kundër plaçkitësve. Pala kundërshtarë i ka të drejtat dhe detyrat, të pranuar prej gjyqeve muslimane.

Karakteristikat kryesore të drejtësisë islame

Çështje e parë që lexuesit të librave juridikë islamë i bie në sy është ajo se kjo drejtësi në të drejtuarit e jetës njerëzore e lyp tërësinë e jetës, si në jetën materiale, ashtu edhe në aspektin shpirtëror. Librat e tillë zakonisht fillojnë me liturgji fetare e në të njëjtën pjesë shqyrtojnë çështjen e sovranitetit – pasi që “imami”, do të thotë kryetari i shtetit, njëkohësisht është prijës

në xhami. Nuk duhet të habitemi kur në të njëjtën pjesë flitet mbi pagimin e tatimit (zeqatit), pasi që Kur'an-i shpesh flet me të njëjtin theks si për namazin, ashtu edhe për zeqatin; nëse namazi është akt trupor fetar, dhënia e zeqatit është akt fetar me pasuri, që të vazhdojë shqyrtimin mbi marrëdhëniet kontraktuese, e pas tyre janë dënimet, ku bashkangjitet diplomacia dhe e drejta ndërkombëtare; mbaron me rregullat e trashëgimisë dhe të testamentit. Njeriu është njësi e trupit dhe e shpirtit; dhe, nëse pushteti kujdeset vetëm për problemet materiale, shpirti do të lihet pasdore, pasi lihet vetëm në mjete private, të cilat janë shumë të varfra me ato që i ka pushteti në dispozicion për çështjet materiale.

Zhvillimi jo i barabartë i trupit çon kah çrregullimi i ekuilibrit, pasojat e së cilës mund të jenë katastrofale për civilizimin. Ky vëzhgim i trupit dhe i shpirtit, si një tërësi, nuk do të thotë se të paudhëzuarit kanë të drejtë që me kompetencë të merren me çështjet nga lëmi fetar, si p.sh. t'i lejohet poetit të bëjë intervenim kirurgjik: të gjithë lëmenjtë e aktiviteteve njerëzore duhet t'i kenë specialistët dhe ekspertët e tyre.

Një karakteristikë tjetër e drejtësisë islame shquhet për theksin e vënë në korrektivitetin e drejtave dhe obligimeve: jo vetëm në marrëdhëniet ndërmjet njerëzve, por edhe në marrëdhëniet e njeriut ndaj Krijuesit të vet, janë me bazë të njëjtë; ritet fetare p.sh. për njeriun nuk janë asgjë tjetër përveçse kryerje e një detyre, e cila është e lidhur me të drejtën e dëfrimit, të cilën Allahu ia ofron njeriut në këtë botë. Të flasim mbi "të drejtat" e njeriut, pa mos i theksuar detyrat e

tij: prej tij mund të krijohet, në atë rast, vetëm shtaza e egër, ujku ose dreqi.

Filozofia e së drejtës

Juristët klasikë muslimanë kanë themeluar drejtësi në bazë të dyfishtë, të së mirës dhe të keqes: të bëjë gjithçka që është e mirë dhe të shmanget nga ajo që është e keqe e mira dhe e keqja nganjëherë janë të dukshme dhe të plota, kurse nganjëherë relative dhe të pjesërishme. Kjo tërheq ndarjen e pesëfishtë të rregullave juridike, si të urdhrave ashtu edhe të ndalimeve: Ajo që është plotësisht e mirë do të jetë e obligueshme; këtë duhet punuar. Ajo që është më shumë e mirë se e keqe, do të jetë e porositur dhe e lavdishme. Ajo, pamja e së cilës është e njëjtë, kur nuk theksohet as e mira e as e keqja, i lihet dëshirës së individit. Për këtë, në sy të ligjit do të jenë të painteres. Ndërsa ajo që është krejtësisht e keqe do të jetë çështje e ndalimit të plotë. E në fund, ajo që është më tepër e keqe do të jetë e dënuar dhe e paporositur.

Në këtë ndarje themelore të veprave në pesë kategori, rregullat mund të kenë edhe nëndarje të nuancuar gjithashtu siç janë të nuancuara në kompas anët e botës.

Ngelë të vërtetojmë se si të dallojmë të mirën nga e keqja. Kur’ani shumë herë flet për këtë dallim, thotë se duhet bërë “maëruf” (fjal për fjale: mirësjellje). Ai e konsideron të mirë atë që si e tillë konsiderohet dhe

pranohet prej të gjithëve dhe e vërtetuar me arsye që e komandon. E keqe konsiderohet ajo që arsyeja e shëndoshë e ndalon. Pjesa më e madhe e moralit islam hyn tërësisht në ato definicione; Të rralla janë rastet që Kur'ani të ve ndalime për të cilat mes njerëzve nuk ka pajtim; mirëpo esenca e ligjit edhe në këto raste të rralla nuk është në kundërshtim me arsyen e mendjeve të sinqerta dhe të pjekura. Gjithsesi, është fjala për besimin në urtësinë dhe inteligjencën e Ligjdhënësit, direktivat e të cilit në të gjithë rastet tjera kanë vetëm miratim të përgjithshëm.

Sanksionet

Gjinia njerëzore përbëhet prej karakteresh të ndryshme. Në këtë pikëpamje njerëzit mund të ndahen në tri kategori të mëdha: në ata që janë të mirë e që iu rezistojnë të gjitha sprovave të këqija, përveç nëse detyrohen me dhunë; në ata që janë të këqinj dhe e gjejnë mënyrën t'u ikin kontrollimeve dhe mbikëqyrjeve më të ashpra; dhe në fund, në ata që sillen mirë nga frika prej ndëshkimit, kurse sillen keq që sprovat dhe rrethanat të jenë të volitshme dhe dënimi më i lehtë. Fatkeqësisht, numri i kategorisë së parë është mjaft i kufizuar; atyre nuk iu nevojiten as udhëzime e as dënime për shkeljen e ligjit. Dy kategoritë tjera kërkojnë dënim në interes të shoqërisë. Animi i njeriut t'u bëjë keq njerëzve mund të jetë sëmundje, si mbeturinë e natyrës së kriminelit dhe të karakterit shtazor,

ose si rezultat i edukimit të dobët e i shumë çështjeve të tjera. Anohet që të pengohet dhe të mbikëqyret dëmi i kategorisë së dytë të njerëzve, numri i të cilëve për fat nuk është aq i madh. Akoma ngel kategoria e mesme, në të cilën është numri më i madh i njerëzve. Edhe për ato dënime, mirëpo të cilit lloj?

Vetvetiu kuptohet nëse një kryetar fshehtazi ose haptazi bën një gabim, dhe për këtë e brenë ndërjegjja, nuk do të ketë guxim t'ua zë për të madhe të tjerëve gabimet e njëjta. Islami qysh në fillim e ka shembur këtë lloj të së keqes, duke deklaruar se askush nuk mund t'i ikë ligjit, bile as shefi i shtetit, e as Pejgamberi i Allahut. Edhe mësimi si dhe jeta praktike e Muhamedit (a.s.), të cilën e kanë ndjekur trashëgimtarët e tij, kanë udhëzuar në atë që edhe shefi i shtetit mund të thirret para gjyqit shtetëror pa farë ngurimi. Tradita islame tregon se gjykatësit asnjëherë nuk kanë qenë të pagximshëm në sjelljen e vendimeve kundër kryetarëve të vet në raste të mos rrespektimit të ligjit.

Nuk ka nevojë të përmendim detajisht sanksionet materiale që gjenden në Islam, sikurse te të gjitha civilizimet tjera. Për atë ekzistojnë shërbime të obliguara për mbajtjen e rendit dhe të ligjit, për roje, për paqe dhe rehati në marrëdhëniet mes shtetasve, prandaj, nëse dikush dëmtohet me dhunë, ai mund të ankohet në gjyq dhe policia të akuzuarin do ta sjellë para gjykatësit, vendimi i të cilit definitivisht zbatohet.

Mirëpo, të kuptuarit e shoqërisë që e vendosi Muhamedi (a.s.) shton edhe një dënim tjetër, ndoshta më efikas prej dënimeve materiale; ai është dënimi shpirtëror. Duke e ruajtur në përgjithësi sistemin gjuhësor,

Islami frymëzoi në shpirt ithtarët e vet me idenë e ringjalljes pas vdekjes, për gjykimin e Allahut dhe shpërblimin në atë botë. Për ate, besimtari i sinqertë i kryen detyrat e veta edhe atëherë kur pa dënim mund t'i cenojë dhe të ikë nga të bëmat keq të tjerëve, edhe atëherë kur është i sigurt se nuk e rrok ndëshkimi.

Kjo fuqi trefishore e dhunës – të nënshtruarit, sunduesit dhe ligjit, dënimi material dhe ai shpirtëror me mallkim në atë botë, ku çdo njeri i vërteton dy të tjerat, - i sigurojnë Islamit mundësi më të mëdha për sukses në pranimin e ligjeve, nderimin e rregullave dhe detyrave të të gjithëve.

Legjislatura

Për të kuptuar sa më mirë implikimet dhe largësinë e arritshme që Allahu është Ligjdhënës Suprem, lypet analizuar aspektet e ndryshme të asaj çështje:

Islami urdhëron të besosh në Një Zot të përsosur, i cili jo vetëm që është Krijues i të gjithëve, por gjithashtu të gjithë edhe i përmban. Ai është “conditio sine quanon” për ekzistimin e gjithësisë. Ai nuk është tërhequr asnjehërë nga ajo që krijoi njëherë e përgjithmonë. Islami urdhëron, mes tjerash, se Allahu është transcendent, jashtë gjithë diapazoneve njerëzore. Ai është gjithkund prezent, i Gjithëfuqishëm, i Drejtë dhe Mëshirues. Ai, njerëzve iu dha jo vetëm mendjen, por edhe udhëheqës, të zgjedhur prej mesit të tyre, të pajisur me udhëzimet e urta dhe më të dobishme për shoqërinë

njerëzore. Pasi Zoti është transcendent, Ai nëpërmjet pejgamberëve të vet ua dërgoi porositë njerëzve.

Nëse ka divergjencë në detaje të legjislaturës, prej të cilave çdo njeri thirret në Shpalljen e Allahut, ajo nuk është për atë se Allahu është i ndryshueshëm; por është për atë shkak se Ai lyp vetëm atë që u përgjigjet aftësive të tyre personale; pasi njeriu është ai ë ndryshon, i ekspozuar zhvillimit të përhershëm; vetëm Allahu është i përsosur dhe i përhershëm. Në realitet, ligji më i vonshëm revokon dhe zëvendëson ligjet e mëparshme. Kështu është rasti edhe me legjislaturat e shpallura. Te muslimanët, Kur'ani, Libër në gjuhën arabe, është fjalë e Zotit, Shpallje e Zotit, të cilën e pranoi Muhamedi (a.s.) dedikuar ithtarëve të vet. Përveç asaj sesi Pejgamber i Allahut, Muhamedi (a.s.), dha komentin e Kur'anit dhe tërë llojet e udhëzimeve të cilat gjenden në Hadith i cili paraqet koleksion mbi lajmet, fjalët dhe veprat e Muhamedit (a.s.).

Kuptohet se ligjet të cilat i vendos një pushtet mund t'i anulojë vetëm ai pushtet ose një pushtet më i lartë, e assesi më i ulët: Shpalljen e Allahut mund ta anulojë vetëm një Shpallje tjetër e Tij, Shpallja e re. Gjithashtu, një udhëzim të Pejgamberit (a.s.) mund ta ndërrojë vetëm ai ose Allahu (xh. sh.) dhe askush tjetër. Mirëpo, kjo teori, me sy e ashpër, në Islam bëhet mjaft elastike, që t'u lihet hapësirë njerëzve që t'u përshtaten kërkesave në raste të dhëna:

1.Ligjet, bile edhe ato me prejardhje prej Allahut, si dhe ato që rrjedhin prej Pejgamberit (a.s.), nuk janë njësoj të vlefshme; do të shohim se ca prej tyre janë të obliguara; të tjerat janë vetëm të porositura; raste të

tjera, ligji ia lë në dëshirë individit. Studimet e burimit tregojnë se rregullat e kategorisë së parë, ato që obligohen, janë shumë pak; rregulla të porositura ka diçka më tepër; rastet për të cilat flet teksti përmbledh çështje të panumërta.

2.Një pushtet më i ulët nuk mund ta ndërrojë ligjin, por ai e interpreton; e drejta e interpretimit nuk është monopol i askujt në Islam; çdo njëri i cili ka njohuri dhe është i udhëzuar në lëndë, ka të drejtë në të. I sëmuri nuk do të konsultohet me poetin, edhe nëse ai është fitues i çmimit Nobël! Para ndërtimit të shtëpisë njeriu nuk do të konsultohet me kirurgun, por me inxhinierin; gjithashtu, në çështjet juridike mund të ndërhyjë vetëm pas studimeve të drejtësisë; pa këtë, çdo gjykim do të paraqes rrezik të paparë. Sipas interpretimeve të ekspertëve të sheriatit, edhe Ligji i Allahut mund t'i përshtatet rrethanave. Mbasi Muhamedi (a.s.) është peygamberi i fundit dhe nuk ka nevojë të zbret Shpallje e re për zgjedhjen e problemeve në rast mospajtimesh rreth zbatimit të Ligjit. Është e natyrshme të ketë pasur mendime të kundërta, pasi të gjithë njerëzit nuk mendojnë njësoj. Të cekim se edhe gjykatësit edhe ekspertët e drejtësisë janë vetëm njerëz, nëse në mes tyre ka pasur qëndrime të ndryshme, populli e ka përmbajtur mendimin e atij i cili ka dhënë përshtypje më autoritative. Kontestin gjyqësor e ka udhëhequr gjykatësi; në raste të tjera, shkollat juridike fitojnë përparësi tek ithtarët e shkollave gjegjëse etj.

3.Vetë Muhamedi (a.s.) ka thënë: “Populli im asnjëherë nuk do të pajtohet me ndonjë lajthitje (gabim). “Ky lloj konzenzusi negativ që i ofron juridikaturës

islame, ka mundësi të madhe për zhvillim dhe për përshtatje të rrethanave.

Fryma e hulumtimeve nuk është shimbur asnjëherë; përkundrazi, ky hadith vë rregullën, me të cilën asnjë mendim që nuk refuzohet njëzërit, me vete nuk tërheq gjykim.

4.Një ngjarje me interes nga jeta e Muhamedi (a.s.) meriton të përmendet: Muadh ibn Xhebeli, pasi u emërua për gjykatës në Jemen, erdhi te Pejgamberi (a.s.) të përshëndetet me të. Mes tij dhe Muhamedit (a.s) u zhvillua kjo bisedë: Në çfarë baze do t'i zgjidhësh kontestet? Sipas dispozitave të Kur'anit. E nëse aty nuk gjen qëndrime të qarta? Atëherë, sipas sjelljes së Pejgamberit të Allahut, nëse edhe aty nuk gjen qëndrime të qarta, atëherë do të përdor arsyen time të shëndoshë. Muhamedi (a.s.) u gëzua dhe tha: "Faleminderit Allahut, i cili të dërguarin, Pejgamberin, e udhëzoi në atë mënyrë që i pëlqeu Pejgamberit të Allahut. "Ky mendim personal i të menduarit të shëndoshë nga njeriu i sinqertë dhe i ndërgjegjshëm, është jo vetëm mënyrë e zhvillimit të drejtësisë, por edhe shumë e porositur nga ana e Pejgamberit (a.s.).

5.Duhet përmendur se në legjislaturë, mbi ndonjë problem të ri, në interpretimin e tekstit të Kur'anit, si dhe në të gjitha rastet tjera të zhvillimit të drejtësisë islame, bile edhe kur ajo themelohet me konsensus, mundet që një rregull e pranuar për një çështje të ndërrohet me rregull tjetër nga ana e juristëve më të vonshëm për të njëjtën çështje.

Mendimi i një personi në tjetrin, një konsensus me tjetrin (krahaso: El-Bezdevi: Usul). Kjo ka të bëjë

vetëm me mendimet e juristëve dhe nuk ka kurrfarë lidhje me Kur'anin ose me Hadithiin autentik. Dispozitat e Allahut mund t'i revokojë vetëm Ai e assesi autoriteti i ulët i juristëve ose kuvendit. Historia tregon se e drejta e formimit të ligjit në Islam iu është besuar personave që e njohin shkencën e sheriatit, pa kurrfarë ndërhyrjesh nga ana e pushtetit. Pra, legjislatura ka qenë e mbrojtur prej luhatshmërive politike, prej interesave personale të njerëzve të dalluar, bile edhe prej shefit të shtetit. Juristët kanë qenë të barabartë në kritika; secili prej tyre lirisht ka mundur të kritikojë mendimin e tjetrit. Kështu, në këtë mënyrë është bërë e mundur që të dalin në shesh të gjithë mendimet mbi një çështje dhe të arrihet zgjedhja më e mirë, qoftë për kohën ose për gjeneratat e ardhshme.

Gjithashtu, shihet që prejardhja hyjnore e legjislaturës në Islam nuk e bëri atë jashtëzakonisht të ashpër. Është me rëndësi se prejardhja hyjnore e ligjit te besimtari ngjalli respektin më të madh ndaj ligjit dhe kryerjen e plotë e të ndërgjegjshme. Shtojmë se juristët e shkollave klasike njëzërit kanë lajmëruar se "gjithçka që muslimani e konsideron të mirë, edhe tek Allahu është e mirë". Edhe nëse ajo nuk ka lidhje drejtpërdrejt me ndonjë thënie të Pejgamberit (a.s.), (Saraksiu këtë e konsideron për thënie të Pejgamberit (a.s.), kurse Ibn Hambeli e konsideron si thënie të Ibn Mes'udit, shok i Pejgamberit /a. s./). Pëlqimi i përgjithshëm, në bazë të këtij interpretimi, implikon, bile, se është konkluzioni i shkencëtarëve laikë, që pas vetes tërheq pëlqimin e Zotit, e që është fakt që i kontribuon respektimit të ligjit në sy të njerëzisë.

Gjykatat

Pikë karakteristike e ligjislaturës islame në lëmin e gjykatave është pavarësia juridike e bashkësive të ndryshme: duke mos i imponuar të gjithëve ligjet e Kur'anit, Islami të gjitha grupacioneve iu lejon të posedojnë gjyqet e veta, si të krishterëve, hebrenjve e të tjerëve, të cilët i zbatojnë ligjet e veta për çështjet civile dhe ndërkombëtare. Nëse në një shtet bëjnë pjesë më tepër bashkësi, një lloj i drejtësisë ndërkombëtare e zgjidh këtë problem. Në vend që të kërkojë aneksimin dhe përvetësimin e të gjitha bashkësive "sunduese", Islami i mbron interesat e të gjitha subjekteve.

Sa i përket gjykatës te muslimanët, institucioni "zgjedhja e dëshmitarëve" meriton të përmendet veçanërisht: në çdo vend gjyqet kanë themeluar arkiva për sjelljen e banorëve, që në rast nevoje të dinë a thua t'i besohet një dëshmitari: pra, nuk i është lënë vetëm palës kundërshtare ta dobësojë vleftën e dëshmisë. Kur'ani (24:4) thotë se nëse dikush e padit gruan për shkeljen e kurorës e nuk paraqet faktin sipas kërkesës së gjyqit, ai jo vetëm që meriton dënimin, por bëhet juridikisht i paaftë përgjithmonë të dëshmojë para gjyqeve.

Burimi dhe zhvillimi i së drejtës

Pejgamberi i Allahut, Muhamedi (a.s.), jo vetëm që iu mësoi ithtarëve të vet dogmat teologjike dhe eskatologjike; ai iu dha me të madhe edhe ligjet për të gjitha fushat e jetës: personale dhe shoqërore, botërore dhe shpirtërore; por, më tepër, ai prej assendit themeloi shtetin që e udhëhoqi, ushtrinë që e komandoi, diplomacinë dhe punët e jashtme që i mbikëqyrte; e, nëse ndodhnin mosmarrëveshje mes qytetarëve, ai i zgjidhte. Pra, nëse dëshirojmë të kthehemi në bazat e së drejtës islame, është e domosdoshme të studiojmë, para së gjithash, sjelljen personale të Muhamedit (a.s.). Ai lindi në Meke, në mesin e familjes tregtare dhe udhëheqëse të karvanëve. Në rininë e vet i vizitoi tregjet e Jemenit, të Arabisë Lindore dhe të Palestinës. Bashkatdhetarët e tij shpesh janë kthyer përmes Irakut, Egjiptit dhe Abisinisë për qëllime tregtare. Kur filloi jetën e vet muslimane, bashkëqytetarët e tij me reaksion të fuqishëm e detyruan që të shpërngulej dhe të vendosej në qytetin e Medines, ku bujqësia ishte degë kryesore e ekonomisë. Aty organizoi një jetë shtetërore. Në fillim ishte vetëm qytet-shtet. Gradualisht, ai këtë qytet e shndërroi në shtet, i cili para vdekjes së tij përfshinte tërë Gadishullin Arabik, me ca vende kufitare të Irakut dhe të Palestinës. Karvanët ndërkombëtarë kalonin nëpër Arabi. Sasanidët dhe bizantinët kishin okupuar ca vende të Arabisë dhe aty kishin themeluar koloni dhe protektorate. Panairët në

Arabi, e veçanërisht në lindje të saj, i kanë tërhequr tregtarët “nga India, Kina, Lindja e Perëndimi”, siç e përshkruan Ibn Kelbi. Në Arabi ekzistonin Jemenitët dhe Lijanitët, civilizimi i të cilëve është më i hershëm sesa ai i Athinës dhe i Romës me mijëra vite.

Ligjet e zakonshme të shtetit, me ardhjen e Islamit u shndërruan në legjislaturë shtetërore. Pejgamberi (a.s.) pati prerogativa jo vetëm të riorganizonte doket e vjetra, por, gjithashtu, të shpallte edhe ligje të reja. Veçoria e pejgamberllëkut, që është titull i shenjtë për muslimanët, prandaj, ata i detyroi të regjistronin jo vetëm fjalët e tij, por edhe veprat e tij, që në tërësi paraqesin ligje të të gjitha fushatave të jetës, bile edhe heshtja është shenjë se ai nuk është kundër ndonjë tradite që e praktikojnë ithtarët e tij. Ai burim trish i ligjit: fjalët e tij, të cilat në tërësi ishin të bazuara në Shpalljen e Allahut (xh. sh.), sjellja e tij personale dhe pranimi në heshtje i ca shprehive dhe traditave të ithtarëve të tij, është ruajtur për ne në Kur’an dhe në Hadithe. Gjatë jetës së tij filloi të paraqitet edhe një burim i ri i së drejtës: deduktimi ose formulimi i një ligji nga ana e juristëve në rast të “heshtjes” në legjislaturë.

Në kohën e Pejgamberit ka pasur gjykatës dhe juristë në kryeqytete, si dhe në qendrat e provincave. Më lart përmendëm udhëzimet që ia dha Muadhit kur e emëroi për gjykatës në Jemen. Ka pasur raste kur edhe nëpunësit provincialë kërkonin udhëzime prej pushtetit qendror; ai intervenonte në vendimet e padrejta të nëpunësve të vet, nëse ishte i lajmëruar për raste të tilla. Rregullat që është dashur t’i mbrojnë ose t’i riorganizojnë doket e vjetra, që do të thotë të

zbatojnë islamizmin e ligjit shtetëror – kanë vepruar krejtësisht shllim-shllim, në atë masë në të cilën këto raste janë paraqitur para gjykatës; edhe pse ka pasur shumë raste kur palët, duke mos e njohur ligjin, kanë vepruar siç iu është përgjigjur atyre.

Për shembull, një musliman ishte martuar me motrën e vet; kur u paraqit rasti te halif Omeri, ai lypi sqarimin për këtë person; personi përgjigjet se nuk ka ditur se është e daluar martesë me motrën. Halifi e shkurorëzoi dhe lypi prej tij t'i paguante dëmin motrës, mirëpo e anuloi këtë dënim për shkak të imoralitetit ose prishjes së familjarizmit.

Vdekja e Pejgamberit (a.s.) shënoi ndërprerjen e Shpalljes së Allahut, e cila mundte të vendoste cilindo ligj të ri dhe të ndërpriste ose të zëvendësonte cilindo dok ose shprehje të vjetër. Pas vdekjes, bashkësia islame e ka pasur doemos të kënaqet me legjislatoren që e vendosi Muhamedi (a.s.) dhe me mjetet e zhvillimit të së drejtës që i miratoi kjo legjislatore. “Zhvillimi” nuk do të thotë ndërpreje për atë që e caktoi Muhamedi (a.s.), por nxjerrje të ligjit në rastet kur nuk ka dispozitë ligjore.

Mes atyre mundësive më karakteristike mund të jetë kjo: disa herë Kur’ani ka precizuar ca ndalime, duke thënë se gjithë çka ka mbetur, është e lejueshme (në atë lëm). Gjithçka që nuk është në kundërshtim me legjislatoren e Pejgamberit të Tij, është e lejuar dhe paraqet një ligj të mirë. Kështu ligjet, doket e shteteve të huaja kanë qenë lëndë e parë për juristët muslimanë, të cilët kanë pasur për detyrë vetëm të sinjalizojnë ato që janë të papajteshme me Islamin. Ky burim është i pashtershëm.

Një burim tjetër, ndoshta jo i zakonshëm, është udhëzimi i Kur'anit në Shpalljet Hyjnore të pejgamberëve të mëparshëm. Ai numëron afër njëzet, mes të cilëve janë: Idrizi, Nuhi, Ibrahim, Musai, Isai, Jahja, të cilët janë të rëndësishëm për muslimanët. Numri dhe afati i këtyre ligjeve është, natyrisht, i kufizuar me atë që pranohej nga ana e Kur'anit dhe e haditheve, duke bërë autentik në këtë mënyrë pjesën e Shpalljeve drejtuar pejgamberëve para Muhamedit (a.s.). Ligji i hakmarrjes prej pesë tabelave është shembulli i përmendur në Kur'an (5:45), ku është thënë: "Zoti atë ua caktoi hebrenjve", pa shtuar "edhe juve".

Vetëm pas 15 vjetëve të vdekjes së Muhamedit (a.s.) muslimanët kanë sunduar në tri kontinente, në territoret e gjera të Azisë, të Afrikës dhe të Andaluzisë (Spanjë) në Evropë. Halifi Omer e vlerësoi sistemin fiskal të Sasandëve të mirë dhe e përdori në provincat e Irakut dhe të Iranit; mirëpo, duke e konsideruar sistemin fiskal të Bizantinëve mizorë, ai atë formoi edhe për Sirinë dhe Egjiptin. Shekulli i parë pas Hixhretit paraqet periudhën e adaptimeve, përforcimeve dhe ndryshimeve. Dokumentet në papirus, me prejardhje nga Egjipti, na informojnë për shumë çështje përsa i përket administratës egjiptase. Tanimë në shekullin e dytë pas Hixhretit hasim në përmbledhje të ligjeve, të kodifikuara prej juristëve të pavarur. Një prej tyre është Zejd ibn Aliu, i cili vdiq 120 vjet pas Hixhretit (viti 733 sipas Isait).

Jemeni qysh herët është quajtur "arabia felix" (arabia e lumtur) dhe, jo për kot. Kushtet e volitshme në kohën e vjetër para krishterimit, superioriteti i këtij

shteti në pikëpamje të kulturës e të civilizimit në krahasim me territoret tjera të Arabisë, pasuria e tij dhe mbretëria e fuqishme mbi të cilën flet Dhiata e Vjetër, ishin të famshme. Në epokën fillestare të krishterimit, vala e emigrimit solli ca fise jemenase në Irak, ku ato themeluan mbretërinë e quajtur Hiru, e cila ishte e njohur për stimulimin e letërsisë e që e vazhdoi deri me ardhjen e Islamit. Mirëpo, Jemeni ra nën sundimin e hebrenjve (Dhu Nuvas), pastaj të të krishterëve (nga abisinasit), pas së cilës vazhdoi okupimi i persianëve, që ia lëshoi vendin Islamit. Ca jemenas të dalluar, të cilët ngelën nën ndikimin e këtyre bredhjeve të pandërprera, edhe një herë në kohën e hHalifit Omer i bindën të shpërngulen dhe të vendoseshin në Irak, sidomos në Kufe (lagjja e nëntë e qytetit Hira). Omeri atje dërgoi Ibn Mes'udin, një nga juristët më eminentë të Pejgamberit (a.s.), që të udhëheqë me një shkollë. Trashëgimtarët e Ibn Mes'udit në këtë shkollë: Alkame, Ibrahim en-Nehaiu, Ebu Hanifeja, sipas rrethave, të gjithë ishin specialistë të drejtësisë. Ndërkohe, Aliu, një ndër juristët e mëdhenj prej shokëve të Muhamedit (a. s), e transferoi halifatin nga Medina në Kufë. Pra, të mos habitemi se kjo qendër u bë vatër e një tradite të pashkëputur në shkencën e drejtësisë dhe fitoi famë që rritej gjithmonë.

Mospërzierja totale e pushtetit qendror në mendimet e lira të gjykatësve dhe të juristëve ka ndihmuar në përparimin e shpejtë të kësaj shkence, mirëpo ajo pati edhe anët e veta të këqija. Një udhëheqës, Ibnul Mekafa, në fillim të shekullit të dytë të Hixhretit u ankua për divergjencat e mëdha në të drejtën procedu-

riale, në ligjin penal, në çështjet e statusit personal dhe në të gjitha degët e drejtësisë. Ai i propozoi halifit që të formonte një institucion për hulumtimin e vendimeve juridike dhe të themelonte një ligj të përbashkët për të gjitha shtetet. Ky sugjerim nuk pati ithtarët e vet. Bashkëkohësi i tij, Ebu Hanifeja, krenar për lirinë e shkencës dhe në orvatje për të lajmëruar luhatjet politike, krijoi një akademi juridike prej 40 anëtarësh, prej të cilëve çdonjëri ishte specialist i ndonjë dege ndihmëse të shkencave juridike, siç janë: Komentimi i Kur'anit, Hadithi, Logjika, Leksikografia etj. Kjo akademi ka vlerësuar të drejtën e asaj kohe dhe ka bërë kodifikimin e saj, por më tepër ajo ka plotësuar zbrazëtitrat në të drejtën islame në vendet ku as teksti i Kur'anit e as drejtësia nuk e kanë thënë fjalën e vet. Nëse mund t'i besohet një biografi të tij, Ebu Hanifeja (vdiq në vitin 150 sipas Hixhretit) ka publikuar afër gjysmë milion rregulla (El Muvafekat, II 137).

Nga ana e tyre, Maliku në Medine dhe el-Euzai në Siri njëkohësisht punuan të njëjtën gjë, për të cilën u ndihmoi vetëm diuria e tyre dhe mjetet personale. Derisa Ebu Hanifeja vendoi theksin në rezonim (duke e ruajtur Kur'anin dhe Hadithin si bazë absolute të çdo ligji), Maliku në vend të logjikës dhe deduktimit i ka dhënë rëndësi praktikës dhe dokeve të medinasve, si qytet më i mbushur me traditat e Muhamedit (a.s.).

Kur'ani është "publikuar" vetëm disa muaj pas vdekjes së Muhamedit (a.s.). Mbledhja e shënimeve mbi fjalët, sjelljen personale dhe lejimet e Pejgamberit (a.s.) në heshtje, që e përbëjnë Hadithin, është bërë gjatë vetë jetës së Pejgamberit (a.s.), por edhe më vo-

në, pas vdekjes së tij. Mëse 100 mijë njohës të Muhamedit (a.s.) na kanë lënë pak a shumë transmetime të pasura mbi atë që kanë ditur për këtë temë: disa duke shkruar, të tjerët me transmetime gojore. Kjo njohuri me vlerë të lartë juridike ishte shpërndarë në tri kontinente, ku u vendosën shokët e Muhamedit (a.s.) në kohën e Umretit dhe të Uthmanit. Në gjeneratat e ardhshme hulumtuesit kanë përfshirë të gjitha përmbledhjet ku u tubuan kujtimet personale të miqve të Muhamedit (a.s.).

Rishqyrtimi i shkencës juridike dhe kodifikimi i Hadithit janë kryer paralelisht dhe gati në të njëjtën kohë, pa pasur besim njëra me tjetrën. Shafiu lindi po në atë vit kur vdiq Ebu Hanifeja. Mospajtimet mes vete i shtynë juristët në njohuri më të thella për Hadithin, kurse muhadithët (shkencëtarët e Hadithit) të sjellin në rend shënimet mbi Pejgamberin (a.s.), duke provuar më parë vleftën personale të transmetuesit që informon dhe duke vërtetuar lindshmërinë dhe kohën e thënieve të shumta të Muhamedit (a.s.), me qëllim që prej këtu të nxjerrin ligje. Shafiu njëkohësisht u specializua në drejtësi dhe Hadith; duke iu falënderuar aftësive të tij të larta dhe mundit të tij, mund të mbërrihej sinteza mes këtyre dy shkencave. Të përmendim se Shafiu ishte i pari në histori i cili la një shkencë të drejtimit abstrakt, që ndryshon prej studimeve të ligjit, si rregulla konkrete të sjelljes.

Shumë juristë, ndër të cilët Ebu Hanifeja, Maliku, Shafiu, Xhafer Sadiku, pas vete lanë shkolla juridike, ithtarët e të cilave sot paraqesin grupe të veçanta në Islam. Kjo do të thotë se në mes tyre ekzistojnë ca da-

llime. Për shembull: në shkollën që e themeloi Xhafer Sadiku, pasardhës i Aliut dhe bashkëkohës i Ebu Hanifes, shkaqet politike shkaktuan zhvillimin specifik të ligjit mbi trashëgiminë. Vetëmse, dallimet mes këtyre shkollave filozofike - kështu do të shohim në shekujt e mëvonshëm - ithtarët e drejtimit Shafi janë larguar prej mësimit të tij dhe në ca pika pranuan mendimet e Malikut, Ebu Hanifes dhe anasjelltas.

Siç pamë, halifati musliman u përhap shumë herët në territore shumë të mëdha, të cilat deri atëherë kishin sisteme të ndryshme juridike: iranas, kinez, indian, biznatin, got, etj. Të mos harrojmë se Arabia uadha muslimanëve kontributin e vet personal. Ky fakt historik pati pasojë, natyrisht, eliminimin total të monopolizimit të së drejtës nga cilido sistem juridik me prejardhje të huaj. Në mes tjerash, mund të shihet se në mesin e themeluesve të shkollave Ebu Hanifeja ishte me prejardhje persiane, Maliku, Shafiu, Xhafer Sadiku ishin arabë; biografi Rahabiu citon se Euzaiu ishte prej Sindi; në gjeneratat e ardhshme do të ketë juristë prej të gjitha kombësive.

Zhvillimi i së drejtës muslimane paraqet, pra, një ndërmarrje “ndërkombëtare”: pasi që juristët muslimanë rrjedhin prej popujve të ndryshëm, flasin gjuhë të ndryshme dhe njohin tradita të ndryshme. Kishte muslimanë evropianë nga Spanja, Portugalia dhe Sicilia, kishte kinezë, abisinas, indianë, persianë, turq dhe shumë të tjerë, përveç arabëve.

Në çdo epokë atakohen temperamente dogmatike dhe të pavarura. Kjo është njerëzore! Njerëzit dëshirojnë të sakrifikojnë në frymën e lirisë të ndonjë mësuesi

të vjetër, të tjerët lëshohen në moskonformizëm; gjithmonë në fund ka mbisunduar mesatarja e sinqertë. Në shpirt të pakompleks të inferioritetit, i cili i di të gjitha shënimet e duhura mbi problemet dhe fetari praktik para saj nuk do të ketë vështirësi të gjejë, njëkohësisht, interpretimin praktik dhe të arsyeshëm, duke i modifikuar qëndrimet e pleqve. Çfarë vendosmërie fshihet në fjalët e juristit të madh Bezdaviu: “Jo vetëm një qëndrim personal, por edhe një konsensus i hershëm mund të ndërrohet me një konsensus të vonshëm”.

Përfundim

E drejta islame fillon si një ligj i një shteti, i një bashkësie sunduese, i cili nuk mbetet pa iu përgjigjur nevojave të bashkësisë gjersa ajo sundonte nga Atlantiku në Pacifik. Kjo e drejtë ka mundësi zhvillimi dhe iu përshtatet nevojave të të gjitha kohëve dhe vendeve. Ajo nuk ka humbur dinamikën e vet as sot dhe kthimi, gjithnjë e më tepër merret si ndërrim kah e mira për shtetet muslimane, të cilat dikur ishin nën dominimin politik dhe juridik të shteteve të huaja.

Kreu X

Sistemi ekonomik në Islam

Thamë se Islami është treguar si udhëheqës efikas sa në planin material të jetës, aq dhe në atë shpirtëror. Edhe në fushën e ekonomisë, mësimet themelore janë marrë prej Kur'anit, i cili në shumë kaptina vërteton se është e nevojshme që njeriu të mos e harrojë mirëqenien materiale: "Mos harro pjesën tënde në këtë botë. . ." (Kur'an, 28:77). Mirëpo, ai asaj nevoje i jep vendin e duhur, duke e vendosur theksin në aspektin e dyfishtë, trupor e shpirtëror, të cilët e përbëjnë njeriun: "...ka njerëz që thonë: 'O Zot! Na jep neve të mira në këtë botë'. Për ta nuk ka pjesë në atë Botë. Ka njerëz që thonë: 'Na jep të mira në këtë botë, por dhe në botën tjetër e na ruaj nga zjarri i Xhehenemit'. Ata do të kenë një pjesë të asaj që e meritojnë; Zoti është i gatshëm që atë ta marrë parasysh" (2:200, 201, 202). Në kaptinat tjera thuhet se Zoti ka krijuar për njeriun gjithë çka ka në tokë, në qiell, në det, në yje etj. Kuptohet se njeriut i është lënë të dijë se si ta shfrytëzojë atë që Zoti e krijoi dhe atë ta shfrytëzojë në mënyrë të kuptueshme, duke pasur parasysh edhe të ardhmen.

Politika ekonomike në Islam është precizuar njësoj në Kur'an me fjalë të paluhatura: "... ajo (pasuria) le të mos mbetet vetëm në rrethin e të pasurve të mesit tuaj" (59:7). Barabarësia mes njerëzve në pasuri dhe komoditet, madje edhe kur është ideale, nuk premtton mirësi të paturbulluar për njerëzimin. E para,

pse talentet natyrore nuk janë të njëjtë te njerëz të ndryshëm, ashtu që madje edhe nëse fillohet me ndonjë grup individësh plotësisht të barabartë, së shpejti plangprishësit do të kishin rënë në vështirësi dhe përsëri do të shikonin pasurinë e shokëve të tyre me lakmi të madhe dhe me zili. Më tutje, në bazë filozofike dhe psikologjike, duket se në interesin e shoqërisë njerëzore është mirë të ketë dallime në pasuri, me qëllim që të varfrit të kishin dëshirë dhe nxitje që më shumë të punojnë. Nga ana tjetër, nëse secilit do t'i thuhej se, madje, edhe nëse punon më shumë se sa është detyra e tij, nuk do të fitojë kurrfarë shpërblimi dhe se do të mbetet si ata që nuk punojnë më tepër se sa është detyra e tyre, njerëzit do të bëheshin përtacë dhe të pakujdesshëm, kurse talentet do të prisheshin për fatkeqësinë e madhe të njerëzisë.

Secili e di që jeta njerëzore është në përparim konstant përmes përvetësimit dhe shfrytëzimit nga njëri-tjetri i gjithë asaj që Zoti krijoi, gjersa shohim se kafshët nuk kanë ndërruar asgjë në jetën e tyre qëkur Zoti krijoi llojet e tyre. Shkaku i këtij dallimi është, sipas zbulimeve të biologëve, në ekzistimin e njëkohshëm të shoqërisë, do të thotë të qenieve njerëzore, ndërsa shtazëve iu mungon njëri prej këtyre kushteve ose nuk e kanë asnjërin. Qentë, macet dhe gjarpërinjtë, p.sh., madje nuk formojnë as familje: ata e vazhdojnë racën e tyre me "dashuri" të lirë dhe të atypëratyshme. Të tjerët, si korbat dhe pëllumbat, krijojnë familjet në formë çiftesh, por përsëri edhe nëse mashkulli i ndihmon në ndërtimin e çerdhes, secili anëtar i çiftit ushqehet pavarësisht. Ndoshta bashkëpunim më

të zhvilluar shoqëror gjejmë te bleta, miza e dheut dhe termi (mizat e bardha të dheut); ato jetojnë në mënyrë kolektive, në barabarësi të plotë në jetë, mirëpo prapëseprapë, pa kurrfarë garash midis anëtarëve të bashkësisë, sado që, edhe sipas kësaj, nuk është e mundur që bletët më të mençura dhe më të dobishme të jetojnë më mirë se të tjerat. Prandaj, nuk ka as evolucion e as ndryshime; aq më pak përparim te cilido prej këtij lloji siç është te raca njerëzore. Historia e njeriut tregon se çdo përparim dhe çdo zbulim i mjeteve të komoditetit është pasojë e garave, e dëshirës për përmirësimin si ekzistim i dallimit në pasuri ose në varfëri mes njerëzve. Po liria absolute i detyron njerëzit e këqinj t'i shfrytëzojnë ata që kanë nevojë. Kështu, ishte e nevojshme që secili civilizim i përparuar dhe secila kulturë e shëndoshë t'u ngarkojë një numër obligimesh anëtarëve të vet (siç është të paguarit e tatimit, ndalimi i shtypjeve dhe mashtrimeve etj.), si dhe të rekomandojnë një numër punësh plotësuese (si mëshirë dhe harxhim për hir të Zotit) dhe në atë rast t'u japin mjaft liri mendimit dhe aksioneve të anëtarëve të vet, kështu që secili individ të ketë dobi, si dhe familja e tij, shokët e tij dhe shoqëria si tërësi. Kjo është dëshira e Islamit dhe është në pajtim me natyrën.

Pikërisht në bazë të këtyre parimeve themelore Islami ka ndërtuar sistemin e vet ekonomik. Nëse e mban pakicën e të pasurve, ai iu vë obligime të rënda; duhet të paguajnë zeqat në dobi të të varfërve dhe nuk guxojnë t'i përdorin mjetet jomorale të eksploatimit, akumulimit dhe grumbullimit të pasurisë. Prandaj, ekzistojnë urdhëresa të caktuara ose ndalesa, por

gjithashtu edhe porosi – për mëshirë dhe sakrifica – me premtimet (të asaj bote) për dhurata shpirtërore. Më tutje, ai bën dallime, në një anë, mes minimumit të domosdoshëm dhe begatisë së dëshiruar, ndërsa nga ana tjetër, mes atyre urdhërave dhe ndalesave të cilat përcillen me sanksione materiale dhe të atyre që nuk janë të tilla, por te të cilat Islami kënaqet vetëm me bindje dhe edukim.

Aspekti moral i problemit është ajo për të cilën duhet qysh në fillim të themi disa fjalë. Disa shembuj mundësojnë që më së miri të kuptohet mundësia e tij: shprehjet më të fuqishme janë përdorur në Islam për të treguar se lypësia është punë e shëmtuar; ajo në Ditën e Gjykimit do të jetë shkak i turpit. Mirëpo, në të njëjtën kohë, falënderimet e pakufishme iu dërgohen atyre që iu ndihmojnë të tjerëve; më i miri në mesin e njerëzve është ai që jep sadaka dhe që më tepër e do të afërmin e vet sesa veten. Njëkohësisht, është e ndaluar kopracia, si dhe shpenzimi i tepërt. Kur njëherë Pejgamberit (a.s.) iu deshën mjete në të holla për ndonjë punë të përgjithshme, njëri prej shokëve të tij dorëzoi një shumë të madhe, kurse në pyetjen e Pejgamberit (a.s.) ai u përgjigj: “Në shtëpi nuk kam lënë asgjë përveç dashurisë ndaj Allahut dhe Pejgamberit të Tij”. Ai pranoi falënderimet më të ngrohta. Në një rast tjetër, një shok të sëmurë rëndë, kur Pejgamberi (a.s.) e vizitoi, e pyeti për diçka të re. Ai tha: “O Pejgamber i Allahut, unë jam njeri i pasur dhe dua që tërë pasurinë time t’ua lë të varfërve”. Pejgamberi (a.s.) u përgjigj: “Jo, më mirë do të jetë t’ua lësh të afërmëve tu, sepse ata atëherë do të mund të jetojnë të pavarur,

e kjo është më mirë sesa t'i lëshë të lypin". Ai nuk u pajtua as me atë që si lëmoshë të lejë 2/3 e pasurisë së vet, as edhe gjysmën; i lejoi 1/3, duke i thënë: "Mirë, por edhe 1/3 është tepër"! Një ditë Muhamedi (a.s.) e pa një prej shokëve të vet, i cili kishte pamje shumë të shëmtuar. Në pyetjen e tij, ai u përgjigj: "O Pejgamber i Zotit, unë nuk jam fukara, por atë që e kam me dëshirë ua jap të varfërve, në vend se t'i harxhoj vetë". Pejgamberi (a.s.) iu përgjigj: "Jo, Zoti don të shohë te robi i vet shenjat e atij që Ai ia ka dhënë". Nuk ka kurrrfarë kontradiktash mes këtyre udhëzimeve të kundërta; secila i ka shkaqet e veta të qarta dhe rolin e vet të veçantë: nga ana tjetër, ato neve na mundësojnë që të konstatojmë kufijtë e arsyes atje ku sadakaja tejkalon minimumin e obliguar.

Të trashëguarit

Legjislatura mbi trashëgiminë ka për detyrë që, njëkohësisht, të sigurojë të drejtën e individit për ta pasur në dispozicion pasurinë e vet dhe secili ka për detyrë të mos e dëmtojë shoqërinë si pjesëtar i saj. Temperamentet shumë ndryshojnë; prandaj, ligjdhënësi e ka për detyrë të vë njëfarë disipline në interes të bashkësisë.

Islami udhëzon që të shfrytëzohen dy rrugë themelore: ndarja e detyrueshme e pasurisë së të vdekurit ndërmjet të afërmeve të tij dhe kufizimi i dispozicionimit të testamentit. Trashëgimtarët ligjorë nuk ka ne-

vojë të cekën në testament: pasurinë e të afërmit të vet të vdekur ata e trashëgojnë automatikisht edhe me pjesët që janë të parapara me ligj. Testamenti është i lejuar vetëm për ata që nuk kanë të drejtë në trashëgimi sipas ligjit. Ka barabarësi të plotë mes farefisit të të njëjtës shkallë: nuk mundet njërit djalë (më i plak ose më i ri) t'i jepet njërit më shumë e tjetrit më pak. Pashurinë që e ka lënë i ndjeri patjetër duhet ndarë si vijon: së pari merren harxhimet e varrimit; në rend të dytë duhet të lahen borxhet – kreditorët gjithmonë kanë përparësi para trashëgimtarëve; në rend të tretë kryhet testamenti në masën që nuk tejkalon të tretën e asaj që mbetet. Pas mbulimit të dy paragrafëve të mëparshëm (shpenzimet e varrimit dhe borxhet), vetëm pas shlyerjes së atyre obligimeve që kanë përparësi, vjen radha e trashëgimtarëve. Burri (ose gruaja), prindërit (babai ose nëna), nipat (djali ose vajza) janë trashëgimtarë të rendit të parë: ata gjithmonë trashëgojnë. Motrat dhe vëllezërit, si dhe kushërinjtë më të largët (kanë të drejtë) trashëgojnë nëse nuk ka trashëgimtarë të rendit të parë. Në listë të farefisit më të largët janë dajët, tezet, nipat etj.

Duke mos hyrë në detaje teknike, do të përmendim vetëm disa rregulla themelore: ai që ka shkaktuar vdekjen e ndokujt përjashtohet nga trashëgimia e viktimës së vet, madje edhe nëse gjyqi konstaton se këtë e ka bërë me mosdashje. Si duket, qëllimi është që të shmanget çdo ngacmim për të vrarë farefisin pasanik, që më vonë të trashëgohet. Pejgamberi (a.s.) ka kërkuar që të pengohet trashëgimia ndërmjet farefisit të feve të ndryshme, madje edhe kur është fjala edhe për

bashkëshortët. (Mirëpo, këtu drejtësia ia bën të mundur testamentit të intervenojë në të mirë të zhveshjes së trashëgimisë: p.sh. burri mund të lë në dyshekun e vdekjes një pjesë të pasurisë në dobi të gruas së vet jomuslimane). Duke marrë parsysh marrëdhëniet ndërkombëtare dhe kuptimet politike të asaj kohe, juristët muslimanë kanë vënë një pengesë tjetër: kombësitë e ndryshme në mesin e farefisit që nuk i takojnë të njëjtit territor politik. Mirëpo, me marrëveshje kjo çështje sipas së drejtës private ndërkombëtare mund të rregullohet edhe në mënyrë tjetër, por në bazë të reciprocitetit.

Në vendet ku ligji islam mbi trashëgiminë nuk aplikohet, por ku e drejta e shkrimit të testamentit është e njohur, muslimanët mund – dhe detyrohen patjetër – të shfrytëzojnë këtë lehtësi që ta kryejnë detyrën e tyre fetare në aspektin e posedimit të pasurisë pas vdekjes.

Testamenti

Përmendëm se Islami i pranon individit të drejtën që vetëm me testament të lë pasurinë e vet në dobi të të gjithë individëve, përveç kreditorit dhe trashëgimtarit, por deri në shumën e një të tretës së pasurisë së vet. Një dispozitë e tillë ka, të themi, qëllim të dyfishtë: t'i lë individit mundësinë të kënaqë drejtësinë atje ku, në përjashtim, e drejta normale do të shkaktonte të padrejtën; dhe qëllimi i dytë: të ndalojë grumbullimin e pasurisë në duart e një numri të vogël, që

ndodh shpesh, sa mund të shkojë deri aty që një person të ketë në dispozicion më shumë se një të tretën e pasurisë ose tërë pasurinë. Islami nxit qarkullimin e pasurisë në një numër sa më të madh individësh, duke pasur parasysh interesat e familjes dhe të atyre që varen nga i vdekuri.

Pasuria publike

Njeriu ka një numër detyrash si pjesëtar i një “familje”, shoqërie a shteti më të madh, pjesëtar i të cilit ai është . Në fushën ekonomike, individi paguan tatime të cilat shteti i shpërndanë në dobi të bashkësisë.

Tarifat e tatimit ndyshojnë sipas llojeve të të ardhurave: është interesant të përmendim se Kur’ani, i cili ka dhënë udhëzime precize për harxhimet e buxhetit, nuk ka dhënë rregulla e as tarifa mbi të ardhurat e shtetit. Duke respektuar të gjitha detajet e praktikës së Pejgamberit (a.s.) dhe të pasardhësve të tij të drejtpërdrejtë, heshtja e Kur’anit mund të shpjegohet si dhënie e lirisë shtetit që t’i ndryshojë rregullat sipas rrethanave, duke u udhëhequr sipas interesave të popullit.

Qe se si në kohën e Pejgamberit (a.s.) është mbledhur zeqati: Mbi një numër minimal të të ardhurave pa zeqat, fshatari jep të dhjetën e vjeljeve, nëse tokën ia ujit shiu ose vërshimet e ujit, ndërsa gjysmën e asaj shume nëse tokën e ujit nga pusi. Në tregti dhe në eksploatimin e xeheve paguhet 2,5 për qind nga vlera e pasurisë. Përsa iu përket karvanëve të huaj në koh-

ën e Pejgamberit (a.s.), dogana në emër të së drejtës së importit arrin të dhjetën. Mirëpo – ai fakt është me interes të përmendet – halifi Omer, e praktikoi atë taksë në gjysmë për disa lloje artikujsh që vinin nga Medina. Ky precedent i autoritetit të lartë na jep mundësi të parandiejmë parimet e politikës financiare islame.

Në kohën e Pejgamberit (a.s.) është dhënë zeqat edhe për devetë, për dhentë, për lopët, madje ato janë rritur nëpër kullosat e shteti, duke llogaritur mbi të ardhurat minimale, të cilat gjithmonë janë të lira nga zeqati. Gjithashtu, kanë qenë të lira shtazët që kanë shërbyer për transport, për lavra dhe për ujitje.

Ekziston edhe një taksë, 2,5 për qind, mbi kursimet në ar dhe argjend. Kjo e ka detyruar individin që të aktivizojë pasurinë e vet (ta vë në qarkullim), e jo ta tubojë dhe ta grumbullojë.

Shpenzimet shtetërore

Kur’ani përcakton rregulla që e definojnë buxhetin e shpenzimeve të shtetit islam si vijon:

“Të ardhurat shtetërore iu takojnë të varfërve, të ngratëve (të mjerëve), mbledhësve të zeqatit, atyre zemrat e të cilëve duhet të përfitohen në Islam, robërve (që të blihen), borxhlinjve (për të paguar borxhet), atyre që janë në rrugën e Allahut (*fi sebililah*), udhëtarit të Allahut; Allahu di dhe është i Urtë” (Kur’an, 9:60).

Tetë kategoritë e numëruara për shpenzimet, të cilat praktikisht mbulojnë të gjitha nevojat e një bash-

kësie, lypin njëfarë shpjegimi që të mund të kuptohet domethënia e tyre e drejtë.

Shprehja “sadakāt”, të cilën ne e kemi përkthyer si “të ardhurat e shtetit”, përfshin të gjitha të dhënat që muslimanët i paguajnë shtetit të tyre në gjendje normale: zeqat në bujqësi, miniera, tregti dhe industri, në rritjen e shtazëve, në kursime etj. Këtu nuk janë përfshirë zeqatet e përkohshme, në raste të veçanta, pastaj tatimet që mbliidhen nga jomuslimanët, nën-shtetasve dhe të huajve, si dhe të gjitha kontributet tjera të padetyrueshme. Literatura juridike e të drejtës islame, sidomos hadithet e Pejgamberit (a.s.), nuk lënë kurrfarë dyshimi se shprehja është përdorur në këtë kuptim. Ajo fare nuk ka pasur lidhje me lëmoshëtarët, të cilët as mund të ishin të obliguar e as nuk e kanë pasur të përcaktuar, as në pikëpamje të sasisë e as të kohës, dhënien. Shprehja gjegjëse për lëmoshëtarët është *infak fi sebililah*, shpenzim në rrugën e Zotit ose *tetavua*, lëmoshë vullnetare.

Ndërmjet shpenzuesve të të ardhurave shtetërore, dy kategoritë e para të përmendura: fukaraja dhe mesakin-i (të mjerët dhe të varfrit), të cilët afërsisht janë me kuptim të njëjtë, nuk janë të shpjeguar nga ana e Pejgamberit (a.s.), prandaj edhe dalin kundërthënie në mendime. Sipas fjalëve dhe veprave të halifit Omer, “fukara” janë të varfrit në mesin e muslimanëve, ndërsa “mesakin” përcakton varfanjakët e huaj, të cilët janë vendosur në vendet islame, jomuslimanët: hebrenjtë, të krishterët etj. Juristi Shafi mendon se ato shprehje janë me të njëjtën domethënie dhe se Allahu me mëshirën e Vet i ka emërtuar të varfrit me dy

emra, që t'u kushtohet sa më tepër kujdes; sipas tij, tetë kategoritë duhet të marrin secili prej tyre nga një të tetën e të ardhurave, ndërsa të varfrit prej saj marrin dy të tetat. Sido që të jetë, qëllimi i parë i të ardhurave shtetërore mbetet që asnjë krijesë që jeton në territorin islam të mos eliminohet nga mjetet themelore për jetë: nga ushqimi, veshja, banimi etj.

Pastaj vijnë rrogat e nëpunësve: personat që kryejnë pagesat, llogaritë, ata që janë të obliguar të paguajnë llogaritë, kontrollorët etj. Në realitet, ajo kategori përfshin tërë administratën civile, si dhe atë ushtarake e diplomatike të një shtetit, siç do të shihet në përshkrimin e tetë kategorive të shfrytëzuesve. Historiani Baldahur në veprën e tij *el-En-sab* ka ruajtur një dokument me të cilin Halifi (Omeri) lyp prej guvernatorit të vet në Siri: "na dërgo neve (në Medine) një grek të aftë, që të sjellë në rregull llogaritë e të ardhurave tona". Nuk ka nevojë asnjë dëshmi më e mirë se si jo-muslimanët jo vetëm që kanë mundur të punësohen në administratën e shtetit musliman, por gjithashtu kanë mundur të shfrytëzojnë "sadikanë", e cila merret kryekëput nga muslimanët.

Kategoria e atyre zemrat e të cilëve duhet të përfitohen ka të bëjë, kjo lehtë kuptohet, me shpenzimet e veçanta të shtetit. Juristi Ebul A'la el-Ferra thekson: "Përsa u përket atyre zemrat e të cilëve duhet të përfitohen, ata janë katër kategori:

1. Ata zemrat e të cilëve duhet të përfitohen që t'u ndihmojnë muslimanëve;

2. Apo ata që duhet të binden që të mos u bëjnë dëm muslimanëve;

3. Ata që thirren të pranojnë Islamin; dhe

4. Ata me ndërmjetësimin e të cilëve thirren shokët dhe familjet e tyre që të rikthehen në Islam.

Është e lejuar që të shpenzohet për secilën prej këtyre kategorive, qoftë për muslimanë, qoftë për idhujtarë.

Me shprehjen “çlirim i të nënshtruarve” nënkuptohen, para së gjithash, dy lloje shpenzimesh: çlirimi i robërve dhe blerja e robërve të luftës prej armikut. Sipas ligjit islam, secili rob ka të drejtë të blejë lirinë duke ia paguar shpërblimin zotëriut të vet: ai gjithashtu ka të drejtë që të mund të fitojë shumën e duhur, të lypë nga zotëriu i vet që ta lëshojë të punojë, nëse ka nevojë, edhe tjetërkund. Aq më tepër, sikurse që e pamë, detyra e pushtetit është që të parashohë për çdo vit në buxhetin e vet një shumë për ndihmë robërve që duan të blejnë lirinë e tyre. Një dokument prej halifit emevij Omer ibn Abdulaziz na njofton neve për pengesën, nga ana e pushtetit islam, të shpërblimit të destinuar për çlirimin e jomuslimanëve të zënë rob nga ana e armikut.

Kategoria e atyre që janë të obliguar rëndë dhe të ngarkuar me obligime, sipas praktikës së ditëve të para të Islamit, ka mjaft shembuj: iu ndihmohet atyre që janë goditur nga fatkeqësitë elementare, siç janë: vërshimet, tërmetet etj. Këtu fare nuk ka të bëjë me të varfrit, të cilët janë përmendur në fillim të ekspozesë, por për njerëzit që iu janë nënshtruar rasteve jashtë fuqisë së tyre. halif Omeri ka organizuar një degë të veçantë të arkës shtetërore për huazimin e mjeteve pa kamatë atyre që përkohësisht iu duhen, e të cilët kanë dhënë garanci për t’i paguar; edhe vetë halifi merrte hua për nevojat personale. Kuptohet që “nacionalizimi-

mi" i huasë pa kamatë pashmangshmërisht përcillet me ndalesën në Islam të huasë me kamatë. I njëjti halif iu ka dhënë hua tregtarëve, me afate të kufizuara, ndërsa arka shtetërore bashkë me të e ndante një përqindje të fitimit (sipas së cilës, të gjithë kanë marrë pjesë te rreziku dhe fitimi eventual). E njëjta kategori e shpenzimeve popullore ka pasur edhe një lloj zbatimi: ajo ka mundur të formojë një lloj pagese të cilën ne sot e quajmë "sigurim social". Nëse dikush pa dashje e vret njeriun dhe nuk ka mundësi që me mjetet e veta të paguajë ligjshëm gjakun, pushteti i ofron ndihmë prej buxhetit, për çka dëshmojnë, në disa raste, qëndrimet e Pejgamberit (a.s.). Për këtë do të flasim më vonë, me më shumë detaje.

Shprehja "në rrugë të Zotit" (*fi sebililah*) në terminologjinë islame më së pari kuptohet si mbrojtje ushtarake, por ka të bëjë edhe me individë e grupe. Mirëpo, me të kuptohet dhe çdo vepër bamirësie; prej ndihmave studentëve, deri tek aksionet fetare, siç është ndërtimi i xhamive, i institucioneve shkollore etj.

Në kategorinë e fundit të shpenzimeve hyjnë gjithë ajo që mund ta përmirësojë situatën e "fëmijës së rrugës, d.m.th. të udhëtarit", qoftë ai tregtar, njeri afa-rist, ose turist i rëndomtë: ngritja dhe mirëmbajtja e urave dhe e rrugëve, e hoteleve, e restoranteve; shërbimi i sigurimit dhe i higjienës, organizimi i transportit dhe, kryesisht, gjithçka që ka të bëjë me komoditetin e udhëtarit në rrugë, që nënkupton, brenda mundësive, mikpritjen pa pagesë (dikur mikpritja pa pagesë është praktikuar për një qëndrim prej tri ditësh në një vend).

Që të çmohet vlera e këtyre udhëzimeve, duhet të sjellim ndër mend se kjo daton që prej ekzistimit të Islamit, para 14 shekush. Ka ca sende të cilat duhet t'i shtohen kësaj, pastaj të aplikohet edhe në kohën tonë, në një vend të përparuar, për mirëqenien njerëzore.

Tatimet e jashtëzakonshme

Sadakaja ka qenë e vetmja taksë shtetërore në kohën e Pejgamberit (a.s.) dhe katër halifëve të parë. Në kohë të vona, me rastin e nevojave të jashtëzakonshme, juristët kanë lejuar të vihen tatime të parregullta, por rreptësisht të përkohshme, që t'u përgjigjen nevojave të jashtëzakonshme. Këto tatime janë quajtur "naraib" (etimologjikisht: vështirësi).

Sigurimet shoqërore

Sigurimet vihen vetëm në raste të rreziqeve të mëdha, ndësa ato rreziqe ndryshojnë sipas kohës dhe vendit. Në atë kohë, veçanërisht tek arabët, sepse kanë qenë më të afërt me natyrën, njiheshin më pak sëmundje sesa sot; ndërkaq, barnat nuk kushtonin gati fare; njeriu ka ndërtuar shtëpinë me duart e veta, ndërsa pjesën më të madhe të materialit ndërtimor as që e ka paguar. Andaj, nuk ka pasur shumë nevojë për sigurimin kundër sëmundjeve, zjarreve e të tjera.

Nga ana tjetër, sigurimi kundër robërisë dhe dhunës ka qenë çështje e rregullt. Për to është menduar qysh në kohën e Pejgamberit (a.s.) dhe kanë gjetur zgjidhje të ndryshme, krejtësisht të përshtatshme për zhvillimin e mëvonshëm dhe për çdo rast. Në kushtetutën e qytetit – shtet të Medines, në vitin e parë të Hixhretit, ai sigurim quhej “Meakil” dhe funksionon në këtë mënyrë: nëse dikush është zënë rob në luftë nga ana e armikut, duhet t’i paguhet shpërblimi për ta paguar lirimin e tij, kurse në rastet e lëndimeve trupore ose vrasjes, paguhen dëmet ose gjaqet. Kjo shpeshherë tejkalon mundësitë e personit identik, robërve të luftës ose të fajtorit. Muhamedi (a.s.) ka organizuar sigurimin në bazë reciprociteti: anëtarët e një fisi mund të llogarisin në arkën qendrore të atij fisi, në të cilën secili dorëzon sipas mundësive të veta; nëse arka nuk mjafton, fisi tjetër, farefisnor ose fqinjësor, duhet t’i dalë në ndihmë, sipas një shkalle e cila është vendosur për të arritur unitetin në një bashkësi komplete. Në Medine atëherë jetonte fisi Ensarij, me prejardhje nga qyte-ti. Pejgamberi (a.s.) urdhëroi ardhacakët që vinin këtu për t’u strehuar, të cilët ishin me prejardhje nga Meka ose vendet tjera të Arabisë, gjithashtu edhe nga Abis-inia, që për qëllimet e sigurimit social reciprok të bashkoheshin në një fis të ri, të ashtuquajtur Muhaxhir.

Më vonë, në kohën e halifit Omer, sigurimet janë organizuar në “bashkësitë e ndihmave reciproke”, sipas zejeve, sipas enteve, civile ose ushtarake, ose sipas rajoneve. Sipas nevojës, pushteti: qendror ose provincial – iu ndihmon atyre bashkësive ashtu siç e

kemi përshkruar kur folëm për parimet e shpenzimeve shtetërore.

Në esencë, sigurimi paraqet radhitjen e obligimeve të një individi në numër sa më të madh të tyre, me qëllim që të lehtësohet barra. Në zgjedhjen mes sigurimit në baza kapitaliste dhe sigurimit në baza të reciprocitetit, Islami i jep përparësi këtij të fundit, duke krijuar sistemin e bashkësive të ndihmës reciproke, majën e së cilës e përbën vetëm pushteti qendror.

Këto ente (të sigurimit) mund të lidhin kontrata tregtare me mjetet e mbetura, të cilat i kanë në dispozicion, që të mund të rrisin kapitalin; ndodh rasti kur anëtarët e shoqatës për ndihma reciproke të lirohen nga pagesat e reja, ose bile nëse mund t'u përcaktohet një shumë në emër të pjesëmarrjes në fitim. Kuptohet vetvetiu se shoqata për ndihma reciproke mund t'i ndërmarrë të gjitha llojet e rreziqeve: fatkeqësitë në komunikacion, zjarret, humbjet në transport etj. Gjithashtu, kuptohet se këto shoqata mund të jenë "të nacionalizuar" dhe se ato mund t'i udhëheq shteti për arsye të sigurimit të të gjithëve ose disa rreziqeve, p.sh. humbjeve të paketave në postë etj.

Duke mos hyrë në imtësi teknike, duhet të përmendim se sigurimet kapitaliste, ku i siguruari nuk merr pjesë në dobinë e kompanisë në përpjesëtim me shumën e pagesës së vet, nuk përputhen me qëndrimet islame, sepse një sigurim i tillë paraqet lojën e fatit.

Të përmendim edhe një ent social nga koha e Omerit: sistemi i pensionimit për të gjithë banorët e vendit (sipas Dha Nuvejhrit dhe disa anëtarëve të tjerë, në mesin e atyre që shfrytëzonin pensionin ka pasur

edhe prej jomuslimanëve): fëmijët këtë ndihmë e kanë shfrytëzuar prej lindjes, kurse të rriturve ajo iu ka siguruar minimumin e jetës. Në fillim halifi ka praktikuar një dallim në shkallën e ndihmave, kategorive të ndryshme të individëve: nëse shumën minimale e përcaktojmë në një (1), kategoria më e privilegjuar (në kohën e Pejgamberit) ka arritur 40, ndërsa në përgjithësi raporti sillej ndërmjet një dhe 15. Kah fundi i jetës, ai vendosi që të gjitha kategoritë t'i barazojë, por vdekja e pengoi për ta realizuar këtë reformë. Ky inatitucion, të cilin Omeri e quajti "Divan", si duket e ka rrënjën qysh në kohën e Pejgamberit (a.s.), që implikohet në këtë rast: "Baza e këtij qëndrimi është ngjarja se Muhamedi (a.s.) e ka caktuar Mahmiun ibn Jaz'in të merrte përgjegjësinë për të pestën shtetërore të çdo plaçke. Me sadakanë (zeqatin) udhëhiqej (veçanërisht) ndaras dhe ai kishte funksionarët e posaçëm. Për të ardhurat në paqe (*faj*) nga armiku (*Fej*) ishin funksionarët e posaçëm. Pejgamberi (a.s.) e kishte zakon që sadakanë t'ua dërgonte jetimëve, të pamundurve dhe të varfërve; kur ndonjë jetim rritej dhe arrinte moshën e obligimit ushtarak (Xhihad), ai kalonte prej listës së sadakasë në listën e atyre që shfrytëzonin *fejin*, mirëpo, nëse refuzonte të kryente obligimin ushtarak, nuk mund të shfrytëzonte sadakanë dhe duhej që vetvetes t'i siguronte mjete për jetesë. (Shih: Saraksi – Sherh es-sijar elkebir, Botimi Munexhed, 1978).

Lojrat e fatit

Duke ndaluar lojrat e bixhozit, Kur'ani (5:90) ato i ka quajtur "punë të shejtanit". Plotësisht e arsyeshme. Dihet se shumë të këqija shoqërore janë rezultat i ndarjes së jorealtë të pasurisë nacionale. Në ç'mënyrë, disa individë pasurohen shumë, kurse të tjerët mbeten shumë fukarenj, të cilët përfundimisht bëhen viktima për shfrytëzim nga të pasurit. Në lojrat e bixhozit, ku hyn edhe lotaria, është provë e madhe për fitim të lehtë të shumë të hollave; pra, çdo fitim i lehtë është e keqe për shoqërinë. Po e zëmë se në vrapimin e kuajve, e të tjera, në lotaritë publike e private dhe në të gjitha lojrat e bixhozit një popull harxhon 30 milionë franga në javë – që ndodh në disa shtete. Vetëm pas dhjetë vjetëve ajo arrin në 15 miliardë e 600 milionë franga, të cilat janë marrë prej duarve të shumë banorëve e të ndara midis një numri shumë të vogël. Mezi 1 për qind fiton në llogari të 99 për qind; me fjalë të tjera, varfërohen 99 për qind të njerëzve, që të pasurohet vetëm 1 për qind; bëhet 1 për qind milioner, për t'u shkatërruar sistematikisht 99 për qind të tjerë. Qofshin lojrat e bixhozit (këtu nënkuptohet edhe lotaria), private ose publike (shtetërore), kjo e keqe e grumbullimit të pasurisë në duart e një numri shumë të vogël në llogari të një numri shumë të madh, mbetet në dobi të pakicës. Prandaj, ndalohet krejtësisht loja e bixhozit dhe lotaria në Islam. Si edhe në sigurime kapitaliste, edhe në lojrat e bixhozit ekziston rreziku i njëanshëm.

Huaja me interes

Me siguri, s'ka asnjë religjion që nuk i ka ndaluar paratë me kamatë; shenjë e posaçme e Islamit është se jo vetë që e ndaloi këtë lloj të fitimit, por gjithashtu i zhduku edhe burimet e kësaj të keqeje shoqërore.

Askush nuk paguan me vetëdashje kamatën në huanë e vet; ai këtë e bën vetëm se i nevojiten paratë dhe se nuk mund të gjejë të holla pa kamatë. Islami ka bërë dallim të qartë mes fitimit tregtar dhe fitimit që arrihet përmes fitimit me interes. Kur'ani thotë: "Allahu ka lejuar tregtinë, ka ndaluar kamatën". Më tutje Ai gjithashtu thotë: "Nëse atë nuk e bëni (nuk i shmangeni kamatës), atëherë i keni shpallur luftë Allahut dhe Pejgamberit të Tij. Nëse pendoheni, juve ju takon baza e pasurisë suaj". (Kur'ani: 2:275)

Shkaku kryesor i kësaj ndalese mbetet i njëjtë siç ishte në rastin e sigurimit kapitalist ose të lojrave të bixhozit. Edhe te huaja me interes rreziku është i njëanshëm: huazohet një shumë e caktuar që me atë të fitojë; është e mundur që rrethanat të mos jenë të volitshme e borxhliu të mos fitojë sa duhet për të paguar kamatat; pra, ai që e jep huanë nuk merr pjesë te rreziku.

Askush nuk mund të "detyrohet" që "të zhvesh" paranë e vet e t'ua japë hua të tjerëve pa interes. Theksuam se Islami, mes tjerash, e detyron shtetin që t'u japë ndihmë shtetasve që për së tepërmi janë të ngarkuar me borxhe: Banka Popullore organizon hua pa interes, së cilës duhet shtuar edhe huatë që vijnë nga

njerëzit e mëshirshëm dhe bashkësitë bamirëse në baza të reciprocitetit dhe të ndihmave mes vete.

Mirëpo, për huatë tregtare ekziston, përveç tjerash, sistemi i ashtuquajtur “Mudarebe”. Paratë merrën hua dhe njëkohësisht merret pjesë edhe në fitim, edhe në rrezik. Nëse dy individë p.sh. bashkohen, secili jep gjysmën e kapitalit dhe nëse punojnë së bashku, ndarja e fitimit nuk është e rëndë; por, nëse kapitali rrjedh nga një anë, kurse puna nga ana tjetër, ose nëse dy vetë japin kapitalin dhe vetëm njëri punon, e kështu me radhë..., atëherë shpërblimi i merituar për punën e kryer, në bazë të kushteve të konfirmuara më parë, merren parasysh para se të ndahet fitimi. Me siguri janë ndërmarrë edhe masat e sigurimit që të evitohet rreziku, por Islami lyp që në çdo marrëveshje kontraktuese të dy anët e kontraktuara të marrin pjesë edhe në fitim edhe në humbje, me të njëjtat kushte.

Përsa i përket bankës, aktivitetet e tyre mund të ndahen në tri veprimtari themelore: transmetim i mjeteve, ruajtje e kursimeve dhe investime (ose huatë me qëllim që të fitohen mjetet). Shpenzimet e punës shkojnë në llogari të atyre që me to shpërblehen: mbetet vetëm çështja e huasë për tregtinë, për industrinë dhe nevojat tjera ekonomike: nëse banka merr pjesë në rrezikun e borxhlinjve të vet, ashtu si në fitimin e tyre, Islami atë e lejon; në të kundërtën, një afarizëm i tillë nuk lejohet.

Besueshmëria lind nga i besueshmi; nëse kursimorja e një shteti lajmëron, jo në fillim, por në fund të vitit, se ajo është në gjendje t’u ndajë këtë e këtë përpjesëtueshmëri klientëve të vet, jo vetëm që Islami atë

do ta lejonte, por edhe populli nuk do të nguronte që kursimet e veta t'ia besojë bankës së shtetit, madje edhe nëse nuk i ofrohet fitimi që mund të pritët prej saj; pra, do të ketë besim të plotë në drejtoratin popullor.

Shkurtimisht, rregulla e ndarjes së fitimit mes vete, si dhe i rrezikut, patjetër duhet të aplikohet në të gjitha kontratat tregtare dhe në ato të huasë.

Statistika

Për çdo planifikim duhet të kemi një ide për burimet që i kemi në dispozicion. Pejgamberi (a.s.), siç përmend Buhariu, ka organizuar regjistrimin e të gjithë banorëve muslimanë. Gjatë kohës së halifit Omer janë bërë regjistrimet e shtazëve, të pemëve dhe të pasurive të tjera. Në provincat e posapushtuara është matur toka e punueshme. Shpirtëmadhësia, bujaria dhe kujdesi për të lirën e popullit, i njëjti halif për çdo vit ka thirrur, pasi e ka tubuar zeqatin, përfaqësuesit e provincave që ta lajmërojnë se a kanë ndo një vërejtje në sjelljet e atyre që e kanë tubuar zeqatin.

Jeta e përditshme

Këtë ekspozë e përfundojmë me shënimin për dy ndalesat karakteritike, të një rëndësie të madhe që ka të bëjë me jetën e përditshme të një muslimani: lojrat e

bixhozit dhe pijet alkoolike. Folëm për lojrat e bixhozit, por ka vite me radhë vetëm shpenzohet e kurrë nuk fitohet. Çfarë dëmi është kjo veçanërisht për familjet e vobegëta?!

Përsa i përket alkoolit, ai ka atë veti që pirja e një sasive të vogël na bën të gëzuar dhe na e heq vendosmërinë tonë që të mos pimë më; mirëpo kur të dehe mi, nuk kemi kontroll mbi sjelljet tona: paratë mund të derdhen pamasë. Të mos llogaritim se ashtu humbet edhe shëndeti. Në një ajet të Kur'anit (2:219) në mënyrë shumë interesante flitet për këto dy tema: "Të pyesin për alkoolin dhe bixhozin. Thuaj: "Që të dyja janë mëkat i madh. Ka edhe ca dobi për njerëzit, por dëmi nga ato është më i madh se dobia." Kur'ani këtu nuk mohon edhe disa dobi por ai shpall se ai është mëkat i madh (kundër shoqërisë, kundër vetë individit i cili e bën atë dhe, natyrisht, kundër Ligjvënësit)". Në një vend tjetër Ai këto porosi i vë në të njëjtin nivel si edhe idhujtarinë dhe i quan "vepra të shejtanit", duke urdhëruar që të ruhen nëse dëshirojmë të jemi në të dy botët fatlumtur.

Kreu XI

Gruaja muslimane

Në këtë kapitull, para se të flasim për të drejtat dhe detyrat e gruas në Islam, do të ishte mirë që në fillim të përmendim se përkundër mundësisë që ka pasur të zhvillohet drejtësia dhe t'u përshtatet rrethanave, në të nuk do të gjejmë ekuivalent të pakufizuar të lirisë të cilën e gëzon gruaja sot, qoftë në shtetet kapitaliste apo socialiste. Islami lyp prej gruas që të jetë qenie inteligjente, duke mos lypur prej saj të bëhet melaqe e as që i lejon të bëhet dreq. "Mesatarja është rruga më e mirë" – ka thënë Muhamedi (a.s.). Nëse bëhet krahasimi i rregullave ose sistemeve religjioze, duhet vëzhguar tërësinë, e jo vetëm pjesët e izoluar. Në sferën e moralit, Islami është më rigoroz dhe më puritan qsa sisteme të kohës sonë.

Vërejtje të përgjithshme

Pozita e nënës është shumë e lartë në traditën islame. Muhamedi (a.s.) ka thënë: "Xheneti është nën këmbët e nënave tuaja". Buhariu na tregon: "Dikush e pyeti Pejgamberin (a.s.): 'Cila vepër i pëlqen Allahut (xh. sh.) më shumë?' – Ai u përgjegj duke thënë: 'Ta falësh namazin në kohën e vet'. Përsëri e pyetën: 'Pastaj çka?' Pejgamberi (a.s.) tha: 'Bamirësia ndaj babës

dhe nënës'''. Kur'ani shumë shpesh cek dhe e thirr njeriun të përkujtojë se nëna e tij e ka mbajtur në bar-kun e saj, ka duruar shumë për shkak të tij dhe se e mëkëmbi duke i bërë gjithë sakrificat e mundura.

Përsa i takon gruas si bashkëshorte, qe thënia e njohur e Muhamedit (a.s.): "Më i miri prej jush është ai që sillet më mirë ndaj gruas së vet".

Në Fjalimin e njohur të Lamtumirës, të cilin e mbajti në Haxhin e Lamtumirës (Haxhi vedan), ai gjithashtu foli për gruan; atëherë tha: "O njerëz! Ju keni të drejta dhe obligime ndaj grave tuaja; edhe ato kanë të drejta dhe obligime ndaj jush. Ato nuk guxojnë t'i lejojnë askujt të afrohet në shtratin tuaj përveç juve, as nuk guxojnë pa pëlqimin tuaj të lejojnë të hyjnë në shtëpitë tuaja ata që nuk dëshironi; ato nuk guxojnë të bëjnë vepra të turpshme. Nëse e bëjnë atë, Allahu ju urdhëron t'i qortoni, t'i largoni prej shtrati dhe t'i dënoni, por jo aq ashpër. Nëse nuk i përmbahen asaj dhe nëse nuk iu përulen, ju duhet të kujdeseni për ato gjithmonë sipas traditës së mirë. Unë ju rekomandoj që me gratë të silleni mirë, pasi që ato janë amanet i Allahut për ju. Ju lejohet që të kënaqeni me to, me ndihmën e Allahut. Frikësojuni Allahut për të drejtat e grave tuaja, e unë ju rekomandoj të silleni mirë ndaj tyre. Vëreni! A dëgjuat (vërejtjen time). O Zot, dëshmo".

Qëndrimi i Islamit ndaj vajzës mund të shihet më mirë prej qortimit që Kur'ani ua drejton idhujtarëve për qëndrimet e tyre kur lind foshnja femër: "Ndërk-aq, kur ndonjërit i lajmërojnë se i ka le vajzë i terrohet fytyra dhe bëhet si i mjerë fshihet prej njerëzve për fa-kteqësinë që i kanë lajmëruar dhe thotë: a ta ruaj kë-

shtu i nënçmuar apo ta shtiej në dhe, po sa keq që gjykojnë!” (Kur’an, 16:58,59). Në Kur’an Allahu përmend se gjithçka krijoi çift, që në lindjen e dy gjinive kanë përgjegjësi të njëjtë dhe funksion të posaçëm. Ai shpall: “...burrave iu takon ajo që kanë fituar, si dhe grave iu takon ajo që kanë fituar...” (Kur’an, 4:32).

Natyrisht, barazia mes dy gjinive është vetëm në prirje dhe funksione. Mashkulli nuk është ai që lind, gruaja nuk mund të mbart... Çështjet qëndrojnë ashtu. Struktura trupore e femrës është e hajthme, duke filluar prej trurit, deri tek eshtrat dhe ajo do të tregojë tendecë të ruajë hajthmërinë. Mashkulli ka më shumë fuqi; ai është caktuar, pra, të merret me pjesën më të rëndë të jetës. Çdokujt sipas nevojave dhe aftësive natyrore dhe logjike.

Edhe pse ka një pabarazi mes gjinive, në shumë fusha të jetës ata janë të ngjashëm; në këto fusha edhe pozita e tyre është e ngjashme. Me këtë u komentua shkurtimisht mësimi islam mbi gruan; ajo konsiderohet e barabartë me mashkullin në disa raste, e në disa jo. Kjo më mirë shihet prej pasqyrës së detyrave dhe të drejtave të saj.

Detyrat e gruas

Sipas fesë, detyra e parë e saj është e njëjtë si e burrit: të besojë në Një Zot - e vetmja mundësi për të shpëtuar në atë Botë. Dihet se Islami rreptësisht e ndaloi përdorimin e fuqisë për transferimin e njerëzve

në Islam – ndërkohë, përmendim se gruaja jomuslimane e martuar për muslimanin ka të drejtë të mbajë fenë e vet dhe ta deklarojë. Por, gjithashtu dihet se brenda bashkësisë islame qëndron disiplina e rreptë që të mbahet uniteti dhe të ruhet sistemi jetësor i tij. Tradhëtia është e dënuar, mirëpo ca raste nga kohët e Halifëve na dokumentojnë se edhe në raste të tilla dënimi për femrën është më pak i rreptë se për mashkullin.

Në kryerjen e obligimeve fetare, namazi është i obliguar për mashkullin, vetëm se me ca lehtësime për femrën: femra në pubertet, gjatë menstruacionit, nuk e ka për detyrë të falë namazin; ndërkaq, namazi i xhumasë është fakultativ për femrat. Edhe obligimi i agjërimit është i toleruar për femrat: si në kohën e shtatzënisë etj. Ajo ka të drejtë të mos agjërojë gjatë Ramazanit.

Në haxh ajo lejohet prej ca riteve nëse nuk mund t'i kryejë nga shkaqet që janë të lidhura me natyrën e saj. Përsa i përket zeqatit, ato janë të barabarta me mashkullin; mirëpo ca drejtime juridike, siç është p.sh. drejtimi i Shafiut, i bën ca lëshime: ka zeqat në pasurinë e kursyer, mirëpo kursimi i femrës në formë të stolisë dhe dekorit për përdorim personal lirohet prej dhënies së zeqatit. Përkundër faktit se Islami insiston për qarkullimin e përhershëm të pasurive nacionale, me qëllim të shtimit, dhe me anë të tatimeve apo zeqatit dëshiron të pengojë akumulimin e kapitalit të vdekur, ai përsëri bën një përjashtim ndaj femrës dhe prirjeve të saj femërore.

Gruaja ka edhe detyra shoqërore. Në ndarjen e drejtë të pasurisë nacionale pengohen mundësitë e grumbullimit të pasurisë në duart e një numri të vo-

gël të njerëzve. Midis këtyre ndalimeve të përmendim kamatën dhe bixhozin, prej të cilave muslimania patjetër duhet të mbrohet sikurse mashkulli. Lotaria, lidhja e bastit për garat sportive, janë të papëlqyera për shkak të ekuilibrit të shoqërisë; ato, pra, janë të ndaluara si për meshkujt, ashtu dhe për femrat.

Të përkujtojmë dhe një burim fatkeqësish dhe defektesh siç është alkooli. Detyrë e muslimanit është që kategorikisht t'i shmanget. Kur'ani e ka quajtur alkoolin "vepër të djallit". Dëmet e tij në shëndet, në ekonomi, në moral dhe në gjithçka tjetër janë të njohura mirë. Alkooli te femra ka ndikim të posaçëm: duke e ushqyer fëmijën e vet, derisa ai ende është në bark, përmes gjakut infektohet qumështi dhe vjen deri te sëmundja e fëmijës. Anasjelltas: nëse nëna nuk e përdor alkoolin, është më e shëndoshë dhe, si rezultat i saj, vjen shëndeti i fëmijës.

Morali rregullon marrëdhënien e njeriut me ato që janë të ngjashme me të siç i rregullon përshepturia marrëdhëniet e tij me Krijuesin e vet. Edhe njëra edhe tjetra caktojnë detyra. Në fushën e moralit Islami është kacafytur me burimet e së keqes, jo vetëm në manifestimet e tyre dhe pasojat: ai urdhëron, këshillon, udhëzon në ca sjellje të cilat nganjëherë habisin, nëse nuk kemi kujdes mbi shkaqet më të thella të asaj. Të gjitha religjionet vërtetojnë se prostitucioni është krim, vetëm Islami në atë aspekt shkoi më larg: ai cakton masa për pakësimin e sprovimeve. Lehtë është të shpresojmë se çdokush do ta përsos moralin e vet, të aftësohet t'u rezistojë sprovave; vetëmse, a nuk është më e logjikshme të pakësohen rrethanat që njerëzit të

jenë me vullnet të dobët – e të tillë janë shumica e njerëzisë – dhe sidomos kur të hyhet në luftë, e cila është e humbur që në fillim.

Për atë Kur’ani (33:59) më parë këshillon që femrat t’i veshin ferexhet e veta, që të pakësohet tërheqja e vëmendjes dhe të mbrohen femrat nga marrëzia joshëse e meshkujve, sikurse që e sqaron ajeti. Pastaj vjen Shpallja (24:30,31) mbi sjelljen në shtëpi ndaj miqve dhe vizitorëve: “Por, thuaju besimtarëve të ulin kryet (shikimet e tyre) dhe të kujdesen për pjesët e turpshme të trupit të tyre. Ajo është punë më e pastër për ata, kurse Allahu është, me siguri, i informuar se ç’bëjnë ata. Thuaju edhe besimtareve le të ulin kryet dhe të kujdesen për pjesët e turpshme të trupit të tyre dhe le të mos i ekspozojnë stolitë e tyre, përveç asaj që edhe ashtu është e jashtme (duket). Le t’i mbulojnë kraharorët e tyre me mbulesa dhe të mos ia tregojnë zbukurimet e tyre askujt...”. Në çdo epokë të historisë islame, duke e marrë edhe kohën e Pejgamberit (a.s.), shohim se si muslimanet marrin pjesë në të gjitha profesionet që iu përgjigjen. Ato kanë punuar si motra medicinale, si mësuese, bile edhe si luftëtare, bashkë me meshkujt.

Kur’ani këtij bashkëpunimi i jep vend të duhur. “Edhe një argument tjetër i Tij është se Ai, nga lloji juaj, krijon bashkëshorte që të gjeni prehje pranë tyre dhe ndërmjet jush mbjell dashuri dhe mëshirë...” (Kur’an, 30:21). Mashkulli dhe femra e plotësojnë njëri-tjetrin (Kur’an, 2:187); në interesin e tyre, pra, është që të nderohen mes vete, mirëpo si dy qenie të pavarura nuk mund të pajtohen krejtësisht; për atë, në interes të kurorës dhe të marrëveshjes më të mirë, në

familje të bëhen lëshime. Këshilla e Kur'anit (4:19), drejtuar meshkujve për sjelljen ndaj grave të tyre, çon në mendim: "...çoni jetë të mirë me to! Po, nëse ndjeni neveri ndaj tyre, ndoshta do të neveriteni nga ajo, për të cilën Allahu jep dobi të shumta". Në realitet, sa jemi të urtë, duhet të bëjmë lëshime më tepër, veçanërisht nëse jemi edhe më të fuqishëm.

Zakonisht njeriu dëshiron të martohet me atë femër që e do, vetëmse dashuria e ka historinë e pikëllueshme në analet e njerëzimit. Shkaqet e dashurisë, apostafat te të rinjtë, shpesh janë fantastike dhe afatshkurtra; një shikim, lëvizja e syve, frizura, një gjest i thjeshtë... dhe drama fillon! Muhamedi (a.s.) në lidhje me këtë dha një këshillë të urtë: "Mos u martoni vetëm për bukurinë, se ajo mund të jetë shkak për degradimin moral; mos u martoni për pasurinë, ajo mund të jetë shkak për mosmarrëveshje familjare; martohuni me dëshirë dhe me besimtare të vërtetë". (Ibn Maxhe, Nr. 1859). Pasi që Islami i rregullon të gjitha fushatat e jetës, kuptohet se ai që me kujdes iu përmbahet detyrave fetare është i aftë të krijojë qetësinë në shtëpi. Në një rast tjetër Muhamedi (a.s.) tha: "Kjo botë është kalimtare, të cilën e shfrytëzojmë përkohësisht; në këtë botë kurgjë nuk është më e rëndësishme se sa të kesh grua të ndershme". (Ibn Maxhe, 1855). Termidhiu dhe Nesaiu përmendin edhe një thënie të Muhamedit (a.s.): "Besimtar më i përsosur është ai që ka karakter të përsosur dhe ai që sillet mirë me gruan".

Siç përmendëm, Islami i jep rëndësi të veçantë moralit. Sipas Kur'anit, nëse njeriu frikësohet nga im-

oraliteti i gruas së vet, lypset më parë ta qortojë, pastaj ta largojë prej shtrati, e më në fund mund ta dënjojë, por jo shumë ashpër. Nëse nuk ka mënyrë që të përmirësohet, atëherë mbetet shkurorëzimi. E, “prej veprave të lejuara, Allahu shkurorëzimin e ka shumë mërzi”, siç tha Pejgamberi (a.s.). Obligimi i besnikërisë është reciprok. Më tutje, Kur’ani (4:128, 130) cek se gruaja nëse dyshon në besnikërinë e burrit, lypset që të mundohet ta përmirësojë situatën dhe, në fund, ajo mund të lyp prej gjykatësit shkurorëzimin.

Mirëpo, mirëkuptimi lyp lëndime identike. Mendimet e ngjashme nganjëherë realizohen spontanisht, kur burri dhe gruaja vijnë në përfundim të përbashkët; mirëpo, nganjëherë njëri prej tyre patjetër duhet të lëshojë pe, duke u larguar nga mendimi i vet. Vetëmse, të lëshuarit pe ka kufi. Të mos habitemi se Muhamedi (a.s.) caktoi: “Nuk duhet t’i nënshtrohesh njeriut duke bërë mëkat ndaj Allahut”. Mund të bëhen lëshime në ca raste, me kusht që ky lëshim të mos dëmtojë detyrat fetare; sidomos ndalimet nuk mund të ndërrohen (të preken).

Një gjë Muhamedi (a.s.) gjithmonë e ka pasur në zemër dhe shpesh e përmendte: “Ngjashmëria mes gjinive me anë të të folurit, të veshurit, të flokëve etj. janë sjellje të ndaluara; duhet të sillemi sipas ligjit natyror e jo kundër tij. Nëma e Allahut do ta godet çdo njërin që e shkel këtë udhëzim”.

Të drejtat e gruas

Arabët para Islamit në pikëpamje të personalitetit femrës i dhanë më pak rëndësi sesa mashkullit. Në rastet kur mashkulli ishte fajtor e femra viktimë, nuk ka mundur të vinte deri te dënimi. Kur'ani e eliminoi këtë pabarazi; kundërvajtja e femrës konsiderohet njësoj si e mashkullit, përsa i përket personalitetit, nderit dhe karakterit. Bile, mund të thuhet se në ca raste të drejtat e femrës janë më të mëdha. Sipas asaj që urdhëron Kur'ani, ata që e paditin një gura për imoralitet, duke mos pasur fakte, ata jo vetëm që dënohen, por përgjithmonë humbin të drejtën që të dëshmojnë para gjyqeve. Kaq, e të mos përmendim dënimin në atë botë. Pendimi i fshin mëkatet në kuptimin eskatologjik po qe se njeriu pendohet, mirëpo kjo nuk ia kthen të drejtën e të dëshmuarit. Si duket Kur'ani tenton ta sigurojë shoqërinë nga dëshmitë e pakujdesshme, veçanërisht kur shpifjet lehtë shprehen e rëndë mohohen.

Pozita e gruas manifestohet jashtëzakonisht në çështjet e pasurisë personale. Sipas ligjit islam, gruaja ka të drejta të plota në pasuritë e saj. Nëse është e moshës së rritur, ajo atë mund ta përdorë pa ndërhyrje të ndokujt: babës, vëllait, burrit, djalit etj. Për këtë nuk ka kurrfarë dallimi mes mashkullit dhe femrës. Nëse burri, babai ose i afërmi i femrës zhytet në borxh, pasuria e saj ngel e paprekur (nuk mund të marrin pa lejen e saj për të paguar borxhet); askush tjetër nuk

përgjigjet për të (për borxhin). Ajo ka të drejtë të fitojë sikur burri, ka të drejtë trashëgimie, të marrë duratë, ose të fitojë duke punuar me mjeshtëritë e saj. Fitimi është kryekëput i saj. Ajo ka të drejtë të shet, të përdorë pasurinë e vet në punë të lejuara sipas dëshirës së vet. Në çdo rast, të drejtat e saj janë të patjetërsueshme: nuk ka nevojë të fitojë me kontrata të veçanta (mes saj dhe burrit) ose koncesioneve që varen nga personi i tretë.

Ligji mbi trashëgiminë lyp ca sqarime. Para Islamit, femra arabe nuk ka pasur kurrfarë të drejtash në trashëgim: as prej babës e as prej burrit. Pejgamberi (a.s.) nuk ka menduar për këtë problem në 15 vitet e para të misionit të vet. Kronologët shënojnë se në vitin e tretë të Hixhretit një pasanik prej Ensarëve, Evs ibn Thabiti, vdiq dhe pas vete la gruan dhe katër vajza të mitura pa trashëgim. Sipas adeteve të vjetra medinase, vetëm mashkulli i moshës së rritur dhe i aftë për luftë, në rast të nevojës, ka pasur të drejtë trashëgimi. (Bile, edhe djali i mitur nuk kishte të drejtë në pasurinë që ia linte baba i tij). Të afërmit e të vdekurit merrnin të gjithë atë që mbetej pas tij, kështu që familja mbetej pa mjete për jetesë.

Kur u shpall teksti i Kur'anit që proklamoi ligjin mbi trashëgiminë, këtë e shfrytëzuan më vonë jo vetëm muslimanët, por edhe bashkësitë tjera (si të krishterët në Siri dhe në Liban). Sipas atij ligji (Kur'an, 4:7 – 12 dhe 4:176), të afërmit e gjinisë femërore, sidomos gruaja, vajza, nëna, motra fitonin të drejtën e trashëgimit. Në pikëpamje të trashëgimit nuk ka kurrfarë dallimi mes të gjërave të tundshme dhe të patund-

shme: të gjithat ndahen ndërmjet trashëgimtarëve ligjorë. Për të evituar keqpërdorimet, Islami kujdeset që me testament të mos dëmtohen kushërinjtë më të afërt, në dobi të të huajve. Pra, trashëgimtarët nuk ka nevojë të caktohen në testament, ata automatikisht kanë të drejtën e trashëgimit. Testamenti nuk mund t'i pakësojë as t'i shtojë të drejtat e trashëgimit të kushërinjve; këto të drejta i garanton dhe i cakton vetë ligji. Testamenti vlen vetëm për të huajt, për ata që nuk kanë të drejtë trashëgimi në pasurinë e të vdekurit. Islami caktoi që më së shumti një e treta e pasurisë mund të lihet me testament, kurse dy të tretat tjera patjetër iu takojnë kushërinjve më të afërt. Testamenti i shkruar kundër kësaj rregulle nuk është i plothuqishëm, në përjashtim nëse trashëgimtarët pajtohen me të.

Ligji mbi trashëgiminë është shumë i ndërlikuar, pasi që të drejtat e trashëgimtarëve dallojnë varësisht prej rrethanave, p.sh. a thua trashëgon vetëm një vajzë apo vajza dhe djali; vetëm nëna apo bashkë me vëllanë, me babën apo me ndonjë fëmijë të të vdekurit; për çdo rast pjesëmarrja ndryshon. Ne këtu nuk kemi për qëllim të japim përshkrimin e detajuar të këtij ligji. Të përmendim vetëm atë që i takon femrës: ajo si bashkëshorte trashëgon të tetën, nëse i vdekuri ka fëmijë; e nëse jo, atëherë trashëgon të katërtën. Vajza nëse është e vetme, ajo pranon një të gjashtën. Motra nuk trashëgon nëse i vdekuri ka lënë fëmijë meshkuj; nëse është e vetme, ajo ka të drejtë në gjysmën. Më shumë motra ndajnë në mes vete dy të tretat; e nëse i vdekuri ka lënë pas vete një vajzë, motra pranon një

të gjashtë; nëse ka lënë një vëlla, ajo pranon gjysmën e asaj që pranoi i vëllai. Ka ca dallime mes motrave prej babës, motrave prej nënës dhe atyre që kanë të njëjtin babë dhe nënë.

Nuk është e tepërt të cekim ca dallime në këtë ndarje mes motrës dhe vëllait, babës dhe nënës, djalit dhe vajzës. Këtu nuk punohet për ndonjë pabarazi parimore apo për diskriminim të padrejtë. Duhet sqarim që të argumentohet se kjo pabarazi bazohet në shkaqe të arsyeshme. Si duket, legjislatura këtu ka vëzhguar të drejtat e femrës në përgjithësi, e jo ndaras së drejtës mbi trashëgiminë; e të mos llogarisim para saj se ligji ka parasysh rastet më normale në jetë dhe përjashtimet jo të rralla (për disa prej këtyre janë paraparë masa të jashtëzakonshme). Pra, ne përmendëm më lart se femra posedon pasuri më vete, në të cilën as baba, as nëna, askush tjetër nuk kanë të drejtë mbi të. Por, më tepër në këtë autonomi ajo ka të drejtën e furnizimit (të ushqimit, të veshmbathjes dhe të banimit), për të cilat gjyqi e obligon babën, burrin, djalin etj. Përveç kësaj, gruaja pranon prej burrit *mehrin* (shumë e kontraktuar, e cila para Islamit i është dhënë babës së femrës). Mehri nuk është miraz, sepse ai nuk është i obliguar, kurse pa mehr kurora juridikisht është e pavlefshme. Në rrethana të këtilla, është e arsyeshme që mashkulli të ketë të drejtë trashëgimi më tepër se femra. Shihet se femra ka më pak obligime materiale, e burri më tepër. Kuptohet se një familje e lirë ka nevojë për bashkëpunim: gruaja gjithashtu punon që t'i shtojë të ardhurat familjare, ose bile t'i pakësojë harxhimet, në raste kur ajo nuk është e

punësuar jasht shtëpisë: mirëpo, ne flasim mbi të drejtat e femrës, e jo mbi çështjet shoqërore, të cilat dallojnë varësisht nga personi. E drejta mbi furnizimin e gruas në Islam shkon deri atje që, sipas ligjit, gruaja nuk është e obliguar të ushqejë fëmijën e vet personalisht: për babën e fëmijës është obligim që të sigurojë ushqim me të hollat e veta nëse gruaja nuk dëshiron t'i japë gji.

Në fund, të themi diçka mbi kurorën, e cila gjithashtu parashtron shumë pyetje. Kurora në Islam është kontratë reciproke, e themeluar në pajtim të plotë mes të dy palëve të kontraktuara. Prindërit sigurisht iu ndihmojnë fëmijëve të tyre, duke i këshilluar para zgjedhjes së bashkëshortit; vetëmse fjalën e fundit, prapëseprapë, e kanë të interesuarit. Këtu, sipas dispozitave ligjore, nuk ka dallim mes mashkullit dhe femrës. Praktika e kundërt ndryshon sipas vendeve dhe klasave, mirëpo ligji nuk njihet adet që është në kundërshtim me rregullat.

Është fakt se poligamia është e lejuar; edhe aty ligji islam është më elastik dhe më i përshtatshëm ndaj nevojave të shoqërisë, përkundër ligjeve të Evropës, të cilat në asnjë mënyrë nuk e lejojnë atë. Të marrim një shembull, i cili mjerisht nuk është i shpikur; një grua e cila ka fëmijë, sëmuret nga një sëmundje e pashërueshme, që ia bën të pamundur të merrret me punët e shtëpisë, ndërsa burri nuk është në gjendje të gjejë ndokend për t'i kryer punët e shtëpisë (të mos përmendim se ai ka nevojë për jetë normale bashkëshortore). Ç'të bëhet? Të themi tash se e sëmurra pajtohet që burri i saj të marrë një burrë tjetër dhe

se gjendet gruaja që pranon të martohet me këto kushte... Mirëpo jo: ligji perëndimor këtu do të pranojë cilëndo zgjidhje jonormale para se të lejojë një kurorëzim legal, i cili do t'i sillte fat një familjeje të mjerë.

Në realitet, ligji islam është më afër arsyes: ai e lejon poligaminë nëse vetë gruaja pajtohet me atë mënyrë të jetës. Ligji nuk e detyron poligaminë, por e lejon në raste të veçanta. Ne thamë se ajo pikërisht varet nga pajtimi i gruas - si të parës, ashtu edhe të dytës; kuptohet që gruaja e dytë mund të refuzojë të bëhet bashkëshorte e atij që është i martuar. Gjithashtu, pamë se gruaja nuk mund të detyrohet për martesë pa pëlqimin e vet. Nëse ndonjë grua pajtohet me të, nuk duhet të fajsohet ligji, ose të akuzohet se është i ashpër ose i padrejtë ndaj gruas dhe se më tepër anon kah mashkulli. Përsa i përket gruas së parë, poligamia varet kryesisht prej saj: para martesës ajo mund të lypë që bashkëshorti i saj të mbetet monogamist. Ky kusht në dispozitat ligjore mbetet i vlefshëm si çdo kusht i një kontrate ligjore. Nëse një grua nuk dëshiron ta shfrytëzojë këtë të drejtë, legjislatura nuk e ka për detyrë ta detyrojë. Ne pikërisht bëmë fjalë në dy rastet e veçanta - vetëmse, është detyrë e ligjit që të kthehet në to dhe të gjejë zgjidhje të mundshme. Poligamia as rastësisht nuk është rregull, por përjashtim, mirëpo përjashtim i cili ka përparësi të shumëfishta sociale dhe të tjera, për të cilat këtu nuk mund të flitet. Këtë përshtatshmëri të rrethanave ligji islam e konsideron përparësi të madhe të veten.

Në ligjet e vjetra fetare nuk ka ekzistuar kurrfarë kufizimi i grave që ka mundur t'i martojë një mash-

kull. Pejgamberët e Dhiatës së Vjetër kanë qenë poligamistë dhe brenda krishterizmit – i cili sot ekskuluzivisht lidhet me idenë e monogamisë – teologët eminentë Luter, Melengton, Buser etj. (shih *Leksikoni i Biblës*, teksti “Poligamia”) nuk kanë nguruar që prej tregimit mbi “Dhjetë vejushat” (Shën Mateu, 25:1-12), ku Isai (Krishti) përmend shembullin e një njeriu që u martua me dhjetë gra në të njëjtën kohë, të konkludojnë se poligamia është e lejuar. Nëse të krishterët nuk duan të shfrytëzojnë lejen të cilën, siç shihet, e jep religjioni i tyre, kjo nuk do të thotë se duhet të ndërrohet ligji. Mbi teorinë dhe praktikën krishtere lexuesi më së afërmi mund të informohet nga *Encyclopedia Britannica*, kap. “Kurora” dhe “poligamia” ose nga libri i Vestmarkut “Historia e kurorës” (në frëngjisht e përkthetur A.Venngennep).

Ligji islam gjithmonë ka njohur mundësinë e anulimit të kurorës. Ky anulim bëhet në mënyra të ndryshme. Me vendimin e njëres anë, burri ka të drejtë të shkurorëzohet, gruaja gjithashtu mund ta shfrytëzojë atë të drejtë në çastet kur vë kurorën. Përveç kësaj, gjyqi mund t’i shkurorëzojë bashkëshortët në bazë të padisë së gruas (nëse nuk është vendosur në momentin e kurorëzimit e drejta e vetëvendosjes), kur burri nuk është në gjendje t’i plotësojë detyrat e kurorës ose vuan nga ndonjë sëmundje tejet e rëndë, nëse humbet dhe nuk le kurrfarë gjurmësh pas vete vite me radhë etj. Ekziston gjithashtu shkurorëzimi në bazë të vetëvendosjes së përbashkët, kur të dy japin pëlqimin për prishjen e kurorës. Kur’ani (4:35) tenton që bashkëshortët t’i shuajnë mosmarrëveshjet e tyre para se të ve-

ndosin të shkurorëzohen në mënyrë të arsyeshme. Është e njohur shumë mirë thënia e Muhamedit (a.s.): “Prej veprave të lejuara, Allahu më shumë e urren shkurorëzimin”. Ligji dhe etika plotësojnë njëra-tjetrën, sepse burimin e kanë të njëjtë, e ato janë Kur’ani dhe Hadithi.

Këto janë elementet karakteristike të pozitës së gruas sipas ligjeve islame.

Kreu XII

Pozita e jomuslimanëve në shtetin islam

Është e natyrshme që njeriu paraqet ndarje, bile një dallim, mes të afërmve dhe të largëve, kushëritit dhe të huajit. Me zhvillimin intelektual dhe moral të bashkësisë njerëzore hetohet tendenca që të lehtësohen asimilimi i të huajve. Nëse një bashkësi themelohet vetëm në fafesisin e gjakut, natyralizmi i të huajve përgjithmonë është i ndërprerë. I njëjti rast ndodh nëse ajo bazohet në ngjyrën e lëkurës. Nëse gjuha është bazë, për t'u futur në bashkësi janë të nevojshme shumë vite depërtim. Përsa i përket vendit të lindjes, kjo nuk është duke e humbur rëndësinë e vet qëkur njeriu e kaloi kufirin e shtetit - qytet të vet. Duhet të përmendim se në të gjitha këto konceptione të bashkimit shoqëror, të gjitha themelet varen në ndodhitë e rastit, që të ruajnë reflekset të cilat janë më të afërta me instinktet e shtazëve sesa me mendjen njerëzore. Islami i hodhi poshtë këto koncepte si të vjetëruara dhe u përcaktua për bashkësinë e ideve – diçka që varret nga njeriu e jo nga rasti i lindjes – si lidhje shoqërore dhe arsyetim i lidhshmërisë. Kuptohet që asimilimi dhe pranimi në një bashkësi të tillë (të bazuar në idenë) janë të lehta dhe të përshtatshme për të gjitha racat njerëzore; gjithashtu, më afër mendjes dhe praktikës për të jetuar në paqe dhe harmoni.

Nëse besimtari ose ndonjë kapitalist konsiderohet si i huaj në shtetet komuniste, zezaku në shtetet e të

bardhëve, ku praktikohet diskriminimi shoqëror ose joitaliani në Itali, nuk do të duhej të paraqiste befasi nëse jomuslimani konsiderohet i huaj në vendin e Islamit. Konceptionet, ose më para këndet e vështrimit, dallohen, por megjithatë, secili bën një dallim të këtij ose të atij lloji mes të atyre që i takojnë grupit të vet dhe atyre që nuk i takojnë atij grupi.

Si çdo sistem tjetër politik ose shoqëror, edhe Islami bën dallimin mes të vetëve dhe të huajve, por përmes dy karakteristikave:

1. Lehtësia në kalimin e pengesave, e cila i përshkruhet ideologjisë së tij, dhe

2. Jobarazia e parëndësishme mes atyre dy kategorie njerëzish në çështjet e kësaj bote.

Ne do të mundohemi të paraqesim tani problemet e aspektit të fundit.

Burimi hyjnor i detyrave

Nuk guxojmë të harrojmë rëndësinë e madhe praktike të fakteve se muslimanët i nënshtrohen sistemit të ligjit të tyre, duke e ditur se kjo e ka burimin nga Allahu (xh. sh.) e jo nga vetë dëshira e shumicës së liderëve të shtetit. Në rastin e fundit, pakica hyn në luftë se si të mbizotërojnë konceptionet personale. Në demokracitë e kohës sonë, shumica jo vetëm që ndryshojnë prej zgjedhjeve në zgjedhje, por gjithashtu konstituohen ose shpartallohen përmes ndërrimeve dhe kombinimeve të ndryshme, ndërsa partia në pushtet

orvatet të nxijë politikën e paraardhësve të saj, duke sjellë përveç ndryshimeve tjera, edhe përfundimin e ligjit. Duke mos hyrë këtu në çështjen e përshtatshmërisë së ligjeve islame, nevojave të zhvillimit shoqëror, mund të konsiderohet si e vërtetë e pakontestueshme se ekziston stabilitet më i madh i drejtësisë muslimane – ngase ajo e ka burimin tek Allahu – se çfarëdo legjislature tjetër botërore me pasojat gjegjëse.

E drejta islame urdhëron drejtësinë dhe mbajtjen e disa rregullave në raport me jomuslimanët. Ata, prandaj, nuk ndjejnë kurrfarë frike para mosmarrëveshjeve politike dhe zgjedhjeve parlamentare në shtetin që jetojnë, duke marrë parasysh ligjet islame që janë në fuqi. Sunduesi e as paramenti nuk mund t'i modifikojnë ato.

Parimet themelore

Besimtarët dhe jobesimtarët nuk mund të jenë të barabartë: por, kjo është në atë botë. Për sa i përket kësaj jete, juristët muslimanë gjithmonë kanë kërkuar barazinë e mundshme më të madhe (sa mund ajo të realizohet) mes “të vetëve” dhe “të huajve”, sikurse që do të shohim.

Parimi i parë është tolerimi fetar: Kur’ani, 2:285, ka paraparë që të mos bëhet kurrfarë dhunimi në fe. Nënshetasve dhe atyre që përkohësisht jetojnë aty iu është siguruar qetësia dhe liria e ndërgjegjes.

Përveç kësaj, ekziston edhe koncepti mbi mikpritjen dhe dhënien e azilit, teori e vërtetuar me prakti-

kën mijëvjeçare. Është i njohur qëndrimi i Kur'anit (9:6): "Nëse një pagan të lyp strehim, ti ofroji surehim... pastaj përgatite në vendin e tij të sigurt". Viktimat e ndjekjeve të luftës, ndjekjeve religjioze, politike etj. gjithmonë kanë gjetur vendstrehim në shtetin islam. Sa mësim i prekshëm, madje e tmerrshme, është urdhëresa që muslimani duhet të bashkëpunojë, madje, edhe me armikun në gjendje të luftës! Kur'ani Famëllartë (5:2) thotë: "Urrejtja kundër atyre që nuk ju kanë mundësuar të hyni në Xhaminë e pacenueshme (Qabe) të mos ju shtyjë në dhunë, por ndihmoni njëri-tjetrin në mëshirë dhe devotshmëri (*takva*). Mos ndihmoni njëri-tjetrin në mëkate e armiqësi. Shikoni! Allahu është i rreptë në dënime". Ndihma reciproke nuk duhet të jetë e kufizuar vetëm te muslimanët, por te mbarë njerëzimi, pa marrë parasysh fenë dhe racën.

Praktika e Pejgamberit (a.s.)

Kur e vendos Muhamedi (a.s.) në Medine, aty gjeti një çrregullim të plotë. Medina kurrë nuk e ka njohur shtetin e as sunduesin që do të bashkonte fiset e përçara nga luftërat e brendshme. Vetëm për ca javë ai bashkoi banorët e kësaj ane, themeloi qytetin – shtet, në të cilin, si me një kontratë shoqërore, do të marshonin muslimanët, hebrenjtë, idhujtarët dhe, me siguri, të krishterët, numri i të cilëve në këtë qytet ishte shumë i vogël.

Kushtetuta e këtij shteti të parë “islam” – që patjetër duhej të ishte konfederatë për shkak të shumë kombësive – është ruajtur plotësisht; ne këtu lexojmë këtë paragraf: “Muslimanëve feja e tyre, hebrenjve feja e tyre...”. Ose: “...midis tyre le të jetë dhembshuria dhe drejtësia...”. Gjithashtu, qëndrimi më pak i pritur: “Hebrenjtë janë një bashkësi me besimtarët” (sipas versionit të Ibn Hishamit), respektivisht “një bashkësi e cila është pjesë përbërëse e besimtarëve” (sipas versionit të Ibn Nuajdës).

Fakti se pas themelimit të qytetit – shtet vendbanime të pavarura të hebrenjve vullnetarisht iu bashkangjitën shtetit konfederal dhe e pranuan Muhamedin (a.s.) për kryetar suprem e politik, kjo çon, sipas mendimit tonë, në përfundimin se jomuslimanët në shtetin musliman marrin pjesë në zgjedhjen e shefit të shtetit.

Obligimi ushtarak, sipas dokumenteve për këtë çështje, ka të bëjë me të gjitha fraksionet e popullit, duke përfshirë edhe hebrenjtë, që nënkupton edhe pjesëmarrjen e tyre në këshillimet dhe në realizimin e planeve të përvetësuar.

Në realitet, paragrafi 37 përshkruan: “Hebrenjtë do t’i mbajnë shpenzimet e veta, muslimanët të vetat, e nëse ndonjë agresor i sulmon nënshkruesit e këtij Dokumenti, paragrafi 45 thotë se lufta dhe paqja do të jenë të pandara për nënshkruesit e këtij dokumenti”.

Ca muaj pas themelimit të këtij shteti – qytet shohim se Muhamedi (a.s.) nënshkroi kontratat për lidhjen e mbrojtjes dhe ndihmën reciproke me paganë arabë nga afërsia e Medines, prej të cilëve disa pranuan Islamin pas dhjetë vjetësh. Gjatë tërë kësaj kohe be-

simi mes vete ishte i plotë, për të cilën dëshmon ngjarja që vijon: Vitin e dytë sipas Hixhretit, paganët e Mekës kanë dërguar një mision diplomatik në Abisini, duke lypur nga Nexhashiu “dorëzimin” e muslimanëve të strehuar në shtetin e tij. Që ta pengojë këtë ngatërresë, Pejgamberi (a.s.) gjithashtu e dërgoi atje deputetin që të angazhohet te Nexhashiu në dobi të muslimanëve që kishin gjetur vendstrehim tek ai nga ndjekjet fetare të bashkëqytetarëve të tyre. Deputet ishte Amër ibn Umejje ed-Damirij, “i cili ende nuk e kishte pranuar Islamin”. Në të vërtetë, ai i takonte njërit prej fiseve aleate në afërsi të Medines.

Në periudhën në të cilën gjithmonë janë zhvilluar luftërat gjatë kufijve të gjerë të territorit islam, shërbimi ushtarak ishte larg asaj që të jetë profesion rentabël: rreziku për jetë dhe për situatën ekonomike të familjes e luanin rolin e vet. Edhe pse lirimi i nënshtetasve jomuslimanë nga lirimi ushtarak ishte i motivuar me mosbesim, të gjithë jomuslimanët që ishin pajtuar me sundimin musliman dhe që nuk bashkëpunonin me të huajt përfitonin dobinë që të liroheshin nga shërbimi ushtarak; kjo u bëri të mundshme që në paqe të merren me punët e veta dhe të ruajnë pasurinë e tyre, ndërsa muslimanët ndërmerrnin çdo rrezik të obligimit ushtarak. Prej jomuslimanëve lypej një tatim i vogël plotësues, xhizja, prej së cilës gratë, të miturit dhe jomuslimanët e varfër ishin të liruar. Ky tatim nuk ishte as i madh, as i padrejtë. Në kohën e Pejgamberit (a.s.) sillej afërsisht 10 derhem në vit, që përfshinte harxhimet e një familje mesatare për dhjetë ditë. Në rast se një shtetas jomusliman ka marrë pjesë

në shërbimin ushtarak gjatë ndonjë aksioni, ai lirohej nga pagesa e xhizjes për atë vit. Ca fakte tregojnë karakterin e vërtetë të këtij tatimi.

Në fillim të Islamit kjo taksë nuk ekzistonte në shtetin islam, as në Medine e askund tjetër. Kur'ani atë e parasheh në vitin IX të Hixhretit. Kjo ka të bëjë me mjetet e nevojshme, e jo me një urdhëresë fetare të Islamit. Se është e tillë, dëshmojnë faktet që vijojnë: kur një egjiptas, jomusliman, pushtetit musliman i ka sjellë planin për hapjen e kanalit prej Kajros gjer te Deti i Kuq (që do ta lehtësonte transportin e prodhimeve ushqimore nga Egjipti në Medine, Emirul Muëminin e njohur, Halifi Omer e shpërbleu atë egjiptas duke e liruar nga pagesa e xhizjes për tërë jetën. Këtij fakti juristët i shtojnë edhe argumentin e drejtësisë, ose, më mirë të themi, të arsyes së shëndoshë: në ditën e sotme, kur Islami ka depërtuar në tërë botën dhe kur miliona muslimanë jetojnë nën sundimin e jomuslimanëve, xhizja e cila do t'u imponohej të krishterëve, hebrenjve, hindusëve dhe të tjerëve që jetojnë në territorin islam, do të kishte reperkusionet e veta në pozitën e muslimanëve që jetojnë në shtetin jomusliman, sidomos në shtetet e atyre që i takojnë së njëjtës fe, të paguajnë xhizjen si ata.

Pejgamberit (a.s.) kur ishte i shtrirë në shtratin e vdekjes, i përshkruhet direktiva që populli hebre e i krishterë të shpërngulen prej Hixhazit në vende të tjera. Tradita nuk na e përmend tekstin, por kuptohet se direktiva kishte të bënte vetëm me disa grupe të atyre bashkësive fetare të motivuara nga qëndrimet e tyre politike e se ajo nuk ishte intradiktë që e godiste

bashkësinë në përgjithësi. Të përkujtojmë që në kohën e halifit kishte robër jomuslimanë, gra e burra, të cilët iu takonin muslimanëve dhe jetonin me zotërinjtë e tyre në Meke e në Medine; ose rasti i mjekut të krishterë, i cili kishte ordinancën e vet nën minaren e xhamisë së Kubas në kohën e halifëve ortodoks (p.sh. Daut ibn Abdurrahman; Dauti ishte musliman, ndërsa babai i tij, Abdurrahmani, deri në vdekje mbeti i krishterë – siç përmend Ibn Sa’di).

Të përkujtojmë dhe një direktivë të Pejgamberit (a.s.) në shtratin e vdekjes: “Gjithmonë me vëmendje t’i përmbaheni mbrojtjes, të cilën e kam praktikuar ndaj delegatëve jomuslimanë” (thekson Mavurdi). Një thënie tjetër e Pejgamberit (a.s.) thotë: “Nëse dikush shtyp nënshtetasit jomuslimanë, unë do të jem mbrojtës i tyre në Ditën e Gjykimit (kundër muslimanëve shtypës)”.

Kuptohet që udhëzimet dhe praktika e Pejgamberit (a.s.) për muslimanët paraqet ligjin më të lartë. Sikur të dimë se si janë zbatuar ato ligje në praktikë edhe në jetën e muslimanëve më vonë, do të jetë e dobishme të shërbehemi me të dhënat historike.

Praktika e mëvonshme

Një guvernator i halifit Omer për sekretar të vet kishte emëruar një jomusliman: si e dëgjoji këtë risi, halifi urdhëroi që ta zëvendësojnë me musliman. Kjo ngjau në periudhën kur ajo provincë ende nuk ishte

qetësuar, derisa lufta vazhdonte. Ai mosbesim ndaj “të huajit”, i cili u vendos në një nga vendet më me rëndësi të shtetit të posafiturar, ishte krejtësisht e arsyeshme; ndërsa për qëndrimin e halifit Omer mund të gjykohet pasi të dihet rasti tjetër nga jeta e tij (e shënoi Baladhuri, Ensab): Një ditë ai i shkruan letër guvernatorit të tij në Siri: “Na e dërgo një grek, i cili mund të na i rregullojë llogaritë e të ardhurave’. Dhe, një i krishterë u vendos në krye të administratës në Medine!

Gjithashtu, shihet që halifi i ka konsultuar jomuslimanët për një varg çështjesh ushtarake, ekonomike dhe administrative.

Muslimanëve nuk mund t’u përhiqet vërejtja se e kanë rezervuar pozitën e shefit të shtetit vetëm për vete. Islami kërkon të harmonizojë të gjitha aspektet e jetës, si shpirtërore, ashtu edhe materiale. Prirja e namazit në xhami është një prej detyrave të shtetit. Duke pasur këtë parasysh, do të jetë lehtë të kuptohet se pse jomuslimanët nuk mund të zgjidhen si shef i shtetit islam.

Mirëpo, ky përjashtim nuk do të thotë përjashtim i jomuslimanëve nga jeta politike e administrative e vendit. Prej kohës së halifit e gjer më sot shihet që jomuslimanët kanë marrë pozitat e ministrave në shtetet islame; praktikë e ngjashme nuk është regjistruar në demokracitë laike të Perëndimit, ku shtetasit muslimanë nuk e kanë këtë privilegj. Angazhimi i jomuslimanëve në punët shtetërore në asnjë rast nuk është kundër mësimëve islame, të cilën gjë haptazi e tregojnë veprat klasike: juristët e Shafiive (si Maverdi) dhe Hanbelij (si Ebul-Ala el-Ferra) nuk u luhatën që

të përmbajnë halifin për të emëruar shtetas jomuslimanë si ministra ose si anëtarë të kryesisë së Këshilltarëve. Ne folëm për deputetin jomusliman, të cilin Pejgamberi (a.s.) e dërgoi në Abisini.

Autonomia shoqërore

Ndoshta vija më karakteristike e Islamit, në qëndrimin e tij ndaj jomuslimanëve, është privilegji që ua jep në formë të autonomisë shoqërore dhe juridike. Në një pjesë të gjatë të Kur'anit mund të lexojmë: "Dhe, si do të të drejtohen ty ata (hebrenjtë) që t'i gjykosh, kur ata e kanë Tevratin, ku janë ligjet e Allahut dhe pas kësaj ta kthejnë shpinën ty. Ata s'janë besimtarë. Ne e Shpallëm Tevratin, ku udhëzimi vërtet është në rrugë të ndritshme. Sipas tij e gjykojnë popullin hebre peygamberët që nuk i janë dorëzuar Allahut, por dhe dijetarët e fukarenjtë (gjykonin) sipas asaj që kanë ruajtur nga librat e Zotit, për të cilën kanë dëshmuar se është e vërtetë. Mos iu frikësoni njerëzve, por vetëm Mua të ma kini frikën. Dhe, mos i blini dëshmitë e Mia me çmime të lira. Kush nuk gjykon me atë që e zbriti Allahu, ata janë pabesimtarë... Ne atyre ua kemi dërguar Isanë, djalin e Merjemes, duke e vërtetuar Tevratin që e kanë në duar dhe i dhamë atij Inxhilin, ku është udhëzimi i vërtetë dhe drita, vërtetim i Tevratit që ata e kanë në duar dhe udhëzim për rrugën e vërtetë dhe këshillë për atë që ka frikë Zotin. Le të gjykojnë pasardhësit e Inxhilit ashtu si e Shpalli

Zoti. Dhe, kush nuk gjykon ashtu si e Shpalli Zoti, ai u takon mëkatarëve të vërtetë. Ne ty (o Muhamed) ta zbritëm Librin më të vërtetë, duke vërtetuar atë që të ka zbritur prej Allahut, dhe mos shko pas dëshirave të tyre që të mos shmangesh nga e vërteta që të zbriti ty. Për çdokend kemi zbritur Ligjin dhe udhëzimet. Sikur të donte Zoti, juve do t'ju bënte si një popull, mirëpo ai deshi t'ju provonte me atë që ju zbriti (se a do t'i përmbaheni asaj), prandaj ju bëni gara në veprat e mira. Ju do t'i riktheni Allahut dhe Ai do t'ju shpjegojë atë për të cilën ju jeni ndarë" (Kur'an, 5:43 – 48).

Në bazë të këtij urdhri, Pejgamberi (a.s.) dhe pasardhësit e tij çdo bashkësie jomuslimane në përbërje të shtetit islam i kanë siguruar autonomi juridike, jo vetëm për çështjet e statusit personal, por edhe në çdo punë shoqërore: civile, ndëshkimore e të tjera. Në kohën e halifëve ortodoksë, p.sh. hasim në tregimet e bashkëkohësve të krishterë, të cilët vërtetojnë se pushteti musliman në të mirë të priftërinjve ka mohuar një numër të madh autorizimesh profane sikur edhe juridike. Në kohën e halifëve Abasij hasim në patriarkë të krishterë dhe hahamë hebraikë në mesin e autoriteteve më të larta shoqërore, të emëruar personalisht nga halifi.

Në kohën e Pejgamberit (a.s.) hebrenjtë kishin *bejtulmirsasin* e tyre (entin shkollor); në kontratën me të krishterët nga Nexhrani – Jemen, Pejgamberi (a.s.) jo vetëm që iu dha garancinë për pasurinë dhe personalitetin e banorëve, por vendosmërisht lejoi emërimin e peshkopit dhe të priftërinjve nga ana e bashkësisë krishtere.

Një numër i madh i njerëzve kanë zakon që në sjelljen e tyre të jashtme të imitojnë modën (veshmbathje, frizurë, sjelljet e bashkësisë sundimtare ose ata që krijojnë ligjin në atë shtet).

Rezultat i kësaj është asimilimi sipërfaqësor, i cili nuk i sjell kurrfarë dobie bashkësisë sundimtare dhe e cila iu bën vetëm keq atyre imitatorëve patronistë. Në shtetet islame jomuslimanët përbëjnë bashkësinë e të mbrojturve. Ligji islam i është përkushtuar asaj që t'u sigurojë privilegje në interesat e tyre të ligjshme. Kështu, në kohën e Halifit Abasij shohim se pushteti jo vetëm që nuk e forcon asimilimin "e të huajve", por edhe e demoralizon çdo imitim të njëres në anën e tjetër: muslimanët, të krishterët, hebrenjtë, magët dhe të tjerët ishin të detyruar të ruajnë mënyrën e veshjes së tyre, traditat e tyre shoqërore dhe individualitetet e tyre të veçanta. Ajo për të cilën është synuar është barazia e thellë, e brendshme dhe e jashtme, përmes luftërave fetare e jo në përzierjen e thjeshtë të bashkësisë. Kuptohet se ajo nevojë për t'u dalluar nuk rrjedh nga kërkesat e fesë islame – ajo nuk haset aspak në kohën e Pejgamberit (a.s.) – në pyetje është të kuptuarit, që i intereson jetës shoqërore: duhej dalluar bashkësinë fetare të çdo individi jo përmes mosbesimit ose maltretimeve, por përkundër saj, të ndihmohet kulturën e secilit, që të veçohen më mirë vlerat e saj ose të metat esenciale. Të përkujtojmë edhe një herë, kalimthi, se kombësia islame nuk bazohet në përbërjen etnike, as në vendlindjen, por në ideologjinë e përbashkët.

Personaliteti, nderi dhe pasuria e çdo individi, plotësisht janë të mbrojtur, qoftë ai i vendit ose i huaj,

në territorin islam. Në Sherhi Haidaje, në doracakun juridik për përdorim të përditshëm, gjejmë p.sh. këtë qëndrim karakteristik: “Shpifja është e ndaluar, qoftë ajo e drejtuar kundër muslimanëve ose tjetrit nga të mbrojturit (jomuslimanit)”. Një jurist tjetër me famë të madhe, shkrintar Bahr er-Raika, thotë: “Kufoma e të vekurit të mbrojtur (jomuslimanëve) ka të drejtë në respektin, si dhe kufomat e të vdekurit musliman; nuk mund të dëmtohen; pasi, nëse qëndrimi i keq ndaj një të mbrojturit (jomuslimanit) ka qenë e ndaluar gjatë jetës së tij, sigurimi i varrit të tij kundër çdo njollosjeje është e domosdoshme edhe pas vdekjes së tij”. Juristët janë të mendimit se, nëse një musliman dhunon një grua jomuslimane, duhet ta shijojë të njëjtin dënim si edhe ai që e dhunon një grua muslimane.

Në kohën e halifit Omer, ca muslimanë kanë rrëmbyer një pjesë të tokës që i takonte një hebrei, dhe aty e ndërtuan xhaminë. Si dëgjoi për këtë, halifi urdhëroi që xhamia të priset dhe toka t’i kthehet hebreit. Profesori Kardavi (i krishterë nga Libani), në vitin 1933 shkruan: “Shtëpia e atij hebrej (bejt-ul-Jehudi) ekziston edhe sot dhe është e njohur nga kjo ngjarje”. Edhe një shembull klasik, të cilin e përmendin Ibn Kethiri dhe të tjerët, ka të bëjë me xhaminë e madhe në Damask. Një halif emevij ka okupuar një kishë që të mund të zgjerohet xhaminë. Më vonë, kur ankesa i arrin halifit Omer ibn Abdulazizit, ai urdhëroi që një pjesë e xhamisë, e ndërtuar në pjesën e uzurpuar, të priset dhe atje të restaurohet kisha. Mirëpo të krishterët vetë më tepër donin që t’u paguhet vendi në të holla dhe kështu problemi u zgjidh në mënyrë miqësore.

Në lidhje me këtë temë të shtojmë edhe një shkrim të halifit Umer II, të cilin shkrim e ka ruajtur Ibn Sa'di. Urdhëresa është shumë e shkoqur.

“Në emër të Allahut, Bamirësit dhe Mëshiruesit! Nga robi i Zotit, kryekomandantit të besimtarëve, Omerit, djalit të Abdulazizit, guvernatorit Addijj ibn Artatu dhe besimtarëve muslimanë rreth tij: paqja e Allahut qoftë mbi ju. Unë ju dërgoj uratat e Zotit, përveç të cilit tjetër nuk ka. Pastaj: keni kujdes në pozitën e të mbrojturve (jomuslimanëve) dhe ndaj tyre silluni mirë dhe me dashuri. Nëse ndonjëri prej tyre e arrin pleqërinë e nuk ka mjete për të jetuar, ju jeni ata që do të kujdeseni për ata. Nëse ai ka vëllezër në gjini, kërkoni prej tyre të kujdesen për ta. Ndaj atyre që iu bëjnë pleqve ndonjë të keqe, aplikoni dënimin. Kam dëgjuar se keni vënë taksë për importimin e verës dhe atë e keni futur në të ardhurat e arkës që i takon Zotit. Unë juve u tërheqi vërejtjen, të mos lejoni që në arkën që i takon Zotit të hyjë çfarëdo e ardhure që s’është e pastër. Paqja e Zotit qoftë me ju”.

Një qarkore tjetër nga i njëjti halif thotë: “Pastroni regjistrat e tatimeve dhe rishqyrtoni dosjet e vjetra, gjithashtu nëse është bërë e padrejtë ndaj muslimanit ose jomuslimanit kthejani të drejtën e tyre. E nëse ai ka vdekur, kënaqësinë e tyre jepjuani pasardhësve”.

Dihet që juristët fqinjëve iu kanë pranuar përparësinë e blerësit të parë: nëse njëri prej tyre e shet pasurinë, fqinji ka përparësi para të huajve. Kjo e drejtë vlen edhe për jomuslimanët.

Mbrojtja e së drejtës së jomuslimanëve në territorin e muslimanëve ka shkuar aq larg, saqë iu është

dhënë liria që të bëjnë ca zakone krejtësisht në kundërshtim me Islamin. P.sh. pirja e alkoolit është e ndaluar për muslimanët, mirëpo, banorët jomuslimanë të vendit kanë të drejtë jo vetëm për ta përdorur, por edhe për ta prodhuar, për ta eksportuar dhe shitur alkoolin. E njëjta është me lojrat e bixhozit, kurorëzimi në mes farefisit, kontratave afariste me interes etj. Në kohët e hershme kjo nuk i godiste muslimanët, pasi keqpëdorimet ishin të rralla. Drejtimet moderne fillojnë të heqin dorë ng ajo liri, sepse tentativat që të kufizohet pirja e alkoolit mbetën të pasuksesshme, nëse ndalesa nuk është për tërë banorët e një vendi. Për këtë qëllim pëlqimi i përfaqësuesve jomuslimanë do të lehtësonte detyrën e juristëve, të cilët në parim, nuk do të intervenojnë në çështjet praktike të bashkësive të ndryshme, të cilat dallohen varësisht nga përkatësia fetare.

Ligji islam ka bërë njëfarë dallimi ndërmjet bashkësive të ndryshme jomuslimane – të paktën në ca çështje të cilat anëtarët e tyre mund t'i kenë në marrëdhënie me muslimanët. Në të vërtetë ai i ndan jomuslimanët në ata që mund të quhen “të zhvilluar” dhe “primitivë”, respektivisht në ata që besojnë një Zot dhe ndjekin Ligjet e Zotit, që kanë shpallur thelmesit e religjioneve të tyre dhe të tjerë në të cilat bëjnë pjesë idhujtarët, paganët, animistët etj. Të gjithë ata janë konsideruar nënshtetas dhe kanë përfituar mbrojtjen, përsa i përket lirisë së tyre të menduarit dhe të jetës, por muslimanët në jetën private e trajtojnë ndryshe: muslimani ka të drejtë të martojë jomuslimanen nga kategoria e parë, por jo edhe me atë që

është “primitive”. Pra, muslimani mund të martohet jo vetëm me të krishteren ose hebrejen, por asaj i jep të drejtën ta ruajë religjionin e vet: ajo mund të shkojë në kishë, mund të pijë verë etj. Muslimanit nuk i lejohej të martohet me grua e cila nuk beson në Një Zot; gjithashtu, nuk mund të hajë shtazët që i kanë therur anëtarët e ashtuquajturës bashkësi primitive. Por, muslimaneja nuk mund të martohet për jomuslimanin, pa marrë parasysh se cilës kategori i takon.

Kthimi

Nëse ligji islam iu pranon, formalisht, jomuslimanëve të drejtat që të mbajnë besimin e tyre, edhe pse kategorikisht iu ndaloi të gjitha mjetet e detyrimit për t’u kthyer në Islam, ai pjesëtarët e vet i mban nën disiplinë të rreptë. Dihet se baza e kombësisë islame është besimi, e jo baza etnike, gjuhësore ose gjeografike. Prandaj shkëputja, natyrisht, konsiderohet tradhti politike dhe për atë vepër ekzistojnë dënimet; mirëpo, historia tregon se ato nuk janë zbatuar. Jo vetëm në kohën kur muslimanët sundonin nga Pacifiku deri në Atlantik, por edhe sot, në kohën e dobësisë politike, materiale e shpirtërore, shkëputja e muslimanëve për afërsisht edhe nuk ekziston. Kjo është e vërtetë, jo vetëm për rajonet ku ekzistojnë kinse shtete muslimane, por edhe tjetërkund, nën dominimin e fuqive kolonialiste, të cilat mundohen në çdo mënyrë t’i kthejnë muslimanët në fe të tjera. Islami në kohën tonë përve-

tëson terrenet e popujve perëndimorë, nga Finlanda e Norvegjia deri në Itali, nga Kanadaja e deri në Argjentinë. Edhe atë, përkundër mungesës së plotë të aktivitetit misionar të organizuar.

Lufta e shenjtë

E përfundojmë këtë ekspozitë të shkurtër me ca fjalë rreth një çështje për të cilën ka më së shumti mospajtim të muslimanët - për çështjen e ashtuquajtur *Luftë Fetare*. E tërë jeta e një muslimani, qoftë ai të merret me çështjet shpirtërore, ose të kësaj bote, është disiplinë e rreptë, e rregulluar sipas Ligjit të Allahut (xh. sh.). Nëse muslimani e fal namazin pa bindje (që të tregohet ndaj të tjerëve, p.sh.), ai jo vetëm që nuk është akt fetar, por është edhe krim ndaj Allahut (xh. sh.), vetvetiu idhujtari, për të cilën do të dënohet në botën e përherëshme. Nga ana tjetër, nëse muslimani ushqehet që të ketë fuqi për të kryer obligimet e veta ndaj Allahut (xh. sh.), nëse ai fle me gruan e tij duke iu nënshtruar Ligjit të Allahut (xh. sh.), ato punë dhe kënaqësi paraqesin akte të devotshmërisë dhe i meritojnë, siç thotë Gazaliu, të gjitha dhuratat që Allahu i premton për devotshmërinë.

Në një koncept të këtillë të jetës, lufta e drejtë nuk mund të mos jetë e shenjtë. Në Islam lufta është e ndaluar, përveç nëse ka shkak të arsyeshëm, i vërtetuar sipas Ligjit të Allahut. Jeta e Pejgamberit (a.s.) na flet për tri lloje të luftës: mbrojtëse, ndëshkuese dhe pre-

ventive. Në korrespondencën e tij të famshme me mbretin e Bizantit, Herakliun, me rastin e vrasjes së një deputeti musliman në territorin e Bizantit, Pejgamberi (a.s.) propozon tri alternativa: “Prano Islamin...Nëse nuk do, paguaj tatimin e xhizjes... Nëse nuk do, mos i pengo shtetasit tuaj, nëse ata duan, të pranojnë Islamin, ose të paguajnë xhizjen” (sipas Ebu Ubejdes). Të vendosësh lirinë e ndërgjegjes në botë, ky ishte qëllimi i luftës të cilën e udhëhiqte Muhamedi (a.s.). Ajo është luftë e shenjtë për muslimanët, e vetmja luftë që nuk ndërmerret me qëllim të eksploatimit, por për qëllimin e sakrifikimit, luftë qëllimi i vetëm i së cilës është triumfi i Fjalës së Allahut (xh. sh.). Të gjitha luftërat tjera janë të ndaluara. Nuk ka fjalë për nisjen e luftës me qëllim që të detyroheshin njerëzia të pranojnë Islamin. Vetë feja atë e ka proklamuar të palejueshme (shih Kur’anin, 2:256).

Kreu XIII

Kontributi i muslimanëve në shkencë e në art

Për të paraqitur kontributin objektiv të muslimanëve në shkencë e në art, është e nevojshme që kjo lëndë të vështrohet nga shumë anë. Larg asaj që të pretendojmë ta përfshijmë plotësisht këtë lëndë, vetëm do të mundohemi të shtrijmë informata themelore mbi kontributin e muslimanëve në ca fusha më të rëndësishme.

Qëndrimi i përgjithshëm

Me rëndësi është të definohet qëndrimi i Islamit në çështjet e shkencës dhe të artit. Pasi, ai është tërësi e konceptit jetësor, e jo vetëm fe që i trajton marrëdhëniet mes njeriut dhe Krijuesit.

Jo vetëm që dëshiron t'i demoralizojë ata që lypin mirëqenie në këtë botë, Islami bile inkurajon me thirrje të shpeshta: "Thuaj": 'Kush i ka ndaluar stolitë e Allahut dhe ushqimet e mira, të cilat Ai i ka bërë për robërit e vet?' Thuaj: 'Këto janë posaçërisht për besimtarët, të cilët në këtë botë e kanë besuar Ditën e Kiametit'. Ja, ashtu Ne ua shpjegojmë argumentet njerëzve që dinë" (7:32). Ai i lavdëroi ata: "...që thonë: Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë dhe në Botën e përher-

shme; na mbro neve prej zjarrit të Xhehenemit” (2:201). Ai lëshoi njeriun: “...mos harro pjesën tënde në këtë botë; bëhu bamirës siç është Allahu Bamirës ndaj teje...” (28:77). Ky është ai tentim për mirëqenie që e lëviz njeriun që në mënyrë sa më të përsosur të njohë gjithçka që gjendet në gjithësi, të shërbehet me të dhe t’i shprehë falënderim Allahut. Kur’ani thotë: “Ne ju kemi bërë të mundur të jetoni në tokë dhe gjithë çka është e nevojshme për jetë, ju kemi dhënë. E si, ju a pak falënderoni!” (7:10 dhe 15:20). Pastaj: “Ai krijoi për ju gjithë çka ka në tokë”, ose “...a nuk shihni se Allahu nënshtroi gjithë çka ka në tokë dhe në qiell! Ai i shpërndau mirësitë e Veta për ju; atë që shihni dhe nuk shihni” (31:20 dhe 14:32, 33 dhe 16:12, 22:65, 45:12, 13 etj.). Nga njëra anë, Kur’ani e thërret njeriun ta nderojë Atë “Që ushqen të uriturin dhe trimëron të frikësuarin” (106:4,5), kurse, nga ana tjetër, ia përsërit nevojën e dhënies së mundit/përpyekjeve në botën përplot me sfida, por fundi do të shpërblehet sipas veprave: “Dhe, me të vërtetë, njeriut i takon vetëm ajo që punoi” (53:39). Kur’ani e nxit njeriun që të hulumtojë të kaluarën: “Thuaj: ‘Udhëtoni ju nëpër botë dhe shikoni se si kanë mbaruar të parët tuaj...’” (30:42), por ai nxit edhe në zbulime të reja: “Për ata që e përmendin Allahun në këmbë, edhe ulur, edhe ratë dhe mendojnë thellë për krijimin e qiejve dhe të tokës, “O Zoti ynë, Ti nuk e ke krijuar këtë më kot; qofsh lartësuar! Dhe, ruajna prej dënimit të zjarrit” (3:191).

Është shumë trishtuese kur të mendojmë se sa më tepër që nxit hulumtimet shkencore, Shpallja e parë që iu drejtua Pejgamberit analfabet, i lindur në mesin

e analfabetizmit, në realitet, ishte vetëm një urdhër për shkrim-lexim, në të cilin urdhër lëvdohet pena si mjet elementar për të arritur njeriu diturinë:

*“Lexo, në emër të Zotit tënd që të ka krijuar!
Që krijoi njeriun prej një dromce .
Lexo! Se është fisnik Zoti yt,
I Cili të mësoi penën;
E mësoi njeriun çka nuk e kishte ditur”. (96:1-5)*

Pastaj vijjnë këshillat mbi edukatën në frymë shkencore : “...pyeti ata që dinë për atë që nuk e dini!” (16:43) dhe pas asaj: “...mos kënaqeni me pak dituri!” (17:85), ose: “...atë që duam e lartësojmë dhe, mbi çdo dijetar ka më dijetar” (12:76). Sa e këndshme është lutja në të cilën Kur’ani e mëson njeriun: “...dhe thuaj: ‘Zoti im, shtojë diturinë time!’” (20:114).

Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Islami ngrihet mbi pesë shtylla: besimi në Një Zot , namazi, agjërimi, haxhi dhe zeqati”. Nëse besimi në Allah lyp kujdesin e shkencave teologjike, e gjithë tjetra lyp ngritjen e diturive botërore. Të kthyer kah Qabeja në Meke i lutemi Allahut, ndërsa riti kryhet në harmoni me fenomenet e caktuara natyrore. Kjo lyp ca dituri fillestare nga gjeografia dhe astronomia. Agjërimi gjithashtu lyp diturinë e ca fenomeneve natyrore - agimin e ditës, lindjen dhe perëndimin e diellit etj. Haxhi lyp njohjen e rrugëve dhe të mënyrës së arritjes në Meke. Llogaritja e zeqatit lyp njohuritë kryesore nga matematika. Të mos flasim se çka duhet të dimë se si duhet të ndahet pasuria e trashëgimisë dhe të kuptojmë Kur’anin me

tërë atë që përmban. Për studimin e Kur'anit lypset, para së gjithash, njohja e gjuhës në të cilën është e shkruar ai; përmendja e popujve dhe e shteteve lyp njohjen e historisë, të gjeografisë e kështu me radhë.

Të përkujtojmë, kur Muhamedi (a.s.) filloi jetën e pavarur, pasi që u shpërngul në Medine, puna e parë e tij ishte ndërtimi i një xhamie, një pjesë e së cilës ishte shkollë. Kjo shkollë, e njohur Sofa, ditën shërbente për klasë të mësimit, ndërsa natën dhomë fjetje për nxënësit.

“Allahu iu ndihmon atyre që i ndihmojnë”, kështu thotë Kur'ani. Prandaj, të mos habitemi aspak, muslimanët kishin letër të lirë dhe të begatshme për përhapjen e diturisë mes njerëzve. Në shekullin e dytë të Hixhretit filloi ndërtimi i fabrikave të letrës në tërë vendin.

Në këtë vështrim të shkurtër do të flasim vetëm mbi ca shkenca në të cilat kontributi i muslimanëve ishte shumë i rëndësishëm për historinë njerëzore dhe vetë njerëzimin.

Shkenca fetare dhe filozofike

Shkenca fetare natyrisht fillojnë me Kur'anin, të cilin muslimanët e pranuan për Fjalë të Allahut, porosi dhe urdhër të Allahut që i kushtohet tërë njerëzimit. Nevoja për kuptimin e Kur'anit nxiti studimet linguistike, gramatikore, historike, bile edhe në mënyrë spekulative, të cilat u zhvilluan dalëgdalë si shke-

nca të pavarura nga interesi i përgjithshëm. Recitimi i teksteve të Kur'anit e krijoi muzikën "fetare islame" (mbi të cilën do të flasim më vonë). Kujdesi për ruajtjen autentike të Kur'anit ndikoi në zhvillimin e shkrimit arab, jo vetëm në kuptimin e përpikërisë dhe të qartësisë, por edhe të bukurisë. Me vendimin e vokalëve, shkrimi arab është aq i rëndësishëm, preciziteti i të cilit u përgjigjet nevojave gati të të gjitha gjuhëve. Karakteri universal i Kur'anit lypte që ta kuptonin edhe joarabët. Përkthime të Kur'anit hasim qysh nga koha e Muhamedit(a.s.) (Selman Farisiu përktheu pjesë të Kur'anit në gjuhën persiane) e gjer në ditët tona – dhe fundi nuk mund të paramendohet. Përkthimet u ishin kushtuar atyre që nuk e dinin gjuhën arabe – vetëm për të njohur Kur'anin, që do të thotë të kuptojnë domethënien e tij, ndërsa në namaz do të përdoret ekskluzivisht në gjuhën arabe. Që të mund të ruhet ky shkrim dhe gjuha në tërësi, nëpërmjet gjeneratave, përgjithmonë përdoret metoda e vet Muhamedit (a.s.) që është: të shkruhet bukur dhe të mësohet përmendsh. Përdorimi i këtyre dy metodave në të njëjtën kohë mundëson largimin e harresës ose gabimeve eventuale. Përveç kësaj, një institucion juridik e përforcoi këtë metodë: patjetër të sigurohet një kopje e Kur'anit dhe të sigurohet leximi i tij në tërësi para një dijetari të njohur, e me këtë të përfitohet kompletimi autentik i tij. Kjo praktikë vazhdon deri më sot. Siç u përvetësua Kur'ani, ashtu u përvetësuan edhe fjalët e Pejgamberit (a.s.). Është ruajtur në tërësi ajo çka punoi në jetën e vet publike e private. Rregullimi i këtyre shkrimeve filloi qysh në kohën e Muhamedit (a.s.),

në bazë të ca dokumenteve të dorës së parë. Si për Kur'anin, ashtu edhe për Hadithin nevojitet besueshmëria. Derisa ajo që dihet mbi jetën e Nuhit, Musait, Isait, Budës dhe njerëzve të tjerë të mëdhenj të historisë antike mund të shkruhet në disa faqe, detajet e njohura nga biografia e Muhamedit (a.s.) përmbledhin qindra faqe; aq i madh ishte kujdesi që të ruhen dokumentet dhe faktet precize për të ardhmen ndër shekuj.

Aspekti abstrakt i fesë, veçanërisht në çështjet e besimit dhe të dogmave, tregon se shqyrtimet kanë filluar që prej kohës së Muhamedit (a.s.), që më vonë të vazhdojnë në shkencat të posaçme, si Kelami (dogmatika), Tesavufi (misticizmi). Polemika fetare me jomuslimanët, e pastaj me vetë muslimanët, dhanë shkas të futen elementet e huaja: përkthehen veprat filozofike të grekëve, indianëve etj. Pastaj, as muslimanëve nuk do t'u mungojnë filozof të mëdhenj, origjinalë, të talentuar dhe të shkolluar: Kindi, Farabiu, Ibn Sinai (Avicena), Ibn Rushdi (Averoes) etj. Ky arabizim aktiv pati epilog fatlum, sepse qindra vepra të përkthyer nga greqishtja dhe sanskritishtja, origjinali i të cilave është humbur, u ruajtën për pasardhësit e tyre në përkthimet arabe.

Shkencat shoqërore

Kontributi i muslimanëve në shkencat shoqërore është, siç do të shohim, shumë i rëndësishëm. Karakteristikë e rëndësishme e mësimit islam është përha-

pja e shpejtë. Kur'ani është libri i parë në gjuhën arabe; vetëm dy shekuj më vonë ajo gjuhë e beduinëve të paditur paraqet një ndër gjuhët më të pasura në botë, e cila së shpejti jo vetëm që bëhet gjuha më e pasur e botës dhe e kohës, por edhe gjuhë e përbashkët e të gjitha shkencave. Të mos ndalemi pa lypur shkaqe të këtij përparimi të vrullshëm, por të përmendim një fakt tjetër: muslimanët e parë përafërsisht të gjithë ishin arabë, por me përjashtim të gjuhës së tyre – me të cilën është ruajtur Fjala e Allahut dhe e Pejgamberit të Tij – ata me ndikimin e Islamit u shkrinë, duke pranuar të gjithë popujt dhe racat në barabarësi të plotë. Pra, të gjithë popujt kanë marrë pjesë në atë kulturë “islame”: arabët, grekët, persianët, turqit, abisinasit, berberët, indianët dhe të gjithë të tjerët që pranuan Islamin. Toleranca fetare ishte aq e madhe, kurse patronazhi shkencor po ashtu i përsosur, sa që të krishterët, hebrenjtë, budistët dhe të tjerët kanë bashkëpunuar për ta përsosur kulturën muslimane, jo vetëm në fushatën e problematikës fetare, por edhe në shkencat tjera. Gjuha arabe u përhap më shumë se çdo gjuhë tjetër në botë, pasi që ishte gjuhë zyrtare e shtetit musliman, territori i të cilit shtrihej nga Kina deri në Spanjë.

Drejtësia

Duke i falënderuar karakterit gjithëpërfshirës, shkenca juridike u zhvillua shumë herët te muslimanët. Ata janë të parët në botë që menduan mbi shkenc-

ën abstrakte juridike, në dallim të kodeve të disa shteteve. Popujt e vjetër i kanë pasur të gjitha ligjet, pak a shumë të zhvilluara, bile edhe të kodifikuara, mirëpo shkencë e cila do të bëjë fjalë mbi filozofinë dhe buri-met e së drejtës, mbi metodën e legjislaturës, mbi interpretimin dhe zbatimin e ligjit nuk ka ekzistuar. Vetëdija mbi këtë shkencë asnjëherë nuk është paraqitur para muslimanëve. Prej shekullit të dytë të Hixhretit hasim në vepra arabe të këtij lloji, të quajtuara *usul*.

Fikhu

E drejta ndërkombëtare në kohën antike nuk ishte as drejtësi, e as drejtësi ndërkombëtare. Ajo ishte pjesë e politikës (e lënë në fshehtësinë e plotë të pushtetmbajtësve). Përfshinte një numër të vogël shtetesh, të banuara me njerëz të një kombësie, të një feje dhe të një gjuhe. Muslimanët ishin të parët që kësaj të drejte i dhanë vend në sistemin juridik, duke i definuar kështu të drejtat dhe detyrat (obligimet). Qysh prej ditëve të para të Islamit, rregullat e së drejtës ndërkombëtare përbënin kaptinë të veçantë në lidhje me shkrimet juridike të muslimanëve (shkrimi më i vjetër që është ruajtur është MEXHMUA prej Zejd ibn Aliut, i cili vdiq më 120 sipas Hixhretit); ky shkrim përmban kaptinën e përmendur. Edhe më tepër, muslimanët e kanë ngritur këtë degë të shkencës në rang të një discipline krejtësisht të veçantë të: monografisë mbi atë temë, me titull të përgjithshëm SIJER, që e hasim prej

shekullit të dytë sipas Hixhretit. Karakteristikë e kësaj të drejte ndërkombëtare është ajo se nuk bën kurrfarë dallimi mes individëve të huaj. Duke lënë anash marrëdhënien mes muslimanëve (le të ishin arabë ose jo), ajo merret vetëm me marrëdhëniet me shtetet jo-muslimane në botë (pasi që Islami në parim patjetër insiston të formojë një tërësi të vetme, një bashkësi organike).

Kontributi i mëtejshëm në atë lëm është shkencën mbi të drejtën komparative: paraqitja e shkollave të ndryshme juridike islame e ka lypur këtë lloj të shkencës, që të njihen shkaqet e dallimeve, si dhe pasojat e të gjitha mospajtimeve parimore në cilëndo çështje juridike. Librat e Dabusit dhe të Ibn Rushdit në këtë pikëpamje janë klasike. Sjamuri, bile, ka shkruar një vepër mbi shkencën e së drejtës komparative ose metodologjinë e së drejtës (Usulu fik'h).

Kushtetuta e shkruar është gjithashtu një risi, e cila rrjedh prej muslimanëve; kushtetutën e parë të këtij lloji e hartoi personalisht Muhamedi (a.s.); kur themeloi qytet-shtetin në Medine, hartoi kushtetutën e cila është e ruajtur dhe, si e tillë, arriti gjer te ne dhe e cila precizon të drejtat dhe detyrat e shefit të shtetit, pjesët e së cilës e përbëjnë shtetin dhe qytetarët – në lëmin e administratës, ligjislaturës, gjykatës, mbrojtjes etj. Të mos harrojmë se e tërë kjo ndodhi në vitin 622 sipas Krishtit!

Në lëmin e drejtësisë, në kuptimin më të ngushtë, kodet janë paraqitur në fillim të shekullit të dytë. Materja ndahet në tri pjesë themelore:

1. Ibadeti,

2. Marrëdhëniet kontraktuese të të gjitha llojeve,
3. Ndëshkimet.

Në konceptonin e vet jetësor, i cili përfshin gjithçka, drejtësia muslimane nuk dallon kurrë mes xhamisë dhe fortifikatës. Në këtë mësim, ku pjesën e së drejtës kushtetutuese e përbën feja, shefi i shtetit njëkohësisht printe në namaz. Arka shtetërore dhe financat janë gjithashtu pjesë përbërëse të fesë, pasi Pejgamberi e shpalli një prej pesë themeleve të Islamit, krahas shehadetit, namazit, Ramazanit dhe haxhit. Pjesën e së drejtës ndërkombëtare e përbëjnë edhe ndëshkimet (dënimet). Lufta është e arsyeshme vetëm kundër hajnave, plaçkitësve dhe shkelësve të tjerë të ligjit e të rregullave.

Ky është i tërë karakteri i së drejtës te muslimanët që na shtyri të flasim kaq gjatë mbi këtë shkencë.

Historia dhe sociologjia

Kontributi i muslimanëve në shkencën e historisë është i madh, veçanërisht në dy pika esenciale të kësaj shence: vërtetimi autentik i dokumenteve, tubimi dhe ruajtja e detajeve të llojllojshme. I lindur në këtë epokë të ndritshme historike, nuk ka nevojë për legjenda dhe hipoteza në historinë e vet. Përsa u takon të dhënave mbi popujt e tjerë, çdo tregim ka fituar vlerën që e meriton; vetëm se historia vijuese islame, për shkak të tërësisë së vet, gjatë viteve ka lypur kontrollim të kohëpaskohshëm. Të argumentuarit me anë të

dëshmitarëve është shfrytëzuar një kohë pikërisht në gjyqe. Muslimanët e kanë zbatuar edhe në histori: për çdo tregim lyprin dëshminë. Nëse në gjeneratën e parë, pas ndodhisë, ka pasur nevojë për një dëshmitar të besueshëm që ka marrë pjesë në ndodhi, menjëherë, në gjeneratën e dytë, ka qenë e domosdoshme të sillen dy burime të pandërprera të informatës (unë kam dëgjuar prej x-it se si ky në këtë e këtë situatë përjetoi atë e atë ndodhi). Në gjeneratën e tretë do të jenë të nevojshme tri burime, e kështu me radhë. Këto informata të hollësishme dhanë mundësi që të vërtetohet e vërteta e zinxhirit të burimeve të pandërpera, mbështur në leksikonet biografike të cilat nuk flasin vetëm mbi karakteret e ca personave, por shënojnë edhe emrat e mësuesve dhe të nxënësve të tyre më të dalluar. Kjo mënyrë e argumentimit është shfrytëzuar jo vetëm mbi faktet nga jeta e Muhamedit (a.s.), por edhe në transmetime të llojllojshme të anekdotave të ndryshme, të cilat janë ritreguar vetëm për argëtim.

Leksikonet biografike janë një nga karakteristikat e literaturës historike të muslimanët: shkruhen leksikone sipas profesioneve, qyteteve, krahinave dhe shekujve etj. Rëndësi e madhe i takon edhe gjenealogjisë; posaçërisht tek arabët janë të njohura informatat mbi qindra kushërinj dhe mijëra persona të dalluar. Kjo ka qenë lehtësim i madh për atë që ka bërë kërkime mbi shkaqet e ndodhive.

Përsa i përket historisë në kuptimin e fjalëpërfjalshëm, pikë karakteristike e kronikës është universaliteti i tyre. Taberiu p.sh., një prej historianëve më të hershëm musliman, nuk i filloi analizat e veta të gjera

vetëm me krijimin e gjithësisë dhe historinë e Ademit (a.s.), por foli edhe mbi të gjithë popujt e njohur të kohës së tij – punë të cilën më me kujdes dhe më me dëshirë vazhduan ta kryenin pasardhësit e tij: Mes’udi, Miskavejhi, Seid el-Endelusi, Rashidud-din Hanë etj. Është shumë interesant të vërejmë se të gjithë këta historianë, duke filluar prej Taberiu, veprat e veta i kanë filluar me shqyrtimin mbi të kuptuarit e kohës. Ibn Halduni shkon shumë larg në studimet e sociologjisë dhe të filozofisë në veprën e njohur të tij *Prolegomena – El-Muked-dime – Për historinë e përgjithshme*.

Gjatë shekullit të parë të Hixhretit filluan të zhbi-lloheshin dy degët e historisë: Historia islame, duke filluar me jetën e Pejgamberit (a.s.), vazhdon me kohën e halifëve dhe Historia joislame, e cila ka të bëjë me historinë paraislame dhe me shtetet e huaja, si me Iranin, Bizantin etj. Më vonë këto dy degë do të bashkohen në një, siç e shohim atë në historinë e botës prej Rashidudin Hanit, një pjesë e madhe e së cilës ka ngelur e pabotuar, e përbërë njëkohësisht në dy versione: arabe dhe persiane. Ky autor me njohuri të njëjtë flet mbi pejgamberët e Allahut, halifët, papët, sunduesit e Romës, të Kinës, Mongolisë etj.

Gjeografia dhe topografia

Praktika e haxhit në Meke dhe nevojat tregtare kanë ndikuar që herët të parashtrahet problemi i komunikimit nëpër perandorinë e gjerë muslimane. “Sa-

herë që nisej lajmëtari nga Turkestani gjer në Egjipt, e që ndodhte për çdo ditë, halifi Omer urdhëronte që të paraqitet në kryeqytet që t'u mundësojë të gjithëve që dëshirojnë të dërgojnë letra e të shfrytëzojnë lajmëtarin zyrtar". Drejtorët e postave përgatitën programin dhe marshutën, që ishte gjithmonë e përcjellë pak a shumë me detajet e përshkrimeve historike-geografike për çdo vend, emrat e të cilëve ishin të radhitur sipas alfabetit. Këto përshkrime geografike gradualisht i kontribuan zhvillimit të studimeve shkencore. U përkthyen arabisht *Gjeografia* e Ptolomeut dhe shumë vepra indiane. Tregimet e udhëtarëve ditë për ditë shtuan diturinë e përfiturar. Është e njohur përgjigjja e Ebu Hanifes që ia dha një mu'teziliti në pyetjen se ku është qendra e botës: "Mu atje ku je ulur ti"! Kjo përgjigje vlen vetëm krahas supozimit se toka është e rrumbullakët. Hartat më të vjetra muslimane paraqesin tokën në formë të rrethit, si p.sh. ajo prej Ibn Hafkalit (kah 975-ta), kategoria e së cilës mundësoi caktimin e lehtë të të gjitha shteteve mesdhetare si dhe të Lindjes së Afërt. Harta e Idrisit, e punuar për Roxherin prej Sicilie, çudit me saktësinë e saj të madhe (autori ka ditur për burimet e Nilit). Të përmendim se hartat arabo-muslimane e vunë jugun lart, ndërsa veriu poshtë. Udhëtimet tejetdare lypën përdorimin e tabelave geografike të gjatësisë dhe të gjerësisë, si dhe astrolabet e instrumentet tjera të lundrimit. Mijëra banknota të gjetura në gërmime të Skandinavisë, Finlandës, Ruisë, Kazanit etj., haptazi tregojnë aktivitetin komercial të prijësve të karvanëve muslimanë në shekullin e mesëm. Ibn Mexhidi, i cili drejtoi anijen e

Vasko de Gamës gjer në Indi, qysh atëherë përmendi kompasin si instrument të njohur mirë. Marinarët muslimanë mahnitën me shkathtësitë e tyre, duke udhëtuar me anijet me vela nga Basra (Irak) deri në Kinë. Fjalët *admiral, arsenal, kablllo, lusan, doganë (douane), tarifë...*, të cilat janë burimore arabe, flasin mjaft qartë për ndikimin e muslimanëve në civilizimin modern të Perëndimit.

Astronomia

Një vend të konsiderueshëm në kontributin e çmueshëm të muslimanëve dhënë njerëzimit zë edhe astronomia. Jo vetëm që edhe sot disa yje në gjuhët evropiane mbajnë emra arabë, por edhe Ibn Rushdi (Avareos) zbuloi ekzistimin e dangëve dhe sipërfaqen e diellit.

Reforma e kalendarit që bëri Omer Khajami ia kalon për kah përsosmëria reformës së kalendarit gregorian. Beduinët arabë para Islamit kanë pasur dijeni të zhvilluar astronomike, jo vetëm për nevojat e udhëtimit natën, nëpër shkretëtirë, por edhe për të paraparë kohën. Dhjetëra libra *El-Enva*, që përmbajnë njohurinë arabe në këtë lëm, na argumentojnë mjaft mbi këtë. Më vonë përkthehen veprat sanskrite, greke etj. Krahasimi i dokumenteve të kundërta lypj rishqyrtime të reja dhe hulumtime durimtare. Observatorët mbinë çdokund. Në kohën e halifit Me'mun është matur perimetri i tokës me mjeshtri të rrallë. Janë shkru-

ar vepra mbi zbaticën dhe baticën, mbi lindjen dhe perëndimin e diellit, mbi muzgun, ylberin, rrezet (korona) e diellit, e veçanërisht mbi diellin e hënën dhe rrotullimin e tyre.

Shkencat natyrore

Pika karakteristike e këtij lloji të shkencës islame qëndron në atë se rëndësinë ua vë eksperimenteve dhe hulumtimeve të liruara nga paragjykimet. Metoda islame ka qenë me të vërtetë e çuditshme. Shkencëtarët i kanë filluar hulumtimet e tyre me përgatitjen e fjalorëve për termat teknikë që i kishin në gjuhën e tyre. Me durim të jashtëzakonshëm ata kanë bastisur të gjithë librat e poezisë dhe të prozës dhe prej tyre kanë marrë çdo term teknik, i cili pastaj është klasifikuar sipas materjes: anatomi, gjeologji, botanikë, astronomi, mineralogji etj. Çdo gjeneratë e re punimet e paraardhësve të tyre i ka riprovuar, që të shtojë diçka të re. Listat e fjalëve, të cilat ishin të thjeshta e që përmbanin vërejtjet letrare dhe anegdodat, kanë paraqitur vlerë të jashtëzakonshme mu atëherë kur filluan punimet e përkthimeve; kanë qenë raste të rralla të përdoret fjala e huaj në gjuhën arabe. Botanika në këtë pikëpamje është shumë karakteristike. Në përjashtim të disa emrave të disa bimëve që nuk janë rritur në vendet muslimane, nuk ka pasur asnjë term me prejardhje të huaj; gjithmonë është gjetur në gjuhën arabe. *Enciklopedia e botanikës e Dihaveriut* (vdiq

në 899-tën), në gjashtë vëllime, është përpiluar, bile, para se të përkthehet në arabishte vepra e parë e botanikës prej greqishtes. Silbergu ka thënë: “Pas një mijë vjet kërkimesh, e gjithë botanika greke gjendet në veprat e Dioskordit dhe të Teofrastit; mirëpo, vepra e parë muslimane (e Dinaveriut) në këtë lëm ia kalon për nga niveli dhe hollësitë”. Ai thjesht thotë: “Çdo rast është i çuditshëm, që e gjithë literatura antike e botanikës na jep vetëm dy shembuj të përngjashëm të librit tonë (prej Dinaveriut). Si mundën muslimanët, në periudhën e hershme të jetës së tyre, të arrijnë në nivelin e gjenive siç ishin grekët, bile t’ua kalojnë në këtë pikëpamje”. (Zeitschrift fuer Asyriologie, Strasbourg, prej 24-25, 1910-1911, shih vol. XXV, 44). Dinaveriu ka përshkruar jo vetëm pamjen e bimës dhe cilësitë tjera farmakologjike; ai ato i ka radhitur dhe ka folur mbi vendin ku mund të rriten ato etj.

Shkenca e medicinës

Medicina te muslimanët gjithashtu ka bërë përparim në anatomi, farmaceutikë, organizimin e spitaleve, ushtrimin e kuadrove medicinale (të cilët kanë kaluar nëpër provime të ndryshme para se të fillonin punën praktike). Duke iu falënderuar shumë shteteve kufitare me Bizantin, Indinë, Kinën etj., medicina islame është formuar si sintezë e shkencave botërore, e vendosur në eksperimente dhe e zhvilluar me anë të kontributit të saj. Vepra e Raziut dhe Ibn Sinait, dhe e

të tjerëve, kanë mbetur deri para pak kohe themel i tërë medicinës, duke llogaritur edhe atë të Perëndimit. Sot dimë se qysh atëherë është ditur për qarkullimin e gjakut (duke falënderuar punimet e Ibn Nefisit).

Optika

Optika veçanërisht i ka borxh shkencës islame. “Libri mbi rrezet” i Kindit gjendej para shkencës së grekëve përsa iu takon eksperimenteve për krijimin e zjarrit. Pastaj vjen Ibn el-Hejthemi (Alhazen – 965), i cili me meritë ngeli i famshëm. Kindiu, Farabiu, Ibn Sinai, Biruni dhe përfaqësuesit tjerë të shkencës islame nuk ngelën pas asnjërit prej emrave të mëdhenj në historinë e shkencës.

Mineralogjia, mekanika e të ngjashmet

Mineralogjia ka tërhequr kujdesin e shkencëtarëve, si për qëllime medicinale, aq për shkak të njohurisë së gurëve të çmuar, të cilët ishin shumë të kërkuar nga sunduesit dhe pasanikët. Vepra e Birunit dhe të tjerëve ende përdoren në këtë lëm. Ibn Firnasi shpiku makinën për fluturim. U mbyt në një fatkeqësi, duke mos lënë trashëgimtarin që do të vazhdonte dhe do ta përsoste veprën e tij. Shkencëtarët tjerë zbuluan maki-

ën për tërheqjen e anijeve të fundosura dhe për shkulljen e drurëve me dimensione të ndryshme.

Në lëmin e hulumtimeve të detit janë shkruar shumë libra mbi peshqit dhe mbi përpunimin e gurëve të çmueshëm.

Zoologjia

Studimi i jetës së shtazëve të egra dhe shpezëve iu ka interesuar qysh herët beduinëve arabë. Xhahidhi ka shkruar veprën e famshme mbi jetën e kafshëve dhe qysh atëherë ai flet mbi zhvillimin e llojeve, temë të cilën më vonë e pranuan Miskavejhi, Kazvini, Damiri etj.

Kimia dhe fizika

Kur'ani gjithmonë lyp prej muslimanëve që të mendojnë për krijimin e gjithësisë dhe të studiojnë se si qielli dhe toka janë të nënshtruara për njeriun. Në Islam asnjëherë nuk ka pasur mosmarrëveshje mes besimit dhe arsyes (mendjes). Mu për këtë muslimanët shumë herë kanë ndërmarrë studime serioze në lëmin e kimisë dhe të fizikës. Vepra të këtilla i përshkruhen Halid ibn Jezidit (vdiq në vitin 704) dhe Xha'fer es-Sadikut (vdiq në vitin 765); ndërkaq, nxënësi i tyre, Xhabir ibn Hajam (vdiq rreth vitit 776), ngeli i famshëm gjatë shekujve. Pikë karakteristike e

punës së tyre ishte eksperimenti objektiv. Me vëzhgimin e tyre, ata kanë mbledhur një numër të madh faktesh. Nën ndikimin e tyre, *al-Kemija* e vjetër u shndërrua pikërisht në shkencë të bazuar në fakte që mund të argumentohen. Xhabiri ka ditur proceset kimike të kalciumit dhe të reduksionit. Ai gjithashtu e ka aplikuar metodën e evaporacionit, sublimacionit, kristalizimit etj. Kuptohet se në këtë lëm të diturisë njerëzore lypset pikësëpari të punohet me durim, gjatë gjeneratave, që më vonë ajo të mund të shfrytëzohet. Përkthimet latine të veprave të Xhabirit dhe të shkencëtarëve të tjerë mund të argumentojnë se u ka borxh shkencë moderne shkencëtarëve muslimanë dhe se përparimit të vet mund t'i falënderojnë pikësëpari metodës arabo-islame të eksperimentit, shumë më përpara se metodës spekulative të grekëve.

Matematika

Dituritë matematikore i kanë ruajtur gjurmët e pashlyeshme të kontributit arab. Fjalët: *algjebër*, *zero*, *shifër* etj. janë me prejardhje arabe. Emrat Elhaverizmi, Omer Khajam, Biruni dhe të tjerë gjithashtu do të mbeten të njohur sikurse emri i Euklidit ose i autorit indian Said Hante etj. Grekët nuk e kanë njohur trigonometrinë. Merita për zbulimin e saj iu takon matematikanëve muslimanë.

Shkurtimisht, muslimanët janë marrë me punë të tjera, derisa fatkeqësitë e mëdha nuk i goditën dy qen-

drat intelektuale të tyre: Bagdadin në lindje dhe Korodovën – Granadën në perëndim. Jo vetëm që këto dy qytete ishin njëri pas tjetrit të pushtuara prej barbarëve, por aq më keq se u dogjën bibliotekat me qindra mijëra dorëshkrime. Masakra nuk ka kursyer as shkencëtarët. Ajo që është krijuar me shekuj, u shkatërrua për ca ditë. Për të rikthyer atë që ishte humbur, ka qenë e nevojshme që të punojnë në shekujt e ardhshëm dhe të formojnë kushte materiale. Përveç kësaj, shpirtrat e lartë dhe karakteret fisnike nuk krijohen sipas porosisë: ato janë dhuratë dhe dhunti e Allahut; nëse ato kanë mbetur pasdore, në vend që ta kenë fjalën e parë në shoqëri, nëse, pra, janë detyruar t’ua lëshojnë vendin njerëzve të këqinj e të çmendur, kjo është tragjedi e madhe, të cilën, për fat të keq, shpesh e ndeshim.

Arti

Si për shkencën, Kur’ani ka merita edhe për zhvillimin e artit te muslimanët: recitimi i teksteve të Kur’anit krijoi mjeshtrinë melodike për Kur’anin; ruajtja e teksteve të Kur’anit nxiti mjeshtrinë e kaligrafisë; për xhaminë lypsej arkitekturë dhe art dekorativ. Më vonë kësaj iu bashkangjitën edhe dëshirat e pakufishme të pasanikëve për të zbukuruar shtëpitë e tyre. Nga dëshira që të ruhet ekuilibri mes trupit dhe shpirtit, Islami në të gjithat lyp art, i udhëheq talentet në rrugën e drejtë dhe rropatet të zhvillojë te njeriu një harmoni të plotë.

Në *Sahihin* e Muslimit mund të lexohet një thënie interesante e Muhamedit (a.s.): “Allahu është i bukur dhe e do bukurinë”. Tjetra: “Bukuri në gjithçka ! Bile, edhe nëse detyrohemi të mbytni, mbytni në mënyrë të bukur”. Allahu (xh. sh.) shpesh thotë në Kur’an: “Me kandila e kemi zbukuruar qiellin...” (67:5) ; ose: “Po, Ne e kemi bërë atë që është në tokë zbukurim i saj, që të shohim pastaj se kush është midis tyre më i miri në vepra”. (8:7) etj. Kur’ani urdhëron: “...kur të falni namazin, vishuni sa më bukur...” (7:3).

Është e njohur një ndodhi prej jetës së Muhamedit (a.s.): Një ditë ai vërejti se sipërfaqja e një varri nuk është e rrafshuar mirë. Urdhëroi që të përmirësohet, duke shtuar se ajo nuk do t’i ndihmojë e as do t’i dëmtojë të vdekurit, vetëm se do të ketë pamje më të bukur për të gjallët.

Prirja për artin e bukur është e lindur te njeriu. Si për çdo dhunti, Islami edhe për talentin lypi zhvillim, mirëpo me maturi. Të përkujtojmë se çdo e tepruar, bile edhe me mundimin e trupit, edhe me ushtrimet shpirtërore, në Islam është e ndaluar.

Minberi i parë në xhami është ndërtuar në kohën e Pejgamberit (a.s.), i cili për dekorim pati dy topa me të cilët luanin nipërit e vegjël të Muhamedit (a.s.). Ky ishte fillimi i drugdhendjes te muslimanët. Më vonë kopjet e Kur’anit janë zbukuruar me ngjyra të gjalla dhe kanë pasur kujdes rreth lidhjes së tyre. Shkurti-misht, Islami me kurr gjë nuk e pengon hovin artistik. Pengesë të vetme që e paraqet Islami është tregimi i figurave të shtazëve (duke bashkangjitur edhe formën e njeriut). Si duket, prapëseprapë, kjo ndalesë nuk ka

qenë absolute, por Muhamedi (a.s.) dëshiroi për qëllime të caktuara metafizike, psikologjike, sociologjike dhe biologjike të orientojë fantazinë e artistëve. Bota shtazore është shprehje më e dukshme e krijimit, pas së cilës vijnë me radhë bimët dhe xehet. Është dashur që ndera e krijimit t'i lihet Allahut e nga ana e vet, njeriu të kënaqet me objektet tjera. Ky është sqarim i ca metafizikanëve.

Një psikolog ndoshta do të mendojë se, pasi që vendin e parë në krijim e mban bota shtazore (aftësia e të lëvizurit të njeriu, aftësia e shpikjes), paraqitja e shtazëve për njeriun sjell lajthitje të dyfishtë, së cilës njeriu nuk i kundërvihet shumë: sprovat që të konsiderohet krijues, gjersa ai është vetëm riprodhues (p.sh. një skulptor grek ishte i dashuruar në skulpturën e vet, saqë u orvat t'i jepte shpirt veprës së vet ose ndonjë cilësi të Zotit). Historia e shekullit të vjetër dhe entuziazmi modern për heronjtë, kampionët dhe artistët haptazi dëshmojnë për këtë. Përsa i përket aspektit biologjik, dihet se mosshfrytëzimi i një talenti përforcon tjetrin që shfrytëzohet: kështu p.sh. një i verbër zakonisht posedon memorje dhe sentimentalitet mbimesatar. Te mosparaqitja e figurave të shtazëve në pikturë, skulpturë etj. talenti i artistit shumë më tepër do të manifestohet në fushat tjera të artit. Përsa i përket aspektit shoqëror, aty hasim në shembuj katastrofalë të keqpërdorimit dhe të tjetërsimit në formë idhujtarie, e që mund të konsiderohet motiv i vërtetë i ndalimit. Megjithatë, ky ndalim ka ca përjashtime: lojrat për fëmijë, zbukurimet e jastëkëve dhe qilimave, nevojat shkencore (anatomi, antropologji),

nevojat e sigurimit dhe të mbrojtjes, policia , identifikimi etj.

Historia tregon se ndalimi i artit figurativ te muslimanët nuk e ka penguar artin në përgjithësi; përkundrazi, artet e tjera përjetuan hov të jashtëzakonshëm. Vetë Kur'ani lyp bukuri dhe grandiozitet në ndërtimin e xhamive. Xhamia Sulejmanije në Stamboll, mauzoleu Taxh Mahall në Agra (Indi), pallati Al-Hamra në Granadë dhe ndërtimet tjera nuk ngelin pas përmedoreve të civilizimeve të tjera, as në arkitekturë e as në punimet artistike.

Kaliografia si art është një prej specialiteteve muslimane. Përdoret në shkrim ose si ornament në fotografi, etj. Fuqia dhe bukuria artistike e këtyre përmedoreve mund vetëm të shihet; është e pamundur të përshkruhen ato.

Një art tjetër special i muslimanëve është këndimi i vargjeve të Kur'anit. Pa përcjellje me instrumente muzikore, pa u shkruar në vargje, Kur'ani prapëseprapë i ka kushtuar kujdes të madh këndimit qysh prej kohës së Muhamedit (a.s.). Gjuha arabe i jep prozës së vet një melodi, kështu që asgjë nuk ngel pas vargjeve të rimuara në gjuhët tjera. Ata që i kanë dëgjuar mjeshtrit e vërtetë se si këndojnë dhe si i recitojnë vargjet e Kur'anit saherë në ditë gjatë namazit, e dinë se kjo mjeshtri specifike ka shkathësinë e vet, që i takon vetëm Kur'anit.

Bile, edhe muzika dhe këngët e kësaj bote ishin nën përkujdesjen e sunduesve dhe pasanikëve, prandaj shënuan përparim te muslimanët. Teorikët si Farabi, shkrimtarët e librit Resail Ihvan es-safa, Avicena

dhe tjerët nuk kanë lënë vetëm vepra të rëndësishme, por ata i kanë kontribuar, gjithashtu, plotësimin të arritjeve të muzikës greke dhe indiane. Ata kanë përdorur shenja për shkrimin e muzikës, kurse në veprat e tyre flasin mbi shumë instrumente. Zgjedhja e melodisë, e vargjeve dhe e instrumenteve sipas nevojave dhe rrethanave, ka qenë çështja e studimit themelor, varësisht se a është fjala për gëzim, dëshpërim, sëmundje etj.

Kur është fjala mbi poezinë, qe një thënie e Muhamedit (a.s.): “Ekzistojnë vargje me plot urtësi dhe biseda që kanë efekt magjik”. Kur’ani e refuzon poezinë jomorale. Muhamedi (a.s.), duke mbajtur këtë qëndërim, ishte i rrethuar nga poetët më të mirë, të cilëve iu trasonte rrugën që duhej ndjekur dhe kufirin që duhej përmbajtur, duke dalluar përdorimin e mirë dhe të keq të atij talenti. Veprat e poezisë muslimane i hasim në të gjitha gjuhët dhe epokat; mbi të nuk është e mundur t’i japim këtu, bile, një pasqyrë të shkurtër. Arabi gjithmonë është në “shtëpi” kur është në pyetje poezia, të cilën e tregojnë dëshmitë që vijojnë: *bejt* njëkohësisht d.m.th. varg me dy gjysmëvargje: *sabab, vatad* etj.

Shkurtimisht, muslimanët e kanë dhënë kontributin e tyre në lëmin e artit, duke e larguar atë që është e dëmshme, duke e vazhduar atë që është e pëlqyer dhe duke zbuluar në art gjëra të reja. Kontributi i tyre nuk mund të mohohet.

Kalimthi mund të japim dy vërejtje:

1.Sikur muslimanët të mos e kishin kulturën e tyre personale – kulturën gjithëpërmbledhëse dhe islame, të cilën Pejgamberi (a.s.) aq intensivisht ua

mbolli – ata pa dyshim do t'i kishin absorbuar kulturat e tyre, të cilat aq lehtë e aq shpejt i nënshtruan.

2.Ndër shtetasit e shtetit të gjerë islam kishte popuj të të gjitha religjioneve: Të krishterë, hebrenj, zarastuer, sabej, brahmanë, budistë e të tjerë dhe të gjithë ata kishin kulturën dhe traditën e tyre. Bile, edhe nëse ata nuk kanë bashkëpunuar mes vete, të gjithë kanë bashkëpunuar me muslimanët; çdonjëri prej tyre ua ka paraqitur pikëpamjet e veta muslimanëve, të cilët ishin të obliguar jo të imitojnë cilëndo prej tyre – pasi që kishte kontradikta në drejtimit e ndryshme shkencore – por ato t'ua nënshtrorjnë analizave dhe të krijojnë një lloj sinteze në dobi të diturisë dhe të njerëzimit.

Kreu XIV

Historia e përgjithshme islame

Historia islame plot 14 shekuj paraqet një pjesë të historisë së botës. Këtu mund të theksojmë vetëm vijat kryesore të asaj historie dhe të përmendim vetëm ngjarjet më të rëndësishme.

Halifët ortodoksë

Në vitin 632 (11 sipas Hixhretit) vdiq Pejgamberi (a.s.). Gjatë 23 viteve të kaluara ai pati sukses të formulonte një fe dhe të ngrinte të gjitha pjesët e një shteti (i cili filloi si një shtet – qytet i vogël, që pas dhjetë vjetëve ta përfshijë tërë Gadishullin Arabik dhe ca pjesë të Irakut e të Palestinës). Përveç kësaj, ai pas vete la një bashkësi prej afër 100 mijë njerëzish, të frymëzuar me mësimet e tij për të vazhduar punën që ai e filloi.

Suksesi fetar i Muhamedit (a.s.) iu dha shkas, kah fundi i jetës së tij, disa aventurierëve që vetes t'ia përshkruajnë vetitë e Pejgamberit (a.s.). Shumë muaj pas vdekjes së Pejgamberit (a.s.) detyra kryesore e päsardhësit të tij, Ebu Bekrit, ka qenë shpartallimi i këtyre rrenacakëve, të cilëve disa njerëz, pasi dëgjuan për vdekjen e Pejgamberit (a.s.), iu bashkangjitën.

Në atë kohë shteti ishte në luftë me Bizantin dhe gati edhe me Persinë: një i dërguar musliman ishte

vrarë në territorin e Bizantit dhe në vend që ta qetësonte atë incident, mbreti hodhi poshtë propozimin e Pejgamberit (a.s.), madje edhe ndërmoi intervenim ushtarak për ta mbrojtur dorasin e të dërguarit nga ekspeditat ndëshkuese të muslimanëve. Përsa i përket Persisë, shumë vjet aty ka pasur përlëshje të përgjashme ndërmjet atij vendi dhe protektorateve të tyre arabe. Disa fise që jetonin në ato protektorate kishin pranuar Islamin. Aktet e dhunimeve nga ana e persianëve nuk mund të kaloheshin më e të mos bënin probleme të karakterit ndërkombëtar. Ndërkohë, të përmendim se Bizanti e Persia në atë kohë paraqisnin dy fuqi udhëheqëse të botës së atëhershme. Përsa iu përket arabëve, ata në sy të të gjithëve ishin një grusht nomadësh, pa organizim ushtarak dhe pa mjete materiale.

Me guximin që mahnit, Ebu Bekri ndërmoi njëkohësisht luftë kundër dy fuqive botërore. Në luftërat e para muslimanët pushtuan ca vende kufitare. Pastaj halifi dërgoi delegacionin në Stamboll, që të gjendet ndonjë zgjidhje paqësore, por pa sukses. Humbjet e komandantit Cezar e tronditën mbretin, i cili dërgoi njësi të reja ushtarake.

Ebu Bekri e pa të arsyeshme që disa pjesë të ushtrisë muslimane t'i transferonte nga Iraku në Siri. Në vitin 634 u shënua fitorja e re tek Ajnadini, në afërsi të Jerusalemit, dhe së shpejti edhe në Fila; atëherë Palestina përfundimisht ishte e humbur për Bizantin. Halifi i vjetër Ebu Bekri vdiq ato ditë, por pasardhësi i tij e vazhdoi detyrën që e trashëgoi. Së shpejti Damasku, pastaj edhe Emesi, në veri të Sirisë, ua çelën dyert muslimanëve. Disa fakte tregojnë se ca të nënshtruar i

pranuan muslimanët jo si armiq e si pushtues, por si çlirimtarë. Pas pushtimit të Emesit, përpjekjet e fundit të Heraklitit i detyruan muslimanët që përkohësisht ta lëshojnë qytetin dhe ca vende të tjera që të organizoheshin. Posa vendosi për tërheqjen, komandanti musliman urdhëroi që të gjithë tatimet e tubuara nga banorët jomuslimanë në tërësi t'i kthehen popullit, sepse nëse nuk mund t'u sigurohet mbrojtja, atëherë e drejta e takimit të tyre humbet. Të mos habitemi, atëherë, se të humburit me lot në sy pranuan lajmin se fituesit e tyre ishin të detyruar të tërhiqeshin prapa kufijve të vet. De Goe-i na bind: "Gjendja e shpirtërave në Siri me të vërtetë ishte shumë e përshtatshme për arabët, e që krejtësisht ishte e meritueshme, sepse shpirtmirësia me të cilën ata u sollën ndaj të mundurve ishte në kundërshtim të madh me tiraninë frikacake të zotërinjve të gjeratëhershëm (bizantëve)". Pas tërheqjes taktike, muslimanët përsëri do të kthehen, edhe më të fuqishëm dhe, gjithashtu, edhe më të dashur.

As fati i Persisë nuk ishte më i mirë. Sulmet e para kishin për qëllim pushtimin e qytetit Nira (Kufës së sotme) dhe të ca vendeve të tjera të fortifikuara. Ikja e përforcimeve ushtarake për në Siri, në Irak shkaktoi qetësi të përkohshme, por ca muaj më vonë luftimet u përtërinë dhe kryeqyteti Medain (Ktesifon) lehtë u pushtua. Mbreti Jezderxhid thirri në ndihmë mbretin e Kinës, mbretin e Turkestanit dhe sundues të tjerë. Ndihamat që iu ofruan nuk i ndihmonin asgjë, kurse aleatët e tij pësuan humbje të mëdha.

Në kohën e sundimit të Omerit (634-644) muslimanët sundonin territorin nga Tripoli (Libi) deri në

Balkha (Afganistan) dhe nga Armenia gjer në Sind dhe Gjratë (Indo-Pakistan), duke përfshirë Sirinë, Irakun e Iranin. Në kohën e trashëgimitarit të tij Othmanit (644:456), tashmë ishin sundues të Nubisë dhe gjer afër Dongolës. Muslimanët pushtuan edhe një pjesë të Andaluzisë (Spanjë), kurse në lindje e kaluan Oksusin, që të marrin edhe ca pjesë të Kinës. Ujdhesat Qipro, Rodos dhe Kretë në atë kohë ishin në pronësinë muslimane, ndërsa Stambolli përjetoj rrethimin e parë musliman. Më pak se 15 vjet pas vdekjes së Muhamedit (a.s.) muslimanët u zgjeruan nga Atlantiku deri afër Pacifikut, në një sipërfaqe më të madhe se Evropa. Në këto pushtime të rrufeshme, befason më shumë fakti se të pushtuarit nuk ishin të pakënaqur. Këtë e tregon fakti se në vitin 656, kur u paraqitën luftërat civile, në mesin e muslimanëve nuk pati asfarë turbullirash të brendshme. Mbreti bizantin nuk mund të llogariste më në shtetasit e vet të mëparshëm dhe ai u pajtua me dëmshpërblimin monetar të guvernatorit musliman në Siri, si zëvendësim për neutralitetin e mbretit.

Do të ishte gabim që shpejtësia e këtij pushtimi të shpjegohet vetëm me dobësitë e mbretërve bizantinë e sasanidë, të lodhur nga luftërat ndërmjet shoqi-shoqit. Në çfarë mase është ajo dobësi në krahasim me "fuqinë" e fitimtarëve muslimanë, të cilët nuk kishin as numrin, as pajisjet, as organizimin, e as kushtet tjera materiale? Shpjegimi nuk mund të gjendet as në shpërnguljet masive, e as në pushtimet me dhunë, nëse merret parasysh territori i gjerë nga Kina deri në Spanjë, në të cilin gjendeshin të shpërndarë një numër i vogël arabësh. Pamë se shkaqet e këtyre luftërave,

në të vërtetë, ishin politike: aspak nuk ishte qëllimi që feja të detyronte ndokë për ta pranuar atë me dhunë, pasi edhe vetë Islami këtë vendosmërisht e ndalon. Historia gjithashtu tregon se në atë kohë dhuna nuk është shfrytëzuar për ndërrimin e popujve të nënsh-truar. Motivet, siç janë plaçkitja dhe interesi ekonomik, edhe më pak e sqarojnë shpejtësinë e pushtimeve. As ndërrimi i zotërisë, shikuar nga ana e të mundurve si përmirësim, nuk jep sqarime. Dokumentet e asaj kohe, të gjetura në papiruse në Egjipt në kohë të fundit, tregojnë se muslimanët barrën e tatimit shumë e kanë lehtësuar, çka është rast edhe në vendet tjera të pushtuara. Shpenzimet e administratës gjithashtu ishin zvogëluar, duke iu falënderuar jo vetëm modestisë dhe jetës së thjeshtë të arabëve, por edhe ndershmërisë së funksionarëve muslimanë. Plaça e luftës, sipas Islamit, nuk iu takon ushtarëve, por pushtetit, i cili më tutje ua ndan pjesëmarrësve të ekspeditave ushtarake ashtu siç e parasheh ligji islam. Halifi Omer shpesh habitet me ndershmërinë e ushtarëve dhe oficerëve, të cilët i dorëzonin gurët e çmueshëm dhe sendet tjera me vlefte të madhe, të cilat shumë lehtë mund t'i fshihnin.

Përfundojmë me një dokument të të krishterëve të asaj kohe. Ai përmban letrën e një peshkopi nesuroni-an drejtuar një shokut të vet (Assemani, *Bibl. Orient.* III, faq.2, XCVI): “Këta taitët (arabët), të cilëve në kohën tonë iu dha zoti dominim, janë bërë zotërinjtë tanë; ata nuk e luftojnë fenë krishtere; ata e mbrojnë fenë tonë, i nderojnë priftërinjtë dhe njerëzit e shenjtë dhe i shpërblejnë kishat dhe manastiret tona”.

Emevijëtë

Pas vdekjes së Kalifit III, bota islame hyri në periudhën e luftërave të brendshme për pushtet, të cilat përafërsisht vazhduan 20 vjet. Gjysma e sunduesve gjatë asaj kohe u ndërruan në krye të shtetit. Me ardhjen e Abdul Melikut (685-705), pushteti forcohet dhe fillon vala e re e pushtimeve. Maroko dhe Spanja, në një anë dhe India Veriore dhe Transaksonia në anën tjetër, iu bashkangjitën territoreve muslimane. Bordo, Narbon dhe Tuluzi (në Francë) gjithashtu ranë në duart e muslimanëve. Kryeqyteti i shtetit transferohet nga Medina në Damask. Mirëpo, kur qyteti i Pejgamberit (a.s.) ia lëshoi vendin e vet deri vonë një qyteti bizantin, edhe zjarri fetar ua lëshoi vendin tentimeve profane. Nuk mungonte as luksi, as plangprishësia, as padrejtësitë me kryengritjet që ishin rezultat i tyre, por nuk mungonin as trimëritë intelektuale dhe shoqërore të reja. Ekonomia mori hov të madh; medicina veçanërisht ishte lëndë e kujdesit të pushtetit, i cili pati marrë përsipër të përkthente në gjuhën arabe shumë vepra të huaja, greke e të tjera. Sundimi i shkurtër i Omer ibn Abdulazit (817-820) veçanërisht ishte brilant: ky Halif me devotshmërinë e tij përtëriu kohën e Ebu Bekrit dhe të Omerit. Ai i dha të revidohen të gjitha regjistrimet e konfiskimeve të mëparshme, pastaj mjetet t'ua kthejë pronarëve të vërtetë ose trashëgimtarëve të ligjshëm. Ndërpreu futjen e tati-meve të paarsyeshme. Bile shkoi aq larg, sa urdhëroi

që të rikthehen disa qytete të pushtuara me dhunë nga ana ushtrisë muslimane. Rezultati ishte i çuditshëm: në fillim të kësaj dinastie të ardhurat e Irakut, p.sh., arrinin në 100 milionë derhemë, që të bien në 18 milionë në kohën e sundimitarit të ardhshëm Omeri II, ndërsa gjatë sundimit tjetër, ato u rritën në 120 milionë derhemë. Zjarri fetar i Omerit II aq i entuziazmoi mbretërit e Sindit, sa që edhe ata e pranuan Islamin. Interesimi për studimin e fesë përsëri mori hov, kështu që u lajmërua plejada e tërë e shkencëtarëve të cilët nën krahët e bashkësisë islame krijuan kuptimin për shkencë. Eliminimi i korrupsionit ndikoi shumë në përmirësimin e administratës shtetërore.

Prej përmendoreve arkitektonike të asaj kohe duhet të përmendim kupolën e ndërtuar më 691 në shkrepat e Jerusalemit. Gërmadhat dhe mbeturinat e përmendoreve tjera në Damask dhe në vendet tjera tregojnë zhvillimin më të hershëm të muslimanëve në atë kohë. Ekzistojnë dëshmi edhe për zhvillimin e menjëhershëm të muzikës në atë kohë; mirëpo, pasi që shenjat e notave në atë kohë ende nuk kanë qenë të vërtetuara, rëndë është sot të jepen informata më të afërta për këtë temë. Dy sektet e mëdha brenda muslimanëve, sunitët dhe shiitët, gjithashtu rrjedhin prej asaj kohe. Këta lindën nga një çështje politike: a thua se trashëgimtarët e Pejgamberit (a.s.) duheshin emëruar përmes zgjedhjeve apo ata patjetër, sipas së drejtës së trashëgimisë, të zgjidheshin nga mesi më i ngushtë i farefisit të Pejgamberit (a.s.). Meqenëse për sunitët kjo ishte çështje fetare, erdhi gjer te përçarja, e cila shkaktoi luftë civile. Një nga ato kryengritje i dha

fund dinastisë Emevije, e cila duke filluar prej viti 750 vendin ia lëshoi dinastisë Abasijje. Sot në mesin e muslimanëve ka afër 10 për qind shiitë, kurse pjesën tjetër e përbëjnë sunitët, nëse nuk llogarisim një drejtim/sekt krejt të vogël të Harixhijve, që paraqitet në të njëjtën kohë.

Abasijtë

Ardhja në pushtet e dinastisë Abasijje përputhet me përçarjet e para politike brenda botës së vetme të vendeve islame. Mbretëria më së pari u përgjysmua në principata të shumta e të pavarura. Kordova (Spanjë) u rrit në Halifat të veçantë rival, i cili gjer në rënien e vet në vitin 1492 mbeti i ndarë nga Halifati lindor, kur Bagdadi e zëvendësoi Damaskun si kryeqytet i ri.

Historia Abasijje nuk është e njohur sipas pushtimeve të mëdha, nëse përjashtohen këto ndërmarje të princërve rajonalë, të cilët vetë e pranuan Halifatin e Bagdadit për sovran të tyre, por prapëseprapë nuk vareshin për asgjë prej tij, si në politikën e jashtme, ashtu edhe në administratën e brendshme. Këtu nuk do të merremi me historinë e kontinentit të Indisë, për të cilën do të flasim në një kaptinë të veçantë. Marrëdhëniet me Bizantin ishin gjithnjë më të përgjakshme dhe Mbretëria greke u detyrua ta lëshonte përfundimisht Azinë e Vogël e të kënaqet edhe për një kohë me pronat e veta në Evropë.

Abasijtë filluan me praktikën e huazimit të merce-narëve, me prejardhje turke, të cilët me vete sollën fillimin e feudalizmit dhe pavarësimin e mëtutjeshëm të autonomive: këtu gjejmë “dinastinë” e guvernatorëve. Përafërsisht një shekull pas ardhjes në pushtet, Halifët abasijë ngadalë i transferonin prerogativat e tyre tek ata guvernatorë “centrifugalë”. Dalëngadalë sovraniteti i tyre i vërtetë zbriti në brendinë e pallatëve të tyre, ndërsa krejt të tjerat erdhën nën kontrollin e emirit, prej të cilëve më i fuqishmi e zuri kryeqytetin. Në atë zhvillim të pushtetit të Halifëve hasim në dallime interesante në marrëdhënie me zhvillimin e fuqisë së papës. Në fillim papa ishte pa asfarë pushteti politik, pastaj dalëngadalë ai pushtet rritet, gjersa u krijua Mbretëria e shenjtë romake, kur papa u bë më i fuqishëm se mbreti, kështu që përsëri dalëngadalë e humbi këtë fuqi... Halifët filluan si sundues të fuqishëm, më vonë e ndanë pushtetin me sulltanët e më në fund u bënë vetëm figura reprezentative dhe sovranë nominalë, pa kurrfarë ndikimi.

Gjatë kohës së Abasijëve edhe guvernatori i Tunisit ishte i thirrur të intervenonte në luftërat civile në Sicili. Ai e mori jo vetëm atë ujdhesë, por edhe një pjesë të madhe të Italisë, duke arritur gjer te muret e Romës, duke u përforcuar në jug të Francës dhe në një pjesë të rëndësishme të Zvicrës. Ai i takonte dinastisë Aglebije, të cilët haptazi, me forcë, i zëvendësuan Fatimijtë. Këta anëtarë të sektës shiite pastaj kaluan në Kajro, ku themeluan një Halifat rival. Edhe pse ata, marrë në përgjithësi, ishin sundues të arsimuar, një prej Fatimijve në momentin e çmendisë la pas dore

zhvillimin dhe përkujdesjen e vendeve të shenjta të të krishterëve në Jerusalem. Ky veprim hasi në reagim të madh në Evropë, prandaj papët filluan të shpjegojnë luftën e shenjtë kundër Islamit. Pasi seria e luftërave të kryqëzatave, të cilat e përgjakën Lindjen dhe Perëndimin gjatë dy shekujve. Në kohën e luftës së kryqëzatës së parë Fatimijtë e lëshuan Palestinën, kurse të pafajshmit u bënë viktimë e pushtuesve fanatikë. Aq më tepër, Fatimijtë lidhën aleancë me kryeqëzatat kundër shteteve të Levantit. Kurdët dhe turqit gjithnjë e më shumë i ndërronin arabët në luftërat kundër Perëndimit. Salahudini, hero musliman gjatë luftës së dytë të kryqëzatave, jo vetëm që i përzë evropianët nga Siria dhe Palestina, por i shkatërron edhe Fatimijtë në Egjipt. Salahudini dhe trashëgimtarët e tij në Egjipt pranuan Halifatin e Bagdadit, por ky kurrë nuk mundi ta kthente fuqinë e vet politike, e cila ishte e ndarë në shumë shtete të vogla. Disa prej tyre patën sukses të zgjerojnë kufijtë e shtetit islam.

Në vitin 921 mbreti i bullgarëve (krahinë rreth Kazanit, në lumin Vollga të Ruisë) lypsi prej Bagdadit që t'i dërgohet një misionar musliman. Atje u dërgua Ibn Fadlan-i. Sipas tregimit, me të vërtetë interesant, që e kemi për udhëtimin e tij, si duket mbreti ka pranuar Islamin dhe krijoi një ishull të vogël musliman në këtë vend joislam. Islamizimi i Kaukazit dhe i territoreve fqinje vazhdoi të përhapej dalëngadalë.

India

Me pushtimin e Indisë, filloi dinastia e Gaznevive nga Afganistani. Pas ca dinastive, të cilat u pajtuan me veriun e shtetit, kilitët u drejtuan kah jugu. Një komandant i zi, Malik Kafuri, në një ekspeditë brilante arriti gjer te Kepi i Kamarinës; por, më vonë, India do të arrijë krijimin e shtetit islam në atë territor. Prapëseprapë, sunduesit më të famshëm në Indi kanë qenë Mogulët e Mëdhenj (1526-1858). Brenda një kohe të gjatë ata sunduan afërsisht me tërë territorin e këtij vendi të gjerë dhe numëroheshin ndër të Mëdhenjtë në botë. Pushteti i tyre qendror në shekullin XVIII filloi të dobësohet në të mirë të guvernatorit të provincës, por në vitin 1858 britanikët më në fund e shtynë që t'ia bashkangjesin kurorës britanike tre të pestat e vendit. Pjesën tjetër e ndanë mes vete shtetet autoktone, prej të cilave disa ishin islame. Këto shtete të vogla të pavarura e kanë ruajtur kulturën indo-muslimane gjer më sot. Njëri prej tyre, Hadarabadi, në qendër të Indisë, me madhësi sa Italia dhe me më tepër se 20 milionë banorë, veçanërisht na e tërheq vëmendjen me reformën e mësimit islam; universiteti i tij i tipit evropian perëndimor përbëhet prej dhjetë fakulteteve, ndër të cilat është edhe fakulteti i shkencave islame. Në të gjitha shkallët dhe në të gjitha fakultetet mësohet në gjuhën amtare, urdu, dhe shkruhet në alfabetin arab. Gjuha arabe, Fikhu (drejtësia islame) dhe Hadithi (shënime nga jeta dhe fjalët e Pejgamberit

/a.s./), kanë qenë lëndë të detyrueshme, krahas gjuhës angleze, matematikës dhe lëndëve të tjera të mësimit modern. Në universitet studentët e Fakultetit të Shkencave Islame kanë mësuar jo vetëm gjuhën angleze në shkallë të lartë profesionale, por edhe arabishten, si dhe lëndët tjera të pastra islame. Përveç kësaj, kanë ekzistuar edhe studime komparative: bashkë me fikhun, është mësuar paralelisht shkenca juridike moderne, me Ilmi Kelamin - historia e filozofisë perëndimore në gjuhën arabe, hebraishtja ose një gjuhë evropiane, veçanërisht frëngjishtja ose gjermanishtja. Derisa studentët përgatisnin punimet e tyre, kanë pasur nga dy mentorë: një profesor nga Fakulteti i Teologjisë dhe një sipas natyrës së punimit, nga Fakulteti i Drejtësisë ose i Letërsisë. Kjo mundësonte që paralelisht, në të njëjtën lëndë, të studiohen faktet mbi Islamin dhe kuptimet moderne perëndimore. Pas tridhjetë vjet pune dhe rezultateve të jashtëzakonshme, prej atyre mundimeve kulturore kanë mbetur vetëm kujtimet. Pasi, kur britanikët në vitin 1947 e lëshuan përgjithmonë këtë vend, do ta ndajnë në Pakistanin musliman dhe në Baratin jomusliman. Ky i fundit jo vetëm që i bashkonte shtetet autoktonte, por i çinte gronte dhe i bashkonte në kombinime të tyre administrative, duke krijuar “popullsi” gjuhësore.

Të kthehemi në temën tonë kryesore. Vëzhguesi pasiv, Halifi i Bagdadit, asistonte në kryengritjet e shpeshta të provincave: grusht shtetet ata i ndanin në dy ose më tepër pjesë, ose, në të kundërtën, i bashkonin në një dorë, duke i ndërruar guvernatorët. Megjithatë, rrallë ndodhte që jomuslimanët të merrnin ven-

din musliman. Do të theksojmë vetëm rastin e selxhukëve. Kur ata u paraqitën në shekullin XI, shpejt e pushtuan jo vetëm Azinë Qendrore, por arritën gjer te kufijtë e Azisë së Vogël. Pas disa gjeneratave të sundimit të shkëlqyeshëm, ata një pjesë të madhe të vendit të tyre ua lëshuan turqve otomanë, siç i quajmë na. Këta të fundit kaluan Bosforin për të zgjeruar krahinën e tyre gjer te muret e Vjenës. Kryeqyteti i tyre në fillim ishte Konja, pastaj Stambolli, e tani Ankaraja. Tërheqja e tyre fillon në shekullin XVIII, duke e lëshuar Evropën dhe përfunduan në vitin 1919, kur humbën të gjitha pronat në Luftën e Parë Botërore. Ngjarjet e volitshme ndërkombëtare, prapëseprapë, i bënë të mundur Turqisë të zhvillohet në republikë, në fillim krejtësisht nacionaliste e laike e në të ardhmen demokratike, gjithnjë më tepër u përshtatet ndjenjave fetare të popullit, i cili është thellësisht islam. Në shek. XVI Perandoria Otomane në Evropë shtrihej gjer në Austri, në Afrikë, gjer në Algjeri, kurse në Azi nga Georgjia gjer në Jemen, duke kaluar nëpër Azinë e Vogël dhe Mesopotami. Ca nga pronat e tyre të vjetra të islamizuara, sot janë shtete të pavarura; ca ranë nën pushtetin sovjetik, ndërsa ato me popullsi jomuslimane krejtësisht janë ndarë nga Turqia.

Në shek. XIII një pjesë e tatarëve ende nuk kishin pranuar Islamin. Hulagu, i cili i udhëhiqte, jo vetëm që ndërkohë i mbyti qindra mijëra muslimanë, por në vitin 1258 e shkatërroi kryeqytetin Bagdad. Prapëseprapë, ushtria e tij u thye në Palestinë nga Bajberi, mbreti musliman nga Egjipti. Hulagu ndërmori edhe një ofensivë, duke lidhur aleancë me kryqëzatat, por

pa sukses. Kjo ngjarje shënon fillimin e rënies së civilizimit musliman dhe fillimin e zhvillimit të civilizimit perëndimor. Edhe në shekullin tonë, XXI, muslimanët janë prapa në këtë fushë në krahasim me evropianët dhe amerikanët. Duhet të përmendim se përpjekjet e mistikëve muslimanë për t'i përfituar tatarrët barabarë gati patën sukses. Kur u islamizuan, ata jo vetëm që luftuan për Islam, por edhe kolonizuan shumë shtete të Evropës Lindore. Edhe sot ka gjurmë të tyre në formën e bashkësive islame në Finlandë, Lituani, Poloni, ish-BRSS etj.

Halifati andaluzian

Siç përmendëm më lart, me ardhjen e dinastisë Abasijje në pushtet Spanja ndahet nga lindja muslimane. Përafërsisht pas 1000 viteve, në vitin 1942, gjurmët e fundit të mbretërisë muslimane këtu do t'i shkatërrojnë të krishterët kastilianë. Ky sundim i gjatë për Spanjën ishte jo vetëm periudhë e përparimit të madh, por veçanërisht burim i prestigjit: fakultetet muslimane të Spanjës nuk pushuan të tërheqnin studentë nga të katër anët e Evropës. Mbeturinat e arkitekturës muslimane, ende të dukshme në Gadishullin e Pirinejeve, tregojnë përparimin mahnitës në këtë lëm. Pas humbjes ushtarake, muslimanët kanë përjetuar persekutime të përgjakshme nga misionarët e krishterë. Përveç kësaj, ata kanë qenë të detyruar të shikojnë edhe shkatërrimin masiv të bibliotekave, kur

janë djegur qindra-mijëra dorëshkrime. Kjo ka ndodhur para se të zbulohet shtypshkronja. Dëmi ka qenë i pazëvendësueshëm.

Lindja dhe juglindja e Azisë

Kina asnjëherë nuk e ka përjetuar pushtetin politik musliman. Duke ardhur në Azinë Veriore, muslimanët islamizuan provincën Sing-Kjang, sigurisht përmes detit arritën deri te provinca Jun-Nan. Ata këtu kishin principata të përkohshme, por duke iu falënderuar veçanërisht veprimit paqësor të misionarëve muslimanë, shumë milionë kinezë dhe tibetianë e pranuan Islamin. Mirëpo, shumica e kinezëve mbetën ende jashtë besimit monoteist islam.

Historia e Azisë Juglindore është krejtësisht ndryshe. Në shekujt e fundit këtu janë kthyer tregtarët muslimanë nga Jugu i Arabisë dhe nga Jugu i Indisë. Duke iu falënderuar përpjekjeve të tyre, është islamizuar jo vetëm Gadishulli i Malajzisë, por edhe mijëra ujdhesa të tjera në rajonin e ri. Islami sundoi jo vetëm në Indonezi, por gjithashtu edhe në ujdhesat jugore të Filipineve. Të ndarë në një numër të madh principatash, këtë territor dalëngadalë e sunduan evropianët, kryesisht anglezët dhe holandezët. Pas shumë shekujve të sundimit të huaj, Indonezia (me 70 milionë muslimanë) fitoi pavarësinë e vet. Gadishulli i Malajzisë e riktheu sovranitetin e vet në suazat e Komonveltit Britanik.

Afrika

Afrika Veriore, nga Egjipti gjer në Marok, territorit islam iu bashkangjit shumë herët. Për ekzistencën e këtij kontinenti historitë janë të ndryshme dhe lëvizin nga territori në territor. Afrika Lindore ka qenë natyrisht e para, për shkak të afërsisë me Arabinë, që pranoi ndikimin islam. Këtu jo vetëm territoret e mëdha kaluan në Islam, por këtu kanë ekzistuar shtete muslimane të rëndësishme.

Afrika Perëndimore ka njohur Islamin shumë më vonë, por përpjekjet energjike të disa sunduesve, gjithsesi në përputhje me kulturën e vendit të asaj kohe, përvetësuan pjesë të mëdha të këtij territori të fesë. Këtu gjatë shekujve gjejmë mbretëri të vërteta muslimane. Sipas fjalëve të kronistëve arabë, prej këtu rrjedhin detarët që të parët zbuluan rrugën për në Amerikë, veçanërisht rrugën për në Brazil. Evropianët e parë me Kristofor Kolombin dhe pasardhësit e tij gjetën atje banorë të zinj. Përpos shkatërrimit të dokumenteve historike, ka bazë besimi se jo vetëm muslimanët e Afrikës së zezë, por edhe berberët kanë marrë pjesë në kolonizimin e Amerikës. Këtë e tregon edhe vetë emri Brazil, duke marrë parasysh se Brizalah është emri i një fisi të njohur berber dhe se anëtarët e përbashkët të atij fisi quhen me emrin e përbashkët Brazil. Kjo fjalë nuk është as braziliane, as evropiane. Është rasti i njohur me ujdhesën Palma në mes të Ujdhesave të Fatit (Ujdhesës Kanarike në Oqeanin

Atlantik), të cilat dikur janë quajtur Bene Hoare, sipas emrit të njohur të një fisi tjetër berber, Beni Huara, që vërteton supozimin mbi Brazilin. Këto marrëdhënie afrikano-amerikane, nën muslimanët, vazhduan deri me rënien e Spanjës muslimane dhe me fillimin e kolonizimit evropian të Amerikës, për të cilën gjë flasin shumë fakte historike. Vetë Afrika ra nën dominimin e fuqive evropiane: të Francës, Gjermanisë, Portugalisë, Belgjikës etj. Shumë krahina kurrë nuk kanë njohur sundimin musliman, por Islami këtu pandërprerë është përhapur deri më sot, me gjithë kundërshtimet e fuqishme të pushteteve perëndimore dhe marionetave të tyre.

Me dekolonizimin e kohëve të fundit, shumë vende me shumicë muslimane u bënë të pavarura, edhe pse disa prej tyre i janë nënshtruar tiranisë dhe persekutimeve të diktatorëve jomuslimanë. Territorët tjera shkojnë kah autonomia më e madhe.

Bota e sotme

Nga Indonezia e deri në Marok ka më shumë se 30 shtete islame, të cilat janë anëtare të OKB. Në Evropë e kemi Turqinë dhe Shqipërinë, ndërsa në ish-BRSS ka një numër republikash muslimane, autonomia e të cilave, si duket, gradualisht rritet, bile edhe në pikëpamje të fesë islame. Komonvelti Britanik tregon se as lidhshmëria në grupin e shteteve jomuslimane nuk e pengon pavarësinë e vërtetë të anëtarëve

muslimanë, me kusht që ata që gjenden në krye të kenë inteligjencë të mjaftueshme dhe altruizëm që të duan më tepër interesin nacional nga ai personal. Nëse Spanja, Franca, ish-BRSS, India, Kina u mundëson bashkësive islame të vendeve të tyre që të zhbillohen pavarësisht, lufta nuk do të ishte e domosdoshme dhe të gjithë do të mund të jetonin në harmoni dhe bashkëpunim për mirëqenien e të gjithëve.

Islami sot është përforcuar brenda të gjitha racave kryesore (përfshi dhe lëkurëkuqit e Amerikës). Muslimanët të cilët flasin gjuhën arabe janë të rëndësishëm veçanërisht, pse gjuha e tyre është thesar i shkencave burimore islame, para së gjithash i Kur'anit dhe Hadithit. Indo-pakistanezët paraqesin dy grupe etnike më të mëdha. Raca e zezë e ka atë domethënie që e ka ruajtur fuqinë e vet burimore. Shkencëtarët, si prof. Tajnbi, vendosmërisht vërtetojnë se udhëheqja e civilizimit të ardhshëm njerëzor do t'u takojë popujve të zinj. Në atë racë Islami ka përfituar ithtarë të shumtë; është e njohur flaka e dashurisë së ithtarëve të rinj.

Numri i muslimanëve në botë asnjëherë nuk mund të vërtetohet në mënyrë precize. Mirëpo, është krejtësisht e njohur se një e katërta ose një e pesta e pasardhësve të Ademit (a.s.) dhe të Havasë kthehen kah Qabeja (në Mekë) që të shprehin "*Allahu ekber-in*" (Allahu është më i madh).

Kreu XV

Jeta e përditshme e muslimanit

Lindja

Në fenë që s'është e rezervuar për një racë a një vend, por i është proklamuar tërë njerëzimit, ekzistojnë dy mënyra që të mund njeriu të bëhet anëtar i bashkësisë: hyrja vullnetare dhe hyrja pa dëshirën e vet.

Hyrja vullnetare e njeriut të rritur, plotësisht të ndërgjegjshëm për qëndrimet e veta dhe të lirë në zgjedhjen e vet, bazohet në atë "deklarimin me gojë dhe dëshmimin me zemër", për të cilën ka folur Pejgamberi (a.s.). Pas larjes apo dushit, me qëllim që trupi simbolikisht të lahet prej njollave të padijes, besimtari i ri shqipton, zakonisht para dy dëshmitarëve, deklaratën që vijon:

*"Besoj se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut
dhe besoj se Muhamedi (a.s.) është Pejgamber i Allahut".
(Esh-hedu en lailahe il-la-llah,
ve eshhedu en-ne Muhameden resulullah).*

Pejgamberi (a.s.) kishte zakon që besimtarët e rinj t'i pyeste se si quheshin; nëse emrin, për ndonjë arsye, e kishin të papajtuëshëm me Islamin, ai e ndërronte dhe personit përkatës i jepte ndonjë emër të përshtatshëm. P.sh. nëse dikush është quajtur "adhurues i Qa-

besë” ose “adhurues i Diellit”, ose “i çrregullt”, ose “i humbur”, Pejgamberi (a.s.) nuk lejonte ndonjë emër të këtillë. Në kohën tonë besimtarët e rinj zakonisht marrin ndonjë emër arab, pasi arabishtja konsiderohet si gjuhë amtare e Pejgamberit (a.s.) dhe e grave të Pejgamberit (a.s.) – të cilat edhe vetë janë quajtur “nëna të besimtarëve” – dhe prandaj meriton të konsiderohet si gjuhë amtare e çdo muslimani. Secili musliman, të paktën si detyrë shoqërore, duhet ta dijë aq gjuhën arabishte (më së paku alfabetin) sa është e domosdoshme që të mund të lexojë tekstet e Kur’anit. Ata që posa kanë pranuar fenë, gjithmonë i kanë dhënë rëndësi kësaj detyre, prandaj shkrimi arab ia kanë përshatur gjuhët e tyre kombëtar: persishten, turqishten, malajzishten, urden etj. Është e rekomandueshme (e prefeueshme), pra, ata që posa kanë pranuar fenë islame të zotërojnë shkrimin arab, që të mund ta përdorin në gjuhën e tyre amtare, bile për kontakt me muslimanët. Ky këshillim ka edhe domethënien praktike, sepse shkrimi arab, duke i patur të gjitha vokalet dhe shenjat e duhura, paraqet shkrimin më preciz në botë, larg çdo pavendosmërie; e të mos flasim për bukurinë dekorative, të vërtetë, që ka ai.

Sa i përket hyrjes në fe me dëshirën e vet (në rastin e bindjes), ajo po ashtu ka formën e vet. Nëse fëmija ka lindur në familjen muslimane, mamia posa ka kryer punën e vet, në veshin e djathtë të fëmijës thirret ezani, kurse në veshin e majtë kameti. Kështu që fjalët e para që i dëgjon fëmija dhe i drejtohen atij janë vërtetim i fesë, thirrje për të adhuruar Krijuesin e vet, që shkurtimisht është edhe thirrje për të mirën e vet.

Ia përmend besën, që ia ka dhënë shpirti i tij qysh në ezel Allahut (xh. sh.) e që e përmend edhe Kur'ani (7:172): “Dhe, kur Zoti yt nga kryqet e të bijve të Ademit nxori pasardhësit e tyre dhe kërkoi prej tyre të dëshmojnë kundër vetes: ‘A nuk jam unë Zoti juaj?’ ‘Po si jo, thanë ata, ne dëshmojmë, që të mos thoni në ditën e kiametit ‘Ne kemi qenë indiferentë ndaj kësaj’”. Ezani ose thirrja në namaz në përkthim ka këtë kuptim: “Allahu është më i madh” (duke e përsëritur 4 herë); “Unë besoj se Muhamedi (a.s.) është i dërguar i Allahut” (2 herë); “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut” (një herë). Kameti ose lajmërimi për të filluar namazin ka këtë kuptim: “Allahu është më i madh”; “Unë besoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut; Unë vërtetoj që Muhamedi është i dërguar i Allahut”; “Ngrihuni për në namaz, ngrihuni për në namaz, ngrihuni për në shpëtim; namazi fillon (2 herë): “Allahu është më i madh; nuk ka zot tjetër përveç Allahut”.

Fillimi i jetës

Kur fëmijës për herë të parë i rruhen flokët, aq sa peshojnë flokët fukarenjve iu ndahet sadaka në argjend ose në vlerën e argjendit. Sipas mundësive, pritët një dele (kurban – akike), mishi i së cilës iu ndahet të varfërve. Koha në të cilën duhet të bëhet syneti fëmija mashkull nuk është e kufizuar, mirëpo kjo praktikohet në vitet e hershme. Ndërsa për ata që kanë pranuar fenë rishtas, syneti nuk është borxh.

Kur fëmija rritet për të shkuar në shkollë, zakonisht pas vitit të katërt, organizohet një solemnitet familjar ku fëmija merr mësimin e parë. Në atë rast para fëmijës lexohen 5 ajetet e para të sures së 96-të të Kur'anit, të cilat njëherit janë edhe ajetet e para që i janë shpallur Pejgamberit *ummij* (që nuk ka ditur shkrim-leximin), e të cilat rekomandojnë shkrim-leximin. Prej fëmijës kërkohet që të përsërit fjalë për fjalë. Teksti në përkthim është ky:

*“Lexo, në emër të Zotit tënd, që të ka krijuar;
Që krijoi njeriun prej gjakut të trashë.
Lexo! Se është fisnik Zoti yt,
Që të mësoi penën.
Që mësoi njeriun çka nuk ka ditur.”*

Më vonë, kur fëmija do të aftësohet, i tregohet se si duhet të falë namazin, duke mësuar gradualisht, që përmendsh të recitojë tekstet, për të cilat do të flasim më vonë. Kur ai mbush shtatë vjeç, prindërit duhet të aplikojnë edhe masa dënimi, që t'i mbetet shprehi namazi.

Agjërimi është i obligueshëm, sikurse namazi, posa fëmija arrin në moshën e pubertetit. Në familjet muslimane fëmija ushtrohet shumë më herët. Në të vërtetë, është gëzim dhe hare kur djali ose vajza agjërojnë ditën e parë të muajit të Ramazanit. Zakonisht fëmija fillon të agjërojë në moshën 12-vjeçare, e pastaj shumë e më shumë, gjatë viteve të ardhshme, kështu që në pubertet të jetë i aftë të agjërojë tërë muajin.

Haxhi (pelegrinazhi në Meke) është i obliguar një herë gjatë tërë jetës. Gjatë javës së dytë të muajit të 12

lunar – Dhulhixhe-xhe – haxhilerët tubohen në Meke e pastaj, për afërsisht një javë, vizitojnë vendet e shenjta në afërsi të Mekes (Arafatin, Muzdelifen, Minaanë). Qeveria saudite siguron udhërrëfytes të aftë, të cilët kanë për detyrë të njoftojnë secilin haxhi për atë se çka duhet të bëjë e kështu të kryejë obligimet, duatë .

Gjatë haxhit burrat i heqin teshat e zakonshme dhe veshin *ihramin* ritual, i cili përbëhet prej dy pjesëve të pëlhurës së paqepur. Me një rën mbështjell pjesën e poshtme të trupit, duke filluar mbi kërthizë e duke shkuar gjer mbi gju, ndërsa pjesa tjetër mbështjell pjesën e epërme të trupit, në përjashtim të kokës, e cila mbetet pa u mbuluar (gratë mbajnë teshat e zakonshme, të cilat duhet t'iu përgjigjen normave të përhershme të sheriatit; duke mbuluar tërë trupin, në përjashtim të fytyrës, duarve deri në nyjë dhe këmbëve gjer te zogu i këmbëve). Prej momentit kur veshin *ihramin* e gjer kur ta zhveshin, gjithmonë duhet t'iu përgjigjen thirrjes së Allahut, të këndojnë *telbije*, sidomos në fund të çdo namazi. Të huajt *ihramin* e veshin prej *mikati* (vend i caktuar që iu përgjigjet të gjitha drejtimeve). Ndërsa Mekasit kanë *mikat* të caktuar, të veçantë, që është në afërsi të Mekes. Pastaj shkohen në Arafat, ku kalohet një ditë (9 Dhulhixhe) në lutje dhe ibadet; nata kalohet në Muzdelife; ditët 10, 11 e 12 të njëjtit muaj kalohen në Mina. Gjatë kësaj periudhe në mënyrë simbolike gjuhet shejtani; bëhen vizita të shkurta në Mekë; bëhet *tavafi* dhe shtatë herë kalohet vendi prej Safasë gjer në Merve (*sa'j*); për të cilët ka dua të posaçme e që duhet të lexohet gjatë kryerjes së këtyre veprave.

Me rastin e kryerjes së *umres*, vetëm bëhet *tavafi* dhe *sa'aji*. Për këtë ritual, kur vishet ihrami, bile edhe bano-rët e Mekes patjetër duhet të dalin jashtë Mekes (*mikat*).

Zeqati

Zeqati është ibadet me pasuri në shtimin e realizuar të pronave të ndryshme: në bujqësi, tregti, eksploatimin e xeheve, blegtori, gjedhe ose deve të cilat kullosin. Zeqati aplikohet edhe te kursimet. Kjo kategori e fundit (zeqati i kursimeve) i është lënë ndër-gjegjes së vet individit, ndërsa zeqatin me kriteret tjera e zbaton pushteti vendas. Ashtu që, nëse dikush kursen një shumë të konsiderueshme (në kohën e Pejgamberit (a.s.) ka qenë 200 derhemë minimumi ose në të holla të argjendta të asaj vlere, së cilës për afërsisht i përgjigjet 68 N.f. ose 5 funta ose 14 dollarë) dhe nëse kjo shumë mbetet në arkë gjatë tërë vitit, ai është i detyruar të paguajë 2,5 për qind në emër të zeqatit. Nëse dikush ka borxhe, ato hiqen prej asaj që është kursyer me rastin e llogaritjes së zeqatit. Zeqati jepet drejtpërdrejt ose përmes organizatës së Bashkësisë Fetare. Sipas Kur'anit (9:60), këtë zeqat e shfrytëzojnë ata që duhet të përfitohen në Islam, robërit (që të blihen), borxhlinjtë (të varfrit, mbledhësit e zeqatit, ata zemrat e të cilëve duhet të shpaguehen), luftëtarët në rru-gën e Allahut dhe udhëtarët. Shuma vjetore e zeqatit mund t'i jepet një kategorie shfrytëzuesish ose më shumë kategorive të tilla .

Një lloj i të dhënave të tjera ka të bëjë me dy manifestimet fetare. Kah fundi i muajit të agjërimit, një shumë e cila mjafton për një ushqim të njeriut të rritur gjatë një dite i jepet ndonjë të varfri. Në manifestimin tjetër, i cili mbahet në kohën e haxhit në Meke, të pasurit duhet të therin një dele për kurban, një pjesë e së cilës iu jepet të varfërve, ndërsa pjesën tjetër e hanë familja me dashamirësit.

Përsa u përket çështjeve të të hollave, duhet të cekim se nuk i lejohet muslimanit të marrë pjesë në veprimet me bazë kamatën, huatë, lojrat e bixhozit, lotarinë e të ngjashme me këto. Askush nuk e paguan kamatën prej vetëdëshirës! Pra, duhet t'u largohemi e të mos lypim kamatë në huatë e dhëna. Kamatën që e jep banka për depozitet është çështje më e ndërlikuar dhe varet nga mekanizmi i organizatës administrative të bankës. Nëse banka është për kamatë, të ardhurat e fituara nga ato janë të ndaluara; megjithatë, në ca shtete nuk ekzistojnë humbje të tjera të bankave; atëherë refuzimi i pranimit të kamatës mund të ketë pasoja të dëmshme për çështjen islame: p.sh. shumat e pangritura të kamatës banka mund t'i investojë në punë që janë të orientuara kundër Islamit. Në raste të tilla duhet të merret kamata në kursimet (depozitet), por nuk duhet të shpenzohen për çështjet personale, por të jepen për qëllimet e besimtarëve.

Janë të lejuara sigurimet me marrëveshje shtetërore dhe të tipit nacionalizim, si dhe shoqatat e sigurimit në formë të reciprocitetit; shoqatat e sigurimit dhe entet e ngjashme në bazë kapitaliste nuk janë të lejuara.

Martesa

Muslimani ka të drejtë të martohet jo vetëm me muslimanen, por ka të drejtë të martohet edhe me hebrejen e me të krishteren, e jo edhe me gruan që është idhujtare, politeiste ose ateiste. Muslimania nuk mund të martohet me një jomusliman.

Nëse ndodh që njeriu i martuar të pranojë Islam-in, ndërsa gruaja e tij është hebreje ose e krishterë dhe ajo nuk do të ndjekë shembullin e burrit të vet, kjo nuk ndikon në martesë. Mirëpo, nëse gruaja i takon kategorisë së grave që nuk iu lejohen muslimanëve dhe ajo mbetet në fenë e vet, jeta bashkëshortore patjetër duhet të ndërpritet menjëherë; gruas i jepet kohë e mjaftueshme që të mendohet, pas së cilës mbetet vetëm ndarja.

Nëse një grua e martuar e pranon Islamin, e burri i saj nuk është musliman, jeta bashkëshortore patjetër duhet të ndërpritet dhe pas kohës së mjaftueshme për t'u menduar që i jepet burrit të saj, ajo përfiton ndarjen gjyqësore dhe kështu kurora fshihet (prishet).

Vdekja

Në shtratin e vdekjes muslimani tenton të shprehë formulën fetare: "Unë besoj se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe besoj që Muhamedi (a.s.) është

Pejgamber i Tij". Njerëzit që gjenden rreth tij i ndihmojnë, duke shprehur para tij të njëjtën formulë me zë, gjersa ai të vdesë.

Trupi i të vdekurit, para se të varroset, lahet. Ai mbështillet në tri fasha të pëlhurës (qefin), pasi që prej tij i kemi hequr teshat e zakonshme. Për larjen e trupit përdoret shkuma e sapunit dhe më në fund shpëlahet me ujë të kafuruar. Nëse nuk është e mundur larja e trupit, mjafton tejmumi. Pasi të mbështillet në tri fasha të pëlhurës (qefin), falet namazi i xhenazes. Namazi i xhenazes mund të falet edhe në mungesë të xhenazes, kudo që të jetë. Për varrim përgatitet varri; sipas mundësive, duhet të jetë paralel me Meken; koka e të vdekurit kthehet në të djathtë, kështu që kur trupi është në varr thuhet: "Në emër të Allahut dhe në fenë e Pejgamberit të Allahut".

Rreptësisht është e ndaluar të bëhen harxhime të mëdha për varrezat; ato duhet të jenë sa më të thjeshta e modeste. Shumë më mirë është që ato harxhime t'u shpërndahen të varfërve, duke iu lutur Allahut që të shpërblejë të vdekurin e mallëngjyeshëm.

Zakonet e përgjithshme

Përsa i përket faljes së namazeve të përditshme dhe agjërimeve vjetore – disa zakone veçanërisht rekomandohen. Më kryesor prej tyre është leximi i Kur'anit rregullisht, i përcjellë me përkthim, nëse ka nevojë, dhe duke menduar për çështjet dhe thelbin që

përmban. Çka mund të jetë më e begatshme dhe më e urtë prej kësaj thirrje të fjalëve të Zotit?!

Kur të fillohet diçka, thuhet *Bismilah-lah*, “Në emër të Zotit”, e kur të kryhet *El-hamdul-lil-lah* “falenderimi i qoftë Allahut”. Kur vendosim të bëjmë diçka, ose kur i premtojmë dikujt diçka, duhet të shtojmë *ishallah* “si të dojë Zoti”.

Në rast të takimit, muslimanët përshëndeten me fjalët: *Selamun alejkum* (ose *es-selamu alejkum*); përgjigje-mi me *alejkum-selam* (të gjitha këto përshëndetje kanë kuptimin: “paqja e Zotit (shpëtimi) qoftë mbi ty”. Kjo përshëndetje përfshin më tepër sesa *mirëmëngjes, mirëmbërëma* etj., të cilat janë pasojë e kohë së indorancës.

Duhet të bëjmë shprehi të përmendim Allahun kur shkojmë të flejmë dhe kur të zgjohemi (*subhanallah* – kjo është formula më e thjeshtë). Është mirë të lusim Allahun për uratën e Pejgamberit, p.sh. themi fjalët: “*All-llahum-me sal-li ala Muhamed ve barik ve selim*” (“O Zot! Fale Muhamedin (a.s.), jepi uratën dhe fute nën mbrojtjen Tënde”).

Pejgamberi (a.s.) gjithmonë ka dashur anën e djathtë: nëse mbathte sandalet; së pari e mbathte të djathtën; pastaj të majtën; anasjellas kur i zbathte. kur veshte ndonjë petk, së pari e veshte krahun e djathtë, pastaj të majtin; kur i krehte flokët, në fillim krehte anën e djathtë, pastaj të majtën; kur hynte në shtëpi ose në xhami, në fillim fuste këmbën e djathtë pastaj të majtën. Përkundër kësaj, duke hyrë në nevojto-re ose në banjo, në fillim fuste këmbën e majtë, pastaj të djathtën. Në të dalë e bënte të kundërtën - së pari nxirrte të djathtën, pastaj të majtën.

Lutjet duhet drejtuar gjithmonë Allahut, në çdo akt të jetës, pa marrë parasysh se a është nevojë natyrore ose akt qëllimtar, siç është më solemnisht, me fjalë të tjera, përgatitja për namaz. Format e lutjes që i ka shfrytëzuar Pejgamberi (a.s.), në ndonjërin prej atyre rasteve, i kemi përmendur më lart. Të tjerat mund t'i lexojmë në veprat më voluminoze.

Ngrënia dhe pija

Në lidhje me ushqimin dhe pijen të përmendim ca pika më kryesore:

Mishi i derrit (nënkuptohet edhe dhjami) është i ndaluar, siç janë të ndaluara dhe pijet alkoolike. Këtu duhet të kuptojmë diçka shumë mirë. Fjala HAMËR, të cilën e përmend Kur'ani, edhe pse ka qëllimin për verën që përfitohet prej rrushit, edhe në kohën e Pejgamberit (a.s.) shprehja *hamër* ka përfshi çfarëdo pije alkoolike, pa marrë parasysh se prej çfarë materje përfitohet alkooli. Kështu që, kur shpallet ajeti për *hamër*-in, muslimanët e Medines derdhën fuçitë e tyre të alkoolit e jo vetëm të verës. Të përmendim se në Medine pijet e fermentuara janë përfituar prej hurmave. Përsa i përket mishit tjetër, muslimani mund të hajë vetëm prej zogjve dhe kafshëve që janë therur në mënyrë të përcaktuar. Kur'ani thotë (53):

“Haram është për ju (ju ndalohet) coftina, gjaku i papastër, mishi i derrit dhe gjithë çka pritët përveç në emër të Allahut; mishi i shtazës së furrës, shtazës së

rrahur, që ka ngordhur prej fatkeqësive, shtazës që e ka vra shtaza tjetër dhe çka e ka shqyer shtaza e egër. Bile, edhe kafshët dhe zogjtë e lejuara, nëse i kanë prerë jomuslimanët, muslimanët nuk kanë të drejtë të ushqehen me to, përveç nëse i ka prerë ndonjë prej *ehli- qitapëve* (atyre që u ka zbritur Libri: të krishterët dhe hebrenjtë), me kusht që t'u përmbahen ritualeve fetare në rastin e prerjes. Pulën nëse e mbyt ndonjë i krishterë, nuk është e lejuar; gjithashtu edhe muslimani, nëse e mbyt, është haram ta hajë.

Therja e kafshëve sipas sheriatit bëhet në këtë mënyrë: së pari thuhet *bismil-lah* (në emër të Allahut), pastaj i pritet qafa, gabzheri dhe kapërçelli, si dhe dy damarët e qafës, duke pasur kujdes që të mos lëndohet palca e qafës, si dhe të mos ndahet koka prej trupit para se të vdesë kafsha krejtësisht.

Përdorimi i pjatave dhe i enëve prej ari e argjendi për ushqim ose pije është i ndaluar për muslimanët. Pejgamberi (a.s.) ka thënë: "Përdorimi i arit dhe i mëndafshit është i ndaluar për burrat, i lejuar për gratë". Por, prapëseprapë ka ca përjashtime. Mëndafshi lejohej për tesha ushtarake. Gjithashtu, përdorimi i arit në stomatologji. Afraxh ibn Esad tregon se Pejgamberi (a.s.) atij personalisht i ka lejuar të vinte hundën e artë në vend të hundës që e kishte humbur në luftë, përderisa hunda artificiale prej argjendi i ishte prishur.

Teshat dhe frizura

Veshja e stofit të endur prej mëndafshit natyror për burrat në Islam është e ndaluar (kjo ndalesë nuk vlen për gratë). Pejgamberi (a.s.) gjithashtu qortoi mbajtjen e teshave të kuqe. Ai ka mbajtur mjekër dhe iu rekomandonte muslimanëve që të mbanin.

Muslimanet duhet të vishen në mënyrë të sjellshme e njerëzore, kështu që nuk lejohet të veshin fustana të shkurtër, tesha me të prera të mëdha, si dhe tesha të tejdukshme. Ato nuk duhet të vishen dhe të paraqesin frizurat e burrave, por duhet të largohen prej gjithçka që iu përngjan burrave. Pejgamberi (a.s.) grave iu rekomandon tesha të ngjashme me pantallonat. Ndërsa, përsa i përket fustanit, duhet të mbulojë më së paku shumicën e pjesës së poshtme të këmbës (pak mbi zog).

Falja e namazit

“Pastërtia është gjysma e besimit”, ka thënë Pejgamberi (a.s.). Mu për këtë, kur të falet namazi së pari duhet të lahet trupi. Për namazet e përditshme mjafton që muslimani të marrë avdes, por në raste të veçanta duhet të lahet i tërë trupi: bashkëshortët pas marrëdhënieve seksuale; burri dhe gruaja pas polucionit; gratë pas menstruacionit, si dhe pas nifasit (pas lindjes, kur të ndërpritet gjakderdhja). Me e la tërë trupin

ditën e xhuma dhe me e falë namazin e xhumasë është sunnet. Larja rituale (gusli): Së pari shpëlahet, siç është përmendur më poshtë, pastaj me ujë lahet i tërë trupi, prej kokës gjer te këmbët, edhe atë së paku tri herë. Nëse shfrytëzohet vaska, pasi të lahemi duhet të zbrazet vaska dhe me ujë të pastër shpëlahemi.

Larja rituale (avdesi) kryhet në këtë mënyrë: thuhet *bismil-lah* (në emër të Allahut), lan duart tri herë, gojën tri herë, hundën tri herë, me duar të pastra lajmë fytyrën tri herë, pastaj lajmë krahun e djathtë gjer pas bërrylit dhe krahun e majtë tri herë; me duar të lagëta fshijmë një të katërtën e kokës (d.m.th. sa kap dora) me gishta të pastër; me gishtin tregues fshijmë brendinë e veshit, me gishtin e madh shpinën e veshit, kurse me shpinën e tre gishtave të tjerë fshijmë qafën. Në këtë mënyrë veprojmë nëse kemi ujë të mjaftshëm; e nëse uji nuk na mjafton, atëherë çdo gjymtyrë e lajmë nga një herë.

Nëse nuk kemi hiç ujë, tejemumi (larja simbolike) e zëvendëson larjen e avdesit, bile edhe të tërë trupit. Tejemumi i lejohet edhe të sëmurit, të cilit uji i bën dëm. Tejemumi merret kështu: Së pari bëhet nijeti, thuhet *Bismil-lahir-rahmanir-rahim* (në emër të Allahut), pastaj shuplakat e duarve vihen në dhe të pastër ose në mur; me duar fshijmë fytyrën, përsëri duart i vëmë mbi dhe të pastër dhe me dorën e majtë fshijmë krahun e djathtë dhe me dorën e djathtë fshijmë krahun e majtë, gjer mbi bërryla. Tejemumi simbolizon përruljen e njeriut ndaj të Gjithëfuqishmit.

Nuk është e domosdoshme që për çdo namaz të përsëritet avdesi, nëse atë nuk e prish si: fjetja, lësh-

imi i gazrave, shurra dhe kryerja e nevojës së madhe ose vjellja. Është e nevojshme të përmendim, pasi që rregullat e pastërtisë kanë të bëjnë me shkaqe higjienike, nëpër nevojtoje duhet të përdorim ujin e jo vetëm letrat! Letrat e shkruara nuk duhet të përdoren, jo vetëm për shkaqe higjienike, por që t'i shmangemi edhe mosrespektimit të njohurive që përmban letra, e të mos bëjmë fjalë nëse është shkruar në të Emër të Zotit.

Për kryerjen e namazit është e nevojshme që edhe teshat të jenë të pastra, si dhe vendi ku do të falemi. Gjithashtu, duhet të dihet që përmes hartës së botës ose kompasit të orientohemi: të dimë se Meka gjendet në mesin e Gadishullit Arabik. Sipas hartës ose kompasit, popujt e Ballkanit duhet të drejtohen në drejtim të juglindjes, duke plotësuar kështu edhe kushtin e drejtimit kah Qabeja kur të fillojnë namazin.

Ka pesë kohë të namazit, përveçse në ditën e xhuma, në vend të namazit të drekës, falet namazi i posaçëm i asaj dite (xhumaja), që duhet të falet patjetër me xhematë, në mënyrë madhështore. Përveç kësaj, ka edhe dy namaze të posaçme e që falen gjithashtu në xhematë e që janë namazet e Bajrameve. Namazi i Fitër-Bajramit falet pasi të mbarojë muaji i Ramazanit, kurse i dyti falet në ditën e 10-të Dhulhixh-xhes, nënkuptohet në kohën e haxhit. Të gjitha ato namaze sipas formës janë të njëjtë, vetëm se ndryshon zgjatja e tyre. Namazi i sabahut ka vetëm dy reقاتë, dreka dhe iqindia kanë nga katër reقاتë, akshami ka tri reقاتë dhe jacia ka katër reقاتë. Këtu është fjala vetëm për namazet që janë farz. Pejgamberi

(a.s.) gjithashtu rekomandoi të falet edhe një namaz prej tri reقاتësh e që quhet *fitër-namaz*.

Pra, farz janë vetëm pesë kohë të namazit, mirëpo Pejgamberi (a.s.) praktikisht ka shtuar, për çdo kohë të namazit, ca reقاتë që konsiderohen të rekomandueshëm. Të rekomandueshme janë dy reقاتë para namazit të sabahut; para namazit të drekës katër reقاتë dhe dy reقاتë pas namazit të drekës; dy reقاتë pas namazit të akshamit; dy reقاتë pas nefive ose një reقاتë sipas shkollave të tjera. Përveç këtyre namazeve, muslimani mund të falë sa të dojë namaze si nafile (vepër devotshmërie). Kur muslimani hyn për herë të parë në xhami, është mirë të falë dy reقاتë për xhaminë – *tehi-jetul-mesxhidi* (përshëndetje xhamisë).

Falja e namazit kryhet në këtë mënyrë: kryhen pastrimet e parapara, zgjidhet vendi i pastër, drejtohem i kah Kibla, bëhet nijeti duke thënë: “vendosa të fal namazin e drekës (p.sh.) për riza të Allahut, u ktheva kah Kibla (nëse lidhet sipas imamit, shton: ‘iu lidha imamit’), pastaj shprehet fjala *Allahu ekber* (*Allahu është më i Madhi*), duke i çuar duart te veshët (me ç’rast me gishtat e mëdhenj preket pjesa e butë e veshit); pastaj duart lëshohen drejt teposhtë (sipas shkollës së Malikut dhe Shiiva, ndërsa në të gjitha shkollat tjera duart lidhen mbi kërthizë, për burrat, ndërsa gratë duart i lidhin mbi gjoks). Prej këtu fillon namazi dhe tanimë nuk lejohet të flitet me askend dhe shikimi duhet të përqendrohet në vendin e sexhdes, bile nuk lejohet të bëhen lëvizje që e prishin namazin. Për çdo lëvizje (ruku, sexhde, ulje) thuhet *Allahu ekber*.

Namazi fillon me një himn, pas së cilës vijon kaptina e parë e Kur'anit (Elhami); pastaj lexohet një kaptinë tjetër ose një pjesë e Kur'anit sipas dëshirës. Me zë lexohet vetëm në namazin e sabahut, dy reقاتët e parë të akshamit, dy reقاتët e parë të jacisë; kurse në reقاتët tjerë lexohet pa zë. Gjithashtu me zë lexohet në namazin e xhumasë dhe në dy Bajramet.

Pasi të kryejmë leximin e Kur'anit, siç u përmend më lart, përkulemi, duke vënë duart mbi gju; në këtë gjendje thuhet tri herë: *“subhane rab-bij-jel adhim”* (lavdi Allahut të Madh). Pastaj drejtohem në këmbë duke thënë: *“Semiall-llahulimen hamide”* (Allahu dëgjon atë që e lavdëron Atë). Pastaj biemi mbi tokë, duke venduar duart, ballin, hundën, gjunjtë dhe dy këmbët aty (sexhde) dhe thuhet tri herë: *“Subhane rab-bijjel Aëla”*. Çohemi në këmbë dhe, kështu, merr fund ose, më mirë të themi, plotësohet një reقات.

Reقاتi i dytë fillon me leximin e sures Fatiha (Kaptinën e Parë, siç u përmend më lart), pas së cilës mund të lexojmë sure tjetër ose ca ajete sipas dëshirës. Pastaj shkojmë në ruku, në sexhde dy herë dhe ulemi në ndejën e parë (*Et-tehij-jat-in* e parë), me ç' rast lexojmë duanë e *Et'hij-atit*.

Nëse namazi, si i sabahut, ka dy reقاتë ai përfundon me përshëndetje (selam), duke e kthyer kokën në anën e djathtë, duke thënë: *“Es-selamu alejkum ve rahmetull-llahi”* (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi ju), pastaj e rrotullojmë kokën në anën e majtë, gjithashtu duke thënë selamin. Me këtë merr fund namazi. Mirëpo, nëse namazi ka më tepër se dy reقاتë, atëherë pas ndejës së parë çohemi përsëri në këmbë, me ç' rast le-

xojmë Kaptinën e Parë të Kur'anit (Fatihanë) dhe pa mos lexuar ajete ose sure (kaptinën), tjetër shkojmë në ruku, në sexhde dy herë dhe përsëri çohemi në këmbë. Përsëri lexojmë Kaptinën e Parë të Kur'anit (Fatihanë) dhe pa mos lexuar kaptinë ose ajet tjetër, shkojmë në ruku, në sexhde dy herë dhe ulemi në ndejën e mbramë. Pas leximit të duave japim selam dhe, namazi kryhet. Nëse namazi përbëhet prej tre reقاتësh, atëherë pasi të lexojmë suren e Fatihasë, për herë të tretë ulemi në ndejën e *ete hijatit* dhe japim selam.

Disa veçori

Sipas shkollës (drejtimit – medhhebit) shiit dhe hambelit, namazit të sabahut i shtohen edhe ca dua të quajtura *kunut*. Pra, pasi të kryhet falja në reقاتin e dytë, pas rukusë, pa rënë në sexhde çohen duart dhe lexohet duaja, pastaj vazhdon namazi, biemi në sexhde e kështu me radhë. Shkollat tjera nuk e praktikojnë këtë, duke pretenduar që Pejgamberi (a.s.) këtë e ka praktikuar përkohësisht.

Shkolla Hanefije gjithashtu ka kunutin e vet, mirëpo ai kryhet në reقاتin e tretë të fitër- namazit, i cili falet pas namazit të jacisë. Me fjalë të tjera, pasi të kryhet leximi i Kur'anit, në reقاتin e tretë nuk shkojmë në ruku. Përkundrazi, i çojmë duart te veshët, duke thënë *Allahu ekber* dhe lidhemi në mes (nën kërthizë) e lexojmë duatë e *kunutit*. Pastaj vazhdojmë si zakonisht, gjer në fund. Është e rëndësishme të për-

mendim se nëse falemi me imam, atëherë pa marrë parasysh se cilit medhheb (shkollë) i takon, duhet vepruar si imami.

Ndryshimet në mes ca shkollave

Te muslimanët ekzistojnë tri grupe: sunitët, shi'itët dhe abaditët (të ashtuquajtur harixhije); me ca nëngrupe, ato mes vete dallojnë në pikëpamje të dogmave dhe të kultit. Këtu ne nuk mundemi të përshkruajmë historinë e këtyre tri medhhebeve, si dhe ndryshimet mes tyre. Mirëpo, nëpër qytetet e mëdha, kur shohim që muslimanë të shkollave të ndryshme të njëjtin akt apo ibadet e kryejnë ndryshe, pyesim: prej nga rrjedhin këto ndryshime? T'i lëmë pasdore ndryshimet në dogma, të cilat rrjedhin prej përfundimeve të teologëve eminentë; themi menjëherë se në ibadet ata nuk kanë ndryshuar kurr gjë, por ai rrjedh prej vetë Pejgamberit (a.s.) ose janë nxjerrë prej lajmeve siç ka vepruar ose ka thënë Pejgamberi (a.s.).

Pikërisht vetë Pejgamberi (a.s.) ndonjëherë ka ndryshuar qëndrimin e tij në ca veprime ose llojet e lutjeve (duave); ndonjëherë vendosmërisht ka ndryshuar vendimin e mëparshëm me qëndrim të ri (p.sh. në ruku në fillim Pejgamberi (a.s.) i ka mbajtur duart lidhur e më vonë i vë në gjunj dhe ndaloi qëndrimin e parë). Në raste të tjera, ai kurr gjë nuk thotë nëse e ndryshon qëndrimin. Në ca raste shqyrtime janë paraqitur te ca gjenerata pas Pejgamberit (a.s.), kështu që

shkencëtarët janë ndarë në më shumë mendime përsa i përket një çështjeje ose qëndrimi të Pejgamberit (a.s.).

Sipas kësaj, shihet haptas se, praktikisht, të gjitha dallimet rrjedhin prej vetë qëndrimeve të shumta të Pejgamberit (a.s.) dhe askush nuk ka të drejtë të përbuzë çfarëdo qoftë prej tij. Shpeshherë nuk kemi shënime, në bazë të të cilave do të mund të përcaktohej kronologjia e kryerjes së të njëjtit akt në ca forma të ndryshme, që të supozohet se akti i fundit e revokon aktin e parë. Nëse p.sh. ndonjë individ i medhhebit (drejtimit) Shafiije refuzon të falë namazin pas imamit Hanefij, kjo do të thotë se ai individ refuzon të ndjekë vetë Pejgamberin (a.s.), kur ai ka vepruar në mënyrën që nuk e njeh shkolla e Shafiijve. Sa e tmerrshme është kjo!!!

Në literaturën islame gjejmë se një prej titujve të nderit për Pejgamberin (a.s.) është *"I dashur i Allahut"* (Habibull-llah). Ndërkaq Kur'ani famëlartë qartë dhe kategorikisht thotë se tek ai (Muhamedi /a. s./) muslimanët kanë shembullin që duhet ndjekur. Është i arsyeshëm fakti se pse Allahu deshi që çdo sjellje të parrevokueshme të Pejgamberit (a.s.) të ndiqet nga çdo mulsiman. Në rastin e kryerjes së ndonjë akti në formë të ndryshme, u mundësua që dikush ta kryente në një rën mënyrë e tjetri në mënyrën tjetër. Nga kjo shiqet që Allahu deshi të vazhdonte të gjitha qëndrimet e Pejgamberit të Tij të dashur përmes shkollave të ndryshme. Për atë shkak, të kultivojmë respektin dhe zemërgjerësinë ndaj njëri-tjetrit.

Namazi i istihares (lutja për udhëzim)

Kur na mundon diçka, Pejgamberi na rekomandon që të lusim Allahun që të na udhëzojë e jo shpëtimin ose rrugëdaljen ta lypim përmes lojrave të fatit ose me ndonjë metodë të besimeve të kota. Për këtë kryhet falja e namazit prej dy reقاتësh: Pasi të falim namazin e obliguar të jaxisë dhe të fitrit, para se të flejmë duhet të falim namazin e *istihares*, i cili kryhet në këtë mënyrë: në reqatin e parë, pasi të lexojmë suren e Fatihasë (Elhamin), lexojmë suren e 109 (El-Kafirun), ndërsa në reqatin e dytë lexojmë Fatihanë dhe suren e 112 (Kul huvall-llahun); ndërkaq, pjesa tjetër falet si çdo namaz tjetër. Pasi të japim selam, i drejtohem Allahut me duanë që i drejtohej Pejgamberi (a.s.); sipas mundësive, duaja lexohet në gjuhën arabe; ata që nuk mundën, mund të lexojnë në përkthim. Pastaj shkojmë të flejmë, duke përmendur (dhikër) Allahun. Kur të ngrihem në ditën e nesërme, mendim i parë rreth problemit është më i përshtatshëm. Nëse në ditën e parë nuk na vjen kurrnjë mendim, atëherë e përsërisim namazin për çdo natë, gjersa të vijë mendimi.

Pengesat në namaz

Nëse gjatë namazit me harresë flet me dikë, lëshojmë gazra, ose qeshim me zë, hamë ose pimë, namazi

prishet; në këto raste namazi patjetër duhet të falet rishitazi, e nëse qeshet me zë, duhet të marrim edhe avdes të ri. Mirëpo, nëse bëjmë lëshim gjatë leximit ose gjatë kryerjes së namazit, nëse kujtohemi para se të japim selam, duhet të bëjmë dy sexhde të reja dhe pastaj japim selam. Në këto dy sexhde të harresës mund të recitojmë fjalët e duave të zakonshme ose në vend tyre themi: “Lavdi Atij që nuk ka gjumë e as harron”.

Nëse dikush vonohet në namazin me xhematë, duke e shqiptuar nijetin, menjëherë duhet të lidhet pas imamit dhe ta ndjekë atë. Nëse nuk e kemi mbërritur një reقاتë, atëherë pasi të japë selam imami, çohemi dhe vazhdojmë ashtu siç e falim vetë. Po e marrim namazin e akshamit. Një prej xhematit nuk e ka mbërritur reقاتin e tretë. Pasi të japë imami selam, ai çohet në këmbë, lexon Fatihanë dhe një sure të shkurtrë ose një ajet, bën rukunë, sexhden, ulet në ndejën e fundit, lexon duatë e nevojshme dhe jep selam. Kështu plotësohet reقاتi dhe namazi.

Vërejtje e përgjithshme

Nëse nuk dihet sigurisht ana e Qabesë, atëherë duhet përafërsisht të vërtetojmë se kah duhet të gjendet, pasi që Allahu gjendet kudo. Në namaz duhet të koncentrohemi mirë; duhet të shikojmë në vendin ku e vëmë ballin në sexhde (në ruku shikojmë në majat e gishtave të këmbëve, ndërsa në sexhde sytë duhet t'i mbajmë çelur) dhe assesi nuk bën të shikojmë në qiell,

majtas apo djathtas. Duhet t'i përqendrojmë këmbët në një vend dhe është traditë e papëlqyeshme që gjatë lëvizjeve t'i luajmë këmbët para ose mbrapa.

Pasi të kryejmë namazin, mund t'i lutemi Allahut çka të duam; mirëpo, rekomandohen duatë e përmendura në Kur'an.

Të gjitha leximet në namaz duhet të jenë në gjuhën arabe, duke filluar prej Fatihasë dhe ajeteve të tjera të Kur'anit.

Namazi i xhenazes

Namazi i xhenazes, sipas formës, ndryshon prej namazeve të tjera. Marrim avdesin, bëjmë nijetin, marrim tekbirin, duke i çuar duart te veshët; pasi të themi *Allahu ekber* lexohet *subhane kall-llahum-me*, merret tekbiri i dytë dhe lexohen salavatet mbi Pejgamberin; merret tekbiri i tretë, lexohet dua ja e posaçme për të vdekurin ose zëvendësohet me ndonjë dua tjetër, merret tekbiri i katërt dhe japim selam në të djathtë dhe në të majtë. Kështu merr fund namazi i xhenazes.

Sëmundja dhe udhëtimi

Njeriu, nëse është i sëmurë, namazin mund ta falë ulur ose shtrirë, sipas gjendjes shëndetësore. Nëse ka fuqi të falet ulur, atëherë rukunë e bën duke e afruar

kokën afër tokës e balli të mos prekë në të, ndërsa se-xhdja kryhet si zakonisht. Nëse, për shkak të sëmundjes, duhet të falet shtrirë në shtrat, atëherë falet vetëm me isharet, duke lexuar gjithë çka ka nevojë.

Udhëtari ka leje që namazet katërrekaqësh t'i shkurtojë në dy reqatë. Përveç kësaj, udhëtarët që me të vërtetë janë të angazhuar shumë, kanë leje që dy namaze t'i falin në të njëjtën kohë; p.sh. namazin e drekës dhe të iqindisë mund ta falin prej kur hyn koha e drekës e deri kur të dalë koha e iqindisë, ose akshamin dhe jacinë mund t'i falë gjer në sabah.

Koha e namazit

Namazi i parë (*fexhr*) falet prej agimit e deri në lindjen e diellit. Namazi i dytë (*dhuhr*), falet prej kur dielli e kalon meridianin e mesditës gjer kah ora 15. Namazi i tretë (*asr*), vonë pasdite, gjer në perëndimin e diellit. Namazi i katërt (*magrib*), prej perëndimit të diellit gjer në mbarim të muzgut. Namazi i pestë (*isha*), prej mbarimit të muzgut gjer në agim, mirëpo rekomandohet që të falet para mesnatës.

E tërë kjo vlen për vendet ekuator – tropikale. Sa më tepër të largohemi nëpër pole, dita ndryshon sipas stinëve të vitit, kështu që dielli shumë pak mund të jetë mjet për matjen e kohës. Në dy paralelet e jugut dhe të veriut në shkallën e 90-të, do të thotë në pole, dielli nuk perëndon gjashtë muaj; ndërsa kur lind, mbetet nën horizont gjashtë muaj (në përjashtim të dy

ditëve që janë të barabarta). Diçka më në jug, në gradën e 72-të të veriut, prej 9 maj gjer më 4 gusht; gradën e 70-të të veriut, prej 17 maj gjer 27 më korrik; gradën e 66-të të veriut, prej 13 deri 29 qershor dielli mbetet mbi horizont, pa perënduar, as gjatë ditës e as gjatë natës. Në periudhën gjegjëse të perëndimit, dielli mbetet nën horizont, duke mos lindur aspak brenda 24 orëve. Në meridianin e 6-të të veriut dielli lind në orën 00 e 3 minuta, ndërsa perëndon në orën 23 e 32 minuta; me dy korrik ai ngrihet në orën 00 e 30 minuta, ndërsa perëndon në orën 23 e 32 minuta. E kështu me radhë. A do të duhet atëherë, pra, brenda disa minutave të falen tri kohë të namazit: *magrib*, *isha* dhe *fexhër*? Njeriu këto vende shpesh i viziton, bile kohëve të fundit ato edhe banohen shumë. Dihet që në llogoret e ish-BRSS ka pasur një numër të mjaftueshëm të punëtorëve muslimanë. Nënkuptohej se në ato kushte klimatike jonormale, as namazet ditore e as Ramazani vjetor nuk mund të barazohen sipas rrotullimit të diellit. Për këto rajone, juristët muslimanë kanë vendosur që për bazë të merret ora e jo dielli. Mirëpo, për këtë duhet të përcaktohet një rajon normal më i afërt dhe sipas tij të përcaktohen kohët për rajonin jonormal. Propozimi i arsyeshëm, i njëzërit, është te të gjithë ulemaja e vendeve të ndryshme islame siç vijon:

Kur’ani (2:286) thotë se: “Allahu askend nuk e obligon jashtë kufijve të mundësisë”. Edhe në vendin tjetër (94:5,6): “Me të vërtetë, krahas vështirësive, ka falur edhe lehtësime...”! Pejgamberi këto i vërtetoi duke lypur prej misionarëve të vet: “Lehtësoni, mos

vështirësoni dhe mos silleni ashtu që njerëzit të tejkalojnë (ligjin islam), por silluni me ta sikur vëllezër". Përveç këtyre udhëzimeve të përgjithshme, Pejgamberi (a.s.), bile, është përgjigjur në pyetjen për ditët e gjata (jonormale) në një hadith, të cilin e transmetojnë Muslimi, Ebu Davudi, Tirmidhiu, Ibn Maxhe e të tjerët: "Kur do të vijë Dexhalli (mashtruesi i madh) të udhëheq popullin, ai do të jetojë në këtë botë 40 ditë, të cilat do të jenë shumë të gjata; dita e parë do të jetë sa një vit, dita e dytë sa një muaj, dita e tretë sa një javë, kurse ditët tjera, normalisht, si ditët tjera tuajat. Një prej as'habëve pyeti: 'A do të mjaftojnë në ditën e parë, që do të zgjasë një vit, të falim vetëm pesë kohë të namazit?' Pejgamberi (a.s.) iu përgjegj: 'Jo, por duhet të llogariten'!"

Dita e parë, e përshkruar këtu, iu përngjan kushteve që i kemi në paralelen 90 në veri dhe në jug, do të thotë në dy polet; dita e dytë atyre më në jug prej 68 shkallësh të hemisferës së veriut, ndërsa dita e tretë atyre në jug prej paraleles 66 shkallë. Duke u mbështetur në këto udhëzime të Pejgamberit (a.s.), mbledhjet e përbashkëta të ulemasë muslimane kanë vendosur që në kushte të tilla të shkojnë sipas lëvizjes së orës e jo të diellit; që të mund të lehtësohet qëndrimi, ata kanë vendosur që të merren për bazë kohët e paraleles 45 shkallë në të gjitha rajonet që gjenden mes paraleles dhe poleve. Kjo vlen si për agjërimin, ashtu edhe për namazet: pesë kohët e namazeve, xhumanë dhe namazet e bajrameve. Nëse nuk marrim këtë qëndrim, por t'i përmbahemi kryekëput ligjit (p.sh. të ndërprejmë agjërimin me perëndimin e diellit), kokë-

çarja do të paraqitej nëse Ramazani vjen në stinën e verës - atëherë do të duhej të agjëroheshin 21 orë më shumë, ndërsa kur Ramazani do të vinte në stinën e dimrit, agjërimi do të zgjaste vetëm tri orë ose edhe më pak. Kohën e përfiturar në 45 shkallë duhet ta respektojmë te të gjitha qëndrimet fetare në të gjitha zonat jonormale, e jo kohën e lejuar emotivisht të Mekes ose Medines, kështu që të mos shprehet lakmia e muslimanëve ndaj zonës mes Medines dhe gjerësisë 45 shkallë.

Koha e lindjes dhe e perëndimit të diellit në ekuator mbetet gjatë tërë sezonit e pandryshuar: anasjelltas, ndryshimi shumë i madh, prej së cilës dalin edhe vështirësitë, godet rajonet e poleve. Gjeografët largësinë e ndajnë në 90 shkallë, prej ekuatorit gjer te polet. Prej saj është vërtetuar liria e vijës në 45 shkallë në veri dhe 45 shkallë të paraleles së jugut. Banorët e ekuatorit dhe të vendeve tropikale mes dy paraleleve, në dy anët e ekuatorit, duhet të ndjekin kohën e cila vlen në shkallën 45 të paraleles, pa marrë parasysh konkretisht kohën lokale të lindjes ose perëndimit të diellit. Në këto zona do të ndodh që agjërimi të ndërpritet edhe pse dielli ka perënduar shumë herët (në stinën e dimrit).

Kjo ndarje në dy paralele, 45 shkallë në veri dhe 45 shkallë në jug, teorikisht e ndan tokën në dy pjesë të barabarta, mirëpo, praktikisht më shumë se tre të katërtat e globit tokësor të banuar i takon zonës normale, si dhe pjesa më e madhe e banorëve në botë, sepse tërë Afrika, India, Oqeania, përafërsisht e tërë Kina, dy Amerikat (në përjashtim të Kanadasë dhe ca pjesëve të Argjentinës dhe të Kilit), gjenden në atë

zonë. Duhet të përmendim posaçërisht se kjo nuk prek kurrëgjë në traditat një mijë e sa vjeçare të muslimanët, sepse vendet e islamizuara në kohën e Pejgamberit (a.s.) dhe pasardhësve – Arabia, Siria, Turqia, Egjipti, Spanja, Italia, Franca jugore, Iraku, Turkestani, Indo-Pakistani, si dhe pjesa më e madhe e Malajzisë dhe Indonezisë – nuk duhet të ndërrojnë asgjë prej traditave të tyre të stabilizuara. Dallimet e përmendura në Evropë përfshijnë rajonet mbi vijën Bordo – Bukuresht - Sevastopol; në Amerikën veriore, mbi vijën Halifaks - Portland; dhe në hemisferën jugore, rajonet e Argjentinës dhe të Kilit të jugut dhe ca ujdhesa në jug të Zelandës së Re. Bashkësitë islame të Francës, Anglisë, Gjermanisë, Holandës, Finlandës, Kazanit dhe të Kanadasa shfrytëzojnë këtë leje të ligjit islam, e cila merret prej disa haditheve të Pejgamberit (a.s.). Në shikim të parë, në hartën gjeografike shumë lehtë mund të përcaktohet se a iu takojmë kushteve të rëndomta apo kushteve jonormale mbi ose nën 45 shkallë.

Pse namazi kryhet vetëm në gjuhën arabe

a) Shumë mirë dihet që gjatë faljes së namazit muslimanët shfrytëzojnë vetëm gjuhën arabe; ata lexojnë disa pjesë prej Kur'anit dhe disa fjali me të cilat vërtetojnë Madhërinë e Allahut (xh. sh.) dhe për-unjtësinë e njeriut. Kështu veprojnë si arabët, ashtu edhe joarabët, bile edhe ata që nuk dinë asnjë fjalë të gjuhës arabe. Ashtu ka qenë në kohën e Pejgamberit

(a.s.) dhe ashtu është gjer më sot, pa marrë parasysh vendin dhe gjuhën e muslimanëve.

b) Në vështrim të parë, mund të jetë e zakonshme, ndoshta edhe e preferuar, që besimtari t'i drejtohet Allahut në atë mënyrë që e kupton plotësisht. S'do mend, gjuha amtare është mediumi që më së miri përgjigjet për atë qëllim, do të thotë lutja të kryhet në aq gjuhë sa fliten në bashkësinë muslimane. Mirëpo, një shqyrtim më i thellë na tregon se ka arsye që rreptësisht e kundërshton këtë vendim.

c) Para së gjithash, pikëpamja metafizike ose psikologjike. Sipas Kur'anit Famëlartë (33:6), gratë e Pejgamberit janë nëna për muslimanët. Dimë se këto zonja kanë folur arabisht. Andaj, gjuha arabe është gjuha e të gjithë muslimanëve. Kush mund të shprejojë se mund të kryejë lutjen në gjuhën e vet amtare?

d)Ndoshta ky argument nuk do të mjaftojë të bindë çdokend. Duke vazhduar shqyrtimin, me rëndësi është të përmendim se, sipas besimit islam, Kur'ani është Fjala e Allahut, prandaj leximi i tij, sipas Kur'anit, është vepër e mirë. Kjo ka të bëjë me çështjen shpirtërore. Rruga e së vërtetës drejt Zotit, përmes Fjalës së shenjtë të Vetë Zotit. Fjala e Tij është rruga drejt Tij, diçka si përçuesi i rrymës elektrike që e shndrit shishen. Udhëtimi kah Zoti për çdo shpirt është caku i fundit që dëshirohet të arrihet. Fjala origjinale është shpallur në gjuhën arabe; çdo përkthim është vepër e njeriut, që e humb qëllimin mistik të këtij udhëtimi.

e) Për ata që lypin arsyetime laike, të përmendim së pari se duhet të bëjmë dallimin e qartë mes lutjes

në formë të duasë dhe lutjes në formë të detyrës ndaj Allahut (*salat*). Përsa i përket duasë – do të thotë në përgjithësi lutjes dhe jashtë detyrës formale të Zotit, bisedës së drejtpërdrejtë me Zotin (munaxhat) – askush nuk ka vënë asfarë vërejtje sado të vogël për lirinë e çdo individit që nevojat e veta, lutjet e veta drejtuar Zotit t’i paraqet në çfarëdo gjuhe qoftë. Kjo është çështje private e çdo njeriu dhe mund ta shprehë lutjen në çfarëdo gjuhe qoftë. Namazi, përkundrazi, është çështje kolektive dhe publike, ku duhet marrë parasysh nevojat dhe lutjet e pjesëmarrësve të tjerë në xhematë. Duhet të cekim veçanërisht që namazi është i preferuar dhe, sipas parimeve, të falet në xhematë; namazi në vetmi është vetëm i lejuar e kurrë nuk preferohet dhe gjithmonë i jepet përparësi namazit në xhematë. Të shohim tani ca aspekte karakteristike të këtij akti kolektiv e publik, i cili kryhet bashkë me të tjerët.

f) Të kishte qenë Islami fe rajonale, fe e një race ose e një kombi, pa dyshim se do të shfrytëzohej gjuha e rajonit, e racës ose e kombit. Mirëpo, janë krejtësisht të ndryshme kërkesat e rajonit universal, ithtarët e të cilit flasin qindra gjuhë rajonale – dhe secila gjuhë është e pakuptueshme për të tjerët – dhe u takojnë të gjitha racave dhe banorëve të të gjithë botës. Jeta jonë për çdo ditë bëhet shumë e më shumë kosmopolite, prandaj, praktikisht, secili qytet ka muslimanë që iu takojnë gjuhëve të ndryshme, qoftë prej atyre që gjithmonë jetojnë në një vend, qoftë udhëtarë që kalojnë tranzit. Po e zëmë se ndonjë anglez vjen në Kinë dhe nuk di asnjë fjalë kinezisht. Po e zëmë se në rrugë dëgjon diçka si “*çen çu shah*”. Normalisht, ai nuk do të

kuptojë asgjë se çka thotë dhe çka dëshiron kinezi me ato fjalë. Nëse kjo është përkthim rajonal për fjalën *Allahu ekber*, ai këtë nuk do ta kuptojë dhe do t'i mbetet namazi i xhumasë pa falur ose ndonjë namaz tjetër në xhema të. (Rastësisht, xhamia e Kinës nuk i përngjan asaj të Anglisë, të Francës ose kudo që të jetë në Lindje). Gjithashtu, muslimani kinez, duke udhëtuar në shtete të tjera, nuk do të gjente asgjë të përbashkët me bashkëbesimtarët nëse namazin në xhema të ata e kryejnë në gjuhën e tyre lokale. Religjoni universal kërkon që sa sende esenciale të jenë të përbashkëta për të gjithë muslimanët. Thirrja në namaz dhe ca tekste të tjera më kryesore, që duhet të lexohen në namaz, gjithashtu parashtrajnë pjesën kryesore për kryerjen e namazit. Kalimthi mund të hetojmë faktin se nganjëherë fjalët e dy gjuhëve kanë tingëllimë të njëjtë, mirëpo kanë kuptime të ndryshme. Ky rrezik është më i madh te gjuhët me të cilat nuk jemi mësuar, ose që i dëgjojmë vetëm në raste të udhëtimeve. Kjo do të ishte kundër respektit të detyrës hyjnore. Në fëmijëri nuk ka qaj shumë komplikime, bile edhe nëse joarabi i mëson tekstet e nevojshme në gjuhën arabe.

g) Nuk kemi të drejtë që të mos përfillim as pamjen psikologjike të njerëzve, të cilët ndonjëherë kanë paragjykimet e njëjta ndaj të huajve. Përkohësisht do të paraqiteshin pengesa nga shkaqet politike, nacionale ose personale e të lindin mosmarrëveshjet, p.sh. ndonjë anglez të mos marrë pjesë në namazin në frëngjisht ose në rusisht a në ndonjë gjuhë tjetër. Arabishtja, si gjuhë e Kur'anit dhe e Hadithit, gëzon respekt dhe nder në shpirt të çdo muslimani, edhe atë jo si

gjuhë arabe, por si gjuhë e Pejgamberit (a.s.), si gjuhë e nënës së muslimanëve, si gjuhë të cilën Vetë Allahu e zgjodhi për të na e Shpallur Fjalën e Tij të fundit.

h) Nevoja e bashkimit të besimtarëve kurrë nuk mund të theksohet sa duhet. Duhet të përgatisim lidhje të reja për përforcimin e vëllazërimit e jo të humbasim atë që veç ekziston.

i) Gjithashtu, mund të përmendim kongreset dhe mbledhjet ndërkombëtare. Kur, p.sh., marrim pjesë në mbledhjet e Kombeve të Bashkuara, nuk mund të zgjedhim mendimin e shprehjeve sipas ekstravagancës dhe animeve, e që do të ishin në kundërshtim me qëllimin e mbledhjes dhe nuk do të kishim mundur të afroheshim me pjesëmarrësit e mbledhjes; patjetër duhet të japim fjalimin që të përkthehet në gjuhët zyrtare të pranuar, frëngjisht e anglisht, dhe askush këtë nuk e kundërshton. Për interesin e përgjithshëm duhet flijuar interesin personal, edhe nëse kohë pas kohe interesi personal humb.

j) Edhe diçka me rëndësi rreth kësaj çështjeje. Në të vërtetë, asnjë përkthim nuk e zëvendëson origjinalin. P.sh. sot ka shumë përkthime të Kur'anit Famëlar-të, në anglisht (siç ka edhe në shumë gjuhë të tjera), mirëpo prapëseprapë paraqitet nevoja e përkthimeve të reja, duke pretenduar që përkthimet e mëparshme pjesërisht kanë të meta. Kjo vlen jo vetëm për anglishten, por për çdo gjuhë të botës, pa marrë parasysh se për çfarë përkthimi është fjala. Atëherë, pra, a të përdorim atë që nuk është komplet, as i përsosur, përkthimin apo origjinalin?

k) Të përmendim edhe këtë, praktikisht asnjë religjion, përveç Islamit, nuk e ka librin (Shpalljen) origjinal ku bazohet. Ajo që kanë të krishterët, hebrenjtë dhe bashkësitë tjera është vetëm përkthim ose vetëm ca fragmente libri. Sa të lumtur janë muslimanët, pasi që vetëm ata e kanë krejtësisht tekstin origjinal të Kur'anit!

1) Aq më shumë, Kur'ani, edhe pse në prozë, përmban cilësitë mahnitëse të poezisë, siç është ritmi, rezonanca, stili i lartë etj.; në atë masë, sa që lëshimi ose shtimi i një germe e prish tekstin, aq sa edhe vargun. Një francez, i cili kishte pranuar fenë islame, sipas profesionit ishte muzikant dhe mendohej të më bindte se në suren e 110-të të Kur'anit është humbur diçka, sepse është: *"Fi dinil-lahi efvaxha. Fe sebbih..."*, që sipas muzikës është e pamundur. Njohuri të pakëta kam rreth Kur'anit, mirëpo pasi që këtu e dija recitimin shumë mirë, kjo më ndihmoi të përgjigjesha: *"Po, leximi i drejtë i tekstit është: 'Fi dinil-lahi efvaxhen-vefeseb-bih...' (n dhe f lidhen, ashtu që pas n vjen v e lehtë, para se të shprehet f në feseb-bih)* Pastaj muzikanti tha: *"Tani po e përsëris fenë time; në përgjigjen tuaj nuk mbeti asfarë zbrazëtie nga pikëpamja e muzikës"*. Proza e Kur'anit është thurur sikur ndonjë poemë. E nëse është ashtu, pse atëherë, pra, atë që është e përsosur ta zëvendësojmë me diçka mesatare?

m) Të mos harrojmë faktin se në tërë namazin ka shumë pak tekst që lexohet. Në fillim lexohet ezani dhe kameti (thirrja) për namaz. Pastaj brenda namazit thuhet *Allahu ekber; Subhane rabbijel adhim, subhane rabbijel a'la*, surja e shkurtër e Fatihasë, dy sure të tjera të shkurtra, ose ajete, *et-tehijjati* dhe merr fund

namazi. E tërë kjo nuk kapërcen më tepër se një faqe, shumicën e së cilës e di çdo musliman dhe ajo ka depërtuar në gjuhët e të gjitha shteteve muslimane, aqsa çdo fëmijë ose fillestar e mëson domethënien e këtyre fjalëve pa kurrfarë mundimi. Me mësimin e këtyre recitimeve, nënkuptohet se namazi nuk është vetëm mënyrë mekanike e pa kuptim.

n) Mendoj se asnjë musliman nuk do t'i kishte kushtuar të njëjtin respekt përkthimit të Kur'anit siç ia kushton origjinalit, të cilin ia Shpalli Allahu Pejgamberit të vet. Për arsye se përkthimin e ka bërë njeriu i rëndomtë e njeriu pa gabime të cilin në këtë rast Allahu e ruajti prej gabimeve.

o) Një student i ri posaçërisht potencon rëndësinë e kuptimit të asaj që shqiptohet. Kur nuk mjaftonin të gjitha dokumentet tjera për ta bindur, i thashë: "Nëse më premtan se rregullisht do të falësh pesë kohët e namazit ditor në gjuhën tënde, do ta lejoj atë". Në atë çast ndërpreu bisedën dhe kurrë më nuk bisedoi rreth kësaj. Me fjalë të tjera, ata që insistojnë në kufizimin e rajonit dhe të kultit për një rajon, ata janë ata që nuk e praktikojnë fare. Besimtari nuk duhet të marrë këshilla prej atyre që nuk i praktikojnë rregullat islame dhe nuk iu besojnë atyre.

p) Më në fund, disa ulema marrin për bazë ca autoritete, siç është Ebu Hanifeja, se leximi i përkthyer lejohet në namaz. Mirëpo, kjo është shumë pak e vërtetë. Këta ulema harrojnë se Ebu Hanifeja, edhe pse në fillim e ka pasur këtë mendim, më vonë e ka ndërruar atë (siç e gjejmë këtë me këmbëngulje te ca nxënës të tij si në Hidaje të El-Marginanisë, Ed-Durr el-Muhr-

at të Haskafiut etj.) dhe ka thënë se namazi duhet të kryhet vetëm në gjuhën e Kur'anit. Zakonisht, për raste të veçanta vlejné rregulla të tjera, siç është rasti tek ata që kanë pranuar fenë: drejtpërsëdrejti ai duhet të falë pesë kohët e namazit dhe duhet të mësojë tekstet e nevojshme përmendsh. Gjersa t'i mësojë këto tekste në mend, ai mund të lexojë kuptimin e tyre në gjuhën e vet. Në lidhje me këtë mjafton të përmendim faktin e Selman Farisiut, i cili përktheu suren e Fatihasë në persishte dhe ua dërgoi atyre që posa kishin pranuar fenë islame. (Më gjerësisht shih në *En-Nihaje Hashijet'ul-hidaje* të Taxh el-Aire).

r) Sipas kësaj, shohim se në përdorimin e gjuhës së huaj në namaz ka të meta dhe dobësi, të cilat mund të hetohen edhe në gjuhët rajonale.

Pse një kalendar i pastër lunar

Shumë mirë dihet se feja islame për ibadetet dhe nevojat fetare për bazë e merr vetëm kalendarin e hënës, ku p.sh. muaji i Ramazanit me agjërimin e vet dhe muaji i Dhul-hixh-xhes me haxhin, gradualisht bien në çdo stinë të vitit. Në Arabinë paraislame pranohej vetëm viti interkalaktik². Pejgamberi (a.s.) e ndërpreu këtë praktikë – mund të thuhet pas shumë shqyrtimeve shumë të shëndosha – në haxhin e tij të fundit, vetëm tre muaj para se të ndërronte jetë. Ky

² Interkalaktik (lat. Interkalare) shtim i mëvonshëm, ndërfitje; shtojcë, ndajshitim. Redaksia.

ndryshim i habitit shumë ata që nuk besonin dhe ata që i mundonte kompleksi inferior dhe donin në mënyrë të verbër të ndiqnin të tjerët. Përveç dobive të tjera që pati kjo reformë islame, do të përmendim tri dobi:

a) Përsa i përket agjërimit, kjo reformë ofron mundësi për çdo stinë të vitit dhe në kushte klimatike të ndryshme të vendeve të ndryshme.

b) Meqë Islami i qe destinuar tërë botës, është dashur të kihen parasysh kushtet e ndryshme klimatike në territore të ndryshme. Nëse agjërimi do të ishte përcaktuar në ndonjë muaj të kalendarit solar, do të thotë në ndonjë stinë të vitit, vetë qëllimi do të kishte qenë i gabuar, si dhe studimet do të kishin qenë të pamundshme të bëheshin. Ndërkaq, gjersa në hemisferën veriore do të kishte qenë verë, në hemisferën jugore do të ishte dimër. Përveç kësaj, dimri konsiderohet i volitshëm në vendet e ekuatorit; në vendet polare do të ishte shumë i vështirë. Kjo pabarabarësi mes besimtarëve të vendeve të ndryshme është shumë me vend e pranueshme për kalendarin lunar: të gjithë gradualisht do ta kemi muajin e Ramazanit në të gjitha stinët e vitit.

c) Zeqati që paguhet në kursime, tregti etj., me përjashtim të zeqatit me bereqete – prodhimet e tokës që varen prej stinës së vitit dhe të korrave, diçka është më i madh, sepse në 33 vjet të kalendarit lunar vijjnë 32 vjet të diellit (solar. Zeqati, pra, paguhet për një vit më shumë. Të përmendim se zeqati merret për dobinë e banorëve të shtetit, posaçërisht për fukarenjtë.

Përfundim

O Zot, mundëso që ky mund të arrijë qëllimin e vet; do të thotë, secili që dëshiron, të mësojë atë që është më me rëndësi në Islam. Për atë që do të dijë më tepër, le të marrë librat e specializuar ose dijetarët me renome dhe institucionet e veçanta, siç është Az'hari në Kajro, Zejtuni në Tunis, Kajrevani në Fes e shumë të ngjashme në Pakistan, Indi etj.

Vall-llahu mustean bi muradihi.

Shënimi i katalogut CIP të këtij libri ndodhet në Bibliotekën Kombëtare Universitare "Shën Kliment Ohridski", Shkup

297

HAMIDULLAH, Muhamed

Hyrje në Islam / Muhamed Hamidullah ; [e përkthyen nga boshnjakishtja Bahri Aliu dhe Neshat Xheladini]. - 2. botim. - Shkup : Logos-A, 2011. - 382 str. ; 21 cm. - (Biblioteka Botime të veçanta)

Превод на делото: Uvod u islam / Muhamed Hamidullah

ISBN 978-9989-58-385-8

а) Ислам

COBISS.MK-ID 89018122



LOGOS-A

Copyright©Logos-A, 2011

www.logos-a.com.mk